

Fluturat e Shqipërisë

Bukuria e natyrës shkruar në krahë

Anila Paparisto = Sylvain Cuvelier

Xhuliana Qirinxhi Eltjon Halimi

Tirana, 2026

Fluturat e Shqipërisë

Bukuria e natyrës shkruar në krahë

Anila Paparisto = Sylvain Cuvelier

Xhuliana Qirinxhi Eltjon Halimi

Tirana, 2026

FLUTURAT E SHQIPËRISË

Monografi Shkencore: financuar nga **AKKSHI** në kuadër të Projektit **PKKZH 2024** "*Hartimi Modeleve Inovative të Konservimit të Biodiversitetit Bazuar në Studimin e llojeve Lepidoptera me Metodën Bashkëkohore për Vlerësimin e Madhësisë dhe Dinamikës dhe Popullatave MRR (Mark – Release – Recapture)*"

Autorë:

Anila Paparisto, *Prof. Dr., Universiteti i Tiranës* = ***Sylvain Cuvelier,*** Dr., Chief Editor of Archives of Western Palearctic Lepidoptera

Xhuliana Qirinxhi, *Dr., Universiteti "Fan. S. Noli" Korçë*

Eltjon Halimi, *Prof. Asoc. Dr., Universiteti i Tiranës*

Reçesent:

Bledar Pepa, *Prof. Asoc. Dr. Universiteti Bujqësor i Tiranës*

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara dhe të mbrojtura sipas Ligjit Nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to". Nuk lejohet shumëfishimi me çdo mjet apo formë tjetër pa lejen e autorëve

ISBN: 9789928869524

Shtypur në Republikën e Shqipërisë
Shtypshkronja……., Tiranë

Tirazhi: kopje



Ky libër i dedikohet Prof. Dr. Kastriot Misjes, për pasionin, dashurinë dhe një jetë të tërë që ua kushtoi fluturave

Hyrje

Fluturat janë një nga thesaret më delikate të natyrës. Me ngjyrat e tyre të ndritshme, fluturimin e lehtë dhe format elegante, ato nuk janë vetëm simbole të bukurisë dhe lirisë, por edhe tregues të ndjeshëm të shëndetit të ekosistemeve ku jetojnë. Çdo specie përfaqëson një histori evolucioni, një rrjet të ndërlikuar marrëdhëniesh ekologjike dhe një pasuri të jashtëzakonshme biologjike, të cilën Shqipëria ka privilegjin ta ruajë.

Ky botim nuk është vetëm një përmbledhje taksonomike.

Ai është një udhëtim vizual dhe shkencor në botën e fluturave të ditës të Shqipërisë, një mundësi për të kuptuar se si speciet me ngjyrat, modelet dhe sjelljet e tyre kanë mbijetuar për të shkëlqyer në peizazhet unike shqiptare. Nga ultësirat e luginave të gjelbra deri në majat e maleve krenare mbi 2,000 metra mbi nivelin e detit, fluturat janë dëshmitare të ndryshimeve të natyrës dhe të ndikimeve njerëzore në mjedis. Përmes këtij botimi, lexuesi ftohet të zbulojë jo vetëm llojet e fluturave, por edhe faktin se çdo specie është një histori në vetvete, një ftesë për të kuptuar rolin e saj në natyrë dhe rëndësinë e mbrojtjes së biodiversitetit.

Në një kohë kur mjedisi natyror ndryshon shpejt dhe disa specie rrezikohen, ky botim synon të frymëzojë kuriozitet, të thellojë njohuritë shkencore dhe të krijojë një lidhje më të fortë mes njeriut dhe natyrës.

Ai është një thirrje për vëmendje, por edhe një ftesë për të admiruar dhe përjetuar mrekullitë e fluturave të ditës, këto krijesa të bukura dhe të brishta, që mbajnë brenda tyre mesazhe të thella për jetën dhe për ruajtjen e ekosistemeve dhe pasurisë natyrore të vendit tonë.

Konsiderata për studimin e Lepidoptera në Shqipëri

Studimi i Lepidoptera në Shqipëri ka një histori të gjatë, që nis nga fillimi i shekullit të 20-të, por shpesh i fragmentuar dhe i shpërndarë në kohë dhe hapësirë. Që nga fillimi, entomologë vendas dhe të huaj kanë kontribuar në dokumentimin e specieve dhe në pasurimin e njohurive mbi shpërndarjen dhe nevojat ekologjike të tyre (Cuvelier et al., 2018, 2023, 2025). Megjithatë, pjesa më e hershme e literaturës mbetet kryesisht punë e autorëve të huaj, ndërsa kontributi vendas ka nisur të strukturohet vetëm disa dekada më vonë. Publikimet e para për fluturat e Shqipërisë datojnë nga viti 1900 me Lord Walter Rothschild, entomolog dhe koleksionist anglez, ndërsa një përmbledhje e të dhënave deri në vitin 1913 u bë nga REBEL H (Misja, 2005). Një hap tjetër i rëndësishëm u hodh në vitin 1918 kur Akademia Austriake e Shkencave organizoi një ekspeditë lepidopterologjike në Shqipërinë e Veriut. Materiali i grumbulluar, i publikuar nga REBEL H. dhe ZERNY H. në vitin 1931, përfshinte

mbi 900 lloje, prej të cilave 500 të reja për faunën shqiptare (Rebel et al., 1931). Pas kësaj, ekspedita e vitit 1961 nga Instituti Entomologjik Gjerman solli përditësime të rëndësishme për faunën lokale (Eichler et al., 1965; Urbahn, 1966).

Për shumë dekada, studimet mbetën kryesisht të fragmentuara, duke u bazuar në përpjekje individuale dhe ekspedita të rastësishme. Kjo shpesh ka krijuar boshllëqe në informacionin për shpërndarjen dhe statusin e specieve, duke vënë në pah nevojën për një qasje më sistematike.

Entomologu i parë shqiptar që hapi një fazë të re të studimeve ishte Murraj (1972), i cili publikoi një listë me 93 specie dhe një çelës identifikimi, përfshirë regjistrime të para për Shqipërinë si *Carterocephalus palaemon, Heteropterus morpheus, Muschampia tessellum, Coenonympha glycerion, Melanargia lachesis dhe Melitaea aurelia*.

Në vitin 1972, filloi një periudhë më e strukturuar kërkimesh me ngritjen e fondit shkencor pranë Muzeut të Shkencave Natyrore, nën drejtimin e Prof. Kastriot Misja. Kërkimet në terren dhe përmbledhjet e punimeve të Prof. Misja për familjet Noctuidae, Geometridae dhe grupet Heteroneura, Rhopalocera dhe Gypocera, kontribuan në dokumentimin e sistematik të faunës shqiptare të fluturave (Misja, 1977, 1978, 1980; Misja & Kurrizi, 1984; Misja, 1990). Lista e specieve u përditësua nga Misja dhe Kurrizi (1984) duke përfshirë 180 lloje, ndërsa gjetje të reja për vendin u shtuan më vonë, përfshirë *Danaus chrysippus* (Linnaeus, 1758), *Euphydryas maturna*, *Satyrus actaea* dhe *Pseudochazara mamurra* (Verovnik & Popović, 2013). Pas viteve 1990, kërkime të reja dhe bashkëpunime ndërkombëtare çuan në zgjerimin e njohurive për lepidopterofaunën shqiptare (Beshkov et al., 1995; Misja et al., 2005; Verovnik et al., 2013). Një hap vendimtar erdhi në vitin 2005, kur Prof. Misja publikoi hartat e para të shpërndarjes për fluturat shqiptare. Në vitin 2018 u publikua një artikull rishikues dhe atlasi përkatës me hartat e reja të shpërndarjes (Cuvelier *et al.*, 2018). Nga përditësimet rezulton se Shqipëria ka regjistruar sot 209 lloje fluturash të ditës, nga 442 lloje që raportohen në botimin e vitit 2025 të listës së Kuqe të fluturave Evropiane (Van Swaay, C., Warren, M., Ellis, S., Clay, J., Bellotto, V., Allen, D.J. and Trottet, A. (2025). Measuring the pulse of European biodiversity using the Red List. European Red List of Butterflies. Brussels, Belgium: European Commission. doi.or/10.2779/935927). Parashikimt dhe vlerësimet tona janë që në Shqipëri ka një potencial për të zbuluar sërisht edhe 10–15 lloje të tjera fluturash të ditës(Cuvelier et al., 2022, 2023).

Në këtë kontekst, është krijuar edhe platforma online "**Fluturat e Shqipërisë – Butterflies of Albania**", nga Sylvain Cuvelier dhe Anila Paparisto, një bashkëpunim i suksesshëm midis entomologëve belgë dhe Universitetit të Tiranë (https://biodiversity.unitir.edu.al/). Platforma ofron të dhëna taksonomike, përshkruese, fotografi dhe koordinata gjeografike, duke mundësuar përditësime të vazhdueshme dhe duke vendosur një standard të ri për dixhitalizimin e informacionit mbi biodiversitetin shqiptar. Nga viti 2017 e deri sot, përparimet kanë qenë të dukshme. Monitorimi sistematik gjithëvjetor për gati tetë vjet dhe

përdorimi i platformës online kanë reduktuar shumë nga sfidat historike: regjistrimet janë më të plota, shpërndarja e specieve dhe statusi i ruajtjes dokumentohen më saktë dhe informacioni ekologjik është më i përditësuar.

Pavarësisht përmirësimeve, puna vazhdon, duke përfshirë evidentimin e specieve të reja dhe monitorimin e ndryshimeve të biodiversitetit në kohë reale.

Ky botim synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të përmbledhur të fluturave të ditës në Shqipëri, duke ndërthurur qasjen shkencore me një prezantim të kuptueshëm për lexuesin e gjerë, duke pasqyruar trashëgiminë historike të studimeve, gjetjet më të reja dhe potencialin për zbulime të reja. Ai mund të shërbejë si një udhërrëfyes i besueshëm për kërkime të mëtejshme dhe për ruajtjen e këtij grupi të jashtëzakonshëm të biodiversitetit shqiptar.

Metodika e grumbullimit në terren

Grumbullimi i fluturave të ditës në terren kryhet kryesisht duke përdorur **rrjeta entomologjike ajrore**, një rrjetë e hollë me krah të lehtë që mundëson kapjen e fluturave pa i dëmtuar. Kjo metodë lejon grumbullimin e individëve në livadhe, kopshte, pyje të hapur dhe zona shkëmbore, duke mbuluar një spektër të gjerë habitatësh nga ultësirat deri në lartësitë alpine.

Përveç kapjes aktive, vëzhgimi dhe fotografimi i fluturave në habitatin natyror përdoren për të dokumentuar sjelljen, ngjyrat dhe modelet karakteristike pa marrë individët. Kombinimi i këtyre metodave siguron të dhëna të plota mbi shpërndarjen, dendësinë dhe preferencat ekologjike të specieve. Grumbullimi kryhet gjatë ditës dhe në kushte moti të favorshme – temperaturë e lartë, diell dhe mungesë erë të fortë – pasi fluturat janë më aktive gjatë këtyre orëve.

Gjatë kapjes regjistrohet gjithmonë koha, vendndodhja, lartësia mbi nivelin e detit dhe bimët e pranishme, duke mundësuar analizën e shpërndarjes së specieve në lidhje me faktorë mjedisorë dhe ndërtimin e hartave të detajuara të biodiversitetit të fluturave të ditës në Shqipëri.


Ngritja, konservimi dhe përcaktimi

Pas kapjes në terren, fluturat e ditës trajtohen me kujdes të veçantë për të ruajtur ngjyrat, strukturën dhe modelet karakteristike të flatrave. Një nga hapat kryesorë është **ngritja e insekteve për formimin e koleksioneve entomologjike**, një procedurë që siguron që specimenët të ruhen në pozicion të natyrshëm dhe të jenë të përdorshëm për studime shkencore. Në praktikë, flutura vendoset mbi tavolina të posaçmde prej bukpeshku/shkumë ose druri të butë me një kanal në mes, ndërsa flatrat dhe trupi mbahen të fiksuara me pinca të holla dhe gjilpëra të posaçme derisa të thahet plotësisht. Kjo ruan ngjyrat dhe modelin e flatrave dhe e bën specien të identifikueshme për studime taksonomike dhe krahasime morfologjike.



Për konservimin afatgjatë, speciet e ngritura vendosen në kuti entomologjike koleksioni, ku duhet të rruhen në kushte të thata dhe të mbrojtura nga drita e fortë, lagështia dhe insekte dëmtuese. Kjo mundëson ruajtjen e tyre për dekada, duke i bërë të vlefshëm si burim të dhënash për studime sistematike, ekologjike dhe biogeografike.





Përcaktimi taksonomik i fluturave të ditës bëhet duke krahasuar karakteristikat morfologjike të specieve me përshkrimin në çelësat identifikues si dhe botimet shkencore ekzistuese. Mes karakteristikave identifikuese përdoren karakteristika të dukshme si ngjyra, modeli i flatrave, forma e trupit dhe shenja karakteristike të llojit. Kur është e nevojshme, përdoren edhe fotografi të specieve për të verifikuar ngjashmëritë me materialin ekzistues dhe për të siguruar saktësinë e përcaktimit.

Metodologjia e përshkruar garanton që fluturat e ditës të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të kontribuojnë në **njohjen dhe ruajtjen e biodiversitetit shqiptar**, duke siguruar që çdo specie të ofrojë informacion të vlefshëm për studime të ardhshme shkencore. Pas grumbullimit dhe dokumentimit të specieve, të dhënat strukturohen dhe analizohen për të krijuar një pasqyrë të shpërndarjes të specieve. Çdo specie pasi emërtohet regjistrohet

në bazën e të dhënave bashkëshoqëruar me informacion të detajuar mbi datën, vendndodhjen/koordinatat, habitatin, bimësinë dhe kushtet mjedisore në të cilat ajo është grumbulluar. Kjo lejon krijimin e një baze të dhënash të qëndrueshme, që shërben për hartat e shpërndarjes dhe për analizat ekologjike.

2.2 Analizimi të dhënave për Lepidoptera

Hartimi i hartave: Hartat e shpërndarjes së specieve të fluturave të ditës përgatiten duke përdorur koordinatat GPS të lokaliteteve të ku fluturat janë grumbulluar në terren. Çdo pikë në hartë përfaqëson një regjistrim të besueshëm të pranisë së specieve, duke lejuar identifikimin e arealeve ku llojet janë të përhapura, si dhe zonat potenciale ku mund të gjenden.

Analiza e arealeve: Speciet klasifikohen sipas shpërndarjes së tyre në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Kjo lejon vlerësimin e dendësisë së popullatave, identifikimin e zonave me biodiversitet të lartë dhe përcaktimin e habitatëve kyç për ruajtjen e specieve të rrezikuara. Për disa flutura, analiza tregon se arealet e shpërndara mund të jenë të lidhura ngushtë me llojet specifike të bimëve pritëse dhe kushtet mikroklimatike.

Vlerësimi i statusit të ruajtjes: Duke kombinuar të dhëna historike dhe monitorime të vazhdueshme, përcaktohen trendet e popullatave dhe statusi i ruajtjes sipas kritereve të IUCN. Kjo siguron informacion të rëndësishëm për masat e menaxhimit dhe ruajtjes së biodiversitetit.

Përdorimi i teknologjive dixhitale: Platforma “Fluturat e Shqipërisë – Butterflies of Albania” ka mundësuar integrimin e të dhënave në një sistem të përbashkët dixhital. Të dhënat e grumbulluara dhe të përpunuara në këtë mënyrë lehtësojnë analizat statistike, vizualizimin e shpërndarjes dhe krahasimet ndërvite. Kjo qasje përmirëson ndjeshëm kuptueshmërinë e ndryshimeve ekologjike duke u mundësuar studiuesve dhe politikëbërësve një bazë shkencore të dhënash për planifikimin e masave të konservimit të bazuara në evidenca shkencore.

***Iphiclides podalirius* /Scarce Swallowtail**
Flatrabishtori podalir
Papilionidae – Papilioninae





***Iphiclides podalirius*, dhe harta e shpërhapjes**

Iphiclides podalirius është një flutur e madhe dhe elegante, lehtësisht e dallueshme nga ngjyrosja e saj karakteristike. Mashkulli ka një gjatësi të flatrave të përparme prej 32–40 mm dhe paraqitet me një sfond të verdhë të zbehtë në gjeneratën e parë dhe krem të bardhë në të dytën, të dyja të shënuara me vija të zeza tërthore që vazhdojnë edhe në flatrat e pasmë. Femra është e ngjashme, por zakonisht më e madhe. Specia është e qartë në identifikim dhe nuk ngatërrohet lehtë me të tjera.
Zhvillon dy deri në tre gjenerata në vit, në varësi të kushteve mjedisore. Faza e vezës zgjat 6–10 ditë, ajo e larvës 27–45 ditë, ndërsa pupa 13–22 ditë ose shumë më gjatë në individët që dimërojnë. Larvat e hershme imitojnë jashtëqitjet e zogjve për kamuflazh, ndërsa më vonë bëhen të gjelbra dhe përshtaten me mjedisin.
Kjo flutur preferon zona të ngrohta dhe kodrinore, shpesh në pemishte dhe hapësira të hapura me shkurre, nga ultësirat deri në rreth 2000 m. Është mesatarisht e zakonshme dhe me aftësi të mira fluturimi, duke përfshirë lëvizje në distanca të gjata. Larvat ushqehen kryesisht me bimë të familjes Rosaceae, veçanërisht me specie të gjinisë *Prunus*, por edhe me *Cotoneaster*, *Crataegus, Malu* dhe *Sorbus aucuparia*, ndërsa të rriturit thithin nektar nga shumë bimë me lule. Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht, ajo gjendet në të gjithë rajonin e Ballkanit, si dhe në pjesën më të madhe të Evropës dhe më tej drejt Azisë. Konsiderohet specie me shqetësim të ulët si në Shqipëri ashtu edhe në vlerësimet e IUCN-së për Evropën dhe aktualisht nuk paraqitet në rrezik për zhdukje. *Iphiclides podalirius* është e listuar si LC në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe të IUCN-së për zonën Evropiane.

***Papilio alexanor* / Southern Swallowtail**
Flatrabishtori aleksanor
Papilionidae – Papilioninae





***Papilio alexanor*, dhe harta e shpërhapjes**

Papilio alexanor është një flutur e madhe dhe tërheqëse, me gjatësi të flatrave të përparme 31–33 mm. Mashkulli ka ngjyrë të verdhë të ndritshme me shenja të zeza dhe katër vija të zeza tërthore në flatrat e përparme; ana e poshtme paraqet model të ngjashëm. Femra është shumë e ngjashme, por zakonisht më e madhe. Lloji mund të ngatërrohet me *Papilio machaon*. Specia zhvillon një gjeneratë në vit, me të rritur që shfaqen nga prilli deri në korrik. Vezët vendosen zakonisht menjëherë pas çiftëzimit dhe faza e tyre është e shkurtër. Zhvillimi larvor zgjat rreth 30 ditë; larva fillimisht është e errët pa model të qartë, më pas zhvillon pika të zeza dhe në stadin përfundimtar shenja portokalli. Dimërimi kryhet në fazën e pupës, e vendosur në shkëmbinj ose çarje. *Papilio alexanor* banon në zona të nxehta, ku livadhet me lule dhe shkurret e shpërndara ndërthuren me hapësira të hapura me zhavorr, brigje ose terrene shkëmbore, nga ultësirat bregdetare deri në rreth 2300 m mbi nivelin e detit. Lloji ka kërkesa të larta për hapësirë, në kushte të favorshme, mund të arrijë dendësi të lartë popullate; individë të shpërndarë mund të vërehen edhe në lartësi të mëdha drejt fundit të periudhës së fluturimit. Larvat ushqehen me bimë të familjes Apiaceae, si: *Falcaria vulgaris, Ferula communis, Foeniculum vulgare, Opopanax, Pastinaca sativa, Pimpinella saxifraga, Scaligeria cretica, Seseli montanum* dhe *Trinia glauca*, ndërsa të rriturit ushqehen me nektarin e shumë llojeve të luleve të mëdha. Në Shqipëri, kjo specie është lokale, ndërsa në Ballkan gjendet në disa vende. Shtrirja e saj përfshin gjithashtu pjesë të ndryshme të Evropës dhe vazhdon në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi dhe më tej drejt lindjes. Për sa i përket statusit të ruajtjes, *Papilio alexanor* klasifikohet si VU dhe konsiderohet specie e kërcënuar, ndërsa në nivel rajonal evropian klasifikohet si NT.

***Papilio machaon*/Swallowtail**
Flatrabishtori makaon
Papilionidae – Papilioninae






***Papilio machaon*, dhe harta e shpërhapjes**

Papilio machaon është një flutur e madhe dhe e dallueshme, me një gjatësi të flatrave të përparme te mashkulli prej 32–38 mm. Flutura ka një ngjyrë të verdhë të zbehtë me shenja të zeza të theksuara, ndërsa në gjeneratën e dytë ngjyra bëhet krem duke ruajtur të njëjtin model. Flatrat e përparme kanë gjashtë vija të zeza tërthore që pasqyrohen edhe në flatrat e pasmë, ndërsa në anën e poshtme dallohen shenja të zeza dhe një njollë blu më pak e theksuar. Femra është e ngjashme, por zakonisht më e madhe. Mund të ngatërrohet me *Papilio alexanor*. Lloji zhvillon dy deri në tre gjenerata në vit dhe ka një jetëgjatësi relativisht të gjatë. Vezët vendosen pak ditë pas çiftëzimit dhe zhvillohen për 5–12 ditë, ndërsa faza e larvës zgjat 22–36 ditë. Larvat e hershme imitojnë jashtëqitjet e zogjve, ndërsa më vonë bëhen të gjelbra me vija të zeza dhe pika portokalli. Pupa dimëron e fiksuar në degë ose gurë, ndërsa gjatë sezonit zhvillimi zgjat 13–22 ditë. Kjo specie gjendet në një gamë të gjerë habitatesh me bar dhe lule, nga kopshte dhe livadhe deri në zona malore deri në rreth 2000 m. Ka kërkesa të larta për hapësirë dhe është një flutur nomade, e aftë për lëvizje në distanca të gjata. Larvat ushqehen kryesisht me bimë të familjes Apiaceae, ndërsa të rriturit me nektarin e shumë luleve. Në Shqipëri kjo specie është e përhapur gjerësisht, dhe gjendet në gjithë Ballkanin. Shtrirja e saj përfshin gjithashtu pjesë të ndryshme të Evropës dhe vazhdon deri në Azinë e Vogël. Statusi i ruajtjes në Shqipëri është rregjistruar si VU B2b, ndërsa në nivel rajonal Evropian klasifikohet si NT A2c

***Parnassius apollo*/Apollo**
Apollonja/flokëbora e Apollos
Papilionidae – Papilioninae





***Parnassius apollo*, dhe harta e shpërhapjes**

Parnassius apollo është një flutur e madhe me gjatësi flatrave të përparme 35–42 mm. Mashkulli shfaq shenja të bardha me pika të zeza dhe njolla të kuqe të rrethuara nga një unazë kontrastante në anën e sipërme, ndërsa ana e poshtme ka ngjyrosje dhe model të ngjashëm. Femra i ngjan shumë mashkullit, por zakonisht është më e madhe. Kjo specie nuk ka lloje të ngjashme të njohura. Lloji zhvillon një brez në vit, me një jetëgjatësi të të rriturve rreth 2–3 javë. Periudha e fluturimit shtrihet nga fillimi i qershorit deri në fund të gushtit, duke u ndryshuar sipas lartësisë dhe klimës lokale. Vezët dimërojnë me larvën plotësisht të zhvilluar brenda tyre, të ngjitura në gurë, degë ose objekte të tjera për t'u mbrojtur gjatë dimrit. Larvat çelin në pranverë, ushqehen për rreth 10 javë, ato janë me ngjyrë të zezë me njolla portokalli dhe blu dhe kanë një organ mbrojtës që lëshon erë kur kafsha ndjehet e kërcënuar. Pupa zhvillohet për 14–25 ditë. Kjo specie banon në vende shkëmbore me bimësi të rrallë nga 700 deri në 2200 m mbi nivelin e detit. Kërkesa për hapësirë është e lartë dhe dendësia e popullatës mund të jetë e madhe. Meshkujt qëndrojnë fillimisht të lidhur me habitatin, ndërsa më vonë mund të sillen si endacakë; femrat kanë një stil jetese më nomade. Larvat ushqehen me bimë të familjes Crassulaceae, veçanërisht *Sedum album*, si dhe *Sedum telephium, Rhodiola rosea* dhe *Sempervivum*. Të rriturit marrin nektar nga lule të mëdha, por edhe nga bimët e tyre pritëse si *Sedum album*. Në Shqipëri kjo specie është lokale, ndërsa shtrirja e saj përfshin Ballkanin, pjesë të Evropës dhe më tej në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi dhe Kaukaz. Statusi i ruajtjes në Shqipëri është (LC), dhe në nivel rajonal Evropian klasifikohet si (LC).

***Driopa mnemosyne* / Clouded Apollo**
Mnemosinja
Papilionidae – Parnassiinae





***Driopa mnemosyne*, dhe harta e shpërhapjes**

Driopa mnemosyne është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 26–31 mm te mashkulli. Ka një ngjyrë bazë të bardhë pa njolla të kuqe, me dy pika të zeza në flatrat e përparme dhe një kufi të gjerë gri margjinal, ndërsa pjesa e poshtme paraqet një model të ngjashëm. Femra është e ngjashme, por zakonisht më e madhe dhe me shenja më të gjera, shpesh me ngjyrim gri të errët, si dhe mban një vulve seksuale të zhvilluar. Mund të ngatërrohet me *Aporia crataegi*. Lloji zhvillon një brezni në vit. Lloji fluturon nga fundi i prillit në ultësira dhe deri në korrik në lartësi më të mëdha Faza e vezës dimëron me një larvë të zhvilluar plotësisht brenda saj. Vemja zhvillohet me shpejtësi, dhe faza e pupës është relativisht e shkurtër. Kjo specie banon në livadhe dhe lëndina me lule në pyje gjetherënëse dhe të përziera, si dhe në shpate malore deri në zona alpine nga rreth 450 deri në 2200 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa të larta për hapësirë; edhe pse dendësia e popullsisë mund të jetë e lartë, individët endacakë shpesh shfaqen në fund të sezonit të fluturimit. Larvat ushqehen kryesisht me bimë të gjinisë *Corydalis*, përfshirë *Pseudofumaria alba*, ndërsa të rriturit vizitojnë një gamë të gjerë lulesh. Në Shqipëri është specie lokale, por e përhapur në të gjithë Ballkanin dhe në pjesë të mëdha të Evropës, si dhe më tej në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt dhe Kaukaz. Statusi i ruajtjes në Shqipëri është (LC), dhe në nivel rajonal Evropian klasifikohet si (LC).

***Allancastria cerisyi* /Eastern Festoon**
Cerisja
Papilionidae – Parnassiinae





***Allancastria cerisyi*, dhe harta e shpërhapjes**

Allancastria cerisyi është flutur me madhësi mesatare, me pamje të dallueshme. Mashkulli ka gjatësi të flatrave të përparme prej 26–31 mm me krahët me sfond të verdhë të zbehtë, të shënuar me njolla të zeza anësore dhe post-diskale në flatrat e përparme. Flatrat e pasmë kanë shenja post-diskale të vogla, të kuqe dhe njollë të kuqe në segmentin 7. Pjesa e poshtme e flatrave është e ngjashme në model dhe ngjyrosje. Femra është e ngjashme, por zakonisht me shenja më të theksuara me ngjyrë të zezë në krahët e saj. Specia është lehtësisht e identifikueshme dhe nuk ngatërrohet me lloje të tjera. Kjo flutur ka 1 brezni në vit, shfaqet në fillim të pranverës në lartësi të ulëta, ndërsa në zonat në lartësi më të mëdha periudha e fluturimit fillon më vonë dhe zgjatet deri në fund të qershorit ose fillim të korrikut. Faza e vezës e shkurtër, ndërsa larva zhvillohet me shpejtësi. Pupëzimi ndodh nën gurë, çarje ose bazën e trungjeve të pemëve. Lloji dimëron në fazën e pupës. Banon në habitate gjysmë të hapura, shpesh në ullishte, përgjatë kanaleve ujitës dhe në zona të kultivuara pranë vendbanimeve. Në lartësi më të mëdha gjendet në kullota me lule. Kjo flutur takohet nga ultësira bregdetare deri në rreth 1500 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa të moderuara për hapësirë dhe mund të arrijë dendësi të lartë popullate. Në fund të periudhës së fluturimit, individë endacakë mund të gjenden larg habitateve të tyre tipike. Larvat ushqehen me specie të gjinisë *Aristolochia*, të rriturit marrin nektar nga lule të ndryshme pranverore. Në Shqipëri është lokal, pjesërisht për shkak të periudhës së kufizuar të fluturimit. Shqipëria është kufirit verior i arealit të saj në Ballkan. E përhapur në shumicën e Gadishullit Ballkanik, më gjerë në pjesën më të madhe të Evropës, Azinë e Vogël dhe Lindjen e Afërt. Specia në Shqipëri klasifikohet si (NT) dhe në nivel Evropian vlerësohet si (LC).

Zerynthia polyxena / Southern Festoon
Poliksenia
Papilionidae – Parnassiinae





***Zerynthia polyxena*, dhe harta e shpërhapjes**

Zerynthia polyxena është një flutur me madhësi mesatare, e dallueshme nga ngjyrosja e saj e verdhë me kontraste të forta të zeza dhe të kuqe. Mashkulli ka një gjatësi të flatrave të përparme prej 23–26 mm, me shenja të zeza tërthore, një njollë të vogël të kuqe pranë skajit flatrave të përparme dhe hënëza margjinale të theksuara. Flatrat e pasmë karakterizohen nga një seri njollash të kuqe të shoqëruara me hënëza të dallueshme, ndërsa në anën e poshtme këto shenja janë më të theksuara. Femra është e ngjashme me mashkullin në pamje.
Ky lloj zhvillon një brezni në vit, me të rritur që fluturojnë nga fundi i marsit deri në maj. Faza e vezës është e shkurtër, larva zhvillohet me shpejtësi dhe më pas kalon në pupë, e cila dimëron. Kjo specie banon në zona të thata, të hapura dhe shkëmbore nga ultësirat deri në rreth 900 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa të ulëta për hapësirë dhe shpesh formon popullata me dendësi të lartë, pasi individët qëndrojnë pranë habitatit të tyre. Larvat ushqehen me bimë të gjinisë *Aristolochia*, ndërsa të rriturit vizitojnë lule të ndryshme pranverore për nektar.
Në Shqipëri është specie lokale. Gjendet në të gjithë rajonin e Ballkanit dhe në një pjesë të madhe të Evropës, duke u shtrirë më tej edhe në Azinë e Vogël dhe deri në rajonet perëndimore të Azisë Qendrore. Specia kërcënohet nga aktivitetet njerëzore, veçanërisht ndryshimet në përdorimin dhe menaxhimin e tokës. Në Shqipëri klasifikohet si e cenueshme VU B2a, ndërsa në nivel Evropian vlerësohet si lloj me shqetësim të ulët LC.

***Gegenes nostrodamus* /Mediterranean Skipper**
Evropianja njollabardhë
Hesperiidae – Hesperiinae





***Gegenes nostrodamus*, dhe harta e shpërhapjes**

Gegenes nostrodamus është një flutur e vogël dhe diskrete, me një gjatësi të flatrave të përparme te mashkulli 15–16 mm. Paraqitet me një ngjyrë kafe të zbehtë, pothuajse pa shenja në anën e sipërme, ndërsa pjesa e poshtme e flatrave të pasmë është kafe në ngjyrë rëre, me një model tipik në pjesën e poshtme që ndihmon në identifikim. Flatrat e përparme në anën e poshtme kanë luspa të dendura kafe të errëta, shpesh të mbuluara nga një tufë qimesh përgjatë skajit anësor, të cilat kur janë të pranishme përbëjnë një tipar të rëndësishëm dallues. Femra është pak më e madhe dhe paraqet një seri njollash të zbehta diskale në anën e sipërme, ndërsa pjesa e poshtme është e ngjashme me atë të mashkullit. Ky lloj mund të ngatërrohet me *Gegenes pumilio*.
Kjo specie banon në mjedise të nxeta, të thata dhe shpesh shkëmbore ose ranore, zakonisht pranë bregdetit ose lumenjve të mëdhenj, nga ultësirat deri në rreth 500 m mbi nivelin e detit, dhe rrallë deri në 1000 m. Ka kërkesa modeste për hapësirë, por është e aftë të lëvizë në distanca të konsiderueshme, megjithëse zakonisht paraqitet me dendësi të ulët popullate. Larvat ushqehen me një gamë të gjerë barërash, ndërsa të rriturit vërehen rrallë duke u ushqyer.
Në Shqipëri është specie lokale dhe gjendet në të gjithë rajonin e Ballkanit, si dhe në një pjesë të madhe të Evropës, duke u shtrirë më tej në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt dhe rajone të tjera më lindore. Në Shqipëri klasifikohet si pothuajse e kërcënuar (NT), ndërsa në nivel Evropian vlerësohet si me shqetësim të ulët (LC).

***Gegenes pumilio*/Pigmy Skipper**
Pumilia
Hesperiidae–Hesperiinae





***Gegenes pumilio*, dhe harta e shpërhapjes**

Gegenes pumilio është një flutur e vogël me pamje të thjeshtë. Mashkulli ka një gjatësi flatrave të përparme rreth 14 mm dhe paraqitet me ngjyrë shumë të errët kafe në pjesën e sipërme. Pjesa e poshtme është gri-kafe e zbehtë dhe karakterizohet nga tipari Lorković, me luspa të dendura kafe të errëta në flatrat e përparme. Femra është pak më e madhe, me njolla të zbehta diskale, ndërsa pjesa e poshtme është e ngjashme. Mund të ngatërrohet me *Gegenes nostrodamus*.
Lloji zhvillon dy ose më shumë gjenerata në vit dhe fluturon nga prilli deri në tetor. Faza e vezës është e shkurtër, larva zhvillohet ngadalë dhe dimëron, ndërsa faza e pupës është e shkurtër. Banon në mjedise të nxehta dhe të thata, kryesisht në zona shkëmbore ose ranore, nga ultësirat deri rreth 250 m, më rrallë deri në 1000 m. Është më e zakonshme në zonat bregdetare dhe në lugina me bimësi të rrallë. Larvat ushqehen me barëra rezistente ndaj thatësirës, ndërsa të rriturit rrallë vërehen duke u ushqyer. Në Shqipëri është specie lokale. Në Ballkan është e përhapur gjerësisht dhe më tej shtrihet në Evropë, Azinë e Vogël dhe Lindjen e Afërt. Specia klasifikohet si NT në Shqipëri dhe LC në nivel Evropian.

***Pelopidas thrax* / Millet Skipper**
Shpejtakja-njollavogla e zbehtë
Hesperiidae–Hesperiinae





***Pelopidas thrax*, dhe harta e shpërhapjes**

Pelopidas thrax është flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme 15–16 mm. Te meshkujt, ana e sipërme ka ngjyrë bazë kafe të errët. Në krahët e përparmë ka njolla të tejdukshme (hialine) të dallueshme dhe 1 sex-brand të dukshëm. Ana e poshtme është më e çelur, ndërsa në krahët e përparmë të poshtëm njollat hialine mbeten të dallueshme. Femrat janë pak më të mëdha se meshkujt. Ana e sipërme ka ngjyrë bazë kafe më të çelur. Në krahët e përparmë ka njolla hialine të dallueshme, pak më të mëdha se te meshkujt. Në krahët e pasmë nga sipër ka 2–3 njolla të vogla hialine. Ana e poshtme është më e çelur dhe në krahët e përparmë të poshtëm njollat hialine janë të dallueshme dhe pak më të mëdha se te meshkujt. Specie të ngjashme: *Gegenes nostrodamus* dhe *Gegenes pumilio*. Meshkujt e të dy llojeve *Gegenes* nuk kanë sex-brand. Ana e sipërme dhe e poshtme e krahëve në këto lloje nuk ka njolla të çelura ose kanë vetëm njolla të vogla të zbehta. Cikli jetësor dy brezni, nga maji në qershor dhe nga shtatori në nëntor. Specia është më e zakonshme në fund të verës dhe gjatë vjeshtës. Veza ka me gjasë një stad të shkurtër. Zhvillimi i larvës varet nga breznia. Pupa ka stad të shkurtër. *P. thrax* banon në zona me kallamishte, shpesh në shtretër lumenjsh pjesërisht të tharë. Është shumë lëvizëse në kërkim të nektarit, shpesh gjendet në kopshte dhe parqe. Njihet vetëm nga lokalitete të ultësirës. Kërkesat hapësinore të vogla, megjithëse mund të përshkojë distanca të konsiderueshme; dendësia e popullatës e ulët. Larvat ushqehen me barëra të gjinisë *Arundo*, *Oloptum miliaceum*, *Phragmites* dhe *Tripidium*. Fluturat janë vërejtur të ushqehen me nektar në lule të ndryshme zbukuruese kopshte dhe parqe. Rregjistruar në Shqipëri. Ballkan dhe Evropë shpërndarje të gjerë. Gjithashtu në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Gadishullin Arabik dhe më tej në lindje. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet si NE. Në Listën e Kuqe të IUCN-së, si NA.

***Hesperia comma*/Silver-spotted Skipper**
Komma
Hesperiidae–Hesperiinae





***Hesperia comma*, dhe harta e shpërhapjes**

Hesperia comma është një flutur e vogël me pamje lehtësisht të dallueshme. Mashkulli ka një gjatësi flatrave të përparme prej 14–15 mm me një sfond të errët me kufij të gjerë kafe të errët. Flatrat e përparme në pjesën e sipërme kanë një njollë të zezë të dukshme dhe njolla të vogla të verdha apikale, ndërsa pjesa e poshtme është me ngjyrim jeshile ulliri me njolla të argjendta diskale në flatrat e pasmë. Femra është pak më e madhe, me pjesën e sipërme më të errët dhe më të theksuar, ndërsa pjesa e poshtme është e ngjashme. Mund të ngatërrohet me *Ochlodes sylvanus*. Kjo flutur ka një brezni në vit dhe fluturon nga fillimi i korrikut deri në fillim të shtatorit, me një jetëgjatësi relativisht të gjatë të individëve të rritur. Faza e vezës është e gjatë dhe dimëron në tufat e barit, ndërsa larva zhvillohet ngadalë gjatë pranverës. Faza e pupës zgjat rreth dy deri në tre javë. Banon në livadhe të hapura me bar të ulët, shpesh në toka gëlqerore, zakonisht nga 500 deri në 1500 m mbi nivelin e detit. Është një flutur aktive, por me kërkesa të moderuara për hapësirë dhe me dendësi popullate zakonisht të ulët deri mesatare. Larvat ushqehen me një shumëllojshmëri barërash, ndërsa të rriturit marrin nektar nga lule të ndryshme. Në Shqipëri kjo specie është lokale. Në rajonin e Ballkanit është e përhapur gjerësisht dhe më tej shtrihet në pjesën më të madhe të Evropës, duke vazhduar drejt Azisë së Vogël, Kaukazit dhe Lindjes së Afërt. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet si NE, ndërsa në nivel Evropian klasifikohet si specie me shqetësim të ulët, LC.

***Ochlodes sylvanus*/Large Skipper**
Kuqaloshja njollakatrore
Hesperiidae–Hesperiinae





***Ochlodes sylvanus*, dhe harta e shpërhapjes**

Ochlodes sylvanus është një flutur e vogël me flatra të përparme 14–17 mm. Mashkulli ka pjesën e sipërme portokalli-kafe të hapur dhe skaj të jashtëm më të errët, ku duket edhe një shenjë karakteristike në flatrat e përparme. Pjesa e poshtme është e verdhë me njolla të zbehta, ndërsa maja e antenave është e trashur në fund, duke formuar një të përkulur si grep. Femra është pak më e madhe se mashkulli dhe pjesa e sipërme e flatrave tësaj ka ngjyrim më të theksuar, ndërsa pjesa e poshtme ngjason me atë të mashkullit. Për nga pamja, kjo specie mund të ngatërrohet me *Hesperia comma*, por dallimet në ngjyrim dhe shenjat e sipërme e bëjnë identifikimin të mundur.
Specia ka një brezni të vetme, ajo fluturon nga mesi i majit deri në mesin e gushtit. Vezët çelin brenda 7–18 ditëve. Larvat ushqehen gjatë verës, por disa prej tyre ndalojnë zhvillimin dhe dimërojnë nëstadin e tretë ose të katërt të zhvillimit, duke rifilluar ushqyerjen në pranverë përpara se të shndërrohen në pupë. Faza e pupës zgjat 15–27 ditë. *Ochlodes sylvanus* banon në livadhe me diell, skaje pyjesh dhe zona me bar, shpesh në mjedise të lagështa, nga ultësirat deri në 2000 m mbi nivelin e detit. Në fillim të periudhës së fluturimit qëndron më lokal, por më vonë mund të shpërndahet gjerësisht. Dendësia e popullatës është zakonisht mesatare. Larvat ushqehen me një gamë të gjerë barërash, ndërsa të rriturit vizitojnë shumë lule për nektar, shpesh bimë të gjinisë *Rubus*. Në Shqipëri, specia është e përhapur. Në rajonin e Ballkanit dhe në pjesën më të madhe të Evropës është e zakonshme, dhe shtrihet më tej drejt Azisë së Vogël, Kaukazit dhe Lindjes së Afërt. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet si NE, ndërsa në nivel Evropian klasifikohet si specie me shqetësim të ulët LC.

***Thymelicus acteon*/Lulworth Skipper**
Antenëgrepja acteon
Hesperiidae – Hesperiinae





***Thymelicus acteon*, dhe harta e shpërhapjes**

Thymelicus acteon është një flutur e vogël me flatra të përparme 11–13 mm. Pjesa e sipërme e flatrave të përparme është gri e turbullt në bazë, me një vijë të verdhë të zbehtë në qelizë dhe një seri njollash të vogla të verdha post-diskale në segmentet 3–9, ku duket edhe një shenjë karakteristike e seksit. Pjesa e poshtme është portokalli-e verdhë uniforme. Femra është pak më e madhe, pjesa e sipërme nganjëherë më e errët se mashkulli, me një vijë të dukshme të verdhë në qelizë dhe njolla post-diskale më të spikatura në segmentet 3–9. Mund të ngatërrohet me *Thymelicus lineola* dhe *Thymelicus sylvestris*.
Specia ka një brezni të vetëm, fluturon nga maji deri në gusht. Vezët çelin në rreth 23 ditë. Larvat e reja dimërojnë brenda një fshikëze mëndafshi të ndërtuar në një gjethe të palosur dhe të tharë, ato rifillojnë të ushqehen në pranverë për 11–12 javë deri në pupacion. Faza e pupës zgjat rreth 15 ditë.
Ky lloj banon në brigje dhe livadhe me bar të ndritshëm, zakonisht pranë skajeve ku bashkohen barërat e shkurtra dhe të gjata, në peizazhe të hapura deri në 2000 m mbi nivelin e detit. Kërkesat e saj hapësinore janë modeste dhe dendësia e popullsisë shpesh është e lartë. Larvat ushqehen me një shumëllojshmëri barërash, ndërsa të rriturit marrin nektar nga një gamë e gjerë lulesh.
Në Shqipëri, *Thymelicus acteon* është i përhapur kryesisht në jug dhe më i lokalizuar në veri. Në Ballkan gjendet në shumicën e vendeve, ndërsa në Evropë shtrihet nga AL - BG - BIH - GR - HR - NMK - MNE - RKS - RO - SLO - SRB; IB - IT - ALP - BAL - NWE - UK* - SCA - EEU, si dhe në Azi të Vogël, Lindjen e Afërt dhe më tej. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet si (NT), ndërsa në nivel Evropian klasifikohet si specie me shqetësim të ulët (LC).

***Thymelicus lineola* / Essex Skipper**
Okërverdha shiritshkurtër
Hesperiidae – Hesperiinae





***Thymelicus lineola*, dhe harta e shpërhapjes**

Thymelicus lineola është një flutur e vogël me flatra të përparme 12–14 mm. Mashkulli paraqitet me ngjyrë të zbehtë dhe një shenjë të ngushtë në flatrat e përparme që shërben si tipas seksual, ndërsa pjesa e poshtme është e verdhë-gri e zbehtë. Maja e antenave është e zezë në pjesën e poshtme. Femra është pak më e madhe, me pamje shumë të ngjashme me mashkullin, por pa shenjën seksuale. Mund të ngatërrohet me *Thymelicus acteon* dhe *Thymelicus sylvestris*. Specia ka një brezni të vetme, lloji fluturon nga maji deri në gusht. Vezët dimërojnë brenda gjetheve të palosura dhe të thara, (deri në 40 javë), ndërsa larvat zhvillohen në pranverë për disa javë deri në pupacion. Faza e pupës zgjat rreth 2–3 javë.
Ky lloj banon në livadhe me lule, brigje me bar dhe zona të hapura, si lëndina dhe skaje pyjesh, nga ultësirat deri në rreth 2200 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë modeste dhe dendësia e popullsisë shpesh është e lartë. Larvat ushqehen me një gamë të gjerë barërash, ndërsa të rriturit marrin nektar nga shumë lule.
Në Shqipëri, *Thymelicus lineola* është i përhapur kryesisht në zonat malore. Në Ballkan gjendet në shumicën e vendeve, ndërsa në Evropë është i përhapur gjerësisht dhe shtrihet më tej në Azinë e Vogël, Kaukaz dhe më në lindje. Specia është e listuar si (NE) në Shqipëri dhe (VU A2b) në nivel Evropian sipas IUCN.

***Thymelicus sylvestris* /Small Skipper**
Okërverdha shiritzi
Hesperiidae – Hesperiinae





***Thymelicus sylvestris*, dhe harta e shpërhapjes**

Thymelicus sylvestris është një flutur e vogël me flatra të përparme 13–15 mm. Mashkulli paraqitet me ngjyrë të zbehtë dhe një shenjë seksuale të dukshme në flatrat e përparme që arrin deri në venën 3, ndërsa pjesa e poshtme është e zbehtë dhe maja e antenave është e çelët poshtë. Femra është pak më e madhe, me pamje shumë të ngjashme me mashkullin, por pa shenjën seksuale. Mund të ngatërrohet me *Thymelicus acteon* dhe *Thymelicus lineola*.
Specia ka një brezni të vetëm, ajo fluturon nga maji deri në gusht, me jetëgjatësi relativisht të gjatë të individëve të rritur. Faza e vezës zgjat 15–33 ditë. Larvat e reja dimërojnë së bashku në një fshikëz të butë dhe rifillojnë ushqyerjen në pranverë për rreth 10 javë deri në pupacion. Faza e pupës zgjat 12–22 ditë.
Ky lloj banon në livadhe me lule, brigje me bar dhe zona të hapura, si lëndina dhe skaje pyjesh, nga ultësirat deri në rreth 2000 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë modeste dhe dendësia e popullsisë shpesh është e lartë. Larvat ushqehen me një shumëllojshmëri barërash, ndërsa të rriturit marrin nektar nga shumë lule.
Në Shqipëri, *Thymelicus sylvestris* është lloj i përhapur. Në Ballkan gjendet në shumicën e vendeve, ndërsa në Evropë është i përhapur gjerësisht dhe shtrihet edhe më tej në Azinë Jugperëndimore. Specia është e listuar si (NE) në Shqipëri dhe (VU A2b) në nivel Evropian sipas IUCN.

***Carterocephalus palaemon* /Chequered Skipper**
Antenëgrepja katrore
Hesperiidae –Heteropterinae





***Carterocephalus palaemon*, dhe harta e shpërhapjes**

Carterocephalus palaemon është një flutur e vogël me flatra të përparme rreth 14 mm. Mashkulli ka me ngjyrë kafe të errët dhe njolla të verdha të dukshme në flatrat e përparme dhe të pasmë, të shoqëruara nga pika të vogla përgjatë skajeve. Pjesa e poshtme e flatrave të pasmë ka njolla më të zbehta të rrethuara me të zezë, ndërsa maja e antenave është e verdhë-portokalli në pjesën e poshtme. Femra është pak më e madhe, me shenja më të zbehta dhe me majën e antenave të ngjyrosur më lehtë.
Specia ka një brezni të vetme, ajo fluturon nga maji deri në mesin e korrikut, me një periudhë fluturimi relativisht të shkurtër. Vezët çelin pas rreth 10 ditësh. Larva dimëron si e rritur plotësisht brenda një tubi të formuar nga një gjethe e tharë e bimës me të cilën ushqehet dhe rifillon zhvillimin në pranverë. Faza e pupës zgjat 24–32 ditë.
Kjo specie banon në zona me bar të lagësht në pyje të hapura, gjendet zakonisht në lartësi nga 1000 deri në 1650 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë të ulëta dhe dendësia e popullsisë zakonisht është e ulët. Larvat ushqehen me një shumëllojshmëri barërash, ndërsa të rriturit marrin nektar nga lule të ndryshme.
Në Shqipëri, *Carterocephalus palaemon* ka shpërhapje lokale dhe ndodhet në kufirin jugor të shpërndarjes së saj në Ballkan. Në rajon gjendet në shumicën e vendeve, ndërsa në Evropë është e përhapur në zona të ndryshme dhe shtrihet më tej drejt Kaukazit dhe më në lindje. Specia është e listuar si (VU) në Shqipëri dhe (NT A2b) në nivel Evropian sipas IUCN.

***Heteropterus morpheus* /Large Chequered Skipper**
E kafejta e madhe me kuadrate
Hesperiidae – Heteropterinae





***Heteropterus morpheus*, dhe harta e shpërhapjes**

Heteropterus morpheus është flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme 16–18 mm. Te meshkujt, ana e sipërme e krahëve të përparmë ka ngjyrë bazë kafe shumë të errët deri në të zezë, me tre deri në katër njolla të vogla të verdha pranë majës së krahut, afër kostës. Ana e poshtme e krahëve të pasmë ka shumë njolla të mëdha të bardha të rrethuara me të zezë. Femrat janë pak më të mëdha se meshkujt. Njollat e verdha pranë majës së krahëve të përparmë janë më të mëdha, ndërsa ana e poshtme e krahëve të pasmë është e ngjashme me atë të meshkujve. Nuk ka specie të ngjashme. Cikli jetësor përfshin 1 brez të vetme nga qershori në korrik, të rriturit jetëgjatësi të shkurtër. Veza zhvillohet për 6–10 ditë. Larva ushqehet nga vera deri në vjeshtë, dimëron si larvë gjysmë e rritur në një tub të hapur dhe rifillon ushqyerjen në pranverë deri në pupëzim. Pupa zhvillohet për 12–18 ditë. *Heteropterus morpheus* banon në livadhe të lagështa me barëra të larta pranë pyjeve dhe përgjatë rrugëve me hije, nga 300 deri në 1400 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore të vogla, dendësia e popullatës shpesh është e ulët. Larvat ushqehen me *Brachypodium sylvaticum*, *Molinia caerulea*, *Phalaris arundinacea* dhe *Phragmites australis*. Fluturat ushqehen me lule të gjembaçëve dhe vërehen gjithashtu duke thithur lagështirë e minerale nga toka e lagësht. Në Shqipëri, në 2023, lloji u konfirmua në Has dhe njihet vetëm nga një lokalitet. Lokalitetet më të afërta, ndodhen në Kosovë, në Majën e Peklenit dhe Grykën e Rugovës. Në Ballkan dhe Evropë shpërndarje të gjerë. Gjendet edhe në Kaukaz, Transkaukazinë Perëndimore dhe më tej në lindje. *Heteropterus morpheus* ndodhet në kufirin jugor të arealit të saj evropian në Gadishullin Ballkanik. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë është listuar si (VU), ndërsa në Listën e Kuqe të IUCN-së në nivel Mesdhetar, si (LC).

***Carcharodus alceae*/Mallow Skipper**
Mëllagagrënësja
Hesperiidae –Pyrginae





***Carcharodus alceae*, dhe harta e shpërhapjes**

Carcharodus alceae është një flutur e vogël me flatra të përparme 13–16 mm. Mashkulli paraqitet me ngjyrim të përzier kafe dhe gri, me shenja të zbehta në flatrat e pasmë dhe një njollë shumë të ngushtë, ndonjëherë të padukshme, në flatrat e përparme. Pjesa e poshtme është më e çelët dhe pa tufë qimesh. Femra është pak më e madhe, me ngjyra më të zbehta dhe shenja pak më të theksuara. Mund të ngatërrohet me *Muschampia lavatherae, Muschampia floccifera* dhe *Muschampia orientalis*.
Specia zhvillon tre ose më shumë brezni në vit, duke fluturuar nga prilli deri në tetor. Vezët çelin brenda 7–18 ditëve. Larvat mund të dimërojnë të zhvilluara plotësisht në një fshikëz ose të zhvillohen më shpejt gjatë sezonit, ndërsa faza e pupës zgjat 11–32 ditë.
Ky lloj banon në kullota të thata dhe bregore me lule, zakonisht në zona kodrinore me barëra të larta dhe shkurre, nga ultësirat deri në rreth 1500 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë relativisht të larta dhe dendësia e popullatës zakonisht e ulët. Larvat ushqehen me bimë të familjes Malvaceae, ndërsa të rriturit marrin nektar nga një larmi e gjerë lulesh, shpesh duke vizituar gjembaçë dhe barëra të këqija.
Në Shqipëri, *Carcharodus alceae* është i përhapur. Në Ballkan gjendet në shumicën e vendeve, ndërsa në Evropë është i përhapur gjerësisht. Lloji shtrihet edhe më tej në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt dhe më në lindje. Statusi i ruajtjes në Shqipëri është (LC), dhe në nivel rajonal Evropian klasifikohet si (LC).

***Erynnis marloyi* / Inky Skipper**
E kafejta e bojatisur
Hesperiidae – Pyrginae





***Erynnis marloyi*, dhe harta e shpërhapjes**

Erynnis marloyi është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 14–15 mm, lehtësisht e dallueshme nga ngjyrosja e errët kafe deri në të zezë. Flatrat e përparme në anën e sipërme janë të pajisura me dy vija të zeza të çrregullta me një shirit postdiskal me ngjyrim të përzier me ngjyrën gri, ndërsa flatrat e pasmë janë uniformisht të zeza pa shenja; në pjesën e poshtme paraqiten të zeza me disa pika të vogla të bardha apikale. Femra është e ngjashme, por zakonisht më e madhe dhe me ngjyrim më të zbehtë. Mund të ngatërrohet me *Erynnis tages*.
Specia zhvillon një gjeneratë të vetme me një gjeneratë të dytë të pjesshme, ose dy gjenerata të plota, në varësi të kushteve lokale klimatike dhe fluturon nga maji deri në gusht; faza e vezës është e shkurtër; larva mendohet se dimëron; pupa zgjat më tepër pas dimërimit të vemjes, dhe është më e shkurtër në periudhen e verës. Banon në kullota të ngrohta, kodrinore dhe malore, shpesh në toka gëlqerore dhe zona shkëmbore, deri në rreth 1500m mbi nivelin e detit. Larvat ushqehen kryesisht me *Prunus cocomilia*, P.spinosa dhe Pyrus amygdaliformis ndërsa të rriturit vizitojnë lule të ndryshme për nektar.
Në Shqipëri është lloj vendas dhe i përhapur, si edhe në të gjithë rajonin e Ballkanit dhe më gjerë në Evropë dhe Azi. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë është listuar si (VU), ndërsa në Listën e Kuqe të IUCN-së, si (LC).

***Erynnis tages*/Dingy Skipper**
E kafejta e zymtë
Hesperiidae –Pyrginae





***Erynnis tages*, dhe harta e shpërhapjes**

Erynnis tages është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 13–14 mm, e dallueshme nga ngjyrosja kafe dhe prania e një serie të plotë pikash anësore të bardha. Flatrat e pasmë në anën e sipërme janë kafe, ndonjëherë me njolla të zbehta post-diskale, ndërsa pjesa e poshtme është kafe më e hapur me pika anësore të bardha. Femra është e ngjashme, por zakonisht pak më e madhe. Mund të ngatërrohet me *Erynnis marloyi*.
Specia zhvillon një ose dy gjenerata në vit (brezi i dytë mund të jetë i pjesshëm), në varësi të lartësisë dhe fluturon nga prilli në gusht. Vezët çelin pas 5–21 ditësh, larva e brezit të parë zhvillohet për rreth shtatë javë, ndërsa brezi i dytë dimëron në një hibernakulum të formuar nga gjethe të thata, të thurura së bashku në shtresën e gjetheve të rëna. Faza e pupës zgjat 14–36 ditë. Banon në habitate të hapura si brigje me lule, zona ranore ose shkëmbore, shpesh në toka gëlqerore, nga ultësira deri në rreth 2000 m mbi nivelin e detit, ku mund të paraqitet me dendësi të lartë. Larvat ushqehen me bimë të gjinive ose llojeve: *Anthyllis, Eryngium campestre, Hippocrepis, Lotus*
dhe *Securigera varia*, ndërsa të rriturit vizitojnë një gamë të gjerë lulesh për nektar.
Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht, si edhe në të gjithë Ballkanin, Evropën dhe më tej drejt Azisë. Specia është e vlerësuar si LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Muschampia alta*/Sage Skipper**
Antenëgrepja e urtë
Hesperiidae –Pyrginae





***Muschampia alta*, dhe harta e shpërhapjes**

Muschampia alta është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 14–15 mm, e dallueshme nga ngjyrosja gri e errët, shpesh e mbuluar me qime të verdha dhe me shenja të dobëta nënmarginale. Pjesa e poshtme e flatrave të pasmë është gri-verdhë deri në të kuqe-rëre, me një model të ngjashëm me anën e sipërme, por me njolla në zonën diskale që nuk formojnë një brez të vazhdueshëm. Femra është e ngjashme, por zakonisht pak më e madhe dhe pa qime të verdha. Mund të ngatërrohet me *Muschampia tessellum*.
Specia ka një periudhë të gjatë shfaqjeje nga prilli gjatë gjithë verës, me shfaqje të individëve në intervale (shpesh pas rreshjeve); faza e vezës është e shkurtër, larva ka të ngjarë të dimërojë dhe të pupojë në fillim të pranverës, por këto faza konsiderohen ende të pakonfirmuara plotësisht. Banon në gryka të thata shkëmbore dhe shpate me bimësi të lartë, zakonisht midis 500 dhe 1500 m mbi nivelin e detit, ku mund të paraqitet me dendësi të larta dhe kërkesa hapësinore modeste. Larvat ushqehen me specie të gjinisë *Phlomis*, ndërsa të rriturit vizitojnë një shumëllojshmëri bimësh me lule, përfshirë dhe bimët e larta.
Në Shqipëri është lloj vendas dhe gjendet kryesisht në jug, megjithëse kërkohen studime të mëtejshme; është i përhapur në të gjithë Ballkanin dhe në pjesë të mëdha të Evropës. Shtrihet në kufirin verior të përhapjes së tij evropiane në Gadishullin Ballkanik; Kjo specie është e listuar si NE në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe si LC në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Muschampia floccifera*/Tufted Marbled Skipper**
Flociferja
Hesperiidae –Pyrginae





***Muschampia floccifera*, dhe harta e shpërhapjes**

Muschampia floccifera është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 14–16 mm, e dallueshme nga ngjyrosja gri-kafe e errët e mbuluar me vija më të errëta. Flatrat e përparme mbajnë tre njolla të bardha pranë majës dhe një njollë të dukshme transparente diskale, ndërsa flatrat e pasmë kanë njolla të zbehta bazale dhe diskale; në pjesën e poshtme, flatrat e përparme mbajnë një tufë të dukshme qimesh, ndërsa flatrat e pasmë janë kafe të errët me shenja të bardha të përcaktuara mirë. Femra është e ngjashme, por zakonisht pak më e madhe. Mund të ngatërrohet me *Muschampia lavatherae*, *Carcharodus alceae* dhe *Muschampia orientalis*.
Specia zhvillon një ose dy gjenerata në vit, në varësi të lartësisë, dhe fluturon nga maji deri në gusht; faza e vezës është e shkurtër, larva dimëron si gjysmë e rritur dhe faza e pupës është gjithashtu e shkurtër. Banon në bregore me lule dhe terrene të ashpra, nga ultësirat deri në rajonet alpine deri në rreth 2000 m mbi nivelin e detit, duke preferuar mjedise më të freskëta dhe me lagështi; ka kërkesa të konsiderueshme hapësinore dhe zakonisht paraqitet me dendësi të ulët. Larvat ushqehen kryesisht me specie të gjinive *Stachys* dhe *Marrubium,* por edhe me lloje e gjini si: *Ballota nigra, Betonica, Leonurus cardiaca* dhe *Malva neglecta*, ndërsa të rriturit vizitojnë një shumëllojshmëri lulesh për nektar.
Në Shqipëri është mjaft e përhapur në zonat malore dhe gjendet në të gjithë Ballkanin, Evropën dhe më tej drejt Kaukazit dhe Azisë. Në Shqipëri është vlerësuar si e cenueshme (VU), ndërsa në Listën e Kuqe të IUCN-së për Evropën figuron si LC.

***Muschampia lavatherae*/Marbled Skipper**
Flatramermerta
Hesperiidae –Pyrginae





***Muschampia lavatherae*, dhe harta e shpërhapjes**

Muschampia lavatherae është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 14–17 mm, e dallueshme nga ngjyrosja ulliri-kafe e errët me pamje të mermertë dhe nuanca më të errëta. Flatrat e përparme paraqesin njolla të theksuara qelqore në qelizë dhe s2, ndërsa flatrat e pasmë kanë një ton më të errët kontrastues me njolla të bardha diskale të dukshme dhe njolla postdiskale sagjitate; pjesa e poshtme është shumë e zbehtë, pothuajse e bardhë, ndonjëherë pak më e errët në zonën diskale, me shenja të reduktuara dhe pa tufë qimesh në flatrat e përparme. Femra është e ngjashme, por zakonisht pak më e madhe dhe me kontrast më të theksuar. Mund të ngatërrohet me *Carcharodus alceae, Muschampia floccifera* dhe *Muschampia orientalis*.
Specia zhvillon një gjeneratë në vit dhe fluturon nga maji deri në gusht, në varësi të lartësisë; faza e vezës është e shkurtër, larva dimëron si gjysmë e rritur dhe faza e pupës është gjithashtu e shkurtër. Banon në shpate të thata me lule në zona kodrinore dhe malore subalpine, shpesh në toka gëlqerore, deri në rreth 1750 m mbi nivelin e detit, duke kërkuar hapësirë të konsiderueshme dhe duke u paraqitur zakonisht me dendësi të ulët. Larvat ushqehen kryesisht me specie të gjinisë *Stachys* dhe herë pas here me *Sideritis*, ndërsa të rriturit vizitojnë një gamë të gjerë lulesh për nektar.
Në Shqipëri është mjaft e përhapur në zonat malore dhe gjendet në të gjithë Ballkanin, Evropën dhe më tej drejt Azisë. Në Shqipëri është vlerësuar si e cenueshme VU, ndërsa në Listën e Kuqe të IUCN-së për Evropën figuron si NT A2b.

***Muschampia orientalis*/Oriental Marbled Skipper**
Aziatikja
Hesperiidae – Pyrginae





***Muschampia orientalis*, dhe harta e shpërhapjes**

Muschampia orientalis është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 14–15 mm, e dallueshme nga ngjyrosja gri-verdhë, zakonisht më e çelët se nuancat kafe të specieve të ngjashme. Flatrat e përparme në anën e sipërme paraqesin tre njolla të bardha pranë majës dhe një njollë diskale transparente të dukshme, ndërsa flatrat e pasmë tregojnë shenja diskale të zbehta dhe nënmarginale të zhvilluara mirë; në pjesën e poshtme, flatrat e përparme mbajnë një tufë të dukshme qimesh, ndërsa flatrat e pasmë janë gri të zbehtë me shenja të bardha të paqarta. Femra është e ngjashme, por zakonisht pak më e madhe. Mund të ngatërrohet me *Muschampia lavatherae, Carcharodus alceae* dhe *Muschampia floccifera*.
Specia zhvillon dy deri në tre gjenerata në vit, nga prilli deri në shtator; faza e vezës është e shkurtër, larva dimëron si e rritur plotësisht dhe faza e pupës është e shkurtër. Banon në livadhe të thata dhe të nxehta me lule në zona malore deri në rreth 1000 m mbi nivelin e detit, duke kërkuar hapësirë të konsiderueshme dhe duke u paraqitur zakonisht me dendësi të ulët. Larvat ushqehen kryesisht me specie të gjinisë *Stachys*, por përmendet edhe *Ballota nigra*, ndërsa të rriturit vizitojnë një shumëllojshmëri lulesh për nektar.
Në Shqipëri është një specie lokale dhe gjendet në të gjithë Ballkanin, si edhe në pjesë të mëdha të Evropës dhe më tej drejt Azisë. Specia është e listuar si (NE) në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe si (LC) në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Pyrgus alveus*/Large Grizzled Skipper**
Thinjoshja
Hesperiidae –Pyrginae





***Pyrgus alveus*, dhe harta e shpërhapjes**

Pyrgus alveus është një flutur e vogël, por ndër speciet me madhësi mesatare të gjinisë në Ballkan, me gjatësi të flatrave të përparme prej 14–16 mm, e dallueshme nga ngjyrosja pothuajse e zezë në gjendje të freskët që zbehet në gri-kafe të errët, me pika të vogla deri në mesatare të bardha në flatrat e përparme. Njollat postdiskale në anën e sipërme të flatrave të pasmë janë shumë të errëta dhe pothuajse të padukshme, ndërsa pjesa e poshtme është gri-kafe e çelët me një brez të zbehtë postdiskal, zakonisht të plotë, por ndonjëherë të reduktuar ose të ndërprerë në s2–s3. Femra është e ngjashme në madhësi, por shpesh me një nuancë të verdhë në anën e sipërme kur është e freskët dhe me njolla të bardha zakonisht më të vogla. Mund të ngatërrohet me *Spialia orbifer, Spialia phlomidis, Pyrgus carthami, Pyrgus sidae, Pyrgus andromedae, Pyrgus armoricanus, Pyrgus cinarae, Pyrgus malvae* dhe *Pyrgus serratulae*. Specia zhvillon një gjeneratë në vit dhe shfaqet nga qershori deri në gusht, me një jetëgjatësi rreth tre javë; vezët çelin pas 14–17 ditësh, larvat ushqehen nga fundi i verës deri në vjeshtë dhe dimërojnë në fazën e dytë të zhvillimit të fshehura në gjethe të tjerrura, duke rifilluar ushqyerjen në pranverë për rreth tre muaj, ndërsa faza e pupës zgjat 14–26 ditë. Banon në livadhe me bar dhe lule, si dhe në zona shkëmbore, kryesisht në male, shpesh në lugina të mbrojtura dhe pranë rrjedhave ujore, zakonisht midis 1000 dhe 2000 m mbi nivelin e detit; kërkon hapësirë të madhe dhe paraqitet me dendësi të ulët. Larvat ushqehen me specie të gjinive *Helianthemum* dhe *Potentilla*, ndërsa të rriturit vizitojnë lule të larta për nektar. Në Shqipëri është e përhapur në Alpet Veriore dhe paraqitet lokalisht në zona të tjera malore; gjendet gjithashtu në të gjithë Ballkanin, Evropën dhe më tej drejt Azisë. Specia është e listuar si NE në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe si LC në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Pyrgus andromedae*/Alpine Grizzled Skipper**
Thinjoshja alpine
Hesperiidae –Pyrginae





***Pyrgus andromedae*, dhe harta e shpërhapjes**

Pyrgus andromedae është një flutur e vogël, që konsiderohet me madhësi mesatare brenda gjinisë në Ballkan, me gjatësi të flatrave të përparme prej 13–15 mm, e dallueshme nga njollat e bardha të përcaktuara mirë në flatrat e përparme, përfshirë tre njolla të vogla diskale nën qelizë. Shenjat në anën e sipërme janë përgjithësisht të zbehta, por mbi një sfond të errët, ndërsa pjesa e poshtme është kafe-ulliri me një karakteristike, e përbërë nga një pikë e bardhë ovale dhe një vijë. Femra është e ngjashme në madhësi dhe pamje. Mund të ngatërrohet me *Spialia orbifer, Spialia phlomidis, Pyrgus carthami, Pyrgus sidae, Pyrgus alveus, Pyrgus armoricanus, Pyrgus cinarae, Pyrgus malvae* dhe *Pyrgus serratulae*. Specia zhvillon një gjeneratë në vit dhe shfaqet nga qershori deri në korrik, menjëherë pas shkrirjes së borës; faza e vezës është e shkurtër, larvat zhvillohen gjatë dy viteve duke dimëruar fillimisht si larva të reja dhe më pas si pupa, ndërsa faza e pupës zgjat gjatë periudhës nga dimërimi deri në fillim të verës. Banon në shpate shkëmbore alpine, zakonisht mbi 2000 m mbi nivelin e detit, shpesh pranë bimës ushqimore *Dryas octopetala*, ku mund të paraqitet me dendësi të lartë dhe kërkesa hapësinore modeste. Larvat ushqehen ekskluzivisht me *Dryas octopetala*, ndërsa të rriturit vizitojnë lule me rritje të ulët, shpesh drejtpërdrejt në bimën ushqimore. Në Shqipëri është shumë lokal në rajonet veriore dhe kërkon studime të mëtejshme; gjendet në pjesë të tjera të Ballkanit dhe në rajone të ndryshme të Evropës, ndërsa mungon në zonat përreth të Azisë. Shtrihet në kufirin jugor të përhapjes së tij evropiane në Gadishullin Ballkanik dhe është e listuar si VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë, dhe LC sipas vlerësimetve të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Pyrgus armoricanus*/Oberthür's Grizzled Skipper**
Pirgusi i Oberturit
Hesperiidae –Pyrginae





***Pyrgus armoricanus*, dhe harta e shpërhapjes**

Pyrgus armoricanus është një flutur e vogël, pak më e vogël se speciet tipike të gjinisë, me gjatësi të flatrave të përparme prej 12–14 mm, e dallueshme nga shenjat e bardha të plota në flatrat e përparme. Ana e sipërme paraqet një shenjë diskale të bardhë të zbehtë dhe shenja submarginale të spikatura, shpesh në formë shigjete, ndërsa pjesa e poshtme karakterizohet nga vena të theksuara, një pikë bazale në s7 me skaje të drejta dhe shenja në formë shigjete në s1 dhe s2, zakonisht jo të ngurta. Femra është e ngjashme në madhësi, por me shenja disi më të dobëta në anën e sipërme. Mund të ngatërrohet me *Spialia orbifer, Spialia phlomidis, Pyrgus carthami, Pyrgus sidae, Pyrgus alveus, Pyrgus andromedae, Pyrgus cinarae, Pyrgus malvae* dhe *Pyrgus serratulae*. Specia zhvillon dy gjenerata në vit dhe fluturon nga maji deri në shtator, me një jetëgjatësi rreth dy javë; vezët zhvillohen për 18–22 ditë, larvat ushqehen rreth gjashtë javë në gjeneratën e pranverës dhe rreth dy javë në të dytën përpara se të dimërojnë si larva të fazës së dytë në një strehë prej gjetheve të tjerrura, ndërsa faza e pupës zgjat 13–18 ditë. Banon në brigje të thata dhe të ngrohta me bar dhe lule, nga ultësirat deri në rreth 1500 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore modeste dhe zakonisht me dendësi të ulët. Larvat ushqehen kryesisht me specie të gjinisë *Potentilla*, por janë raportuar edhe në *Helianthemum nummularium, Filipendula vulgaris* dhe *Fragaria vesca*, ndërsa të rriturit vizitojnë lule me rritje të ulët për nektar. Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht dhe gjendet në të gjithë Ballkanin, Evropën dhe më tej drejt Azisë. Specia është e listuar si LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Pyrgus carthami*/Safflower Skipper**
Kafezijoshja
Hesperiidae –Pyrginae





***Pyrgus carthami*, dhe harta e shpërhapjes**

Pyrgus carthami është një flutur e vogël, por ndër më të mëdhatë e gjinisë në Ballkan, me gjatësi të flatrave të përparme prej 15–17 mm, e dallueshme nga ngjyrosja gri e errët në nuancë qymyri dhe shenjat e forta të bardha. Në anën e sipërme paraqiten njolla të zgjatura postdiskale dhe submarginale, shpesh të përcaktuara mirë, ndërsa pjesa e poshtme është gri e zbehtë në të verdhë, me një kufi të bardhë të plotë që ndan zonën bazale të çelët nga skajet. Femra është e ngjashme, por zakonisht pak më e madhe. Mund të ngatërrohet me *Pyrgus alveus, Pyrgus andromedae, Pyrgus armoricanus, Pyrgus cinarae, Pyrgus malvae, Pyrgus serratulae* dhe *Pyrgus sidae*.
Specia zhvillon një gjeneratë në vit dhe fluturon nga qershori deri në shtator; faza e vezës është e shkurtër, larvat dimërojnë në faza të ndryshme dhe faza e pupës është gjithashtu e shkurtër. Banon në kullota të thata, shkëmbore dhe të rralla, zakonisht mbi 1000 m dhe deri në rreth 2000 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore të moderuara dhe dendësi të ulët. Larvat ushqehen me specie të ndryshme të gjinisë *Potentilla*, ndërsa të rriturit vizitojnë lule më të larta për nektar.
Në Shqipëri është shumë lokal dhe kërkon studime të mëtejshme; gjendet në të gjithë Ballkanin, Evropën dhe me popullata të izoluara në Azinë e Vogël dhe Kaukaz, dhe më tej në lindje deri në Malet Urale. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet si NE, ndërsa në nivel Evropian klasifikohet si specie me shqetësim të ulët LC.

***Pyrgus cinarae*/Sandy Grizzled Skipper**
Thinjoshja e rërët
Hesperiidae –Pyrginae





***Pyrgus cinarae*, dhe harta e shpërhapjes**

Pyrgus cinarae është një flutur e vogël, por ndër më të mëdhatë e gjinisë në Ballkan, me gjatësi të flatrave të përparme prej 15–16 mm, e dallueshme nga njollat e mëdha të bardha në flatrat e përparme dhe një njollë karakteristike në formë trapezi pranë fundit të qelizës. Flatrat e pasmë në anën e sipërme paraqesin njolla të vogla bazale, shenja të theksuara diskale dhe njolla të bardha submarginale. Femra është e ngjashme në madhësi, por me njolla më të dobëta dhe më të vogla në anën e sipërme. Mund të ngatërrohet me *Spialia orbifer, Spialia phlomidis, Pyrgus carthami, Pyrgus sidae, Pyrgus alveus, Pyrgus andromedae, Pyrgus armoricanus, Pyrgus malvae* dhe *Pyrgus serratulae*.
Specia zhvillon një gjeneratë në vit dhe fluturon nga qershori deri në gusht; vezët kanë një stad të gjatë zhvillimi; larva dimëron brenda vezës dhe faza e pupës është e shkurtër. Banon në kullota të thata shkëmbore dhe livadhe me lule në shpate malore midis 500 dhe 1500 m mbi nivelin e detit, rrallë më lart, me kërkesa hapësinore mesatare dhe dendësi popullate që mund të jetë e lartë. Larvat ushqehen kryesisht me specie të gjinisë *Potentilla*, veçanërisht *Potentilla recta*, por edhe me *Filipendula vulgaris*, ndërsa të rriturit vizitojnë një gamë të gjerë lulesh dhe shpesh grumbullohen në baltë.
Në Shqipëri është lokal në rajonet juglindore, në kufirin verior të përhapjes së tij në Ballkan; gjendet në të gjithë Ballkanin, Evropën dhe me popullata të izoluara në Azinë e Vogël dhe Transkaukaz. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet si NE, ndërsa në nivel Evropian klasifikohet si specie me shqetësim të ulët LC.

***Pyrgus malvae*/Grizzled Skipper**
Mëllagëngrënësja njollshumtë
Hesperiidae –Pyrginae





***Pyrgus malvae*, dhe harta e shpërhapjes**

Pyrgus malvae është një flutur e vogël, dhe më e vogla ndër Pyrgus-ët në Ballkan, me gjatësi të flatrave të përparme prej 11–13 mm, e dallueshme nga shenjat e forta të bardha nënmarginale në flatrat e përparme dhe nga njolla e bardhë diskale në formë molari në flatrat e pasmë. Ngjyra bazë në anën e sipërme është kafe, shpesh me nuancë të gjelbër ose të verdhë. Femra është e ngjashme, por zakonisht pak më e madhe. Mund të ngatërrohet me *Spialia orbifer, Spialia phlomidis, Pyrgus carthami, Pyrgus sidae, Pyrgus alveus, Pyrgus andromedae, Pyrgus armoricanus, Pyrgus cinarae* dhe *Pyrgus serratulae*.
Specia zhvillon dy gjenerata në vit (me një në lartësi të madhe); vezët zhvillohen për 5–14 ditë, larvat ushqehen rreth 9 javë në zonat më të larta ndërsa në ultësira zhvillohen më shpejt, dhe pupacioni ndodh gjatë dimrit në strehë të fshehur në pjellë. Banon në një shumëllojshmëri kullotash dhe hapësirash të hapura, përfshirë lëndina pyjore dhe zona me tokë të zhveshur, nga ultësirat deri në të paktën 2000 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore modeste dhe dendësi popullate që mund të jetë e lartë. Larvat ushqehen me specie të gjinive *Agrimonia*, *Filipendula, Fragaria, Potentilla* dhe *Sanguisorba*, si dhe herë pas here me *Rubus*, ndërsa të rriturit vizitojnë një gamë të gjerë lulesh për nektar.
Në Shqipëri është e përhapur në veri dhe më lokale në jug; gjendet në të gjithë Ballkanin, Evropën dhe më tej drejt Azisë. Specia është e listuar si (NE) në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe si (NT A2b) në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Pyrgus serratulae*/Olive Skipper**
Ngjyrëullijta
Hesperiidae –Pyrginae





***Pyrgus serratulae*, dhe harta e shpërhapjes**

Pyrgus serratulae është një flutur e vogël, me madhësi mesatare brenda gjinisë në Ballkan, me gjatësi të flatrave të përparme prej 12–14 mm, e dallueshme nga shenjat e ndryshueshme dhe shpesh të reduktuara në flatrat e përparme në anën e sipërme, ndërsa flatrat e pasmë kanë shenja përgjithësisht të errëta ose rudimentare. Pjesa e poshtme ka ngjyrë jeshile-ulliri dhe paraqet shenja karakteristike, përfshirë pikën bazale në s7 të rrumbullakosur ose ovale, shenjën diskale në s4/5 me skaje të drejta në të dy anët dhe një shenjë të fortë margjinale në s2. Femra është e ngjashme në madhësi, zakonisht me njolla të vogla të bardha dhe të njëjtin model në pjesën e poshtme. Mund të ngatërrohet me *Spialia orbifer, Spialia phlomidis, Pyrgus carthami, Pyrgus sidae, Pyrgus alveus, Pyrgus andromedae, Pyrgus armoricanus, Pyrgus cinarae* dhe *Pyrgus malvae*.
Specia zhvillon një gjeneratë në vit, nga maji deri në gusht në varësi të lartësisë; vezët zhvillohen për 11–18 ditë, larvat dimërojnë në fazën L4 brenda një fshikëze dhe faza e pupës zgjat rreth 19 ditë. Banon në livadhe në shpate kodrinore dhe malore me bimësi të pasur me lule, zakonisht midis 500 dhe 1500 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore modeste dhe dendësi të ulët popullate. Larvat ushqehen me specie të gjinive *Geum, Potentilla* dhe llojin *Sibbaldia procumbens*, ndërsa të rriturit vizitojnë një gamë të gjerë lulesh për nektar.
Në Shqipëri është lokal në jug dhe kërkon studime të mëtejshme; gjendet në të gjithë Ballkanin, Evropën dhe më tej drejt Azisë. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet si NE, ndërsa në nivel Evropian klasifikohet si specie me shqetësim të ulët LC.

***Pyrgus sidae*/Yellow-banded Skipper**
Kafeportokalleja
Hesperiidae –Pyrginae





***Pyrgus sidae*, dhe harta e shpërhapjes**

Pyrgus sidae është një flutur e vogël, por ndër më të mëdhatë e gjinisë në Ballkan, me gjatësi të flatrave të përparme prej 16–18 mm, e dallueshme nga shenjat e plota dhe të mirëpërcaktuara në anën e sipërme të flatrave. Flatrat e përparme paraqesin një njollë të madhe qelizore dhe njolla trekëndore submarginale, ndërsa flatrat e pasmë shpesh kanë njolla të zbehta por të spikatura. Pjesa e poshtme është karakteristike, me bazë të bardhë dhe vija diskale e postdiskale të verdha-portokalli. Femra është e ngjashme në madhësi dhe shenja. Mund të ngatërrohet me *Pyrgus alveus, Pyrgus andromedae, Pyrgus armoricanus, Pyrgus cinarae, Pyrgus malvae, Pyrgus serratulae* dhe *Pyrgus carthami*.
Specia zhvillon një gjeneratë në vit dhe fluturon nga maji deri në korrik, në varësi të lartësisë; vezët kanë një fazë të shkurtër zhvillimi, larvat dimërojnë si L4 në një fshikëz dhe jetëgjatësia e fazes së pupës është ndoshta e shkurtër. Banon në livadhe me bar dhe zona shkëmbore me lule të bollshme, nga ultësirat deri në rreth 1700 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore mesatare dhe dendësi popullate që mund të jetë e lartë. Larvat ushqehen me *Potentilla recta* dhe *Potentilla pedata*, ndërsa të rriturit vizitojnë një shumëllojshmëri lulesh dhe shpesh vërehen duke u ushqyer me baltë.
Në Shqipëri është lloj local, por për ta njohur më mire shpërhapjen kërkon studime të mëtejshme; gjendet në të gjithë Ballkanin, Evropën dhe është i shtrirë edhe më tej drejt Azisë. Specia është e listuar si (LRnt) në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe si LC në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Spialia orbifer*/Orbed Red-underwing Skipper**
Antenëgrepja hungareze
Hesperiidae –Pyrginae





***Spialia orbifer*, dhe harta e shpërhapjes**

Spialia orbifer është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 11–14 mm, më e vogël se *Spialia phlomidis*, e dallueshme nga njollat e bardha post-diskale të rreshtuara rregullisht në flatrat e përparme dhe nga njollat nënmarginale të përcaktuara mirë që shpesh formojnë një seri të plotë. Flatrat e pasmë gjithashtu paraqesin një seri të plotë njollash nënmarginale. Pjesa e poshtme është e zbehtë kafe e kuqërremtë me pika ovale deri në të rrumbullakëta të shpërndara në mënyrë të barabartë. Femra është pak më e madhe, por e ngjashme në shenjat dhe figurat e flatrave. Mund të ngatërrohet me *Spialia phlomidis*.
Specia zhvillon dy gjenerata në vit dhe fluturon nga prilli deri në shtator; vezët çelin pas rreth një jave, larvat dimërojnë si individë të rritur të fshehur nën gjethet e vyshkura të bimës pritëse dhe pupacioni zgjat rreth 14 ditë. Banon në kullota të ashpra me shkurre të shpërndara dhe bimësi të pasur me lule, deri në rreth 1700 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore të ulëta dhe dendësi popullate që mund të jetë e lartë. Larvat ushqehen me specie të familjes Rosaceae, kryesisht *Sanguisorba minor, S. officinalis* dhe *Rubus idaeus*, ndërsa të rriturit vizitojnë një gamë të gjerë lulesh për nektar.
Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht; gjendet në të gjithë Ballkanin, Evropën dhe përhapja zgjerohet edhe më tej drejt Azisë. Specia është e listuar si (LC) në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe si (NT A2c) në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Spialia phlomidis*/Persian Skipper**
Flomidja
Hesperiidae -Pyrginae






***Spialia phlomidis*, dhe harta e shpërhapjes**

Spialia phlomidis është flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 14–15 mm, më e madhe se *S. orbifer*. Meshkujt, flatrat e përparme paraqesin shenja të bardha të mëdha, të plota, baza e skajit të përparmë të flatrës (costa) është e bardhë. Flatrat e sipërme të pasme kanë një njollë diskoidale të madhe, në formë drejtkëndëshe, si dhe njolla nënmarginale të mirëpërcaktuara. Pjesa e poshtme është gri-jeshile e zbehtë. Femrat janë pak më të mëdha, shenjat e tyre janë të ngjashme me ato të meshkujve. Specie të ngjashme të gjitha ato të gjinisë *Pyrgus*, të cilat në flatrat e përparme kanë dy njolla post-diskale të zhvendosura nga jashtë. Krahasuar me *S.orbifer*, kjo specie është më e madhe, nuk ka bazë të bardhë në skajin e përparmë të flatrës dhe ka njolla të bardha më të vogla në flatrat e përparme. Në flatrat e sipërme të pasme ka një njollë diskoidale të vogël dhe të bardhë, ndërsa në pjesën e poshtme ngjyra është kafe, me një njollë ovale në bazë dhe me njolla diskoidale të ndara. *S.phlomidis* ka një gjeneratë të vetme në vit dhe fluturon nga qershori deri në fund të korrikut. Veza ka një stad të shkurtër zhvillimi, ndërsa larva dimëron në stadin L3 dhe rifillon ushqimin në pranverë. Pupa ka stad të shkurtër. Lloji banon në zona të hapura, të nxehta dhe të thata, në terrene të ashpra dhe shpate shkëmbore, dhe mund të gjendet nga zonat e ulëta deri në rreth 2000 m. Kërkesat hapësinore modeste dhe ndonjëherë formon popullata me dendësi të lartë. Larvat ushqehen me lloje gjinisë *Convolvulus*, ndërsa fluturat e rritura ushqehen me nektar me shumëllojshmëri lulesh të ulëta. Në Shqipëri është e pranishme lokalisht në Ballkan e shpërndarë në shumë vende, gjendet në pjesë të ndryshme të Evropës në Azinë e Vogël dhe rajonet lindore. Specia është e listuar si DD në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe si LC në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin Mesdhetar.

***Colias alfacariensis*/Berger's Clouded Yellow**
Verdhoshja e turbulit e Bergerit
Pieridae –Coliadinae





***Colias alfacariensis*, dhe harta e shpërhapjes**

Colias alfacariensis është një flutur mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 21–27 mm, e dallueshme nga ngjyra e verdhë e ndritshme në anën e sipërme dhe shenjat apikale jo të gjera, si dhe nga nuanca bazale e errët e reduktuar që kufizohet në s1a dhe nuk shtrihet në qelizë. Shenjat submarginale shpesh mungojnë, ndërsa nëse janë të pranishme, shenjat margjinale mbeten të vogla. Ana e poshtme karakterizohet nga një njollë e ndritshme portokalli diskale. Femra është e ngjashme ose pak më e madhe, me anën e sipërme zakonisht të bardhë, megjithëse janë raportuar edhe ekzemplarë të rrallë të verdhë. Mund të ngatërrohet me *Colias hyale*.
Specia zhvillon të paktën dy gjenerata të plota, me një të tretë të plotë ose të pjesshëm në varësi të lartësisë, dhe fluturon nga prilli deri në tetor; vezët zhvillohen për 4–7 ditë, larvat dimërojnë në stadin L3 të vendosura në anën e sipërme të gjethes së bimës ushqimore pranë tokës, ndërsa pupacioni zgjat 8–15 ditë. Banon në kullota të thata dhe shkëmbore me shkurre të shpërndara, nga lartësi të ulëta deri në mesatare, deri në rreth 1700 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore modeste dhe dendësi popullate që mund të jetë e lartë. Larvat ushqehen kryesisht me *Hippocrepis comosa*, herë pas here me *Securigera varia* ose *Coronilla*, dhe rrallë me *Astragalus monspessulanus*, ndërsa të rriturit vizitojnë një gamë të gjerë lulesh, shpesh *H. comosa* në pranverë.
Në Shqipëri është e përhapur në zonat malore; gjendet në të gjithë Ballkanin, Evropën dhe më tej drejt Azisë. Specia është e vlerësuar si LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Colias aurorina*/Greek Clouded Yellow**
Grekja me krah me re
Pieridae – Coliadinae





***Colias aurorina*, dhe harta e shpërhapjes**

Colias aurorina është një flutur mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 27–28 mm, pak më e madhe se speciet e tjera të gjinisë *Colias*, e dallueshme nga ngjyra portokalli e zbehtë në anën e sipërme dhe reflektimet vjollcë të dukshme në dritë të pjerrët. Flatrat e përparme kanë një kufi të gjerë margjinal të zi, të ndërprerë nga venat e verdha, si dhe një shenjë seksi të dukshme mbi venën mesatare. Ana e poshtme është e verdhë-gjelbër me skaje të kuqërremta, ndërsa zona diskale e verdhë mund të mungojë ose të jetë rudimentare. Femra është pak më e madhe, me anën e sipërme portokalli pa reflektime vjollcë; janë regjistruar edhe forma të rralla të bardha (forma fountanei), dhe paraqet njolla të mëdha nënmarginale gjelbër-të verdha. Ana e poshtme është gri-gjelbër me një njollë të vogël diskale të zbehtë dhe një brez nënmarginal të zbehtë të vazhdueshëm. Mund të ngatërrohet me *Colias croceus, Colias caucasica* dhe *Colias alfacariensis*.
Specia zhvillon një gjeneratë në vit dhe fluturon nga maji deri në korrik, në varësi të lartësisë; vezët kanë zhvillim të shkurtër, larvat dimërojnë si individë të rinj dhe ushqehen në pranverë deri në pupacion, ndërsa faza e pupës është e shkurtër. Banon në shpate të ashpra malore mbi toka gëlqerore nga rreth 1000 deri mbi 2000 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore të larta dhe dendësi popullate që mund të jetë e lartë. Larvat ushqehen me shkurre të ulëta me gjemba të gjinisë *Astracantha* (*A. parnassi, A. cretica, A. thracica*), ndërsa të rriturit vizitojnë një gamë të gjerë lulesh për nektar.
Në Shqipëri është lokale në jug, në kufirin verior të përhapjes së saj në Ballkan; gjendet në të gjithë Ballkanin, Evropën dhe më tej drejt Azisë. Specia është e listuar si NT në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe si LC në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Colias caucasica*/Balkan Clouded Yellow**
Verdhoshja e turbullt e Balkanit
Pieridae - Coliadinae





***Colias caucasica*, dhe harta e shpërhapjes**

Colias caucasica është një flutur mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 25–27 mm, e dallueshme nga ngjyrosja portokalli-e kuqe e thellë në anën e sipërme dhe kufiri i errët i thjeshtë pa vena të verdha. Flatrat e pasmë paraqesin një shenjë seksi të shndritshme mbi venën mesatare dhe hënëza të vogla të zbehta submarginale që kufizojnë brezin e zi margjinal. Femra është e ngjashme në madhësi ose pak më e madhe, me anën e sipërme portokalli-e kuqe të thellë që kontraston fort me kufirin e errët dhe me njolla të vogla të verdha midis venave; forma të bardha (rebeli) janë të rralla. Flatrat e pasmë të femrës janë pak më të errëta me njolla të theksuara të verdha të zbehta submarginale. Mund të ngatërrohet me *Colias aurorina* dhe *Colias croceus*, ndërsa femrat gjithashtu me *Colias alfacariensis*. Specia zhvillon një gjeneratë në vit dhe shfaqet nga qershori deri në korrik; faza e vezës është e shkurtër, larvat besohet se dimërojnë si individë të rinj dhe ushqehen gjatë pranverës deri në pupacion, ndërsa faza e pupës është e shkurtër. Banon në shpate të hapura me bar dhe të kullotura gjerësisht, ku *Chamaecytisus* mbulon sipërfaqe të mëdha, zakonisht në nivele subalpine pranë ose mbi vijën pyjore (1000–2000 m mbi nivelin e detit); individë nomadë mund të gjenden edhe më lart. Ka kërkesa të larta hapësinore dhe mund të paraqitet me dendësi të lartë. Larvat ushqehen me *Chamaecytisus eriocarpus, C. supinus* dhe *C. triflorus*, ndërsa të rriturit vizitojnë një shumëllojshmëri lulesh për nektar. Në Shqipëri është shumë lokal në rajonet veriore, në kufirin perëndimor të përhapjes së tij evropiane; gjendet në të gjithë Ballkanin dhe në pjesë të tjera të Evropës, si dhe në Kaukaz dhe Transkaukaz. Specia është e listuar si EN në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe si VU B2ab (iii,v)c(iv) në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Colias croceus*/Clouded Yellow**
Verhoshja krocea
Pieridae –Coliadinae





***Colias croceus*, dhe harta e shpërhapjes**

Colias crocea është një flutur mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 23–27 mm, që shfaq ndryshime në madhësi në varësi të gjeneratës dhe kushteve të thatësirës, e dallueshme nga ngjyrosja e verdhë-portokalli e ndritshme në anën e sipërme. Flatrat e përparme kanë vena të verdha që kalojnë përmes kufirit të zi, ndërsa flatrat e pasmë paraqesin një kufi të zi që rrallë ndërpritet nga vena të verdha dhe një shenjë seksi të dukshme pranë bazës në hapësirën 7. Femra është e ngjashme ose pak më e madhe, me ngjyrë bazë të verdhë-portokalli të ndritshme; forma të bardha ose gjelbërta-të bardha (helice) nuk janë të rralla. Flatrat e përparme në anën e sipërme mund të tregojnë një sufuzion gri bazal dhe një kufi me njolla të verdha që nuk kontrastojnë fort me ngjyrën bazë. Mund të ngatërrohet me *Colias aurorina* dhe *Colias caucasica*, ndërsa femrat edhe me *Colias alfacariensis*. Specia zhvillon dy deri në tre gjenerata në vit dhe fluturon nga marsi deri në nëntor, shpesh me sjellje migratore drejt veriut; vezët zhvillohen për 4–7 ditë, larvat dimërojnë dhe ushqehen gjatë periudhave pa ngrica, ndërsa faza e pupës zgjat 8–15 ditë. Banon në një gamë të gjerë habitatësh të hapur dhe mund të gjendet deri në rreth 2500 m mbi nivelin e detit, me kërkesa të larta hapësinore dhe shpesh me dendësi të lartë për shkak të natyrës migratore. Larvat ushqehen me një shumëllojshmëri të gjerë bimësh bishtajore, përfshirë *Astragalus, Chamaecytisus, Colutea, Coronilla varia, Hippocrepis, Lotus, Medicago, Melilotus, Onobrychis, Robinia pseudoacacia, Securigera varia, Trifolium* dhe *Vicia*, ndërsa të rriturit vizitojnë një gamë të gjerë lulesh për nektar. Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht; gjendet në të gjithë Ballkanin, Evropën dhe më tej drejt Azisë. Specia është e vlerësuar si LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Gonepteryx cleopatra*/Cleopatra**
Kleopatra
Pieridae –Coliadinae





***Gonepteryx cleopatra*, dhe harta e shpërhapjes**

Gonepteryx cleopatra është një flutur e madhe, me gjatësi të flatrave të përparme prej 25–30 mm, e dallueshme nga ngjyra portokalli e thellë në flatrat e përparme të sipërm, e rrethuar nga një kufi i verdhë margjinal, ndërsa pjesa e poshtme e të dy flatrave është e verdhë-jeshile e zbehtë, veçanërisht përgjatë bregut. Kufiri i jashtëm i flatrave të pasmë në venën 3 është pak i dhëmbëzuar dhe jo shumë i theksuar. Femra është e ngjashme ose pak më e madhe, me një ngjyrë gjelbër-të bardhë (me raste edhe forma të rralla të verdha); në anën e poshtme të flatrave të përparme shpesh shihet një nuancë e zbehtë portokalli përmes qelizës, ndërsa kufiri i flatrave të pasmë mbetet pak i dhëmbëzuar si tek meshkujt. Individët që kanë dimëruar mund të duken të zbardhur dhe të dëmtuar në majat e flatrave, duke u ngatërruar me *Gonepteryx farinosa* ose *Gonepteryx rhamni*.
Specia zhvillon një gjeneratë në vit dhe shfaqet nga qershori deri në gusht; individët dimërojnë dhe mund të fluturojnë përsëri deri në maj, duke pasur një jetëgjatësi shumë të gjatë. Vezët çelin brenda rreth një jave, larvat ushqehen për 5–6 javë në pranverë dhe faza e pupës është e shkurtër. Banon në zona me shkurre dhe hapësira pyjore, shpesh në kodra shkëmbore malore deri në rreth 1700 m mbi nivelin e detit, me kërkesa të larta hapësinore dhe shpesh me dendësi të lartë, ndërsa individët mund të tregojnë sjellje nomade. Larvat ushqehen me specie të gjinisë *Rhamnus*, ndërsa të rriturit shpesh grumbullohen për t'u ushqyer me lule të larta, përfshirë gjemba.
Në Shqipëri është lokale; gjendet në të gjithë Ballkanin, në pjesë të Evropës dhe më tej në Azinë e Vogël dhe Lindjen e Afërt. Specia është e listuar si NT në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe si LC në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Gonepteryx farinosa*/Powdered Brimstone**
Limonja e arrçit
Pieridae –Coliadinae





***Gonepteryx farinosa*, dhe harta e shpërhapjes**

Gonepteryx farinosa është një flutur e madhe, me gjatësi të flatrave të përparme prej 28–32 mm, duke qenë specia më e madhe në gjininë Gonepteryx, e dallueshme nga ngjyra e verdhë e ndritshme në bazë të flatrave të përparme të sipërm dhe nga luspat paksa të ashpra, ndërsa flatrat e pasmë të sipërm janë dukshëm më të zbehtë. Kufiri i jashtëm i flatrave të pasmë është i dhëmbëzuar dhe maja e antenave paraqitet më e zbehtë në anën e sipërme. Femra është pak më e madhe, me anën e sipërme zakonisht të bardhë (rrallë të verdhë) dhe me një breg të gjelbër që bën kontrast me zonën e brendshme pothuajse të bardhë të anës së poshtme; kufiri i flatrave të pasmë mbetet i skalopuar dhe antenat po ashtu më të zbehta sipër. Mund të ngatërrohet me *Gonepteryx cleopatra* dhe *Gonepteryx rhamni*.
Specia zhvillon një gjeneratë në vit dhe fluturon nga fillimi i qershorit deri në korrik; individët dimërojnë dhe rishfaqen në fillim të pranverës deri në prill, duke pasur një jetëgjatësi shumë të gjatë. Vezët zhvillohen shpejt, larvat ushqehen nga marsi deri në korrik (në varësi të lartësisë) për rreth 5–6 javë para pupacionit, ndërsa faza e pupës është e shkurtër. Banon në zona të ngrohta, të thata dhe shkëmbore me shkurre të shpërndara, nga rreth 300 deri në 1700 m mbi nivelin e detit, duke kërkuar hapësira të mëdha të hapura; popullatat mund të jenë të dendura në habitate të favorshme dhe shpesh shfaqin sjellje nomade. Larvat ushqehen kryesisht me specie të gjinisë *Rhamnus* dhe *Paliurus spina-christi*, me raste edhe me *Pistacia, Rhus* dhe *Buxus*, ndërsa të rriturit shpesh ushqehen në grupe mbi gjemba të gjatë dhe lule të tjera të spikatura. Në Shqipëri është shumë lokale dhe kërkon studime të mëtejshme; gjendet në të gjithë Ballkanin, Evropën dhe më tej drejt Azisë. Specia është e listuar si NT në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe si LC në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Gonepteryx rhamni*/Brimstone**
Limonja e barbletës
Pieridae –Coliadinae





***Gonepteryx rhamni*, dhe harta e shpërhapjes**

Gonepteryx rhamni është një flutur e madhe, me gjatësi të flatrave të përparme prej 26–30 mm, e dallueshme nga ngjyra uniforme e verdhë limoni në anën e sipërme të të dy flatrave dhe nga mungesa e një pamjeje të ashpër në luspat e flatrave të përparme. Flatrat e pasmë paraqesin një kënd të dukshëm dhëmbëzor në kufirin e jashtëm në v3. Femra është e ngjashme në madhësi dhe shenja, por me një ngjyrë më të zbehtë gjelbër-të bardhë në anën e sipërme. Mund të ngatërrohet me *Gonepteryx cleopatra* dhe *Gonepteryx farinosa*.
Specia zhvillon një gjeneratë në vit dhe shfaqet nga maji deri në gusht; individët dimërojnë në shkurre dhe rifillojnë fluturimin deri në prill, duke pasur një jetëgjatësi jashtëzakonisht të gjatë. Faza e vezës zgjat 4–8 ditë, ajo e larvës 24–43 ditë dhe pupa 9–16 ditë. Banon kryesisht në zona pyjore, por edhe në habitate të hapura me bar dhe shkëmbore me kullota të dendura, si dhe në parqe dhe kopshte, deri në rreth 2000 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa të larta hapësinore dhe popullatat mund të jenë të dendura, shpesh me sjellje nomade ose migratore. Larvat ushqehen me specie të gjinisë *Rhamnus* dhe *Frangula alnus*, ndërsa të rriturit vizitojnë një shumëllojshmëri lulesh në varësi të stinës.
Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht; gjendet në të gjithë Ballkanin, Evropën dhe më tej drejt Azisë. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet si NE, ndërsa në nivel Evropian klasifikohet si specie me shqetësim të ulët LC.

***Leptidea duponcheli*/Eastern Wood White**
Flutura e Duponkelit
Pieridae –Dismorphinae





***Leptidea duponcheli*, dhe harta e shpërhapjes**

Leptidea duponcheli është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 17–21 mm, e dallueshme nga ngjyra e bardhë e anës së sipërme me një nuancë të zbehtë të verdhë. Flatrat e përparme paraqesin një shenjë gri apikale në gjeneratën e pranverës dhe një shenjë më të vogël të zezë në gjeneratën e verës. Ana e poshtme e flatrave të pasmë është jeshile-gri me mbushje uniforme në pranverë (përveç bazës), ndërsa në verë është e verdhë pa shenja të errëta. Këmbëza e antenave është portokalli-kafe. Femra është e ngjashme në madhësi dhe formë, por shenja apikale është shumë e zbehtë në pranverë ose mungon në verë; përndryshe modeli dhe ngjyrosja janë të njëjta. Mund të ngatërrohet me *Leptidea sinapis* dhe *Leptidea juvernica*. Specia zhvillon dy deri në tre gjenerata në lartësi të ulëta dhe fluturon nga prilli deri në shtator; faza e vezës është e shkurtër, larvat zhvillohen për rreth pesë javë dhe faza e pupës zgjat rreth dy javë, por mund të zgjasë shumë më tepër te individët që dimërojnë. Banon në zona të hapura shkëmbore, të ngrohta dhe me diell, të pasura me shkurre, në lartësi deri në rreth 1200 m mbi nivelin e detit, me kërkesa të ulëta hapësinore dhe ndonjëherë me dendësi të lartë popullate. Larvat ushqehen me specie të gjinisë *Onobrychis, Lathyrus* dhe *Lotus*, si dhe janë regjistruar edhe *Medicago sativa falcata* dhe *Vicia*, ndërsa të rriturit ushqehen me një shumëllojshmëri lulesh të ulëta. Në Shqipëri është lokale në rajonet malore; gjendet në të gjithë Ballkanin, Evropën dhe më tej drejt Azisë. Specia është e listuar si VU B1 në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe si LC në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Leptidea juvernica*/Cryptic Wood White**
Bardhoshja kriptike e drurit
Pieridae -Dismorphinae





***Leptidea juvernica*, dhe harta e shpërhapjes**

Leptidea juvernica është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 19–24 mm, e dallueshme nga ngjyra e bardhë e anës së sipërme. Flatrat e përparme paraqesin një shenjë të madhe këndore gri në gjeneratën e pranverës, e cila shtrihet përgjatë bregut, ndërsa në gjeneratën e verës kjo shenjë bëhet më e vogël dhe më pak e dukshme. Ana e poshtme e flatrave të pasmë tregon shenja të errëta të theksuara në pranverë, të cilat reduktohen ndjeshëm në verë. Këmbëza e antenës është e zezë me një njollë të bardhë në pjesën e poshtme. Femra është e ngjashme në madhësi, me shenjë apikale që paraqitet si vija gri të zbehta në pranverë ose mungon në verë; përndryshe modeli është i njëjtë me mashkullin. Mund të ngatërrohet me *Leptidea duponcheli* dhe *Leptidea sinapis*. Specia zhvillon zakonisht dy gjenerata dhe shfaqet nga qershori deri në gusht; në lartësi më të ulëta mund të ndodhë edhe një brez i tretë i pjesshëm. Faza e vezës është e shkurtër, larvat zhvillohen për rreth pesë javë dhe faza e pupës është gjithashtu e shkurtër. Banon në livadhe me bar të lagësht dhe në skaje pyjore, si dhe është regjistruar në habitate ligatinore, kryesisht në lartësi mbi 1500 m mbi nivelin e detit, shpesh në të njëjtat zona me *Leptidea sinapis*. Ka kërkesa të ulëta hapësinore dhe dendësia e popullatës mund të jetë e lartë. Larvat ushqehen me specie të gjinisë *Lathyrus*, si dhe janë regjistruar edhe *Coronilla varia*, specie të *Lotus, Medicago sativa falcata* dhe *Vicia*, ndërsa të rriturit ushqehen me një shumëllojshmëri lulesh të ulëta. Në Shqipëri është regjistruar vetëm një herë në rajonet veriore, në kufirin jugor të përhapjes së saj në Ballkan; gjendet në të gjithë rajonin dhe në pjesë të tjera të Evropës, si dhe në Transkaukaz dhe më tej në lindje. Shpërndarja e saj kërkon studime të mëtejshme. Është e listuar si DD në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe si LC në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Leptidea sinapis*/Wood White**
Flutura e mustardës
Pieridae –Dismorphinae





***Leptidea sinapis*, dhe harta e shpërhapjes**

Leptidea sinapis është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 19–24 mm, e dallueshme nga ngjyra e bardhë e anës së sipërme dhe nga shenja e madhe këndore gri në gjeneratën e pranverës, e cila nuk shtrihet përgjatë bregut; në gjeneratën e verës kjo shenjë zëvendësohet nga një njollë më e vogël apikale e zezë. Ana e poshtme e flatrave të pasmë paraqet shenja të errëta të theksuara në pranverë, të cilat reduktohen shumë ose bëhen pothuajse të bardha në verë. Këmbëza e antenës është e zezë me një njollë të bardhë në pjesën e poshtme. Femra është e ngjashme në madhësi, me shenjë apikale të përbërë nga vija gri të zbehta në pranverë ose që mungon në verë; përndryshe është e njëjtë me mashkullin. Mund të ngatërrohet me *Leptidea duponcheli* dhe *Leptidea juvernica.* Specia zhvillon dy deri në tre gjenerata në varësi të lartësisë dhe fluturon nga prilli deri në shtator; faza e vezës zgjat 5–10 ditë, ajo e larvës 18–33 ditë dhe faza e pupës 9–15 ditë, ndërsa gjatë dimrit pupa qëndron e bashkangjitur në kërcell bime për një periudhë më të gjatë. Banon në lëndina dhe livadhe të pyllëzuara, në kullota të thata deri mezofile, deri në rreth 2000 m mbi nivelin e detit, shpesh në të njëjtat habitate me Leptidea juvernica. Ka kërkesa të ulëta hapësinore dhe mund të arrijë dendësi të lartë popullate. Larvat ushqehen kryesisht me specie të gjinisë *Lotus* dhe *Lathyrus*, si dhe me *Coronilla varia, Medicago sativa falcata* dhe *Vicia*, ndërsa të rriturit ushqehen me një shumëllojshmëri lulesh të ulëta. Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht; gjendet në të gjithë Ballkanin, në Evropë dhe më tej drejt Azisë. Specia është e vlerësuar si LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Anthocharis cardamines*/Orange Tip**
Flutura Aurorë
Pieridae –Pierinae





***Anthocharis cardamines*, dhe harta e shpërhapjes**

Anthocharis cardamines është një flutur mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 19–24 mm, e dallueshme nga ana e sipërme e bardhë me njollë të vogël të zezë të vendosur brenda zonës apikale portokalli, ndërsa maja dhe kufiri margjinal janë gri. Ana e poshtme e flatrave të përparme paraqet nuanca të verdha-jeshile në majë, ndërsa flatrat e pasmë kanë një ngjyrosje të gjerë të verdhë-jeshile me shenja të buta. Femra është e ngjashme në madhësi dhe formë me mashkullin, por në vend të zonës apikale portokalli ka një njollë të zezë më të madhe dhe më të theksuar; por modeli është i njëjtë me mashkullin. Lloji mund të ngatërrohet me *Anthocharis damone, Anthocharis gruneri, Euchloe ausonia* dhe *Pontia edusa.*
Specia zhvillohet në një brezni të vetëme nga marsi deri në korrik, në varësi të lartësisë; faza e vezës zgjat 3–10 ditë, ajo e larvës 11–34 ditë dhe faza e pupës 46–49 javë. Lloji dimëron në fazën pupë. Banon në një gamë të gjerë livadhesh me lule, nga niveli i detit deri në rreth 1900 m mbi nivelin e detit, ka kërkesa hapësinore të moderuara dhe aftësi për të arritur dendësi të lartë popullate, shpesh me sjellje nomade. Larvat ushqehen kryesisht me specie të familjes Brassicaceae, përfshirë *Cardamine, Alliaria petiolata* dhe *Arabis,* si dhe me gjini të tjera si *Barbarea, Capsella, Draba, Lepidium* dhe *Sinapis*, ndërsa të rriturit ushqehen kryesisht me nektarin e luleve të kësaj familjeje.
Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht dhe gjendet në të gjithë Ballkanin, në Evropë dhe më tej drejt Azisë së Vogël dhe Kaukazit. Specia është e listuar si NE në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe si LC në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Anthocharis damone*/Eastern Orange Tip**
Lindorja majëshenjuar portokalli
Pieridae –Pierinae





***Anthocharis damone* ♂, dhe harta e shpërhapjes**

Anthocharis damone është një flutur mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 19–21 mm, e dallueshme nga ana e sipërme e verdhë e ndezur me një njollë të zezë në zonën apikale portokalli, ndërsa maja dhe kufiri margjinal janë gri. Ana e poshtme e flatrave të përparme paraqet një zonë apikale të verdhë, ndërsa flatrat e pasmë janë të verdha me shenja të gjelbër-gri, të ngjashme me ato të *Anthocharis cardamines*. Femra është pak më e madhe, por përndryshe e ngjashme me mashkullin; tek meshkujt mungon njolla apikale portokalli në anën e sipërme, ndërsa modeli i pjesës së poshtme mbetet i njëjtë. Mund të ngatërrohet me *Anthocharis cardamines* dhe *Anthocharis gruneri*.
Specia zhvillohet në një brez të vetëm nga marsi deri në maj, në varësi të lartësisë; vezët kanë një zhvillim të shkurtër, larvat ushqehen në pranverë dhe specia dimëron në fazën e pupës, e cila ka një periudhë të gjatë zhvillimi. Banon në shpate shkëmbore të hapura me lule dhe argjinatura deri në rreth 1100 m mbi nivelin e detit. Lloji ka kërkesa hapësinore të moderuara dhe popullata mund të arrijnë dendësi të lartë, shpesh me individë nomadë. Larvat ushqehen me *Isatis tinctoria* dhe *Aethionema saxatile*, ndërsa të rriturit ushqehen me një shumëllojshmëri lulesh.
Në Shqipëri është shumë lokale e referuar vetëm në jug të Shqipërisë, gjendet në Ballkan, Evropë dhe është e shpërhapur edhe më tej drejt Azisë së Vogël dhe Kaukazit. Si rezultat i vlerësimit bazuar në treguesët e IUCN është e listuar si NT në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe EN B2ab(v) në Listën e Kuqe Evropiane të IUCN-së.

***Anthocharis gruneri*/Gruner's Orange Tip**
Aurora e Grunerit
Pieridae -Pierinae





***Anthocharis gruneri*, dhe harta e shpërhapjes**

Anthocharis gruneri është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 15–18 mm, e dallueshme nga ana e sipërme me ngjyrim të verdhë të çelët me një njollë të vogël të zezë dhe në zonën apikale portokalli, ndërsa maja dhe kufiri margjinal janë gri, me skaje të kuadratuara. Ana e poshtme e flatrave të përparme ka një majë të ngjyrosur në të verdhë-gri pak të njollosur, ndërsa flatrat e pasmë janë të verdha me shenja gri-gjelbër, të ngjashme me ato të *Anthocharis cardamines*. Femra është e ngjashme në madhësi me mashkullin, por ka një njollë të madhe të dukshme diskale gri në anën e sipërme, me kufi të gjerë apikal dhe skaje gri të kuadratuara; pjesa e poshtme është e ngjashme me mashkullin. Mund të ngatërrohet me *Anthocharis cardamines, Anthocharis damone, Euchloe ausonia* dhe *Pontia edusa*.
Specia zhvillon një brezni të vetme nga marsi deri në qershor; vezët çelin pas një faze të shkurtër, larvat ushqehen në pranverë dhe specia dimëron si pupë me një fazë të gjatë zhvillimi. Banon në shpate shkëmbore të hapura, të nxehta dhe të thata, të rrethuara. Lloji gjendet deri në rreth 1600 m mbi nivelin e detit, ka kërkesa hapësinore të vogla, mundësi për dendësi të lartë popullate dhe sjellje nomade. Larvat ushqehen me *Aethionema saxatile*, ndërsa të rriturit ushqehen me një shumëllojshmëri lulesh.
Në Shqipëri është shumë i lokalizuar dhe kërkon studime të mëtejshme; gjendet në Ballkan, në pjesën më të madhe të Evropës dhe është i shpërhapur edhe më tej drejt Azisë së Vogël dhe Kaukazit. Kjo specie është e listuar si NT në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe si LC në Listën e Kuqe të IUCN-së për zonëm Evropiane.

***Aporia crataegi*/Black-veined White**
Bardhoshja e murizës
Pieridae –Pierinae





***Aporia crataegi*, dhe harta e shpërhapjes**

Aporia crataegi është një flutur e madhe, me gjatësi të flatrave të përparme prej 28–34 mm, e dallueshme nga ana e sipërme e bardhë me vena të zeza. Ana e poshtme është e ngjashme me anën e sipërme, me nuanca të zbehta dhe model të thjeshtë. Femra është pak më e madhe, por e ngjashme me mashkullin; në disa raste individët e vjetër mund të shfaqin transparencë të theksuar të krahëve për shkak të konsumimit të luspave. Mund të ngatërrohet me *Parnassius mnemosyne*.
Specia zhvillohet në një brezni të vetme nga prilli deri në korrik, me jetëgjatësi të shkurtër rreth 2 javë; vezët çelin pas 12–23 ditësh, larvat e hershme jetojnë në streha me rrjetë dhe dimërojnë si larva gjysmë të rritura në fole të përbashkëta me 10–40 individë, duke rifilluar ushqimin në pranverë, ndërsa faza e pupës zgjat 12–19 ditë. Banon në zona të ngrohta me shkurre, shpesh edhe në pemishte, nga ultësirat deri në rreth 1700 m mbi nivelin e detit, me aftësi për t'u shfaqur edhe më lart në formën e individëve nomadë. Ka kërkesa hapësinore të moderuara, mund të arrijë dendësi të lartë dhe shfaq sjellje nomade, dhe në disa vite migron në distanca të gjata. Larvat ushqehen me specie të ndryshme *Rosaceae*, përfshirë *Crataegus, Prunus, Pyrus*, si dhe *Malus, Sorbus, Amygdalus* dhe *Rosa*, ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga një shumëllojshmëri lulesh të ulëta.
Në Shqipëri është e përhapur dhe gjendet në të gjithë Ballkanin, në Evropë dhe më tej drejt Azisë së Vogël dhe rajoneve lindore. Specia është e vlerësuar si LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Euchloe ausonia*/Eastern Dappled White**
Ausonja
Pieridae –Pierinae





***Euchloe ausonia*, dhe harta e shpërhapjes**

Euchloe ausonia është një flutur mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 20–24 mm, e dallueshme nga ana e sipërme e bardhë dhe nga një njollë e zezë diskale e ngushtë, me hije të errët pranë buzës së flatrës. Ana e poshtme e flatrave të përparme paraqet një njollë diskale me qendër të bardhë dhe me nuanca të gjelbra në majë, ndërsa flatrat e pasmë shfaqin shenja të gjera të gjelbra me pamje pak të pluhurosur në të verdhë. Femra është pak më e madhe, por e ngjashme me mashkullin; tek individët më të mëdhenj njolla diskale në anën e sipërme të flatrave të përparme është më e madhe, ndërsa flatrat e pasmë mund të kenë një ngjyrë të verdhë të zbehtë në bazë. Mund të ngatërrohet me *Pontia edusa, Anthocharis cardamines* dhe *Anthocharis gruneri.*
Specia zhvillohet në dy breza (me një brez të dytë të pjesshëm) nga marsi deri në qershor; vezët çelin pas një periudhe të shkurtër, larvat zhvillohen shpejt dhe dimëron në fazën e pupës. Banon në zona të hapura dhe të thata me lule të bollshme, shpesh pranë tokave bujqësore, nga ultësirat deri në rreth 1300 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore mesatare deri të larta dhe me sjellje nomade. Larvat ushqehen me lloje të ndryshme *Brassicaceae*, përfshirë *Aethionema saxatile, Biscutella laevigata, Brassica nigra, Bunias erucago, Iberis sempervirens, Sinapis* dhe *Sisymbrium*, ndërsa të rriturit ushqehen me një shumëllojshmëri lulesh.
Në Shqipëri është e përhapur dhe gjendet në të gjithë Ballkanin, në Evropë dhe më tej drejt Azisë së Vogël dhe rajoneve lindore. Specia është e listuar si NE në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe Evropiane sipas kritereve të IUCN-së.

***Euchloe penia*/Eastern Greenish Black-tip**
Verdhoshja e vogël
Pieridae –Pierinae





***Euchloe penia*, dhe harta e shpërhapjes**

Euchloe penia është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej rreth 18 mm, e dallueshme nga ngjyra e verdhë squfuri në anën e sipërme dhe nga njolla e madhe e zezë diskale në flatrat e përparme, si dhe nga maja e errët me njolla të verdha të zbehta/difuze; ana e poshtme e flatrave të përparme paraqet vija kufitare të kuqe dhe një majë uniforme të gjelbër, ndërsa ana e poshtme e flatrave të pasmë është e gjelbër-gri e njollosur me shenja të zbehta. Femra është e ngjashme në madhësi, me shenjë diskale më të theksuar në flatrat e përparme por e ngjashme në figure me mashkullin. Speciet e ngjashme: asnjë. Specia fluturon në një brezni që jeton gjatë ose në dy brezni pjesërisht të mbivendosura me njëra tjetrën. Lloji fluturon nga prilli deri në fillim të gushtit; vezët çelin pas një faze të shkurtër, vemjet zhvillohen shpejt dhe specia dimëron në fazën pupë. Banon në vende të hapura, të thata dhe të ngrohta shkëmbore, zakonisht në toka gëlqerore nga 700 deri në 1500 m mbi nivelin e detit ose më lart, me kërkesa hapësinore të ulëta dhe mundësi për dendësi të lartë popullate. Vemjet ushqehen *me Matthiola fruticulosa* dhe *Hesperis laciniata*, ndërsa të rriturit ushqehen me një larmi të madhe lulesh të bimëve të ulëta. Në Shqipëri është shumë lokale dhe kërkon më shumë studim; gjendet në të gjithë Ballkanin dhe më gjerë në Evropë, Azinë e Vogël dhe Lindjen e Afërt. Referuar kritereve të IUCN-së, kjo specie është e listuar si VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe si NT B2a në Listën e Kuqe Evropiane.

***Pieris balcana*/Balkan Green-veined White**
Bardhoshja e Ballkanit
Pieridae –Pierinae





***Pieris balcana*, dhe harta e shpërhapjes**

Pieris balcana është një flutur mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 20–24 mm, e dallueshme nga njolla e zezë apikale në flatrat e përparme që shtrihet përgjatë skajit të jashtëm si trekëndësh ose njolla në majat e venave, si dhe nga ndryshimet e theksuara të modelit në pjesën e poshtme midis brezave të pranverës dhe verës, ku shfaqet një shtresë e errët difuze përgjatë venave. Femra është e ngjashme në madhësi dhe model me mashkullin, me të njëjtat tipare apikale dhe variacione sezonale në anën e poshtme. Mund të ngatërrohet me *Pieris napi*.
Specia ka gjasa të ketë disa breza nga fillimi i pranverës deri në tetor; vezët zhvillohen shpejt, larvat zhvillohen me ritëm të shpejtë dhe dimërimi ndodh në fazën pupë. Ka kërkesa hapësinore modeste dhe dendësi popullate të moderuar, ndërsa larvat ushqehen me *Brassicaceae* sp., të rriturit ushqehen me lule të ndryshme.
Në Shqipëri është lokale në zonat malore dhe është e përhapur në të gjithë Ballkanin. Specia është e vlerësuar si LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Pieris brassicae*/Large White**
Flutura e lakrës
Pieridae -Pierinae






***Pieris brassicae* ♀, dhe harta e shpërhapjes**

Pieris brassicae është një flutur e madhe, me gjatësi të flatrave të përparme prej 28–33 mm, e dallueshme nga ana e sipërme me ngjyrë të bardhë me një njollë apikale të zezë dhe nga efekti i "pluhurimit" të dendur me luspa të errëta në anën e poshtme, i cili në gjeneratat e pranverës krijon një nuancë të gjelbër, ndërsa në gjeneratat e verës mund të jetë i reduktuar ose të mungojë. Femra është e ngjashme në madhësi dhe model, me të njëjtat tipare të njollës apikale dhe variacione sezonale në anën e poshtme. Mund të ngatërrohet me *Pieris ergane*, *Pieris mannii* dhe *Pieris rapae*.
Specia zhvillon dy deri në tre gjenerata/brezni nga marsi deri në tetor dhe ka një jetëgjatësi relativisht të gjatë; vezët çelin brenda 4–7 ditësh, larvat zhvillohen për 13–24 ditë dhe pupacioni është i shkurtër, ndërsa pupa e ekspozuar dimëron e ngjitur në gurë, mure ose trungje. Banon në një gamë të gjerë habitatesh me lule nga ultësirat deri në 2000 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore mesatare dhe potencial për dendësi të lartë popullate, shpesh duke shfaqur sjellje migratore të lartë. Larvat ushqehen me lloje të ndryshme *Brassicaceae*, ndërsa të rriturit ushqehen me një shumëllojshmëri lulesh.
Në Shqipëri është e përhapur dhe gjendet në të gjithë Ballkanin dhe më gjerë në Evropë, Azi të Vogël dhe rajonet përreth. Specia është e vlerësuar si LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Pieris ergane*/Mountain Small White**
Bardhosja e vogël e lartësive
Pieridae –Pierinae





***Pieris ergane*, dhe harta e shpërhapjes**

Pieris ergane është një flutur e vogël deri në mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 19–23 mm, e dallueshme nga fakti se është Pieris më e vogël, me anën e sipërme të bardhë dhe një shenjë apikale katrore gri kryesisht në flatrat e përparme, si dhe me një njollë postdiskale të zbehtë ose që mungon në s3; në flatrat e pasmë të sipërme shpesh mungon një shenjë e vogël gri në buzë në s6. Ana e poshtme paraqet një zonë apikale të verdhë pa njolla të errëta, ndërsa flatrat e pasmë janë të verdhë me nuancë gri të pluhurosur. Femra është e ngjashme në madhësi dhe model, por me shenjë apikale më të madhe katrore gri dhe dy njolla postdiskale më të theksuara në gjeneratat verore; në flatrat e pasmë mund të shfaqet një njollë në buzë në s6. Mund të ngatërrohet me *Pieris brassicae, Pieris mannii* dhe *Pieris rapae*.
Specia ka dy deri në tre gjenerata nga prilli deri në gusht; vezët çelin shpejt, larvat zhvillohen shpejt dhe pupacioni përfshin dimërimin. Banon në vende të thata dhe të nxehta shkëmbore me shkurre të shpërndara nga ultësirat deri në 1800 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore të moderuara dhe mundësi për dendësi të lartë popullate. Larvat ushqehen me *Aethionema* (sidomos *A. saxatile*) dhe *Isatis tinctoria*, ndërsa të rriturit ushqehen me lule të ndryshme.
Në Shqipëri është e përhapur në zonat malore, gjendet në të gjithë Ballkanin, por edhe e përhapur më gjerë në Evropë dhe Azinë e Vogël. Specia është e vlerësuar si LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Pieris krueperi*/Krueper's Small White**
Bardhoshja e Kruperit
Pieridae –Pierinae






***Pieris kreuperi*, dhe harta e shpërhapjes**

Pieris krueperi është një flutur mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 21–25 mm, e dallueshme nga ana e sipërme e bardhë me një njollë të zezë të rrumbullakët në s3 që nuk prek trekëndëshat margjinalë të zinj përgjatë skajit të jashtëm, si dhe nga prania e një shenje preapikale më të theksuar në gjeneratat e verës; flatrat e pasmë të sipërm shpesh tregojnë një shenjë brinjësore në s6. Ana e poshtme paraqet një model tipik gri-jeshil në zonat bazale dhe diskale, i cili bëhet më pak i theksuar në gjeneratat verore dhe mund të reduktohet në zonën brinjësore. Femra është pak më e madhe, me shenja më të gjera të zeza në flatrat e përparme, ku njolla postdiskale mund të prekë trekëndëshat margjinalë pranë skajit të jashtëm, ndërsa ana e poshtme e flatrave të pasmë është e ngjashme me atë të mashkullit. Mund të ngatërrohet me *Pieris rapae* dhe *Pieris mannii*.
Specia zhvillon tre deri në katër breza nga marsi deri në shtator, me vezë dhe larva me zhvillim të shpejtë dhe dimërim në fazën e pupës. Banon në vende të thata, të ngrohta shkëmbore ose karstike nga ultësirat deri në rreth 1200 m mbi nivelin e detit ose më lart, me kërkesa hapësinore të moderuara dhe mundësi për dendësi të lartë popullate. Larvat ushqehen me lloje të gjinisë *Alyssum* dhe të afërme, ndërsa të rriturit ushqehen me një larmi lulesh.
Në Shqipëri është lokale në kufirin verior të arealit të saj në Gadishullin Ballkanik dhe kërkon studime të mëtejshme; gjendet në të gjithë Ballkanin dhe më gjerë në Evropë dhe Azi të Vogël, duke u listuar si VU në Shqipëri dhe si NT B2a në Listën e Kuqe Evropiane bazuar në kriteret e IUCN-së.

***Pieris mannii*/Southern Small White**
Bardhoshja e vogël e jugut
Pieridae – Pierinae





***Pieris mannii*, dhe harta e shpërhapjes**

Pieris mannii është një flutur mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme të ngjashme me Pieris të tjerë (rreth 20–24 mm), e dallueshme nga ana e sipërme e bardhë me shenja të zeza më të theksuara në flatrat e përparme dhe nga një model i qëndrueshëm në varësi të brezave sezonalë, ndërsa ana e poshtme mbetet relativisht e ngjashme me atë të Pieris-ve të tjerë. Femra është e ngjashme në madhësi dhe model, me variacione të vogla në intensitetin e shenjave. Mund të ngatërrohet me *Pieris brassicae, Pieris ergane* dhe *Pieris rapae*.
Specia ka breza të njëpasnjëshëm nga marsi deri në tetor, me zhvillim të shpejtë të vezëve dhe larvave dhe dimërim në fazën e pupës. Banon në vende të ngrohta, të ashpra dhe shkëmbore me shkurre dhe pemë të shpërndara deri në rreth 2000 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore të moderuara dhe dendësi të lartë populate. Lloji tregon zgjerim të përhapjes drejt veriut dhe perëndimit në Evropën Veriperëndimore. Larvat ushqehen me një gamë të gjerë bimësh të familjes Brassicaceae dhe të tjera të lidhura, ndërsa të rriturit ushqehen me lule të ndryshme.
Në Shqipëri është e përhapur dhe gjendet në të gjithë Ballkanin dhe Evropën. Specia është e vlerësuar si LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Pieris napi*/Green-veined White**
Flutura e repës
Pieridae – Pierinae





***Pieris napi*, dhe harta e shpërhapjes**

Pieris napi është një flutur mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 18–22 mm në gjeneratën e pranverës dhe deri në 25 mm në gjeneratën e verës, e dallueshme nga ana e sipërme e bardhë dhe nga njollat apikale të zeza të formuara nga njolla trekëndëshe përgjatë skajeve të venave deri në v2, ku njolla në s3 ndonjëherë mungon. Ana e poshtme tregon ngjyrë të verdhë në bazë, më të theksuar në gjeneratat e pranverës dhe të reduktuar në verë, me mbushje të errët përgjatë venave që në gjeneratat verore mund të bëhet rudimentare dhe mezi e dukshme. Femra është e ngjashme në madhësi dhe model, me të njëjtat karakteristika të njollave postdiskale dhe variacione sezonale. Mund të ngatërrohet me *Pieris balcana*.
Specia zhvillon gjenerata të vazhdueshme nga marsi deri në tetor; vezët çelin brenda 3–7 ditësh, larvat zhvillohen për 11–22 ditë dhe pupacioni zgjat 7–13 ditë, me dimërim në fazën pupale. Banon në një gamë të gjerë habitatesh si fusha me lule, zona bujqësore, kopshte, parqe, lugina lumenjsh dhe zona pyjore të hapura nga ultësirat deri në 2000 m mbi nivelin e
detit, me kërkesa hapësinore të konsiderueshme, dendësi të lartë popullate dhe sjellje nomade. Larvat ushqehen me një gamë të gjerë Brassicaceae, ndërsa të rriturit ushqehen me lule të ndryshme.
Në Shqipëri është e përhapur dhe gjendet në të gjithë Ballkanin dhe Evropën. Lloji në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet si NE, ndërsa në nivel Evropian klasifikohet si specie me shqetësim të ulët LC.

***Pieris rapae* / Small White**
Flutura e vogël e lakrës
Pieridae – Pierinae





***Pieris rapae*, dhe harta e shpërhapjes**

Pieris rapae është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 23–27 mm, e dallueshme nga ana e sipërme e bardhë me shenja gri në gjeneratën e pranverës dhe shenja gri-të zeza në gjeneratat e mëvonshme, zakonisht me një njollë në s3 dhe me kufirin apikal që shtrihet deri në v7 ose v6; gjithashtu paraqet një njollë të vogël kostale në s6. Ana e poshtme ka dy njolla në s1b dhe s3, me majë të verdhë të zbehtë. Femra është e ngjashme ose pak më e madhe, me dy njolla të zeza në flatrat e përparme dhe një shenjë shtesë të pjerrët në s1b, ku njolla apikale është më e errët dhe më e theksuar; ana e poshtme është e ngjashme me atë të mashkullit. Mund të ngatërrohet me *Pieris brassicae, Pieris ergane* dhe *Pieris mannii*.
Specia ka gjenerata të vazhdueshme nga marsi deri në tetor; vezët çelin për 3–7 ditë, larvat zhvillohen për 11–22 ditë dhe pupacioni zgjat 7–13 ditë, me dimërim të pupës të ngjitur në mure, gurë ose trungje. Banon në një gamë shumë të gjerë habitatesh si kopshte, zona bujqësore, brigje detare dhe lugina lumenjsh nga ultësirat deri në rreth 2000 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore të konsiderueshme, dendësi të lartë popullate dhe sjellje nomade, ndonjëherë duke migruar. Larvat ushqehen me shumë lloje Brassicaceae dhe bimë të tjera të lidhura, ndërsa të rriturit ushqehen me një shumëllojshmëri lulesh dhe shpesh marrin lagështi nga toka në kushte të thata.
Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht dhe gjendet në të gjithë Ballkanin, Evropën dhe më tej. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Pontia chloridice* / Small Bath White**
Bardhoshja kloridikë
Pieridae – Pierinae





***Pontia chloridice*, dhe harta e shpërhapjes**

Pontia chloridice është një flutur mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 18–22 mm në gjeneratën e pranverës dhe pak më të madhe në gjeneratat verore, e dallueshme nga ana e sipërme e bardhë dhe nga shenjat apikale gri-të zeza të reduktuara në formë vijash përgjatë skajit të jashtëm të flatrës së përparme, ndërsa ana e sipërme e flatrës së pasme zakonisht është pa shenja; ana e poshtme e flatrës së përparme paraqet një njollë diskale që nuk arrin costa-n dhe shenja apikale jeshile lineare, ndërsa ana e poshtme e flatrës së pasme tregon vijëzime margjinale lineare. Në gjeneratën verore shenjat apikale të flatrës së përparme janë më të zhvilluara dhe më kontrastuese, ndërsa flatrat e pasme shfaqin shenja postdiskale dhe margjinale më të theksuara. Mund të ngatërrohet me *Pontia edusa, Euchloe ausonia, Anthocharis cardamines* dhe *Anthocharis gruneri*. Specia zhvillon dy deri në tre gjenerata nga prilli deri në shtator, me vezë dhe larva me zhvillim të shkurtër dhe pupëzim me kohëzgjatje të ndryshueshme sipas sezonit, i shkurtër pas gjeneratës së parë dhe më i gjatë gjatë estivimit dhe dimërimit. Banon kryesisht në zona me zhavorr dhe vegjetacion të rrallë, shpesh pranë lumenjve dhe përrenjve, deri në rreth 850 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore mesatare dhe sjellje nomade dhe mund të gjendet në distanca të konsiderueshme nga habitati; larvat ushqehen me *Cleome ornithopodioides* dhe herë pas here me *Descurainia sophia*, ndërsa të rriturit fluturojnë aktivisht dhe vizitojnë rrallë lulet. Në Shqipëri nuk është regjistruar së fundmi që nga Rebel & Zerny (1931); në Ballkan gjendet në disa vende përreth Shqipërisë. Lloji është i pranishëm dhe në Evropë e më gjerë drejt Azisë së Vogël dhe Kaukazit; është shumë lokal në rajonin ballkanik dhe e listuar si DD në Shqipëri dhe LC në nivel Evropian bazuar në kriteret e IUCN-së.

***Pontia edusa*/Eastern Bath White**
Bardhoshja lindore
Pieridae –Pierinae





***Pontia edusa*, dhe harta e shpërhapjes**

Pontia edusa është një flutur mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 21–24 mm, e dallueshme nga ana e sipërme e bardhë dhe nga shenjat apikale tipike gri-të zeza që nuk shfaqen në formë vijash përgjatë skajit të jashtëm të flatrës së përparme, ndërsa ana e sipërme e flatrës së pasme ndonjëherë tregon njolla të vogla të zeza kostale; ana e poshtme e flatrës së përparme ka një njollë të madhe diskale që shtrihet deri në costa dhe shenja apikale gri-jeshile, ndërsa ana e poshtme e flatrës së pasme paraqet shenja gri-jeshile të errëta me njolla margjinale jo lineare. Gjeneratat e dyta dhe ato pasuese mund të jenë pak më të zbehta në jeshile me nuancë të verdhë. Mund të ngatërrohet me *Pontia chloridice, Euchloe ausonia, Anthocharis cardamines* dhe *Anthocharis gruneri.*
Specia zhvillon gjenerata të vazhdueshme nga fundi i shkurtit deri në nëntor, me vezë dhe larva me zhvillim të shkurtër dhe pupëzim që përfshin dimërimin. Banon në zona të hapura, të ashpra dhe me lule nga ultësirat deri në rreth 2000 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore të konsiderueshme dhe shpesh me dendësi të lartë popullate; është nomade dhe ndonjëherë migratore. Larvat ushqehen me një gamë të gjerë Brassicaceae dhe bimë të afërta, ndërsa të rriturit ushqehen me shumë lloje lulesh.
Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht, gjendet në të gjithë Ballkanin dhe pjesën më të madhe të Evropës, duke u shtrirë përtej edhe në Azinë e Vogël dhe rajonet përreth; Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Lycaena alciphron*/Purple-shot Copper**
Flakëroshja verdhoshe
Lycaenidae –Lycaeninae





***Lycaena alciphron*, dhe harta e shpërhapjes**

Lycaena alciphron është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 16–18 mm, e dallueshme nga ana e sipërme me ngjyrë bazë portokalli-të kuqërremtë me shkëlqim dhe me nuancë blu-vjollcë më të theksuar në flatrat e përparme; flatrat e përparme paraqesin njolla të errëta në modelin tipik, ndërsa rreshti postdiskal i parregullt, mund të jetë i zbehtë ose të mungojë, flatrat e pasme kanë një shirit të errët qelizor me njolla postdiskale shpesh rudimentare. Ana e poshtme është portokalli e zbehtë me njolla të errëta të theksuara, ndërsa femrat janë zakonisht më të errëta në anën e sipërme, shpesh kafe të errët me një brez submargjinal portokalli dhe me modele të ngjashme në anën e poshtme. Mund të ngatërrohet me *Lycaena candens*.
Specia zhvillon një gjeneratë të vetme nga qershori deri në fillim të gushtit (në varësi të lartësisë), me vezë me zhvillim të shkurtër, larva të reja që dimërojnë dhe ushqehen në pranverë, dhe pupëzim të shkurtër. Banon në livadhe me lule nga ultësirat deri në rreth 2000 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore mesatare dhe dendësi të ulët popullate; larvat ushqehen me specie të gjinisë *Rumex*, ndërsa të rriturit ushqehen me një shumëllojshmëri lulesh.
Në Shqipëri është e përhapur në zonat malore. Lloji është i përhapur në Ballkan dhe pjesën më të madhe të Evropës, duke u shtrirë edhe në Azinë e Vogël dhe rajonet përreth. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Lycaena candens*/Balkan Copper**
Flakëroshja e Ballkanit
Lycaenidae –Lycaeninae





***Lycaena candens* ♀, dhe harta e shpërhapjes**

Lycaena candens është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 17–19 mm, e dallueshme nga ana e sipërme me reflektime të dukshme ngjyrë vjollcë, ndërsa flatra e përparme paraqet një njollë të vetme diskale të zezë; ana e poshtme e flatrave të përparme ka njolla postdiskale të zeza të vendosura në një rresht pothuajse të harkuar në mënyrë të rregullt, ndërsa flatrat e pasme në anën e poshtme tregojnë një brez submargjinal portokalli më pak të theksuar me pika të zeza pak më të mëdha në të dy anët. Femrat janë me madhësi të ngjashme me meshkujt, por ana e sipërme nuk ka reflektime vjollcë dhe është kafe me zona portokalli të ndryshueshme (ndonjëherë pothuajse mungojnë), me njolla të errëta të vendosura në modelin tipik dhe me njollat postdiskale që formojnë një rresht pothuajse të harkuar në mënyrë të rregullt; ana e poshtme e flatrave të përparme paraqet të njëjtin rresht të harkuar të njollave postdiskale, ndërsa flatrat e pasme kanë një brez submargjinal portokalli më pak të theksuar me pika të zeza pak më të mëdha në të dy anët. Mund të ngatërrohet me *Lycaena alciphron*. Specia zhvillon një gjeneratë të vetme nga qershori deri në gusht, me fazë veze ndoshta të shkurtër, larva që dimëron si e re dhe ushqehet gjatë pranverës, me fazë pupëzimi ndoshta të shkurtër. Banon në livadhe malore të lagështa dhe me lule pranë ujërave rrjedhëse dhe në hapësira të hapura në pyje, nga rreth 1000 m deri mbi 2000 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore të ulëta dhe dendësi popullate që ndonjëherë mund të jetë e lartë; larvat ushqehen me *Rumex acetosa*, ndërsa të rriturit vizitojnë një shumëllojshmëri lulesh alpine për nektar. Në Shqipëri është e përhapur në zonat më të larta malore dhe në rang më të gjerë gjendet në Ballkan dhe në pjesë të mëdha të Evropës, si edhe në Azinë e Vogël, Transkaukazi, Kaukazi dhe më tej në lindje. Specia është e listuar si VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ndërsa në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin mesdhetar ka status LC.

***Lycaena dispar*/Large Copper**
Flakëroshja e artë e madhe
Lycaenidae – Lycaeninae





***Lycaena dispar*, dhe harta e shpërhapjes**

Lycaena dispar është flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 17–18 mm, e dallueshme nga ana e sipërme me ngjyrë portokalli-të kuqërremtë; flatrat e përparme paraqesin një shirit diskal të ngushtë të zi dhe kufij margjinalë të ngushtë të zinj, në flatrat e pasme shiriti i zi është shumë i ngushtë dhe kufijtë margjinalë janë gjithashtu të ngushtë. Ana e poshtme e flatrave të përparme ka një ngjyrë bazë portokalli të ndritshme, përveç një brezi margjinal gri, me njolla postdiskale të vendosura në një rresht pothuajse të drejtë, ndërsa flatrat e pasme kanë një ngjyrë bazë gri në të verdhë me një brez submargjinal më të zbehtë dhe shpesh më pak të zhvilluar. Femrat janë më të mëdha në madhësi, me anën e sipërme portokalli-të kuqërremtë, me një rresht pothuajse të drejtë të njollave postdiskale në flatrat e përparme dhe me një kufi margjinal më të gjerë; ana e poshtme e flatrave të përparme ka një brez submargjinal portokalli të dukshëm, ndërsa flatrat e pasme janë të ngjashme me ato të mashkullit. Mund të ngatërrohet me *Lycaena thersamon*. Specia zhvillon dy ose tre gjenerata nga gjysma e dytë e prillit deri në shtator dhe karakterizohet nga jetëgjatësi e gjatë; vezët çelin për 5–11 ditë, larva dimëron L3 dhe ushqehet në pranverë, në verë zhvillimi drejt gjeneratës së dytë zgjat 3–5 javë, dhe faza e pupëzimit 10–24 ditë. Banon në zona të ashpra me vende të lagështa, kanale ujore nga ultësirat deri në rreth 1000 m, me kërkesa të larta hapësinore, zakonisht me dendësi të ulët popullate; larvat ushqehen me *Rumex acetosa, R. aquaticus, R. conglomeratus, R. crispus, R. hydrolapathum, R. obtusifolius, R. patientia* dhe *R. sanguineus*, ndërsa *Iris pseudacorus* përmendet rrallë, të rriturit ushqehen me nektarin e luleve të disponueshme. Në Shqipëri është shumë lokale më gjerë gjendet në Ballkan, në pjesë të mëdha të Evropës, në Azinë e Vogël, Transkaukaz, Kaukaz dhe më tej në lindje. Specia është e listuar si VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ndërsa në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin mesdhetar ka status LC.

***Lycaena ottomanus*/Grecian Copper**
Flakëroshja e jugut
Lycaenidae –Lycaeninae





***Lycaena ottomanus*, dhe harta e shpërhapjes**

Lycaena ottomanus është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 14–15 mm, e dallueshme nga ana e sipërme me ngjyrë bazë të kuqe-ari të ndritshme; flatrat e përparme me njolla të vogla të zeza në fundin e qelizës dhe në s4–s7, me një kufi margjinal të zi më të gjerë në majë, ndërsa flatrat e pasme shpesh kanë një "dhëmb" të vogël margjinal dhe kufi margjinal të zi me njolla të rrumbullakëta margjinale të zeza, të dallueshme ose të bashkuara. Ana e poshtme ka ngjyrë bazë gri në të verdhë, ndërsa flatrat e pasme në anën e poshtme mbajnë hënëza të gjera submargjinale portokalli-të kuqe në s1a–s5 pa shenja të bardha. Femrat janë me madhësi të ngjashme, me anën e sipërme me ngjyrë bazë të ndritshme portokalli-ari dhe me njollat e zakonshme të errëta në të dy flatrat; flatrat e pasme kanë një "dhëmb" margjinal në gjeneratën e pranverës dhe një "bisht" margjinal në gjeneratën e verës, ndërsa ana e poshtme është e ngjashme me atë të mashkullit dhe nuk ka shenja të bardha në flatrat e pasme. Mund të ngatërrohet me *Lycaena virgaureae* dhe *Lycaena phlaeas*. Specia zhvillon dy gjenerata të plota dhe një të tretë të pjesshme: nga mesi i prillit deri në mesin e majit, nga qershori në korrik dhe përsëri në shtator, me vezë që ka të ngjarë të kenë një fazë të shkurtër, larva dimëron brenda vezës, me fazë pupëzimi ndoshta të shkurtër. Banon në zona të ashpra dhe livadhe me lule nga ultësirat deri të paktën në rreth 1000 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore mesatare dhe me dendësi popullate që mund të jetë e lartë, është lloj nomad; larvat ushqehen me *Rumex acetosella*, të rriturit vizitojnë një shumëllojshmëri lulesh. Në Shqipëri është lokale dhe në rang më të gjerë gjendet në gjithë Ballkanin, në pjesën më të mëdhe të Evropës, si edhe në zonat bregdetare të Turqisë jugore. Në Shqipëri është e listuar si VU B2a, ndërsa në nivel Evropian sipas kritereve të IUCN-së ka status LC.

***Lycaena phlaeas*/Small Copper**
Flakëroshja e artë
Lycaenidae – Lycaeninae





***Lycaena phlaeas* ♂, dhe harta e shpërhapjes**

Lycaena phlaeas flutur e vogël, më e vogla e gjinisë *Lycaena*, gjatësi të flatrave të përparme prej 12–15 mm, e dallueshme nga ana e sipërme e flatrave të përparme që varion nga një ngjyrë e ndritshme kuqe-ari deri pothuajse në kafe të errët të plotë, me një njollë diskale, një seri të parregullt njollash postdiskale dhe një kufi margjinal të zi, ndërsa maja është e theksuar; flatrat e pasme shpesh kanë një zgjatim të shkurtër margjinal dhe në anën e sipërme janë kafe të errëta me brez submargjinal të kuq të kufizuar nga njolla të vogla të zeza. Ana e poshtme e flatrave të përparme është portokalli me shenja të ngjashme dhe një kufi të verdhë, me kufirin margjinal të verdhë-kafe të zbehtë, ndërsa flatrat e pasme në anën e poshtme tregojnë njolla të vogla të errëta dhe hënëza submargjinale të kuqe të holla ose pak të dukshme. Femrat janë pak më të mëdha se meshkujt, me një majë më pak të theksuar të flatrave të përparme, por të ngjashme me ta. Mund të ngatërrohet me *L. ottomana* dhe *L. virgaureae*. Lloji zhvillon të paktën tre gjenerata nga marsi deri në tetor, ndonjëherë edhe në nëntor; vezët zgjasin 4–10 ditë, larvat dimërojnë në shtresën e mbeturinave bimore si larva të reja (L2–L4). Faza e pupëzimit zgjat 8–21 ditë. Banon në shumëllojshmëri brigjesh me lule në livadhe, zona të ashpra, përgjatë rrugëve, parqeve dhe kopshteve nga ultësirat deri në rreth 2000 m mbi nivelin e detit, me kërkesa të vogla hapësinore dhe me dendësi popullate që mund të jetë e lartë. Specie nomade. Larvat ushqehen me *Rumex acetosa, R. acetosella, R. bucephalophorus, R. conglomeratus, R. crispus, R. cristatus, R. hydrolapathum, R. obtusifolius, R. pulcher, R. sanguineus, R. scutatus* dhe *R. thyrsiflorus*, ndërsa të rriturit vizitojnë shumëllojshmëri lulesh. Në Shqipëri e përhapur gjerësisht dhe më gjerë në gjithë Ballkanin, në pjesën më të mëdhe të Evropës, në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz dhe Kaukaz. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Lycaena thersamon*/Lesser Fiery Copper**
Tersamonia
Lycaenidae –Lycaeninae





***Lycaena thersamon*, dhe harta e shpërhapjes**

Lycaena thersamon është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 14–16 mm, e dallueshme nga ana e sipërme me ngjyrë portokalli-të kuqërremtë me zona të shtrira vjollcë, më të theksuara në flatrat e pasme, dhe me një kufi të ngushtë të zi; në gjeneratat e verës flatrat e pasme shpesh paraqesin një "bisht" të vogël në v2. Flatrat e përparme në anën e sipërme janë të pacenuara, ndërsa flatrat e pasme tregojnë një shirit të vogël qelizor të zbehtë dhe një brez submargjinal me ngjyrë paksa të ndryshme që rrethon njolla të vogla të zeza, të cilat bashkohen me kufirin e zi. Ana e poshtme e flatrave të përparme është gri e zbehtë me modelin e zakonshëm të njollave të errëta, ndërsa flatrat e pasme në anën e poshtme tregojnë hënëza submargjinale portokalli të ndritshme nga s1b–s6. Femrat janë me madhësi të ngjashme, me anën e sipërme që tregon modelin e zakonshëm të njollave në të dy flatrat, ndërsa ana e poshtme është e ngjashme me atë të mashkullit. Mund të ngatërrohet me *Lycaena dispar*. Specia zhvillon një gjeneratë pranverore, pasuar nga dy ose tre gjenerata vere nga prilli deri në shtator, ndonjëherë edhe në tetor; vezët ka të ngjarë të kenë një fazë të shkurtër, larvat ndoshta dimërojnë si larva të reja dhe faza e pupëzimit ndoshta është e shkurtër. Banon në vende të ngrohta të braktisura, livadhe të thata dhe kanale me shkurre të shpërndara nga ultësirat deri në rreth 1000 m mbi nivelin e detit, rrallë më lart, me kërkesa të vogla hapësinore dhe me dendësi popullate që mund të jetë e lartë, veçanërisht në gjeneratat e verës, duke qenë gjithashtu specie nomade; larvat ushqehen me *Polygonum aviculare* dhe më rrallë me *Bistorta officinalis*, ndërsa të rriturit shpesh gjenden duke u ushqyer me *Mentha* sp. në kanale. Në Shqipëri është lokale dhe në rang më të gjerë gjendet në gjithë Ballkanin, në pjesë të mëdha të Evropës, si edhe në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz dhe Kaukaz. Specia është e listuar si NE në Shqipëri dhe LC në nivel Evropian sipas kritereve të IUCN-së.

***Lycaena tityrus*/Sooty Copper**
Flakëroshja e errët
Lycaenidae –Lycaeninae





***Lycaena tityrus*, dhe harta e shpërhapjes**

Lycaena tityrus është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 14–16 mm, e dallueshme nga ana e sipërme me ngjyrë gri-kafe të errët dhe me njolla më të errëta sipas modelit të zakonshëm; flatrat e pasme shpesh kanë një lob anal të theksuar, ndërsa hënëzat portokalli në anën e sipërme janë të zbehta ose mungojnë. Ana e poshtme e flatrave të përparme është gri, ndonjëherë gri e verdhë e zbehtë, ndërsa flatrat e pasme në anën e poshtme tregojnë një brez submargjinal portokalli më të theksuar. Femrat janë me madhësi të ngjashme, me anën e sipërme të flatrave të përparme portokalli (e ndryshueshme) dhe me njolla të errëta më të theksuara sipas modelit të zakonshëm; flatrat e pasme shpesh kanë një lob anal të theksuar dhe në anën e sipërme janë të errëta me njolla të zakonshme, ndërsa brezi submargjinal portokalli është i dukshëm, rrethon njolla të zeza dhe prek lehtë kufirin. Ana e poshtme paraqet shenja portokalli në flatrat e përparme me njolla të errëta të forta dhe një ngjyrë gri në të verdhë në flatrat e pasme. Specia zhvillon dy deri në tre gjenerata nga marsi deri në tetor, në varësi të lartësisë; vezët kanë një fazë të shkurtër prej 4–10 ditësh, larvat dimërojnë si stade L3 ose L4 dhe faza e pupëzimit zgjat 8–22 ditë. Banon në livadhe me lule të rrethuara nga shkurre të shpërndara nga ultësirat deri në rreth 1500 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore të moderuara dhe me dendësi popullate modeste, duke qenë gjithashtu specie nomade; larvat ushqehen me *Rumex acetosa*, *R. acetosella, R. crispus, R. hydrolapathum, R. scutatus* dhe *R. thyrsiflorus*, ndërsa të rriturit vizitojnë një shumëllojshmëri lulesh. Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht në zonat malore dhe në rang më të gjerë gjendet në gjithë Ballkanin, në pjesë të mëdha të Evropës, si edhe në Azinë e Vogël, Transkaukaz dhe Kaukaz. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Lycaena virgaureae*/Scarce Copper**
Flakëroshja e rallë
Lycaenidae –Lycaeninae





***Lycaena virgaureae*, dhe harta e shpërhapjes**

Lycaena virgaureae është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 16–17 mm, e dallueshme nga ana e sipërme me ngjyrë të ndritshme të kuqe-ari; flatrat e përparme janë pa njolla dhe paraqesin një brez të zi margjinal më të gjerë pranë majës, ndërsa flatrat e pasme kanë një brez të zi të ngushtë që prek ose bashkohet me njolla të zeza midis venave. Ana e poshtme e flatrave të përparme është portokalli e zbehtë me njolla sipas modelit të zakonshëm, ndërsa flatrat e pasme në anën e poshtme janë gri në të verdhë me njolla të vogla të zeza, ku njollat postdiskale kanë kufij të bardhë në anën distale. Femrat kanë anën e sipërme me njolla të mëdha të zeza sipas modelit të zakonshëm, ndërsa ana e poshtme është e ngjashme me atë të mashkullit. Mund të ngatërrohet me *Lycaena phlaeas*. Specia zhvillon një gjeneratë të vetme nga mesi i qershorit deri në shtator, në varësi të lartësisë; vezët dimërojnë mbi bimën ushqyese për 37–41 javë, larvat çelin dhe zhvillohen pas dimërimit në stadin e vezës, dhe ushqehen në pranverë për 52–57 ditë, ndërsa faza e pupëzimit zgjat 14–20 ditë. Banon në livadhe me lule, shpesh në zona të lagështa pranë pyjeve, nga rreth 600 deri në 1800 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore të moderuara dhe me dendësi popullate që ndonjëherë mund të jetë e lartë, duke qenë gjithashtu specie nomade; larvat ushqehen me *Rumex acetosa, R. acetosella, R. crispus, R. obtusifolius, R. scutatus* dhe *R. thyrsiflorus*, ndërsa të rriturit vizitojnë një shumëllojshmëri lulesh. Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht në zonat malore dhe në rang më të gjerë gjendet në gjithë Ballkanin, në pjesë të mëdha të Evropës, si edhe në Azinë e Vogël, Transkaukaz dhe Kaukaz. Specia është e listuar si VU në Shqipëri dhe LC në nivel Evropian sipas kritereve të IUCN-së.

***Aricia agestis*/Brown Argus**
Flatrakafejta bordurëkuqe
Lycaenidae –Polyommatinae





***Aricia agestis*, dhe harta e shpërhapjes**

Aricia agestis është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 12–14 mm, e dallueshme nga ana e sipërme me ngjyrë kafe të errët dhe me hënëza portokalli zakonisht të pranishme në një seri të plotë në flatrat e përparme dhe të pasëm; flatrat e përparme paraqesin një njollë diskale dhe një majë të mprehtë. Ana e poshtme është gri deri gri-kafe e lehtë, me një seri zakonisht të plotë të hënëzave portokalli submargjinale në të dy flatrat; flatrat e përparme në anën e poshtme nuk kanë njollë qelizore dhe tregojnë njolla diskale dhe postdiskale të rrethuara me të bardhë, ndërsa flatrat e pasme paraqesin njollën postdiskale në s6 të zhvendosur drejt bazës dhe një shenjë të bardhë në v4 shpesh të dukshme. Femrat janë pak më të mëdha, me majën e flatrave të përparme më pak të mprehtë dhe me hënëza portokalli shpesh më të mëdha në një seri të plotë në të dy flatrat; ana e poshtme ka hënëza më të mëdha dhe më të ndritshme portokalli, si te mashkulli, flatrat e përparme nuk kanë njollë qelizore. Mund të ngatërrohet me *A. artaxerxes* dhe *A. anteros*. Specia zhvillon gjenerata të vazhdueshme nga fundi i marsit deri në tetor; vezët çelin në 4–8 ditë, larvat dimërojnë në shtresën e mbeturinave bimore dhe ushqehen përsëri në pranverë, ndërsa faza e pupëzimit zgjat 11–22 ditë. Banon në një gamë të gjerë vendesh të hapura nga ultësirat deri në rreth 1650 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore dhe dendësi popullate modeste, lloj nomad; larvat ushqehen kryesisht me *Erodium* sp., *Geranium* sp., *Lotus corniculatus* dhe *Helianthemum* sp., si dhe raportohen edhe në *Medicago* sp. dhe *Tuberaria guttata*, ndërsa të rriturit ushqehen me një shumëllojshmëri të gjerë lulesh. Në Shqipëri e përhapur gjerë gjendet në gjithë Ballkanin, në pjesë të mëdha të Evropës, si edhe në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz, Kaukaz dhe më tej në lindje. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Aricia anteros*/Blue Argus**
Ballkanja anteros
Lycaenidae –Polyommatinae





***Aricia anteros*, dhe harta e shpërhapjes**

Aricia anteros është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 13–15 mm, e dallueshme nga ana e sipërme blu e hapur dhe e ndritshme me kufi të zi marginal; flatrat e përparme kanë një njollë të vogël diskale të zezë, ndërsa flatrat e pasme paraqesin njolla të vogla rrethore afër buzës së flatrës, ndonjëherë me gjurmë portokalli. Ana e poshtme është gri-kafe e zbehtë me shenjat e zakonshme; flatrat e përparme nuk kanë njollë qelizore, ndërsa në flatrat e pasme njolla postdiskale në s6 është e zhvendosur drejt bazës, me hapësirë para njollës në s5. Femrat janë me madhësi të ngjashme, me anën e sipërme kafe, njollë diskale të zezë dhe hënëza portokalli submargjinale (ndonjëherë të paplota në flatrat e përparme); flatrat e pasme tregojnë njolla të errëta rrethore buzë flatrës të rrethuara me shkallëza kaltër-gri dhe hënëza portokalli me shenja të vogla trekëndëshe të zeza. Ana e poshtme është e ngjashme me mashkullin, me hënëza më të ndritshme. Mund të ngatërrohet me specie të gjinsë *Polyommatinae* (p.sh. *Polyommatus eros*), por mashkulli është gjithmonë blu i hapur, ndryshe nga *Aricia agestis* dhe *Aricia artaxerxes*. Specia zhvillon një deri në tre gjenerata nga maji deri në shtator; vezët ka të ngjarë të kenë fazë të shkurtër, larvat ndoshta dimërojnë si stade të reja dhe pupëzimi është i shkurtër. Banon në pjerrësi të thata, shkëmbore dhe të lulëzuara mbi gëlqeror nga rreth 250 m deri mbi 2000 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore modeste dhe dendësi që mund të jetë e lartë; larvat ushqehen me *Geranium* dhe *Erodium*, ndërsa të rriturit vizitojnë shumë lule. Në Shqipëri është lokale në zona malore dhe më gjerë gjendet në Ballkan, Evropë, Azinë e Vogël, Transkaukaz, Kaukaz dhe Iran. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Aricia artaxerxes*/Mountain Argus**
Flatrakafejta verlore
Lycaenidae –Polyommatinae





***Aricia artaxerxes*, dhe harta e shpërhapjes**

Aricia artaxerxes është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 12–14 mm, e dallueshme nga ana e sipërme me ngjyrë kafe të errët; flatrat e përparme kanë majë të ngushtë dhe të mprehtë, ndërsa në anën e sipërme paraqitet një seri e reduktuar hënëzash portokalli që mund të jenë të dobëta ose të mungojnë. Ana e poshtme tregon gjithashtu hënëza portokalli të reduktuara ose ndonjëherë të munguara; flatrat e përparme nuk kanë njollë qelizore dhe shfaqin njolla diskale e postdiskale me rreth të bardhë, ndërsa në flatrat e pasme njolla postdiskale në s6 është e zhvendosur drejt bazës dhe një shenjë e bardhë në v4 shpesh është e dukshme. Femrat janë pak më të mëdha, me majën e flatrave të përparme më të rrumbullakosur dhe në përgjithësi të ngjashme me mashkullin. Mund të ngatërrohet me *Polyommatus icarus, Aricia agestis* dhe *Aricia anteros*, por dallohet nga zhvendosja e njollës postdiskale në s6. Specia zhvillon një gjeneratë nga qershori deri në fund të gushtit; vezët kanë fazë të shkurtër, larvat ndoshta dimërojnë si stade të reja dhe pupëzimi ka të ngjarë të jetë i shkurtër. Banon në livadhe të lulëzuara shkëmbore të ngrohta në male gëlqerore, nga 600 deri në 2000 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore modeste dhe me dendësi popullate që mund të jetë e lartë, duke qenë specie nomade; larvat ushqehen me *Helianthemum nummularium, H. oelandicum* dhe lloje të *Geranium*, ndërsa të rriturit ushqehen me një shumëllojshmëri lulesh. Në Shqipëri është e përhapur në Alpet Veriore dhe lokale në zona të tjera malore, dhe në rang më të gjerë gjendet në Ballkan, Evropë, Azinë e Vogël, Transkaukaz, Kaukaz dhe më tej në lindje. Specia është e listuar si NE në Shqipëri dhe si LC në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin mesdhetar.

***Cacyrius marshalli*/Geranium Bronze**
Bronzta e geraniumeve
Lycaenidae –Polyommatinae





***Cacyreus marshalli*, dhe harta e shpërhapjes**

Cacyreus marshalli është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 12–13 mm, e dallueshme nga ana e sipërme me ngjyrë kafe të errët me skaje shumë të rrjetëzuara dhe pa shenja të dukshme; flatrat e pasme kanë një bisht pranë këndit anal dhe një njollë të zezë me sy, të rrethuar nga një kufi i zbehtë drejt bazës. Ana e poshtme është gri-kafe me një brez diskal kafe të errët dhe një njollë syri më pak të dukshme. Femrat janë pak më të mëdha, me anën e sipërme dhe të poshtme të ngjashme me mashkullin. Specia zhvillon gjenerata të vazhdueshme nga marsi deri në nëntor; vezët çelin në 4–6 ditë, larvat zhvillohen në 22–33 ditë dhe dimërojnë brenda gjetheve të *Pelargonium*, ndërsa pupëzimi zgjat 9–13 ditë.
Banon në parqe dhe kopshte mbi Pelargonium dekorativ, kryesisht në ultësira por edhe mbi 1000 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore të ulëta dhe dendësi popullate që mund të jetë e lartë, duke qenë specie nomade dhe ndonjëherë e vërejtur larg zonave të banuara; larvat ushqehen pothuajse ekskluzivisht me *Pelargonium* dhe më rrallë me *Geranium*, ndërsa të rriturit ushqehen me lule dekorative.
Në Shqipëri është e pranishme me disa raste të regjistruara dhe në rang më të gjerë gjendet në gjithë Ballkanin dhe Evropën; gjithashtu është përhapur pas prezantimit aksidental rreth vitit 1990 në Majorca dhe është zgjeruar në Azinë e Vogël dhe Lindjen e Afërt. Specia është e listuar si NE në Shqipëri dhe në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin mesdhetar ka status NA.

***Celastrina argiolus*/Holy Blue**
Flatrabluja e mamaferës
Lycaenidae –Polyommatinae





***Celastrina argiolus*, dhe harta e shpërhapjes**

Celastrina argiolus është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 13–17 mm, e dallueshme nga ana e sipërme blu e ndritshme si qielli në gjeneratën e pranverës dhe blu më e errët në gjeneratën e verës, me një vijë të hollë të zezë marginale pak më të trashë pranë majës së flatrave të përparme. Ana e poshtme është e bardhë me hijëzim të lehtë blu bazal dhe njolla shumë të vogla, shpesh vestigiale ose të munguar. Femrat janë pak më të mëdha, me anën e sipërme më të errët blu dhe me një kufi të gjerë të zi në majë të flatrave të përparme që shtrihet përgjatë kostës dhe skajit të jashtëm; flatrat e pasme shpesh tregojnë njolla të vogla gri-zi antemargjinale, ndërsa ana e poshtme është e ngjashme me atë të mashkullit.
Specia zhvillon dy gjenerata nga marsi deri në shtator; vezët çelin në 3–5 ditë, larvat zhvillohen në 15–27 ditë dhe pupëzimi zgjat 15–27 ditë, ndërsa gjenerata e dytë dimëron si pupë për 31–47 javë në gjethe të thara ose në shtresën e litrit. Banon në pyje të lehta, skaje pyjesh, kopshte dhe parqe nga ultësirat deri në rreth 1500 m mbi nivelin e detit, me individë nomadë që mund të gjenden më lart; kërkesat hapësinore janë të ulëta dhe dendësia e popullatës mund të jetë e lartë në kopshte e parqe, duke qenë specie nomade. Larvat ushqehen me një gamë të gjerë shkurresh dhe bimësh barishtore si *Frangula alnus, Rhamnus, Cornus, Hedera helix* dhe shumë të tjera, ndërsa të rriturit ushqehen me lule shkurresh, bimësh barishtore dhe pemësh lulëzuese.
Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht dhe në rang më të gjerë gjendet në gjithë Ballkanin dhe Evropën, si edhe në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz dhe Kaukaz. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Cupido alcetas*/Provençal Short-tailed Blue**
E Blujta provençale me bishta të shkurtër
Lycaenidae –Polyommatinae





***Cupido alcetas*, dhe harta e shpërhapjes**

Cupido alcetas është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 13–16 mm, e dallueshme nga ana e sipërme violet-blu me një vijë të ngushtë të zezë marginale; flatrat e pasme kanë një bisht të shkurtër në venën 2, ndërsa flatrat e përparme nuk kanë njollë të zezë diskale dhe flatrat e pasme paraqesin një njollë të zezë antemargjinale në s2. Ana e poshtme është shumë e zbehtë bardhë-gri me njolla të vogla shpesh në seri të paplotë; flatrat e përparme kanë një vijë të ngushtë diskale, ndërsa flatrat e pasme kanë një njollë të vogël të zezë marginale në s2 dhe një hënëzë të vogël gri drejt bazës, ndonjëherë me një shenjë të lehtë portokalli ndërmjet tyre. Femrat janë të ngjashme në madhësi, me anën e sipërme të zezë dhe të pacenuar, ndërsa ana e poshtme është e ngjashme me atë të mashkullit. Mund të ngatërrohet me *Cupido argiades, Cupido decolorata, Cupido minimus* dhe *Cupido osiris*. Specia zhvillon dy deri në tri gjenerata nga maji deri në gusht; vezët kanë fazë të shkurtër, larvat dimërojnë si stade të plota dhe pupëzimi është i shkurtër. Banon në livadhe mezofilike të hapura me bimë lule, shpesh në vende të lagështa pranë pyjeve, ujërave të rrjedhshëm dhe liqeneve nga ultësirat deri në rreth 1500 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore të ulëta dhe dendësi popullate që mund të jetë e lartë; larvat ushqehen me *Galega officinalis, Lathyrus latifolius, Lotus corniculatus, Medicago* sp., *Securigera varia, Trifolium pratense, Vicia* sp. dhe herë pas here *Colutea arborescens*, ndërsa të rriturit ushqehen me lule të bimëve të larta dhe meshkujt janë territorialë. Në Shqipëri ka të dhëna të kufizuara dhe kërkon më shumë studim, ndërsa në rang më të gjerë gjendet në gjithë Ballkanin dhe Evropën, si edhe në Azinë e Vogël, Transkaukaz dhe Kaukaz. Specia është e listuar si NE në Shqipëri dhe LC në nivel Evropian sipas kritereve të IUCN-së.

***Cupido argiades*/Short-tailed Blue**
Trupshkurtra blu-vjollcë
Lycaenidae –Polyommatinae





***Cupido argiades*, dhe harta e shpërhapjes**

Cupido argiades është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 10–15 mm, e dallueshme nga ana e sipërme violet-blu me një vijë të ngushtë marginale; flatrat e pasme kanë një bisht të vogël në venën 2, ndërsa flatrat e përparme paraqesin një njollë të zbehtë diskale shpesh thuajse të padukshme dhe flatrat e pasme mund të kenë njolla antemargjinale në s1b–s4. Ana e poshtme është shumë e zbehtë gri; flatrat e përparme tregojnë njolla postdiskale në një seri të rregullt lehtësisht të harkuar, ndërsa flatrat e pasme kanë 2–3 njolla portokalli të dukshme pranë këndit anal. Femrat janë të ngjashme në madhësi, me anën e sipërme të zezë me nuanca blu në bazë dhe me njollë diskale thuajse të padukshme, ndërsa në gjeneratat verore mund të shfaqet një lunulë portokalli pranë këndit anal; ana e poshtme është e ngjashme me atë të mashkullit. Mund të ngatërrohet me *Cupido alcetas, Cupido decolorata, Cupido minimus* dhe *Cupido osiris*.
Specia zhvillon dy deri në tri gjenerata nga fundi i prillit deri në shtator; vezët zhvillohen në 5–8 ditë, larvat dimërojnë si stade të plota për 23–34 javë në shtresën e mbeturinave dhe zhvillohen për 16–29 ditë, ndërsa pupëzimi zgjat 10–16 ditë. Banon në livadhe me lule dhe zona me shkurre, shpesh në vende të lagështa nga ultësirat deri në rreth 750 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore të ulëta, dendësi popullate mesatare dhe duke qenë specie nomade; larvat ushqehen me *Lathyrus, Lotus, Medicago, Melilotus, Securigera varia, Trifolium dhe Vicia*, si dhe herë pas here me *Erica ciliaris, Colutea arborescens* dhe *Ulex*, ndërsa të rriturit ushqehen me lule të bimëve të larta. Në Shqipëri është lokale dhe në rang më të gjerë gjendet në gjithë Ballkanin dhe Evropën, si

edhe në Azinë e Vogël, Transkaukaz dhe Kaukaz. Specia është e listuar si NE në Shqipëri dhe LC në nivel Evropian sipas kritereve të IUCN-së.

***Cupido decolorata*/Eastern Short-tailed Blue**
Ezbardhëllemja
Lycaenidae –Polyommatinae





***Cupido decolorata*, dhe harta e shpërhapjes**

Cupido decolorata është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 12–13 mm, e dallueshme nga ana e sipërme blu e errët me një kufi marginal të gjerë të zi që shtrihet përgjatë venave; flatrat e pasme kanë një bisht të shkurtër në venën 2, ndërsa flatrat e përparme paraqesin një njollë diskale të zezë. Ana e poshtme është shumë e zbehtë gri me njolla të vogla sipas modelit të zakonshëm; flatrat e përparme kanë një vijë diskale të fortë dhe njolla në s2 të serisë postdiskale të zhvendosur pak drejt bazës, ndërsa flatrat e pasme nuk kanë hënëza portokalli. Femrat janë të ngjashme në madhësi, me anën e sipërme të zezë dhe të paprekur, ndërsa ana e poshtme është e ngjashme me atë të mashkullit. Mund të ngatërrohet me *Cupido alcetas, Cupido argiades, Cupido minimus* dhe *Cupido osiris*.
Specia zhvillon dy deri në tre gjenerata nga maji deri në gusht; vezët kanë fazë të shkurtër, larvat ndoshta dimërojnë si stade të plota dhe pupëzimi është i shkurtër. Banon në livadhe të hapura me lule mbi shpatet shkëmbore nga niveli i detit deri në rreth 1200 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore të ulëta dhe dendësi popullate të ulët; larvat ushqehen me *Medicago, Vicia* dhe *Trifolium pratense*, ndërsa të rriturit ushqehen me një gamë të gjerë lulesh.
Në Shqipëri ka të dhëna të kufizuara dhe kërkon më shumë hulumtim, ndërsa në rang më të gjerë gjendet në gjithë Ballkanin dhe Evropën, si edhe lokale në Turqi (W. Konya). Specia është e listuar si DD në Shqipëri dhe LC në nivel Evropian sipas kritereve të IUCN-së.

***Cupido minimus*/Little Blue**
Vogëlushja blu
Lycaenidae –Polyommatinae





***Cupido minimus*, dhe harta e shpërhapjes**

Cupido minimus është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 10–12 mm, e dallueshme nga ana e sipërme kafe-e zezë me shkëlqim të shpërndarë argjendi-blu; flatrat e pasme nuk kanë bisht, ndërsa ana e poshtme është gri e zbehtë, ndonjëherë me nuancë blu në individë të freskët, me njolla të vogla të zeza të rrethuara me të bardhë sipas modelit të zakonshëm. Flatrat e përparme në anën e poshtme kanë një seri pothuajse të drejtë njollash postdiskale, ndërsa flatrat e pasme kanë një seri të valëzuar me njollën në s6 të zhvendosur drejt bazës dhe një njollë të vogël marginale në s2. Femrat janë të ngjashme në madhësi, por ana e sipërme është kafe-e zezë pa shkëlqimin argjendi-blu të mashkullit, ndërsa ana e poshtme është e ngjashme me atë të mashkullit. Mund të ngatërrohet me *Cupido osiris, Cupido alcetas, Cupido argiades, Cupido decolorata, Cyaniris semiargus* dhe *Glaucopsyche alexis*. Specia zhvillon një gjeneratë nga prilli deri në gusht, ndonjëherë edhe një gjeneratë të pjesshme të dytë; vezët zgjasin 3–7 ditë, larvat zhvillohen në 18–27 ditë dhe dimërojnë si stade të plota për 36–48 javë në lule të vyshkura ose në shtresën e mbeturinave, ndërsa pupëzimi zgjat rreth dy javë. Banon në livadhe të hapura me bar të shkurtër në zona të thata dhe shkëmbore, shpesh të rrethuara nga shkurre ose pyje të hapura deri në rreth 1700 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore shumë modeste dhe dendësi popullate që mund të jetë e lartë; larvat ushqehen me *Anthyllis vulneraria, Astragalus, Colutea arborescens* dhe *Oxytropis*, ndërsa të rriturit thithin minerale nga sipërfaqe të lagështa (baltë, rërë ose tokë e lagur me kripëra). Në Shqipëri është e përhapur në Alpet Veriore dhe lokale në zona të tjera malore, ndërsa në rang më të gjerë gjendet në gjithë Ballkanin dhe Evropën, si edhe në Azinë e Vogël dhe më tej në lindje. Specia

është e listuar si LC në Shqipëri dhe NT A2b në nivel mesdhetar sipas kritereve të IUCN-së.

***Cupido osiris* /Osiris Blue**
E Blujta e Osirit
Lycaenidae –Polyommatinae





***Cupido osiris*, dhe harta e shpërhapjes**

Cupido osiris është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 12–15 mm, e dallueshme nga ana e sipërme vjollcë-e kaltër dhe pa shenja, me linja të holla të zeza në skaj. Ana e poshtme është gri e çelët me shenja të ngjashme me *Cupido minimus*, por shpesh me shkëlqim blu bazal më të theksuar. Femrat janë të ngjashme në madhësi, por ana e sipërme është kafe e errët–e zezë, ndonjëherë me shkëlqim blu bazal ose shkëlqime të shpërndara; ana e poshtme e flatrave të përparme ka pika postdiskale të vendosura në një linjë pothuajse të drejtë. Mund të ngatërrohet me *Cupido minimus, Cupido alcetas, Cupido argiades, Cupido decolorata, Cyaniris semiargus* dhe *Glaucopsyche alexis*.
Specia zhvillon një gjeneratë të vetme, ndonjëherë edhe një gjeneratë të pjesshme të dytë, nga prilli deri në gusht; vezët kanë fazë të shkurtër, larvat dimërojnë në stadin e prepupës, dhe pupëzimi është i shkurtër. Banon në livadhe të hapura me lule mbi shpate shkëmbore, shpesh pranë shkurreve, nga ultësirat deri në rreth 2000 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore mesatare dhe dendësi popullate që mund të jetë e lartë; larvat ushqehen me *Onobrychis*, si dhe me *Colutea arborescens* dhe *Lathyrus linifolius*, ndërsa të rriturit ushqehen me lule të vogla dhe thithin minerale nga sipërfaqe të lagështa.
Në Shqipëri është e përhapur kryesisht në Alpet e Veriut dhe lokale në zona të tjera malore, ndërsa në rang më të gjerë gjendet në gjithë Ballkanin dhe Evropën, si edhe në Azinë e Vogël dhe më tej në lindje. Specia është e listuar si VU B2a në Shqipëri dhe LC në nivel mesdhetar sipas kritereve të IUCN-së.

***Cyaniris semiargus*/Mazarine Blue**
Kaltëroshja vjollcë e pyllit
Lycaenidae –Polyommatinae





***Cyaniris semiargus*, dhe harta e shpërhapjes**

Cyaniris semiargus është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 14–17 mm, e dallueshme nga ana e sipërme blu-vjollcë me një kufi relativisht të gjerë të zi në skaj, pak i shpërndarë përgjatë venave. Ana e poshtme është gri-kafe e çelët me shkëlqim blu bazal; flatrat e përparme nuk kanë pikë në qelizë dhe shenjat diskale e postdiskale janë të qarta, ndërsa flatrat e pasme kanë një pikë diskale, pika postdiskale të ngjashme me ato të flatrave të përparme dhe një pikë bazale shtesë në s7, me shenja skajore shpesh të dobëta. Femrat janë të ngjashme në madhësi, por ana e sipërme është kafe dhe pa shenja, ndërsa ana e poshtme është pak më e errët gri-kafe dhe e ngjashme me atë të mashkullit. Mund të ngatërrohet me *Cupido osiris* dhe *Glaucopsyche alexis*.
Specia zhvillon një gjeneratë në lartësi të mëdha dhe deri në tre gjenerata në zonat e ulëta, nga fundi i prillit deri në mes të gushtit; vezët çelin në 3–6 ditë, larvat zhvillohen për rreth 4 javë dhe dimërojnë si L3 në shtresën e mbeturinave bimore për 29–43 javë, ndërsa pupëzimi zgjat 11–17 ditë. Banon në livadhe të thata kalcare mbi shpate shkëmbore, si dhe në zona me lule të lagështa dhe skaje pyjesh, nga ultësirat deri në 2200 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore modeste dhe dendësi popullate shpesh të lartë; larvat ushqehen kryesisht me *Trifolium pratense*, si dhe me *Armeria, Anthyllis, Genista tinctoria, Lotus corniculatus, Onobrychis viciifolia, Securigera varia* dhe të tjera *Trifolium*, ndërsa të rriturit ushqehen me një gamë të gjerë lulesh dhe marrin pjesë në thithjen e mineraleve nga sipërfaqe të lagështa si dhe ushqehen me ekskremente. Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht në zonat malore dhe në rang më të gjerë gjendet në gjithë Ballkanin dhe Evropën, si edhe në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt

dhe më tej në lindje. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Eumedonia eumedon*/Geranium Argus**
Flatrakafenjta e kamaroshës
Lycaenidae –Polyommatinae





***Eumedonia eumedon*, dhe harta e shpërhapjes**

Eumedonia eumedon është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 14–16 mm, e dallueshme nga ana e sipërme kafe dhe pa shenja. Ana e poshtme është gri deri në gri-kafe me shenjat e zakonshme të rrethuara me të bardhë; flatrat e përparme nuk kanë pikë në qelizë dhe shenjat postdiskale, skajore dhe gjysmë-hënat nënskajore janë të ndryshueshme, ndërsa flatrat e pasme tregojnë një nuance blu bazale, pika postdiskale të lakueshme rregullisht, gjysmë-hëna portokalli të zhvilluara dhe shpesh një vijë të bardhë përgjatë v5 nga pika diskale deri te postdiskalet, e cila mund të mungojë. Femrat janë pak më të mëdha, me anën e sipërme kafe shpesh me gjurmë gjysmë-hënash nënskajore, ndërsa ana e poshtme është e ngjashme por me shenja të zhvilluara mirë.
Specia nuk ka specie të ngjashme në rajon. Zhvillon një gjeneratë të vetme nga maji deri në fillim të gushtit; vezët kanë zhvillim të shkurtër, larvat dimërojnë si stade të reja dhe pupëzimi është i shkurtër. Banon në livadhe të ngrohta dhe të mbrojtura me lule të bollshme, veçanërisht me *Geranium*, nga ultësirat deri në zonat malore, me kërkesa hapësinore mesatare dhe dendësi popullate që mund të jetë e lartë; larvat ushqehen kryesisht me *Geranium sanguineum*, si dhe me *G. cinereum, G. phaeum, G. tuberosum* dhe *Erodium*, ndërsa të rriturit ushqehen me një gamë të gjerë lulesh, shpesh edhe mbi bimën ushqyese.
Në Shqipëri është lokale në zonat malore dhe në rang më të gjerë gjendet në gjithë Ballkanin dhe Evropën, si edhe në Azinë e Vogël dhe më tej në lindje.

Specia është e listuar si VU në Shqipëri dhe LC në nivel Evropian sipas kritereve të IUCN-së.

***Glaucopsyche alexis*/Green-underside Blue**
Aleksja
Lycaenidae –Polyommatinae





***Glaucopsyche alexis*, dhe harta e shpërhapjes**

Glaucopsyche alexis është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme prej 13–18 mm, e dallueshme nga ana e sipërme blu qielli me një kufi të gjerë të zi në skaj dhe pa shenja. Ana e poshtme është gri e çelët pa shenja skajore; flatrat e pasme tregojnë një shkëlqim jeshil-blu bazal dhe një seri të ndryshueshme pikash të vogla postdiskale. Femrat janë të ngjashme në madhësi, por ana e sipërme është kafe, herë pas here me shkëlqim blu bazal, ndërsa pjesa tjetër është e ngjashme me atë të mashkullit. Mund të ngatërrohet me *Cyaniris semiargus, Cupido osiris* dhe *Iolana iolas*.
Specia zhvillon një gjeneratë të vetme nga prilli deri në fillim të korrikut; vezët zhvillohen në 3–8 ditë, larvat ushqehen për 16–30 ditë dhe pupëzimi kalon dimrin në shtresën e letërthëllëzës. Banon në livadhe me lule dhe shkurre të shpërndara mbi shpate nga ultësirat deri në 1500 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore modeste dhe dendësi popullate zakonisht të ulët; larvat ushqehen me fabace si *Astragalus, Colutea arborescens, Genista, Lathyrus, Lotus, Medicago, Melilotus, Onobrychis, Securigera varia* dhe *Vicia*, ndërsa të rriturit ushqehen kryesisht me lule të bimëve ushqimore të larvave.
Në Shqipëri është e përhapur por lokale, ndërsa në rang më të gjerë gjendet në gjithë Ballkanin dhe Evropën, si edhe në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt dhe më tej në lindje. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Iolana iolas*/Iolas Blue**
Kaltëroshja e madhe
Lycaenidae –Polyommatinae





***Iolana iolas*, dhe harta e shpërhapjes**

Iolana iolas është një flutur me madhësi mesatare, me krah të përparme 18–21 mm dhe përfaqëson një nga speciet më të mëdha të Lycaenidae në Gadishullin Ballkanik. Ana e sipërme është blu-vjollcë e ndritshme me një kufi të hollë të zi në skaj pa shenja, ndërsa te femra është më e errët me kufi blu marginal kafe të errët (fuscous) më të gjerë, që mund të shtrihet pothuaj deri në bazë dhe me vena të zeza më të dukshme. Ana e poshtme është gri e çelët me linjë të hollë diskale, seri të plotë pikash postdiskale dhe gjysmë-hëna gri antemarginale të dobëta, ndërsa në flatrën e pasme shfaqet një shkëlqim i lehtë blu bazal dhe pika të zeza bazale.
Specia jeton në zona të nxehta dhe shkëmbore me shkurre, nga niveli i ulët deri mbi 1000 m mbi nivelin e detit, ku *Colutea arborescens* është e pranishme dhe e domosdoshme për ciklin jetësor; kërkesa hapësinore është e lartë, ndërsa dendësia e popullsisë mesatare. Larvat ushqehen ekskluzivisht me *Colutea arborescens* dhe zhvillohen brenda fasuleve të saj. Të rriturit ushqehen kryesisht me nektarin e së njëjtës bimë dhe fluturojnë në një gjeneratë të vetme (ndonjëherë pjesërisht në të dytën) nga prilli deri në gusht, varësisht nga lartësia; faza e vezës është e shkurtër, ndërsa pupëzimi kalon dimrin.
Në Shqipëri është lokale dhe e listuar si VU, ndërsa në nivel Evropian klasifikohet si NT A2c sipas kritereve të IUCN-së.

***Kretania sephirus*/Zephyr Blue**
Zefiri blue
Lycaenidae –Polyommatinae





***Kretania sephirus*, dhe harta e shpërhapjes**

Kretania sephirus është një flutur e vogël me gjatësi të krahut të përparme 14–17 mm. Ana e sipërme është blu-vjollcë e qartë me një kufi të hollë të zi në skaj; krahët e përparme janë pa shenja, ndërsa krahët e pasëm shfaqin pika të zeza antemarginale në s2, shpesh edhe në s1b, s3 dhe s4. Ana e poshtme është gri deri në gri-kafe të çelët, me krahun e përparme pa pikë në qelizë, ndërsa krahët e pasëm tregojnë pika portokalli nënskajore të dukshme, zakonisht jo të bashkuara në brez, të kufizuara pranë shenjave të zeza në formë V; pikat e zeza nënskajore nuk kanë syza blu-jeshile, rrallë me një ose dy syza. Femra është pak më e madhe, me anën e sipërme kafe gjysmëhëna nënskajore me pika të zeza antemarginale, të kufizuara në skaj me disa luspa të zbehta blu, ndërsa krahët e pasëm shfaqin gjysmë-hëna nënskajore me pika të zeza antemarginale dhe shkëlqime të lehta kaltërosh në skaj; ana e poshtme është e ngjashme me mashkullin. Specie të ngjashme përfshijnë *Plebejus argus*, *Plebejus argyrognomon* dhe *Plebejus idas*.
Specia ka një gjeneratë të vetme nga maji deri në gusht në lartësi të mëdha; faza e vezës është e shkurtër, larva e kalon dimrin si larvë gjysmë e rritur, ndërsa pupëzimi është i shkurtër. Jeton në livadhe të thata dhe të ngrohta me bimësi të pasur ushqimore nga 500 deri mbi 2000 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore të ulëta dhe dendësi popullate që mund të jetë e lartë; larvat ushqehen me specie të ndryshme të gjinisë *Astragalus*, ndërsa të rriturit marrin nektar nga bimë të ulëta me lule.

Është e përhapur në Alpet e Shqipërisë dhe lokale në zona të tjera malore. Gjendet në të gjithë Ballkanin dhe në pjesën më të madhe të Evropës, si dhe në Azi të Vogël dhe Kaukaz. Në Shqipëri klasifikohet si VU, ndërsa në nivel Evropian vlerësohet si LC.

***Lampides boeticus*/Long-tailed Blue**
Trupgjata vjollcë-blu
Lycaenidae –Polyommatinae





***Lampides boeticus*, dhe harta e shpërhapjes**

Lampides boeticus është një flutur e vogël me gjatësi të krahut të përparme 15–18 mm. Ana e sipërme është blu-vjollcë me qime (androconia) dhe një kufi të hollë në skaj; krahët e pasëm kanë bisht në venën 2 dhe një okelus të zi në s2. Ana e poshtme është kafe-hirush, ku krahët e pasëm shfaqin një brez të bardhë postdiskal të dukshëm me linja të shumta të holla dhe të rregullta, si dhe okeluse ngjyrë gjelbër-pavone në s1c dhe s2. Femra është më kafe në anën e sipërme, me zona bazale dhe diskale të shpërndara blu-vjollcë, ndërsa ana e poshtme është e ngjashme me mashkullin.
Specie të ngjashme përfshijnë *Leptotes pirithous, Cupido alcetas, Cupido argiades* dhe *Cupido decoloratus*. Ka gjenerata të vazhdueshme (4–5) nga fundi i marsit deri në tetor; faza e vezës është e shkurtër (4–7 ditë) dhe mund të dimërojë e ngjitur në degë deri në 12 javë, larva zhvillohet në 14–25 ditë dhe pupa në 10–18 ditë. Jeton në bregore, të thata, të ngrohta dhe fusha të kultivuara, kryesisht në zona të ulëta, por mund të migrojë deri në 2000 m mbi nivelin e detit; kërkesa hapësinore është e lartë, me dendësi popullate shpesh të lartë dhe sjellje migratore. Larvat ushqehen me një gamë të gjerë bimësh të familjes Fabaceae, ndërsa të rriturit ushqehen me një gamë të gjerë lulesh.
Është e përhapur në Shqipëri, në të gjithë Ballkanin dhe në pjesën më të madhe të Evropës, si dhe në Azi të Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz dhe Kaukaz.

Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Leptotes pirithous*/Lang's Short-tailed Blue**
Trupshkurtra vjollcë-blu
Lycaenidae –Polyommatinae





***Leptotes pirithous*, dhe harta e shpërhapjes**

Leptotes pirithous është një flutur e vogël me gjatësi të krahut të përparme 12–13 mm. Ana e sipërme është blu me një kufi të hollë të errët në skaj; krahët e pasëm kanë bisht në këndin anal, ndërsa ana e sipërme e tyre tregon pak pika të errëta skajore në s1b dhe ndonjëherë në s2. Ana e poshtme nuk ka brez të dukshëm të bardhë postdiskal dhe modeli i vijave të bardha është i ndryshueshëm. Femra është kafe me shpërndarje blu bazale dhe me pika të errëta diskale e postdiskale; ana e poshtme është e ngjashme me mashkullin.
Specie të ngjashme përfshijnë *Lampides boeticus, Tarucus balkanicus, Cupido alcetas, Cupido argiades* dhe *Cupido decoloratus*. Ka gjenerata të vazhdueshme (deri në 4) nga fundi i marsit deri në nëntor; faza e vezës mund të dimërojë ose të jetë e shkurtër, ndërsa fazat e larvës dhe pupës janë të shkurtra. Jeton në zona të nxehta dhe të lagështa me shkurre dhe *Rubus*, shpesh pranë zonave të kultivuara, me kërkesa hapësinore të ulëta, dendësi popullate që mund të jetë e lartë dhe sjellje migratore. Larvat ushqehen me një gamë të gjerë bimësh të familjes *Fabaceae*, por janë raportuar edhe në *Lythraceae* dhe *Ericaceae*, ndërsa të rriturit ushqehen shpesh me *Rubus*.
Është e përhapur në Shqipëri, në të gjithë Ballkanin dhe në pjesën më të madhe të Evropës, si dhe në Azi të Vogël, Lindjen e Afërt dhe më tej në lindje. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Lysandra bellargus*/Adonis Blue**
Flatrablujta bukuroshe
Lycaenidae –Polyommatinae





***Lysandra bellargus*, dhe harta e shpërhapjes**

Lysandra bellargus është një flutur e vogël me gjatësi të flatrat të përparme 14–17 mm. te mashkulli ana e sipërme ka ngjyrë blu qielli me një kufi shumë të hollë të zi; skajet e flatrave me model bardhë-zi të dukshëm si kuadratë. Krahu i përparme pa shenja; krahu i pasëm me pika të vogla të zeza antemarginale. Ana e poshtme gri-kafe e çelët me shenjat standarde të plota; krahu i pasëm me shkëlqim bazal blu-jeshil. Femra e ngjashme në madhësi me mashkullin. Ana e sipërme kafe, ndonjëherë me nuanca blu; krahët mbajnë shenja në formë gjysmë-hëna portokalli të dukshme nënskajore. Ana e poshtme më e errët, me shenja të ngjashme me mashkullin; krahu i pasëm me gjysmë-hëna portokalli të mëdha nënskajore, ndërsa nuanca bazale blu është i reduktuar ose mungon. Speciet e ngjashme me të janë ato të gjinisë *Polyommatus* dhe lloji *Lysandra coridon*.
Specia ka dy gjenerata nga prilli deri në tetor; vezët zhvillohen në 7–28 ditë, larvat rreth 6 javë gjatë verës dhe dimërojnë si larva të hershme (L1–L2) për 30–34 javë, ndërsa pupëzimi zgjat 11–19 ditë. Jeton në livadhe të thata, të ekspozuara ndaj diellit mbi shkëmbinj gëlqerorë nga zona e ulët deri në 2000 m mbi nivelin e detit, me kërkesë hapësinore mesatare dhe dendësi popullate që mund të jetë e lartë; larvat ushqehen kryesisht me *Hippocrepis comosa*, si dhe me *Genista*, *Lotus corniculatus* dhe *Securigera varia*, ndërsa të rriturit ushqehen me një gamë të gjerë lulesh, shpesh mbi *Eryngium*.

Në Shqipëri është e përhapur në zonat malore dhe konsiderohet e statusit LC sipas Listës së Kuqe të Shqipërisë, ndërsa në nivel Evropian sipas kritereve të IUCN-së është klasifikuar si NT A2b.

***Lysandra coridon*/Chalck-hill Blue**
Kaltëroshja e argjendë
Lycaenidae –Polyommatinae





***Lysandra coridon*, dhe harta e shpërhapjes**

Lysandra coridon është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme 15–18 mm. Te mashkulli ana e sipërme është blu e zbehtë e argjendtë me skaje të dukshme bardhë-zi si "tavolina e shahut"; krah i përparmë me një kufi të gjerë kafe të errët, ndërsa krah i pasëm me kufi të ngushtë në skaj dhe pika të vogla rrethore antemarginale. Ana e poshtme gri e zbehtë me shenjat standarde; krah i pasëm gri-kafe e çelët me shkëlqim të lehtë gjelbër-blu dhe shenja shpesh të vogla ose të paplota, me gjysmë-hëna portokalli të vogla nënskajore. Femra e ngjashme në madhësi me mashkullin; ana e sipërme kafe me skaje me model bardhë-zi si tavolinë shahu në kafe të çelët dhe të errët, krahët me gjysmë-hëna portokalli të vogla, ose mungojnë, rrallë e pranishme, por ekzistojnë forma me blu të çelët (forma blu); ana e poshtme kafe e errët me gjysmë-hëna portokalli të vogla dhe shenja të ngjashme me mashkullin.
Speciet e ngjashme janë *Lysandra bellargus*. Ka një gjeneratë nga fundi i qershorit deri në shtator; vezët dimërojnë mbi bimën ushqyese pranë tokës (26–34 javë), larvat zhvillohen për 105–132 ditë dhe pupëzimi zgjat 21–32 ditë. Jeton në livadhe të thata të ekspozuara ndaj diellit mbi shkëmbinj gëlqerorë nga 500 deri në 2100 m mbi nivelin e detit, me kërkesë hapësinore mesatare dhe dendësi popullate që mund të jetë e lartë; rrallë nomade. Larvat ushqehen me *Hippocrepis*

comosa dhe *Securigera varia*, ndërsa të rriturit ushqehen me një gamë të gjerë lulesh.
Në Shqipëri është e përhapur në zonat malore. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Phengaris alcon*/Alcon Blue**
Kaltëroshja e vogël e kënetës
Lycaenidae –Polyommatinae





***Phengaris alcon*, dhe harta e shpërhapjes**

Phengaris alcon është një flutur e vogël me gjatësi të flatrave të përparme 17–19 mm. Te mashkulli ana e sipërme është blu e zbehtë me një kufi relativisht të hollë të zi, pa shenja; krah i përparme ndonjëherë me një pikë të vogël diskale. Ana e poshtme gri-kafe e zbehtë, me shkëlqim të dobët ose që mungon dhe me shenja të vogla skajore gri; krah i përparmë me pikë diskale dhe një rresht të harkuar shenjash postdiskale, ndërsa krah i pasëm ndonjëherë me pika bazale të vogla. Femra pak më e madhe; ana e sipërme gri-kafe e errët me shpërndarje blu bazale dhe krah i përparme me pikë diskale; ana e poshtme e ngjashme me mashkullin.
Speciet e ngjashme: *Phengaris arion*. Ka një gjeneratë nga qershori deri në korrik/fillim gushti; vezët zhvillohen në 7–11 ditë, larvat ushqehen për një periudhë të shkurtër (1–2 javë) mbi bimën ushqimore dhe më pas dimërojnë në foletë e milingonave, ku ushqehen sërish në pranverë, ndërsa pupëzimi zgjat rreth 22 ditë. Jeton në livadhe të lagështa gëlqerore me bushe dhe pemë të shpërndara, me bimë ushqimore lulëzuese, nga 500 deri në 2000 m mbi nivelin e detit; kërkesa hapësinore është shumë e vogël dhe shpesh shumë vezë vendosen mbi një bimë të vetme. Larvat ushqehen me *Gentiana cruciata* para se të jetojnë brenda folesë së milingonave, ndërsa të rriturit rrallë vërehen duke u

ushqyer. Në Shqipëri është e përhapur në Alpet Veriore dhe lokale në zona të tjera malore; në Ballkan dhe Evropë ka shpërndarje të gjerë.
Nuk konsiderohet e rrezikuar globalisht, por habitatet e vogla janë të ndjeshme ndaj kullotjes së tepërt dhe menaxhimit pyjor; sipas Listës së Kuqe të Shqipërisë është e vlerësuar si VU sipas kritereve të IUCN (D1+D2), ndërsa në nivel Evropian është klasifikuar si NT A2c.

***Phengaris arion*/Large Blue**
Kaltëroshja njollazezë
Lycaenidae –Polyommatinae





***Phengaris arion*, dhe harta e shpërhapjes**

Phengaris arion është një flutur e vogël deri mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 16–20 mm. Te mashkulli, ana e sipërme është blu e ndritshme me skaje të bardha dhe kufi të gjerë të zi në skaj; krahu i përparme paraqet një seri të ndryshueshme shenjash të zeza të gjata postdiskale (rrallë mungojnë), ndërsa krahu i pasëm ka pika të vogla postdiskale, ndonjëherë të reduktuara. Ana e poshtme është gri deri gri-kafe, me skaje bardhë-zi në formë shahu dhe shenja standarde të dukshme; krahu i pasëm ka në bazë ngjyrim me shpërndarje të gjerë blu-jeshile. Femra është pak më e madhe, me anën e sipërme blu të ndritshme, skaje të bardha dhe kufij të gjerë të zi; krahu i përparme shpesh me pika më të mëdha të zeza postdiskale. Ana e poshtme është e ngjashme me mashkullin. Specie e ngjashme është *Phengaris alcon*.
Specia zhvillon një gjeneratë nga qershori deri në fillim të gushtit; vezët zhvillohen në 6–8 ditë, larvat ushqehen për një periudhë të shkurtër mbi bimën ushqimore (rreth 17 ditë), më pas dimërojnë si larvë e fazes 4 në fole të milingonave dhe ushqehen sërish në pranverë brenda tyre, ndërsa pupëzimi zgjat rreth 24 ditë. Jeton në relieve të hapura me bar dhe trumzë, në zona me shkurre dhe lule të bollshme nga 250 deri në 2000 m mbi nivelin e detit; ka kërkesë hapësinore mesatare dhe dendësi popullate mesatare. Larvat ushqehen

kryesisht me specie të gjinisë *Thymus*, por janë raportuar edhe në *Origanum vulgare*; të rriturit ushqehen kryesisht mbi të njëjtat bimë.
Në Shqipëri është e përhapur në Alpet Veriore, por është lokale edhe në zona të tjera malore; gjendet në gjithë Ballkanin dhe Evropën, si dhe në pjesë të Azisë së Vogël deri në Kaukaz. Në Shqipëri është klasifikuar si CR, ndërsa në nivel mesdhetar nga IUCN si NT A2c.

***Plebejus argus*/Silver-studded Blue**
Kaltëroshja argus
Lycaenidae –Polyommatinae





***Plebejus argus*, dhe harta e shpërhapjes**

Plebejus argus është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme 12–15 mm. Mashkulli ka gjemba tibialë në këmbët e përparme, megjithëse këto janë të vështira për t'u dalluar në terren edhe me ndihmën e një lupe. Ana e sipërme është blu e thellë me një kufi të gjerë të zi në skaj; krahu i pasëm ka pika të vogla të zeza midis venave. Ana e poshtme nuk është gri-blu uniforme; krahu i pasëm paraqet një brez të dukshëm të bardhë midis shenjave postdiskale dhe nënskajore, ocelle të mëdhenj me unaza të bardha të dallueshme, një brez portokalli të zbehtë nënskajor dhe pika të zeza antemarginale me qendra blu-jeshile të ndritshme. Femra është e ngjashme në madhësi me mashkullin, ndonjëherë më e vogël; ana e sipërme kafe, ndonjëherë me ngjyrim të shpërnarë blu në pjesën bazale, ndërsa krahu i pasëm mund të ketë gjysmë-hëna portokalli nënskajore të ndryshueshme (ose të mungojnë). Ana e poshtme kafe, me brez të bardhë të dukshëm si te mashkulli.
Specie të ngjashme janë *Plebejus argyrognomon*, *Plebejus idas* dhe *Kretania sephirus*. Specia zhvillon dy gjenerata nga mesi i prillit deri në shtator; vezët dimërojnë mbi bimët me të cilat ushqehen pranë tokës, larvat zhvillohen për 65–75 ditë dhe pupëzimi zgjat 13–20 ditë. Jeton në një gamë të gjerë habitatesh nga të thata deri të lagështa, përfshirë livadhe gëlqerore, zona me shkurre të ulëta

dhe vende me bimësi të rrallë, nga ultësirat deri në 2000 m mbi nivelin e detit; ka kërkesë hapësinore shumë të vogël dhe dendësi popullate shpesh të lartë. Larvat ushqehen me bimë të familjeve *Fabaceae, Ericaceae* dhe *Cistaceae*, shpesh me *Helianthemum nummularium, Lotus corniculatus* dhe *Securigera varia*; të rriturit ushqehen me lule të vogla dhe marrin minerale nga toka e lagësht.
Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht; gjendet në gjithë Ballkanin dhe Evropën, si dhe në Azi të Vogël, Transkaukaz dhe Kaukaz. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Plebejus argyrognomon*/Reverdin's Blue**
Argirognomonia
Lycaenidae –Polyommatinae





***Plebejus argyrognomon*, dhe harta e shpërhapjes**

Plebejus argyrognomon është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme 15–18 mm. Te mashkulli, këmbët e përparme nuk kanë gjemba tibiale (tipar i vështirë për t'u vërejtur në terren); ana e sipërme është blu e ndritshme me kufi të ngushtë të zi. Ana e poshtme është e njëtrajtshme, bardhë–blu e hapur, me një brez të plotë gjysmë-hënash portokalli nënskajore deri te maja e krahut të përparme; krahu i pasëm tregon gjysmë-hëna të zeza nënskajore të buta e të harkuara, ocelle të zeza margjinale me qendra blu të ndritshme dhe shenja të zeza në formë V pranë gjysmë-hënave portokalli. Femra është pak më e madhe; ana e sipërme kafe, shpesh me shpërndarje të gjerë blu bazale dhe me brez të plotë gjysmë-hënash portokalli nënskajore; ana e poshtme kafe e hapur, me model të ngjashëm me mashkullin.
Specie të ngjashme janë *Plebejus argus*, *Plebejus idas* dhe *Kretania sephirus*. Specia zhvillon dy gjenerata nga maji deri në gusht; vezët dimërojnë mbi kërcellin e bimës ushqimore pranë tokës, larvat zhvillohen për 43–64 ditë në gjeneratën e parë dhe 27–40 ditë në të dytën, ndërsa pupëzimi zgjat 8–14 ditë. Jeton në livadhe me lule dhe në shpatet malore nga 400 deri në 1500 m mbi nivelin e

detit; ka kërkesë hapësinore mesatare dhe dendësi popullate që mund të jetë e lartë. Larvat ushqehen kryesisht me *Coronilla varia*, por edhe me *Astragalus, Hippocrepis comosa, Lotus corniculatus, Melilotus officinalis, Onobrychis viciifolia* dhe *Securigera varia*; të rriturit ushqehen me nektar lulesh në shtresën e barit. Në Shqipëri është e përhapur në Alpet Veriore dhe lokale në zona të tjera; gjendet në gjithë Ballkanin dhe Evropën, si dhe në pjesë të Azisë së Vogël, Transkaukazit dhe Kaukazit. Sipas kritereve të IUCN, në nivel kombëtar klasifikohet si NE në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ndërsa në nivel Evropian klasifikohet si LC.

***Plebejus idas*/Idas Blue**
Idas blu
Lycaenidae Polyommatinae





***Plebejus idas*, dhe harta e shpërhapjes**

Plebejus idas është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme 14–16 mm. Te mashkulli, këmbët e përparme nuk kanë shpina tibiale (tipar i vështirë për t'u vërejtur në terren); ana e sipërme është blu e ndritshme me kufij të ngushtë të zi. Ana e poshtme është uniformë gri e hapur, me një brez të bardhë pak të dallueshëm midis shenjave postdiskale dhe nënskajore, si dhe ocelle të vegjël me unaza të bardha të zbehta; krahu i pasëm paraqet një brez portokalli të ndritshëm nënskajor. Femra është e ngjashme në madhësi; ana e sipërme kafe me shpërndarje blu bazale jo të vazhdueshme, ndërsa ana e poshtme kafe e hapur me breza portokalli të ndritshëm në skaj. Specie të ngjashme janë *Plebejus argus*, *Plebejus argyrognomon* dhe *Kretania sephirus*.
Specia zhvillon dy gjenerata nga maji deri në gusht; vezët dimërojnë mbi bimën ushqimore pranë tokës, larvat zhvillohen për 50–61 ditë dhe pupëzimi zgjat 14–21 ditë. Jeton në livadhe të thata dhe zona të ashpra me shkurre të shpërndara nga 300 deri në 2000 m mbi nivelin e detit; ka kërkesë hapësinore mesatare dhe dendësi popullate të ulët. Larvat ushqehen me *Helianthemum nummularium, Lotus, Hippophae rhamnoides* dhe *Genista*; të rriturit ushqehen me lule të vogla.

Në Shqipëri është e përhapur në Alpet Veriore dhe lokale në zona të tjera malore; gjendet në gjithë Ballkanin dhe Evropën, si dhe në Azi të Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz dhe Kaukaz. Sipas kritereve të IUCN, në nivel kombëtar klasifikohet si NE në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ndërsa në nivel Evropian klasifikohet si LC.

***Polyommatus admetus*/Anomalous Blue**
Anomalja e madhe
Lycaenidae –Polyommatinae





***Polyommatus admetus*, dhe harta e shpërhapjes**

Polyommatus admetus është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparëm 15–19 mm. Te mashkulli, ana e sipërme është kafe me një zonë të dukshme me luspa androconiale me pamje të leshtë; ana e poshtme kafe e hapur me shenja nënskajore të qarta. Krahu i përparme në anën e poshtme nuk ka pikë qelizore, por paraqet një vijë diskale të unazuar dhe pika postdiskale, si dhe pika margjinale kafe të hapura; krahu i pasëm zakonisht ka shenja në formë harku dhe "V"-sh (chevrons), ndonjëherë edhe një shenjë të bardhë trekëndëshe postdiskale në v4. Femra është pak më e vogël; ana e sipërme kafe e hapur dhe më e njëtrajtshme, ndërsa krahu i pasëm mund të tregojë gjysmë-hëna margjinale të paqarta pranë zonës anale. Ana e poshtme është më e ndritshme, me shenja më të zhvilluara, ndonjëherë me shenjë të bardhë trekëndëshe si te mashkulli.
Specie të ngjashme janë ato të kompleksit *Polyommatus aroaniensis* dhe *Polyommatus damon*. Specia zhvillon një gjeneratë nga fundi i qershorit deri në gusht; vezët dimërojnë si larvë e re brenda guaskës së vezës, ndërsa fazat e larvës dhe pupës janë të shkurtra. Jeton në habitate të ngrohta, të thata dhe shkëmbore me lule dhe shkurre të shpërndara, nga 300 deri në 1500 m mbi

nivelin e detit; ka kërkesë hapësinore mesatare dhe dendësi popullate që mund të jetë e lartë. Larvat ushqehen me specie të ndryshme të gjinisë *Onobrychis*, ndërsa të rriturit ushqehen me lule të ndryshme në habitat.
Në Shqipëri është lokale dhe nuk është regjistruar në Alpet Veriore; gjendet në gjithë Ballkanin dhe Evropën, si dhe në Azi të Vogël dhe Transkaukazin jugor. Sipas kritereve të IUCN, në nivel kombëtar klasifikohet si NE në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ndërsa në nivel Evropian klasifikohet si LC.

***Polyommatus amandus*/Amanda's Blue**
Kaltëroshja e hijshme
Lycaenidae –Polyommatinae





***Polyommatus amandus*, dhe harta e shpërhapjes**

Polyommatus amandus është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparëm 16–19 mm. Te mashkulli, ana e sipërme është blu qielli me kufi të errët të shpërndarë përgjatë venave; ana e poshtme gri e hapur me nuancë blu pranë bazës. Krahu i përparme nuk ka pikë qelizore dhe paraqet shenjat e zakonshme me shenja margjinale të paqarta, zakonisht pa gjysmë-hëna portokalli nënskajore; krahu i pasëm ka gjysmë-hëna portokalli nënskajore në s1c, s2 dhe s3 (ndonjëherë më shumë) dhe pika të vogla të zeza antemarginale deri në s7. Femra është pak më e madhe; ana e sipërme kafe me gjysmë-hëna portokalli nënskajore (jo gjithmonë në krahun e përparme) dhe me nuancë blu bazale të ndryshueshme; krahu i pasëm ka pika margjinale të zeza brenda gjysmë-hënave portokalli nga s1c deri në s3 ose pak më tej. Ana e poshtme është gri-kafe me shenja më të theksuara dhe brez nënskajor më të zhvilluar.
Specie të ngjashme janë ato të gjinisë *Polyommatus*, si *Polyommatus icarus* dhe *Polyommatus thersites*. Specia zhvillon një gjeneratë nga maji deri në mes të gushtit; vezët kanë fazë të shkurtër zhvillimi, larvat dimërojnë si larva të reja dhe faza e pupës është e shkurtër. Jeton në livadhe të ngrohta me shumë lule, me shkurre të shpërndara, në pyje të hapura dhe skaje pyjesh, nga ultësirat deri në

1800 m mbi nivelin e detit; ka kërkesë hapësinore mesatare dhe dendësi popullate që mund të jetë e lartë. Larvat ushqehen kryesisht me specie të gjinisë *Vicia*, por edhe me *Lathyrus, Medicago sativa* dhe *Securigera varia*; të rriturit ushqehen me lule të mëdha të ndryshme.
Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht në Alpet Veriore dhe lokale në zona të tjera malore; gjendet në gjithë Ballkanin dhe Evropën, si dhe në Azi të Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz dhe Kaukaz. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Polyommatus damon*/Damon Blue**
Kaltëroshja e gjelbërt
Lycaenidae –Polyommatinae





***Polyommatus damon*, dhe harta e shpërhapjes**

Polyommatus damon është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme 15–17 mm. Ana e sipërme e mashkullit është blu e ndritshme me një brez të gjerë kafe të errët në skaj, që shtrihet përgjatë venave të errëta; krahu i përparme pa shenjë seksuale (sex-brand). Ana e poshtme është ngjyrë verdhë-gri me një vijë të qartë diskale të rrethuar me të bardhë dhe pika të errëta postdiskale; krahu i pasëm pak më kafe, me një vijë të bardhë të theksuar në venën v4 që shtrihet nga baza pothuaj deri në skaj, ndërsa shenjat bazale dhe postdiskale janë të vogla ose mungojnë. Femra është pak më e vogël dhe ka anën e sipërme kafe, shpesh me shpërndarje blu pranë bazës dhe pak blu mbi toraks; ana e poshtme ngjyrë kafe e çelët me shenja të ngjashme me mashkullin. Speciet e ngjashme përfshijnë *Polyommatus amandus, Polyommatus admetus,* kompleksin *Polyommatus aroaniensis* dhe *Polyommatus ripartii*.
Specia ka një gjeneratë nga korriku deri në fillim të shtatorit; vezët kanë fazë të gjatë dhe dimërojnë si larvë e re brenda vezës, ndërsa pupa zhvillohet për 26–30 ditë. Jeton në lëndina të brezit të ngrohtë, në zona shkëmbore dhe gëlqerore me lule dhe shkurre të shpërndara, nga 750 deri në 2000 m mbi nivelin e detit;

larvat ushqehen me specie të ndryshme *Onobrychis*, ndërsa të rriturit ushqehen me lule të ndryshme në habitat.
Në Shqipëri është vlerësuar si VU, ndërsa sipas kritereve të IUCN, specia klasifikohet si LC në nivel Evropian.

***Polyommatus daphnis*/Meleager's Blue**
Flatradhëmbaçja blu
Lycaenidae –Polyommatinae





***Polyommatus daphnis*, dhe harta e shpërhapjes**

Polyommatus daphnis është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme 18–19 mm. Krahu i pasëm ka një skaj të dalluar, pak të valëzuar (si i dhëmbëzuar) midis venave v2 dhe v3. Ana e sipërme e mashkullit është blu e ndritshme me një brez të ngushtë të zi në skaj; krahu i përparme shpesh ka një njollë të zbehtë diskale (ndonjëherë mungon), pa shenja të tjera. Ana e poshtme është ngjyrë gri e gjallë me shenjat bazale dhe postdiskale të zeza tipike, ndërsa shenjat margjinale janë gri të zbehta; krahu i pasëm nuk ka hënëza portokalli nënskajore dhe krahu i përparme nuk ka pikë qelizore. Femra është pak më e madhe, me skajin e jashtëm të krahut të pasëm më të valëzuar se te mashkulli; ana e sipërme është blu më e errët ose kafe (forma steeveni), me skaje dhe kufij të errët, shpesh me njollë diskale në krahun e përparme dhe shenja të zbehta diskale e antemarginale në krahun e pasëm. Ana e poshtme është kafe e çelët, e ngjashme me mashkullin. Specia ka një gjeneratë nga mesi i qershorit deri në fillim të shtatorit; lloji dimëron në fazën vezë, larvat zhvillohen gjatë pranverës për një periudhë të gjatë dhe pupëzimi është i shkurtër. Jeton në shpatet e ngrohta dhe të lulëzuara, nga 250 deri në 1750 m mbi nivelin e detit, me kërkesë hapësinore modeste dhe dendësi popullsie që mund të jetë e lartë; larvat

ushqehen me disa lloje Fabaceae (si *Astragalus, Coronilla varia, Hippocrepis comosa, Lathyrus, Onobrychis, Securigera varia* dhe *Thymus*), ndërsa të rriturit ushqehen me lule të ndryshme në habitat. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Polyommatus dorylas*/Turquoise Blue**
Kaltëroshja e jonxhës
Lycaenidae –Polyommatinae





***Polyommatus dorylas*, dhe harta e shpërhapjes**

Polyommatus dorylas është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme 15–17 mm. Ana e sipërme e mashkullit ka një shkëlqim blu të çelët me një vijë të hollë margjinale që shtrihet pak përgjatë venave; femra është kafe, shpesh me nuanca blu në bazë. Ana e poshtme është ngjyrë gri e çelët deri në olive, me shenjat tipike të gjinisë. Krahu i përparme nuk ka njollë qelizore dhe ka një brez të gjerë të bardhë, ndërsa shenjat antemarginale janë shumë të zbehta ose mungojnë; krahu i pasëm ka hënëza portokalli submarginale trekëndëshe me skaj të zi të zbehtë, të cilat mund të jenë të reduktuara ose të mungojnë.
Specia në varësi të lartësisë ka një gjeneratë nga maji deri në shtator; vezët kanë fazë të shkurtër, larvat dimërojnë dhe pupëzimi është i shkurtër. Jeton në shpatet e ngrohta dhe të lulëzuara me shkëmbinj gëlqerorë, nga 500 deri në 2000 m mbi nivelin e detit, me kërkesë hapësinore modeste dhe dendësi popullsie që mund të jetë e lartë; femrat shihen rrallë. Larvat ushqehen kryesisht me *Anthyllis vulneraria*, si dhe me *Anthyllis montana*, *Astragalus glycyphyllos* dhe *Thymus serpyllum*, ndërsa të rriturit ushqehen me lule të ndryshme në habitat.
Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Polyommatus eros*/Eros Blue**
Flatrakaltra e zakonshme e livadheve
Lycaenidae –Polyommatinae





***Polyommatus eros*, dhe harta e shpërhapjes**

Polyommatus eros është një flutur i vogël, me gjatësi të flatrave të përparme 15–18 mm. Ana e sipërme e mashkullit është blu e kaltërt me rreth 2 mm kufij të zinj në skaj dhe me venat pjesërisht të errësuara; krahu i pasëm sipër ka njolla të rrumbullakëta të zeza antemarginale të bashkuara me kufirin e zi. Ana e poshtme është ngjyrë gri-kafe: krahu i përparme poshtë ka njolla qelizore dhe një njollë bazale shtesë me shenjat tipike, ndërsa krahu i pasëm poshtë ka shkëlqim të bardhë të reduktuar në venën v4 pas njollës postdiscale dhe shenja këndore të zeza mbi hënëzat portokalli submarginale; androconia mungojnë dhe nuk ka njollë diskale. Femra është e ngjashme në madhësi, por me anën e sipërme kafe me shpërndarje blu bazale (përfshirë edhe kraharorin); krahu i pasëm sipër ka hënëza portokalli submarginale të ndryshueshme, njolla të zeza antemarginale dhe një vijë të hollë margjinale të zezë, ndërsa ana e poshtme është pak më e errët me shenja më të theksuara dhe njollë diskale të pranishme. Speciet e ngjashme përfshijnë *Polyommatus icarus* dhe *Aricia anteros*.
Specia ka një gjeneratë nga qershori deri në gusht; vezët kanë fazë të shkurtër, larvat me shumë gjasa dimërojnë dhe pupëzimi është i shkurtër. Jeton në luginat e hapura malore të lulëzuara, veçanërisht mbi dhe pranë kufirit të pyllit, nga 750 deri në 2250 m mbi nivelin e detit, me kërkesë hapësinore modeste dhe

dendësi popullsie që mund të jetë e lartë; larvat ushqehen me disa Fabaceae si *Astragalus, Chamaecytisus, Genista, Lotus corniculatus, Onobrychis montana* dhe *Oxytropis*, ndërsa të rriturit ushqehen me lule të ndryshme në habitat.
Sipas kritereve të IUCN-së, specia klasifikohet si LC në nivel Evropian dhe konsiderohet e qëndrueshme në këtë nivel. Sipas Listës së Kuqe të Shqipërisë është e vlerësuar si VU.

***Polyommatus escheri*/Escher's Blue**
Esheria
Lycaenidae –Polyommatinae





***Polyommatus escheri*, dhe harta e shpërhapjes**

Polyommatus escheri është një flutur e vogël deri mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 17–20 mm. Krahët kanë skaj të jashtëm pak të valëzuar; krahu i përparme shfaq një formë të lehtë fryrjeje, ndërsa krahu i pasëm është më i rregullt dhe më pak i valëzuar. Ana e sipërme e mashkullit është blu e kaltër e çelët me një bordurë të zezë 1–2 mm, jo plotësisht të rregullt në margjina dhe pak të shtrirë përgjatë venave; kosta dhe venat duken më të çelëta. Ana e poshtme është gri e çelët deri pothuaj e bardhë me shenjat tipike: krahu i përparme poshtë ka njolla të mëdha të zeza postdiskale dhe nuk ka njollë qelizore, ndërsa krahu i pasëm poshtë ka njolla më të vogla postdiskale dhe një shkëlqim blu bazal. Femra është pak më e madhe, me anën e sipërme kafe dhe me një seri hënëzash portokalli submarginale të mëdha si në krahun e përparme (rrallë mungojnë) ashtu edhe në krahun e pasëm, ku hënëzat shpesh përmbajnë njolla të zeza; shkëlqimi blu bazal është i rrallë ose i dobët. Ana e poshtme e femrës është kafe me shenja më të theksuara se te mashkulli dhe pa njollë qelizore në krahun e përparme.
Speciet e ngjashme përfshijnë *Polyommatus amandus, Polyommatus daphnis, Polyommatus dorylas, Polyommatus icarus* dhe *Polyommatus thersites.* Specia ka një gjeneratë nga fundi i majit deri në gusht; vezët kanë fazë të shkurtër, larvat

dimërojnë si larva të reja dhe pupëzimi është i shkurtër. Jeton në shkëmbinj të nxehtë dhe të thatë nga 500 deri në 1750 m mbi nivelin e detit, me kërkesë hapësinore modeste; larvat ushqehen me disa specie *Astragalus* (*A. angustifolius, A. exscapus, A. monspessulanus*), ndërsa të rriturit ushqehen me lule të ndryshme në habitat.
Sipas kritereve të IUCN-së, specia klasifikohet si LC. Ndërsa në Shqipëri sipas Listës së Kuqe është e vlerësuar si VU.

***Polyommatus icarus*/Common Blue**
Flatrablujta e zakonshme
Lycaenidae–Polyommatinae





***Polyommatus icarus*, dhe harta e shpërhapjes**

Polyommatus icarus është një flutur i vogël me gjatësi të flatrave të përparme 14–18 mm. Ana e sipërme e mashkullit është blu me shkëlqim të shndritshëm, me një bordurë të ngushtë të errët në skaj dhe pa luspa të veçanta aromatike; në disa raste mund të shfaqen njolla të dobëta antemarginale në flatrën e pasme. Ana e poshtme është gri me nuancë blu–jeshile pranë bazës dhe me shenjat tipike të zhvilluara mirë; hënëzat portokalli submarginale zakonisht shihen vetëm në flatrën e pasme. Flatra e përparme në anën e poshtme ka një njollë në qelizë dhe një njollë të dytë bazale (në disa forma mund të mungojnë). Femra është zakonisht kafe, shpesh me hënëza portokalli submarginale të theksuara dhe me nuanca blu të zhvilluara në bazë dhe në zonën diskale, ndonjëherë të përhapura gjerësisht; ana e poshtme është kafe me shenjat më të forta se te mashkulli. Specie të ngjashme: *Polyommatus eros* dhe *Aricia anteros*. *Polyommatus icarus* ka gjenerata të vazhdueshme nga pranvera deri në vjeshtë (zakonisht nga marsi deri në nëntor). Vezët çelin pas 5–12 ditësh; larvat zhvillohen 21–57 ditë gjatë verës dhe dimërojnë si larva (L3) për 34–46 javë; pupacioni zgjat 9–24 ditë. Kjo specie jeton në një gamë shumë të gjerë habitatesh me lule, përfshirë livadhe, zona bujqësore dhe edhe mjedise urbane, nga niveli i ulët deri mbi 2000 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa hapësinore të ulëta dhe

mund të formojë popullata të dendura. Larvat ushqehen me bimë të familjes Fabaceae si *Lotus, Medicago, Securigera varia* dhe *Trifolium*, si dhe rrallë me *Helianthemum*; të rriturit ushqehen me nektarin e shumë luleve të ndryshme. Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht. Në Ballkan dhe Evropë është gjithashtu shumë e zakonshme dhe e shpërndarë në mënyrë të gjerë, duke u shtrirë edhe në Azi të Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz dhe më tej në lindje. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Polyommatus aroaniensis lurae*/Lura's Anomalous Blue**
Luranja
Lycaenidae -Polyommatinae






***Polyommatus aroaniensis lurae*, dhe harta e shpërhapjes**

Polyommatus aroaniensis lurae është një flutur e vogël me gjatësi të flatrës së përparme 14–18 mm. Ana e sipërme e mashkullit është kafe dhe pa shenja të dukshme, me një zonë të dallueshme me luspa aromatike (androconia) në flatrën e përparme; ana e poshtme është kafe pa shenja submarginale, me mungesë të vijës së bardhë postdiscale si në flatrën e përparme ashtu edhe në atë të pasme. Femra është pak më e madhe, me anë të sipërme kafe dhe zakonisht pa shenja të veçanta, duke ndjekur tiparet e mashkullit.
Specie të ngjashme përfshijnë *Polyommatus aroaniensis, Polyommatus admetus, Polyommatus orphicus* dhe *Polyommatus ripartii*. Lloji me gjasë ka një gjeneratë në vit; vezët kanë zhvillim të gjatë, larva ndoshta dimëron brenda vezës ose si larvë e re, dhe pupacioni është i shkurtër. Jeton në shpate shkëmbore me substrat ofiolitik (shkëmbinj ultramafikë), të rrethuar nga shkurre ose vegjetacion i rrallë, në lartësi 900–1500 m mbi nivelin e detit; ka kërkesa hapësinore modeste dhe dendësi popullate të ulët deri mesatare, me larva që me shumë gjasë ushqehen me *Onobrychis alba* dhe të rritur që ushqehen me nektar lulesh të ndryshme në habitat.

Në Shqipëri është shumë lokal dhe i njohur vetëm në dy qarqe (Dibër dhe Korçë). Sipas Listës së Kuqe të Shqipërisë lloji klasifikohet si: DD (Data Deficient – të dhëna të pamjaftueshme). Në Listën e Kuqe Evropiane kjo specie klasifikohet NA (Not Assessed – nuk është vlerësuar).

***Polyommatus aroaniensis orphicus*/Kolev's Anomalous Blue**
Orficusi i kafejtë
Lycaenidae–Polyommatinae





***Polyommatus aroaniensis orphicus*, dhe harta e shpërhapjes**

Polyommatus aroaniensis orphicus është një flutur e vogël me gjatësi të flatrës së përparme 13–18 mm. Ana e sipërme e mashkullit është kafe dhe pa shenja, me një zonë të dukshme me luspa aromatike (androconia) në flatrën e përparme dhe pa njollë diskale. Ana e poshtme është kafe e lehtë deri mesatare; në flatrën e përparme poshtë mungon njolla qelizore, ndërsa linja diskale është e zakonshme me rreth të bardhë dhe njollat postdiskale mund të jenë të dobëta ose të mungojnë. Në flatrën e pasme poshtë, mund të shfaqet një vijë e bardhë e dukshme përgjatë venës 4 nga baza, por kjo është shumë e ndryshueshme dhe shpesh mungon në popullata të ndryshme. Femra është pak më e vogël, me anë të sipërme kafe më të çelët dhe pa shenja të theksuara; mund të shfaqë një njollë të vogël diskale dhe ndonjëherë hënëza portokalli të zbehta pranë këndit anal, ndërsa ana e poshtme është më e errët me shenja më të forta dhe me vijën e bardhë të pasme që mund të jetë e dukshme ose e munguar sipas popullatës. Specie të ngjashme përfshijnë *Polyommatus admetus, Polyommatus lurae, Polyommatus aroaniensis* dhe *Polyommatus ripartii*. Ka një gjeneratë në vit nga fundi i qershorit deri në gusht; vezët me gjasë kanë zhvillim të gjatë, larva ndoshta dimëron brenda vezës ose si larvë e vogël, dhe pupacioni është i

shkurtër. Jeton në shkëmbinj të hapur e të ngrohtë me lule dhe shkurre të shpërndara mbi substrat gëlqeror dhe në Shqipëri edhe mbi substrat të përzier gëlqeror–ofiolitik, në lartësi 500–1500 m mbi nivelin e detit; ka kërkesa hapësinore modeste dhe densitet popullate që mund të jetë i lartë, me larva që ushqehen me *Onobrychis* spp. dhe të rritur që ushqehen me nektar nga lule të ndryshme në habitat. Në Shqipëri ka pka përhapje shumë lokale dhe kërkon studime të mëtejshme, ndërsa në Ballkan është e pranishëme në disa vende, por me konfirmime të kufizuara; sipas Listës së Kuqe të Shqipërisë ka statusin DD (të dhëna të pamjaftueshme) dhe bazuar në kriteret e IUCN-së, në Listën e Kuqe Evropian ka statusin NA (nuk është vlerësuar).

***Polyommatus ripartii*/Ripart's Anomalous Blue**
Anomalja e vogël
Lycaenidae –Polyommatinae





***Polyommatus ripartii*, dhe harta e shpërhapjes**

Polyommatus ripartii është një flutur e vogël me gjatësi të flatrave së përparme 14–17 mm. Ana e sipërme e mashkullit është kafe dhe pa shenja, me një zonë të dukshme me luspa aromatike (androconia) në flatrën e përparme dhe pa njollë diskale. Ana e poshtme është kafe e lehtë deri gri; në flatrën e përparme poshtë mungon njolla qelizore, ndërsa linja diskale me rreth të bardhë dhe njollat postdiskale janë të pranishme, shenjat margjinale zakonisht mungojnë ose janë shumë të dobëta. Në flatrat e pasme poshtë shfaqet një vijë e bardhë nga baza përgjatë venës 4, e cila është shumë e ndryshueshme në gjatësi dhe intensitet dhe shpesh zgjerohet në pjesën distale, ndërsa shenjat margjinale kryesisht mungojnë. Femra është pak më e vogël, me anë të sipërme më të çelët dhe pa shenja të dukshme; mund të ketë një njollë të errët diskale në flatrën e përparme dhe ndonjëherë hënëza portokalli të zbehta pranë këndit anal në flatrën e pasme, ndërsa ana e poshtme është më e errët me shenja më të theksuara dhe vijën e bardhë të pasme të ndryshueshme, shpesh më të zgjeruar. Specie të ngjashme përfshijnë *Polyommatus aroaniensis, Polyommatus admetus, Polyommatus lurae, Polyommatus orphicus* dhe *Polyommatus damon*. Ka një gjeneratë në vit nga fundi

i qershorit deri në fillim të shtatorit; vezët kanë fazë të shkurtër, larva dimëron me shumë gjasa në vezë ose si larvë e re, dhe pupacioni ka të ngjarë të jetë i shkurtër. Jeton në habitate të hapura e të ngrohta shkëmbore, të pasura me lule dhe me shkurre të shpërndara mbi substrat gëlqeror dhe ofiolitik, në lartësi 500–2000 m mbi nivelin e detit; ka kërkesa hapësinore modeste dhe densitet popullate që mund të jetë i lartë, me larva që ushqehen me *Onobrychis alba, O. arenaria, O. caput-galli, O. montana* dhe *O. viciifolia*, ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga lule të ndryshme në habitat. Në Shqipëri është lloj lokal dhe nuk është regjistruar në Alpet e Veriut. Specia ka statusin NT në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ndërsa sipas Listës së Kuqe (niveli Evropian) është NT A2c.

***Polyommatus thersites*/Chapman's Blue**
Flatrablujta e shkathët
Lycaenidae –Polyommatinae





***Polyommatus thersites*, dhe harta e shpërhapjes**

Polyommatus thersites është një flutur e vogël, me gjatësi flatrash 13–16 mm. Ana e sipërme tek meshkuj është blu me një vijë të ngushtë të errët në skaj dhe me shumë qime androconiale, ndërsa krahët e pasëm sipër rrallë shfaqin njolla të errëta antemarginale. Ana e poshtme është gri e çelët deri në kafe me një nuancë blu-jeshile në bazë (më pak e dukshme në verë); shenjat tipike janë të zhvilluara mirë, me hënëza portokalli nënmarginale shpesh të pranishme si në krahun e përparme ashtu edhe në atë të pasëm (ndonjëherë të dobëta). Krahët e përparme poshtë nuk kanë njollë qelizore dhe nuk shfaqin njollën e dytë bazale, ndërsa krahët e pasëm poshtë kanë shenjat standarde dhe një shenjë të bardhë të dallueshme në venën 4. Femra është me madhësi të ngjashme me mashkullin; ana e sipërme e saj është kafe me nuancë blu në bazë dhe mund të ketë përhapje të pjesshme ose të gjerë të blu-së, dhe me hënëza portokalli nënmarginale në krahët e përparme (mund të jenë edhe të reduktuara) dhe në krahët e pasëm; ana e poshtme është kafe-gri më e errët me shenja më të forta dhe me shenjën e bardhë në venën 4 të dukshme. Specie të ngjashme përfshijnë të tjera të gjinisë

Polyommatus, veçanërisht *Polyommatus icarus*. Specia ka dy deri tre gjenerata nga prilli deri në tetor; vezët zhvillohen për 6–9 ditë, larvat dimërojnë si L2 ose L3 në shtresën e mbeturinave bimore dhe pupacioni zgjat 11–27 ditë. Jeton në livadhe të ngrohta, të thata dhe të lulëzuara me shkurre të shpërndara nga zona e ulët deri në 1700 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore shumë modeste dhe dendësi popullate mesatare; larvat ushqehen me speciet e gjinisë *Onobrychis*, por janë raportuar edhe në llojet *Hedysarum coronarium* dhe *Securigera varia*, ndërsa të rriturit ushqehen me një gamë të gjerë lulesh. Kjo specie në Listën e Kuqe të Shqipërisë ka statusin NE, edhe në nivelin Evropian sipas IUCN-së është klasifikuar si LC.

***Pseudophilotes vicrama*/Eastern Baton Blue**
Flatrabluja njollëzezë
Lycaenidae –Polyommatinae





***Pseudophilotes vicrama*, dhe harta e shpërhapjes**

Pseudophilotes vicrama është një flutur e vogël, me gjatësi flatrash 10–12 mm. Ana e sipërme tek meshkujt është blu e lehtë, me pamje të pluhurosur dhe me një kufi të ngushtë në skaj; krahët e përparme sipër kanë një njollë të zezë diskale, ndërsa krahët e pasëm sipër kanë gjithashtu njollë diskale dhe disa njolla të vogla të zeza antemarginale, pa prani të njollave portokalli nënmarginale. Ana e poshtme është gri e çelët deri gri-kafe me njolla të errëta të dallueshme; krahët e pasëm nga poshtë kanë hënëza portokalli nënmarginale që shtrihen deri në segmentin s5. Femra është me madhësi të ngjashme me mashkullin; ana e sipërme e saj është kafe e errët me një nuancë blu bazale të ndryshueshme, ndërsa modeli i njollave antemarginale mbetet i njëjtë dhe hënëzat portokalli nënmarginale mungojnë; ana e poshtme është e ngjashme me mashkullin, gri e çelët deri gri-kafe me njolla të errëta dhe hënëza portokalli të zhvilluara në krahët e pasëm. Specia ka dy gjenerata nga fundi i marsit deri në gusht (varësisht nga lartësia); vezët zhvillohen për 5–8 ditë, kohëzgjatja e larvës ndryshon sipas gjeneratës dhe pupa dimëron. Jeton në livadhe të thata,

shkëmbore me shkurre ose vegjetacion të shpërndarë nga zona e ulët deri në 2000 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore modeste dhe densitet popullate të ulët; larvat ushqehen me *Thymus* sp., por janë regjistruar edhe në *Hyssopus officinalis, Mentha spicata* dhe *Satureja montana*, ndërsa të rriturit ushqehen kryesisht me nektarin e bimëve pritëse. Në Shqipëri është e përhapur, po ashtu gjendet edhe në Ballkan dhe Evropë, përhapja e saj shtrihet deri në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz dhe Kaukaz e më tej në lindje. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Scolitantides orion*/Chequered Blue**
Flatrakafeblujta
Lycaenidae –Polyommatinae





***Scolitantides orion*, dhe harta e shpërhapjes**

Scolitantides orion është një flutur e vogël, me gjatësi flatrash 13–16 mm. Ana e sipërme është ngjyrë gri–blu e zbehtë me model bardhë–zi si tabelë shahu. Krahët e përparëm sipër kanë një njollë të zezë diskale të dukshme, me nuancë blu bazale të dobët ose që mund të mungojë dhe hënëza nënmarginale me kontur të ndritshëm blu. Krahët e pasëm sipër kanë hënëza nënmarginale të ndritshme blu, gjithashtu të konturuara (me bordurë). Ana e poshtme është ngjyrë gri e çelët me njolla të mëdha të zeza; krahët e pasëm poshtë kanë një brez portokalli nënmarginal të dukshëm. Femra është pak më e madhe se mashkulli; ana e sipërme është ngjyrë gri–e zezë me model bardhë–zi si tabelë shahu, krahet e përparëm me një njollë diskale të zezë, ngjyrim flur ose jo në bazë blu të zbehtë dhe hënëza nënmarginale të ndritshme blu të konturuara, ndërsa krahet e pasëm sipër kanë të njëjtat hënëza nënmarginale blu të konturuara. Specia ka dy gjenerata nga prilli deri në fillim të qershorit dhe nga fillimi i korrikut deri në gusht (gjenerata e dytë ndonjëherë e pjesshme); vezët dhe larvat kanë stad të shkurtër dhe pupa është faza dimëruese. Jeton në livadhe të thata, shkëmbore me shkurre të shpërndara dhe zona të hapura shkëmbore, kryesisht mbi

gëlqerorë, por edhe mbi ophiolite, nga zona të ulëta deri në 1500 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore modeste dhe densitet popullate mesatar deri të ulët; larvat ushqehen me *Sedum* sp., ndërsa të rriturit marrin nektar kryesisht nga lulet e bimës ushqimore ose lule të ulëta përreth. Në Shqipëri është e përhapur në Alpet e Veriut dhe lokale në zona të tjera malore, gjendet në Ballkan dhe Evropë, gjithashtu lokale në Azinë e Vogël dhe më tej në lindje. Specia ka statusin VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe Evropiane.

***Tarucus balkanica*/Little Tiger Blue**
Ballkanja
Lycaenidae –Polyommatinae





***Tarucus balkanica*, dhe harta e shpërhapjes**

Tarucus balkanica është një flutur e vogël, me gjatësi flatrash 9–11 mm. Ana e sipërme është ngjyrë lila–blu me kufij të errët marginalë. Krahët e përparme sipër kanë pika të zeza të dukshme diskale dhe postdiskale. Krahët e pasëm sipër kanë vena të zeza, ndonjëherë një vijë të zezë diskale dhe pika të errëta nënmarginale të paqarta. Ana e poshtme është ngjyrë e bardhë me vija dhe pika të zeza në të dy krahët. Krahët e pasëm poshtë kanë oceli nënmarginale argjendi–blu të shndritshme me rreze të zeza të ndryshueshme. Femra është pak më e madhe se mashkulli; ana e sipërme është ngjyrë kafe më e errët me një ngjyrim bazal të shpëhapur blu dhe me pika më të theksuara. Ana e poshtme është pak më e verdhë–e bardhë, ndryshe e ngjashme me mashkullin. Speciet e ngjashme: asnjë. Specia ka gjenerata të mbivendosura nga fundi i prillit deri në shtator; vezët kanë stad të shkurtër, larvat kanë stad të shkurtër Dimërojnë në fazën punë. Jeton në livadhe të brezit me klimë të ngrohtë, në territore shkëmbore dhe të thata, në barishte dhe kullota pranë shkurreve të llojit *Paliurus spina-christi*,

nga zonat e ulëta deri në 1000 m mbi nivelin e detit. Lloji ka kërkesa hapësinore shumë modeste dhe densitet popullate që mund të jetë i lartë; larvat ushqehen me *Paliuris spina-christi*, por janë regjistruar edhe në *Ziziphus jujuba* dhe *Ziziphus lotus*, ndërsa të rriturit marrin nektar nga lule të ulëta përreth bimëve ku rriten larvat. Në Shqipëri është lloj lokal (nevojiten më shumë studime), gjendet në Ballkan dhe Evropë, si dhe në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz dhe Kaukaz. Specia ka statusin VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë (kriteri B2a) dhe në Listën e Kuqe Evropiane LC.

***Callophrys rubi*/Green Hairstreak**
Ferrakja
Lycaenidae –Theclinae





***Callophrus rubi*, dhe harta e shpërhapjes**

Callophrys rubi është një flutur e vogël me gjatësi flatrash 13–15 mm, e dalluar nga krahët e pasëm me qoshe të buta të valëzuara që krijojnë një zgjatim të lehtë në këndin anal të skajit të jashtëm, ndërsa ana e sipërme është ngjyrë kafe e zbehtë pa shenja, me një zonë të vogël te krahët e përparme me luspa të veçanta aromatike te mashkulli (njolla androconiale), kurse ana e poshtme e flatrave është me ngjyrë jeshile me pika të bardha postdiskale të rreshtuara në formë vije, të cilat në krahun e përparme shpesh janë të paplota; femra është pak më e madhe ose e ngjashme me mashkullin, por nuk ka zonën aromatike. Kjo specie ka një brezi në vit, që shfaqet gjatë pranverës nga marsi deri në maj, ndërsa në lartësi më të mëdha kjo periudhë mund të zgjatet deri në korrik për shkak të kushteve klimatike. Vezët çelin pas 5–10 ditësh dhe larvat kalojnë një periudhë zhvillimi 22–30 ditore përpara se të kalojnë në fazën pupë, ndërsa pupa dimëron për 36–46 javë deri në shfaqjen e fluturës së rritur. *Callophrys rubi* jeton në livadhe të hapura, shkurre dhe skaje pyjore në shpate shkëmbore nga zonat e

ulëta deri në 1600 m mbi nivelin e detit. Lloji paraqet kërkesa hapësinore modeste dhe karakterizohet nga popullata me dendësi të moderuar. Në fazën larvare specia ushqehen me bimë të llojeve: *Calluna, Erica, Cytisus, Frangula alnus, Genista, Rubus* dhe *Vaccinium*, ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga lule të vogla dhe herë pas here edhe me mjaltë. *Callophrys rubi* është i përhapur në Shqipëri (sidomos në Alpet e Veriut dhe lokalisht në zona të tjera), në Ballkan, Evropë dhe gjithashtu në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz dhe Kaukaz. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë ka statusin NE, edhe në nivelin Evropian sipas IUCN-së është klasifikuar si LC.

***Favonius quercus*/Purple Hairstreak**
Bishtakja vjollcë e dushkut
Lycaenidae –Theclinae





***Favonius quercus*, dhe harta e shpërhapjes**

Favonius quercus është një flutur e vogël me gjatësi flatrash 12–14 mm, në krahët e pasëm që ka një bisht të shkurtër në venën v2 dhe një njollë portokalli të zbehtë në këndin anal; ana e sipërme është ngjyrë blu e purpurt me shkëlqim, me skaje të qarta të zeza dhe pa shenja të tjera, ndërsa ana e poshtme është gri në të hirtë me një vijë të bardhë postdiskale në të dy krahët dhe krahët e pasëm me një njollë të vogël portokalli si edhe një tjetër njollë portokalli me qendër të zezë pranë bishtit; femra është pak më e madhe se mashkulli dhe ana e sipërme e saj është më e errët, me shkëlqim blu-vjollcë të kufizuar kryesisht në qelizë dhe zonën s1b, ndërsa ana e poshtme është e ngjashme me mashkullin, por me shenja submarginale më të dukshme. Kjo specie ka një brezni në vit, që zhvillohet nga qershori deri në gusht, me vezë që dimërojnë zakonisht të vendosura pranë kërcellit të bimës, larvat zhvillohet për 30–68 ditë dhe faza pupë zgjat 18–22 ditë. Specia jeton në pyje të hapura ose të lagështa me dushk dhe pemë të shpërndara të gjinisë *Quercus*, nga zonat e ulëta deri në 1500 m mbi

nivelin e detit. Lloji ka kërkesa hapësinore modeste dhe popullata që mund të jenë të dendura në kurorat e pemëve pritëse. *Favonius quercus* është lloj shumë i lokalizuar në Shqipëri (me nevojë për studime të mëtejshme), i përhapur në Ballkan, Evropë dhe gjithashtu në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz dhe Kaukaz. Sipas Listës së Kuqe të Shqipërisë ka statusin VU D1D2, ndërsa në Listën e Kuqe Evropiane është klasifikuar si LC.

***Satyrium acaciae*/Sloe Hairstreak**
Bishtakje e akacies
Lycaenidae –Theclinae





***Satyrium acaciae*, dhe harta e shpërhapjes**

Satyrium acaciae është një flutur e vogël me gjatësi flatrash 14–16 mm, me krahun e pasëm që mban një bisht të shkurtër në venën v2; te mashkulli ana e sipërme është ngjyrë kafe e errët, ndonjëherë me njolla shumë të zbehta portokalli, ndërsa krahët e përparme nuk kanë shenja dhe nuk kanë zonën me luspa aromatike, kurse ana e poshtme është më e çelët, kafe, me një vijë të bardhë postdiskale që në krahun e përparme shpesh është e ndërprerë ose mungon, por në krahun e pasëm është e zhvilluar mirë; krahët e pasëm paraqesin gjithashtu hënëza portokalli nga s1a deri në s3, një njollë të vogël blu dhe në hapësirën s2 një njollë të zezë në skajin e jashtëm të lunulës portokalli; femra ka përmasa të ngjashme me mashkullin dhe ka një tufë të zezë të dukshme në fund të barkut, ndërsa ana e sipërme e flatrave është kafe e errët me shenja portokalli të ndryshueshme dhe ana e poshtme është e ngjashme me mashkullin. Kjo specie ka një brezni në vit nga qershori deri në fillim të gushtit, vezët dimërojnë mbi degët e bimës ushqyese, ku larva e vogël mbetet brenda korionit (mbështjellësit të vezës) për 41–46 javë, më pas larvat ushqehen për 31–52 ditë

përpara se të kalojnë në fazën e pupës, e cila zgjat 14–21 ditë. *Satyrium acaciae* jeton në zona të thata dhe shkëmbore me shkurre të ulëta dhe pemë të vogla ku është e pranishme *Prunus spinosa*, nga zonat e ulëta deri në 1600 m mbi nivelin e detit (rrallë deri në 2000 m). Ky lloj ka kërkesa hapësinore shumë modeste dhe popullatat e tij mund të jenë të dendura. Larvat ushqehen kryesisht me *Prunus spinosa*, por edhe me *Prunus dulcis* dhe *Cotoneaster integerrimus*, ndërsa të rriturit ushqehen me mjaltë dhe nektar nga lulet e shkurreve dhe të bimëve të gjinisë *Rubus*. *Satyrium acaciae* ka përhapje lokale në Shqipëri, ai është i përhapur në Ballkan, Evropë dhe gjithashtu në Azinë e Vogël, Transkaukaz, Kaukaz dhe më tej në lindje. Specia ka statusin VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe Evropiane.

***Satyrium ilicis*/Ilex Hairstreak**
Bishtakja e dushkut
Lycaenidae –Theclinae





***Satyrium ilicis*, dhe harta e shpërhapjes**

Satyrium ilicis është një flutur e vogël me gjatësi flatrash 16–18 mm, e dalluar nga prania në krahët e pasëm e një bishti të shkurtër në venën v2; ana e sipërme është ngjyrë kafe e errët, ndërsa te mashkulli krahët e përparme zakonisht nuk kanë zona të veçanta dalluese dhe vetëm rrallë shfaqin një njollë të zbehtë portokalli, ndërsa ana e poshtme është kafe, më e hapur, me një vijë të bardhë postdiskale që shpesh mungon ose është e ndërprerë në krahët e përparme, por është e dukshme në krahët e pasëm, të cilët gjithashtu kanë një varg njollash portokalli–të kuqërremta në skaj të kufizuara me të zezë; femra është pak më e madhe, gjithashtu në anën e sipërme me ngjyrë kafe të errët, por shpesh me njolla portokalli më të dukshme në krahët e përparme dhe me shenja më të theksuara në anën e poshtme. Kjo specie ka një brezni në vit dhe shfaqet nga mesi i majit deri në fillim të gushtit; veza dimëron mbi degët e bimës ushqyese për një periudhë të gjatë, pas së cilës larva zhvillohet për rreth 28–34 ditë dhe më pas kalon në fazën pupë që zgjat 14–23 ditë. *Satyrium ilicis* jeton në pyje të

hapura të ngrohta, shkurre të thata dhe shpate shkëmbore të dominuara nga lisi (*Quercus*), nga zonat e ulëta deri në rreth 2000 m mbi nivelin e detit. Lloji ka kërkesa hapësinore modeste dhe popullatat mund të arrijnë dendësi të lartë, veçanërisht në kurorat e drurëve të lisit. Larvat ushqehen kryesisht me lloje të ndryshme të lisit, ndërsa më rrallë janë regjistruar edhe në *Prunus spinosa* dhe *Ulmus minor*; të rriturit ushqehen me mjaltë dhe nektarin e luleve të vogla. Kjo specie është e përhapur në Shqipëri, si edhe në Ballkan, Evropë dhe më tej në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz dhe Kaukaz. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Satyrium pruni*/Black Hairstreak**
Kordelja e zezë
Lycaenidae –Theclinae





***Satyrium pruni*, dhe harta e shpërhapjes**

Satyrium pruni është një flutur e vogël me gjatësi flatrash 15–16 mm, e dalluar nga krahët e pasëm me një bisht të shkurtër në venën v2; ana e sipërme është ngjyrë kafe e errët kur është e freskët, ndërsa te mashkulli krahët e përparme kanë një zonë të vogël ovale me luspa të veçanta aromatike (njollë androconiale), dhe krahët e pasëm shfaqin një varg njollash portokalli nënmarginale nga s1b deri në s4; ana e poshtme është ngjyrë kafe e artë me një vijë të bardhë postdiskale të dukshme në të dy krahët, ndërsa krahët e pasëm kanë një brez portokalli të ndritshëm nënmarginal, më të zhvilluar në këndin anal dhe të kufizuar nga të dyja anët me njolla të zeza të qarta, që ndonjëherë shtrihet edhe në krahët e përparme deri në s2; femra është pak më e madhe, në anën e sipërme me ngjyrë kafe të errët, por shpesh me njollë portokalli diskale në krahët e përparme dhe me hënëza portokalli më të zhvilluara në krahët e pasëm, ndërsa ana e poshtme është më e çelët dhe me të njëjtin model si mashkulli. Kjo specie

ka një brezni në vit dhe shfaqet nga qershori deri në fund të korrikut; veza dimëron mbi degët e bimës ushqyese, më pas larva zhvillohet për rreth 23–32 ditë dhe kalon në fazën pupë, e cila është e shkurtër. *Satyrium pruni* jeton në livadhe të pasura me shkurre dhe barishte, shpesh të rrethuara nga gardhe, në lartësi 500–1200 m mbi nivelin e detit. Lloji ka kërkesa hapësinore modeste dhe popullatat mund të kenë dendësi të moderuar. Larvat ushqehen kryesisht me *Prunus spinosa*, por janë regjistruar edhe në lloje të tjera të gjinisë *Prunus* dhe rrallë në *Rosa canina*, ndërsa të rriturit ushqehen me mjaltë ose nektar nga lule. Kjo specie është shumë lokale në Shqipëri dhe është regjistruar vetëm në një lokalitet, duke përfaqësuar kufirin jugor të shpërndarjes së saj në Ballkan; ajo gjendet në Ballkan, Evropë dhe në rajonet me klimë të butë të Azisë. Sipas Listës së Kuqe të Shqipërisë ka statusin VU, ndërsa në Listën e Kuqe për Evropën klasifikohet si VU A2c

***Satyrium spini*/Blue-spot Hairstreak**
Bishtakja e kulumbrisë
Lycaenidae-Theclinae





***Satyrium spini*, dhe harta e shpërhapjes**

Satyrium spini është një flutur e vogël me gjatësi flatrash 14–16 mm, me flatrat e pasme që zakonisht kanë një bisht të shkurtër në v2. Tek femrat, ana e sipërme e flatrave është ngjyrë kafe e errët ose e zezë–kafe kur flutura është e freskët, ndërsa te mashkulli flatrat e përparme kanë një zonë të vogël ovale me luspa të veçanta aromatike, pa shenja të tjera; ana e poshtme e flatrave është kafe më e hapur, me një vijë të bardhë postdiskale, shpesh e ndërprerë në flatrat e përparme dhe e zhvilluar mirë në flatrat e pasme, të cilat paraqesin një vijë karakteristike në formë W, hënëza portokalli nënmarginale të kufizuara me të zezë, një njollë të vogël blu dhe në s2 një njollë margjinale të zezë në pjesën e jashtme të lunulës portokalli; femrat janë pak më të mëdha dhe kanë shenja më

të theksuara se mashkulli. Kjo specie ka një brez në vit që shfaqet nga mesi i majit deri në mes të gushtit, në varësi të lartësisë; veza kalon dimrin mbi degët e bimës ushqyese, shpesh pranë sythit terminal, më pas larva zhvillohet për 37–78 ditë dhe kalon në fazën pupë, e cila zgjat 13–26 ditë. *Satyrium spini* jeton në habitate të ndryshme ku gjenden specie të gjinisë *Ulmus*, nga pemë të izoluara deri në skaje pyjesh, pyje kanionesh dhe lugina aluvionale, nga 500 deri në 2000 m mbi nivelin e detit; ka kërkesa hapësinore shumë modeste dhe popullatat mund të arrijnë dendësi të lartë, sidomos në kurorat e pemëve të veçuara. Larvat ushqehen kryesisht me *Rhamnus cathartica*, ndërsa përmenden gjithashtu *Frangula alnus*, *Paliurus spina-christi*, lloje të tjera të gjinisë *Rhamnus* dhe *Prunussp*. Të rriturit ushqehen me mjaltë dhe me nektar nga lule të vogla ose nga lule me gjendra sipërfaqësore mjalti. Kjo specie është shumë lokale në Shqipëri dhe kërkon studime të mëtejshme, por në përgjithësi është e përhapur në Ballkan, Evropë dhe gjithashtu në Azinë e Vogël, Transkaukaz dhe Kaukaz. Sipas Listës së Kuqe të Shqipërisë ka statusin NE, ndërsa në Listën e Kuqe për Evropën klasifikohet si VU A2b.

***Satyrium w-album*/White-letter Hairstreak**
Bishtakja e vidhit
Lycaenidae-Theclinae





***Satyrium w-album*, dhe harta e shpërhapjes**

Satyrium w-album është një flutur e vogël me gjatësi flatrash 15–16 mm; mashkulli dallohet nga flatrat e pasme me një bisht të shkurtër në venën v2 dhe nga ana e sipërme me ngjyrë kafe shumë e errët deri në të zezë kur është e freskët, ku flatrat e përparme kanë një zonë të vogël me luspa aromatike (njollë androconiale), ndërsa ana e poshtme është kafe më e hapur me një vijë të bardhë postdiskale të theksuar në të dyja flatrat dhe në flatrat e pasme formon një vijë karakteristike në formë “W”, të shoqëruar me hënëza portokalli nënmarginale të kufizuara me të zezë, një njollë të vogël blu dhe një njollë të zezë në segmentin

s2; femra është pak më e madhe, me bisht pak më të gjatë në flatrat e pasme dhe me shenja më të theksuara në anën e poshtme, por në përgjithësi e ngjashme me mashkullin. Speciet e ngjashme: *S. acacia, S. ilicis, S. pruni, S. spini*. Kjo specie ka një brez në vit, që shfaqet nga mesi i majit deri në mes të gushtit në varësi të lartësisë; vezët kalojnë dimrin mbi degët e bimës ushqyese, larvat zhvillohen për rreth 37–78 ditë dhe më pas kalojnë në fazën pupë që zgjat 13–26 ditë. Jeton në habitate të ndryshme ku gjenden specie të gjinisë *Ulmus*, nga pemë të izoluara deri në skaje pyjesh, pyje kanionesh dhe lugina aluviale, në lartësi 200–1500 m mbi nivelin e detit; ka kërkesa hapësinore modeste dhe mund të arrijë dendësi të lartë në kurorat e pemëve pritëse. Larvat ushqehen me sytha lulesh në fazën e çeljes dhe më pas, kur janë të disponueshëm vetëm sythat gjethorë, kalojnë në gjethet e llojeve të ndryshme të gjinisë *Ulmus*, më shpesh *Ulmus glabra*, rrallë *Rhamnus cathartica*. Të rriturit ushqehen me mjaltë (honeydew) në kurorat e pemëve dhe me nektar nga lule të ndryshme në shtresën barishtore, përfshirë Umbelliferae dhe *Origanum vulgare*. Në Shqipëri lokale, ndërsa në shkallë më të gjerë gjendet në Ballkan, Evropë, si edhe në Azinë e Vogël, Transkaukaz dhe Kaukaz. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë, specia ka statusin VA A1b, ndërsa në Listën e Kuqe për Evropën vlerësohet LC.

***Thecla betulae*/Brown Hairstreak**
Bishtakja e mështeknës
Lycaenidae –Theclinae





***Thecla betulae*, dhe harta e shpërhapjes**

Thecla betulae është një flutur e vogël me gjatësi flatrash 17–18 mm, në flatrat e pasme ka një bisht të shkurtër në venën v2; mashkulli ka anën e sipërme me ngjyrë kafe, me flatrat e përparme me një shenjë të hollë vertikale në fund të qelizës, ndërsa flatrat e pasme kanë njolla të vogla portokalli në zonat pranë bazës së margjinës (v1 dhe v2); ana e poshtme është portokalli në të verdhë, me një vijë të bardhë postdiskale dhe një shenjë të ngushtë në flatrat e përparme, ndërsa flatrat e pasme duken më të errëta midis vijës diskale dhe asaj

postdiskale; femra është pak më e madhe, me flatrat e përparme që dallohen nga një brez i gjerë portokalli–i kuq postdiskal dhe me anën e poshtme më të ndritshme se te mashkulli. Kjo specie ka një brezni në vit dhe shfaqet nga korriku deri në fund të shtatorit; vezët kalojnë dimrin mbi degët e bimës ushqimore për rreth 36–39 javë, larvat zhvillohen për 31–41 ditë dhe më pas kalojnë në fazën pupë që zgjat 20–38 ditë. Jeton në zona të hapura me diell në pyje gjetherënëse, livadhe shkëmbore me shkurre të shpërndara dhe me prani të bollshme të *Prunus spinosa*, gjendet në lartësi nga 300 deri në 1500 m mbi nivelin e detit; ka kërkesa hapësinore relativisht të larta dhe dendësia e popullatës është e vështirë për t'u vlerësuar, pasi individët e rritur rrinë shpesh të fshehur, megjithëse vezët mund të gjenden në numër të madh mbi bimët ushqimore. Larvat ushqehen kryesisht me *Prunus spinosa*, por janë regjistruar edhe në disa specie të tjera të gjinisë *Prunus*, ndërsa të rriturit ushqehen me mjaltë (honeydew) dhe nektar nga lule të ndryshme. Në Shqipëri është shumë lokale dhe kërkon më shumë studime, ndërsa në shkallë më të gjerë gjendet në Ballkan, Evropë, si edhe në Azinë e Vogël, Transkaukaz dhe Kaukaz. Sipas kritereve të IUCN në Listën e Kuqe të Shqipërisë, specia ka statusin VA A1b, ndërsa në Listën e Kuqe për Evropën vlerësohet LC.

***Hamearis lucina*/Duke of Burgundy Fritillary**

Luçina

Riodinidae - Riodininae





***Hamearis lucina*, dhe harta e shpërhapjes**

Hamearis lucina është një flutur e vogël me gjatësi flatrash 14–17 mm, me buzë (fringes) të ndara në katër segmente të dukshme; ana e sipërme është ngjyrë kafe–e zezë, flatrat e përparme kanë pika të vogla portokalli të zbehta (fulvous) të renditura në vija tërthore, ndërsa flatrat e pasme kanë pika të ngjashme që shpesh zbehen ose mbulohen nga sfondi i errët; ana e poshtme është kafe–kanellë, me flatrat e pasme që dallohen nga pika të bardha bazale dhe

postdiskale të qarta. Femra është pak më e madhe, me pika portokalli më të mëdha dhe më të ndritshme në të dyja flatrat, ndërsa ana e poshtme ka pika të bardha më të zgjeruara. Nuk ngjan me asnjë specie tjetër, gjë që e bën relativisht të lehtë për t'u dalluar në terren. Kjo specie ka një brezni në vit dhe shfaqet nga prilli deri në qershor, me raste të rralla të një brezi të pjesshëme verore; vezët çelin pas 8–14 ditësh, larvat zhvillohen për 25–45 ditë dhe më pas kalojnë në fazën pupë që dimëron për 43–46 javë. Jeton në livadhe të lagështa, skaje pyjesh dhe zona me pyje të hapura, ku ka prani të bimëve pritëse *Primula elatior, P. veris* dhe *P. vulgaris*, në lartësi të ndryshme; ka kërkesa hapësinore modeste dhe popullata ka dendësi mesatare. Larvat ushqehen me *Primula*, ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga lule të vogla dhe shpesh edhe me *Rubus*. Në Shqipëri është shumë lokale dhe gjendet në kufirin jugor të shtrirjes së tij në Ballkan; në shkallë më të gjerë gjendet në Ballkan dhe Evropë, por mungon në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz dhe Kaukaz, dhe më tej në lindje. Sipas Listës së Kuqe të Shqipërisë ka statusin VU B2a, ndërsa në Listën e Kuqe për Evropën vlerësohet LC.

***Apatura ilia*/Lesser Purple Emperor**
Apartura
Nymphalidae - Apaturinae






***Apatura ilia*, dhe harta e shpërhapjes**

Apatura ilia është një flutur e madhe me gjatësi flatrash 32–35 mm, e dalluar nga ana e sipërme për shkëlqimin metalik blu–violet mbi një sfond të errët, ku mund të shfaqen shenja të bardha (të rralla për popullatat në Ballkanin jugor) ose portokalli në forma të ndryshme; flatrat e përparme kanë pika të ngushta postdiskale të verdha ose të bardha në segmentet s4–s6 dhe një njollë sy të madhe në s2, ndërsa flatrat e pasme paraqesin një brez portokalli diskal pa shkëlqim të dukshëm dhe pika postdiskale të errëta në formë të veçantë, gjithashtu me njolla sy në s2; ana e poshtme e flatrave të përparme ka njolla sy

të mëdhenj, ndërsa flatrat e pasme kanë njolla sy me qendër të kaltër. Femra është pak më e madhe, me shenja më të mëdha dhe më të çelëta në anën e sipërme, por pa shkëlqimin metalik tipik të mashkullit, ndërsa në anën e poshtme shenjat i ka më të theksuara. Ngjan me *Apatura metis* dhe *Apatura iris*, nga të cilat dallohet kryesisht nga modeli i shenjave postdiskale dhe intensiteti i shkëlqimit blu. Kjo specie ka një brezni në vit dhe shfaqet nga qershori deri në gusht; vezët çelin pas 6–14 ditësh, larvat kanë një zhvillim të gjatë dhe kalojnë dimrin në stadin L3, ndërsa pupacioni zgjat 12–19 ditë. Jeton në pyje, shpesh pranë ujërave të rrjedhshme, me prani të lartë të bimëve të gjinive *Populus* dhe *Salix,* në lartësi 200–1250 m mbi nivelin e detit; ka kërkesa hapësinore të konsiderueshme dhe mund të arrijë dendësi të lartë lokale. Larvat ushqehen kryesisht me *Populus alba, P. nigra, P. tremula* dhe disa specie të gjinisë *Salix*, si edhe rrallë me *Alnus glutinosa*; të rriturit ushqehen me lëngje frutash të kalbura, jashtëqitje, lëngje në kurorat e pemëve dhe me ushqim mineral në toka të lagështa. Në Shqipëri është lokale dhe kërkon më shumë studime, ndërsa gjendet në Ballkan dhe Evropë, si edhe në Transkaukaz dhe më tej në lindje. Specia ka statusin VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe Evropiane.

***Apatura iris*/Purple Emperor**
Perandori i purport
Nymphalidae – Apaturinae





***Apatura iris*, dhe harta e shpërhapjes**

Apatura iris është një flutur e madhe me gjatësi flatrash 31–37 mm dhe më e madhja ndër speciet e gjinisë *Apatura*, e dalluar për shkëlqim metalik blu–vjollcë nga ana e sipërme i vendosur mbi një sfond të errët me shenja të bardha; flatrat e përparme kanë një ocel të errët në segmentin s2, ndërsa flatrat e pasme shfaqin një brez të bardhë diskal të pjerrët. Ana e poshtme e flatrave të përparme dhe të pasme është ngjyrë kafe në të gjelbër ulliri, flatrat e përparme kanë një njollë rrethore portokalli që përfshin ocelin me mes të kaltër në s2, ndërsa flatrat e pasme kanë një brez të bardhë me skaj të brendshëm të drejtë dhe skaj të

jashtëm të dhëmbëzuar. Femra është pak më e madhe dhe dallon nga mashkulli nga mungesa e në anën e sipërme të shkëlqimit metalik blu–vjollcë, si edhe nga shenjat më të mëdha dhe më të theksuara në të dy anët e flatrave. Ngjan me *Apatura ilia* dhe *Apatura metis*, nga të cilat dallohet kryesisht nga madhësia më e madhe, ngjyra më e errët dhe modeli më i zhvilluar i brezit të bardhë në flatrat e pasme. Kjo specie ka një brezni në vit dhe shfaqet nga qershori deri në gusht; vezët çelin pas 8–18 ditësh, larvat kanë një zhvillim të gjatë dhe kalojnë dimrin në stadin L3, ndërsa pupacioni zgjat 13–22 ditë. Jeton në pyje (zona më të freskëta se speciet e tjera të Apatura), shpesh pranë ujërave të rrjedhshme me prani të bollshme të *Salix*-it, në lartësi 500–1700 m mbi nivelin e detit; ka kërkesa hapësinore të konsiderueshme dhe mund të arrijë dendësi lokale të lartë. Larvat ushqehen kryesisht me *Salix alba, S. aurita, S. caprea* dhe *S. cinerea*, si edhe më rrallë me *Populus nigra* dhe *P. tremula*; Të rriturit ushqehen me lëngje nga materiale të kalbura, jashtëqitje, kufoma dhe me kripra minerale në toka të lagështa. Në Shqipëri lokale, ndërsa gjendet në Ballkan dhe Evropë, si edhe në Azinë e butë; mungon në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz dhe Kaukaz. VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe Evropiane.

***Apatura metis*/Freyer's Purple Emperor**
Perandori i purpurt i Freyerit
Nymphalidae – Apaturinae





***Apatura metis*, dhe harta e shpërhapjes**

Apatura metis është një flutur e madhe me gjatësi të flatrat të përparme 30–32 mm, më e vogla ndër speciet e gjinisë *Apatura*. Ana e sipërme ka shkëlqim blu–violet me efekt me ndriçim metalik të vendosur mbi sfond të errët me shenja portokalli. Flatrat e përparme kanë pika të gjera postdiskale me ngjyrë të verdhë në s4–s6 dhe një njollë sy të vogël në s2 me majë të mprehtë. Flatrat e pasëme kanë një brez diskal me ngjyrë portokalli me fryrje të dukshme, ndërsa shenjat e errëta postdiskale formojnë një brez të dallueshëm. Ana e poshtme e flatrave të përparme ka një njollë sy të vogël, ndërsa flatrat e pasëme kanë një njollë sy

shumë të vogël ose që mungon. Femra është pak më e madhe; ana e sipërme nuk shfaq shkëlqimin metalik blu–violet dhe ka shenja portokalli. Maja e flatrave të përparme më e rrumbullakosur me model të ngjashëm me mashkullin. Speciet e ngjashme janë *Apatura ilia* dhe *Apatura iris*. Kjo specie ka dy brezni, nga maji deri në qershor dhe nga fundi i korrikut deri në gusht; veza ka stad të shkurtër, larva kalon dimrin si L2, ndërsa pupëzimi është i shkurtër. Jeton në pyje përgjatë liqeneve, ligatinave dhe lumenjve nga zona e ulët deri në 700 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore të konsiderueshme dhe popullata që mund të jetë shumë e dendur. Larvat ushqehen kryesisht me *Salix alba*, ndërsa të rriturit ushqehen me lëngje nga material i kalbur, pleh dhe kërma, si dhe kryejnë thithje mineralesh nga balta e lagësht. Në Shqipëri është lloj shumë lokal (nevojiten më shumë kërkime), është i pranishëm në Ballkan dhe Evropë, si dhe në pjesë të Azisë Perëndimore dhe më tej në lindje. Specia ka statusin VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe Evropiane.

***Charaxes jasius*/Two-tailed Pasha**
Dybishtakja jasius
Nymphalidae – Charaxinae





***Charaxes jasius*, dhe harta e shpërhapjes**

Charaxes jasius është një flutur e madhe me gjatësi të flatrave të përparme 38–41 mm, me sfond të errët ngjyrë kafe të thellë; flatrat e përparme kanë një brez të gjerë të verdhë në skaj dhe pika të vogla postdiskale me ngjyrë të verdhë–kafe, ndërsa flatrat e pasme shfaqin një brez margjinal të verdhë të theksuar me kufi të zi dhe pika blu pranë bazës nga s1c deri në s4; ana e poshtme në zonën bazale ka njolla me ngjyrë vishnje të rrethuara me të bardhë dhe një model vijëzimesh të dukshme, ndërsa femra është pak më e madhe, por me model të ngjashëm;

speciet e ngjashme: nuk ka. Kjo specie ka dy brezni, breznia pranverore nga prilli deri në qershor dhe breznia verore nga gushti deri në tetor; veza ka stad të shkurtër, larva dimëron dhe pupëzimi është i shkurtër; jeton në zonën e makies bregdetare në shpatet me shkurre me prani të bollshme të *Arbutus unedo*, nga zona e ulët deri në 1000 m mbi nivelin e detit. Lloji ka kërkesa hapësinore të konsiderueshme dhe popullata mund të jetë e dendur; larvat ushqehen kryesisht me *Arbutus unedo*, por edhe me *Arbutus andrachne*, *Citrus* spp., *Laurus nobilis* dhe *Prunus persica*, ndërsa të rriturit ushqehen me lëngje nga fruta të kalbura, pleh dhe kërna; në Shqipëri është lloj lokal, është e pranishme në Ballkan dhe Evropë si dhe në zonat bregdetare të Azisë së Vogël dhe Lindjes së Afërt. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Danaus chrysippus*/Plain Tiger**
Shtegëtarja krisipus
Nymphalidae – Danainae





***Danaus chrysippus*, dhe harta e shpërhapjes**

Danaus chrysippus është një flutur e madhe me gjatësi të flatrave të përparme 35–42 mm, me sfond të verdhë-kafe të lehtë; pranë bazës flatrat e përparme janë më të errëta, flatrat kanë një majë të gjerë të zezë me një brez të bardhë transversal dhe pika të vogla të bardha submarginale, ndërsa flatrat e pasme kanë tre pika të vogla të zeza diskale dhe një shenjë seksuale në v2 te mashkulli, si dhe një brez margjinal të zi me pika të vogla të bardha; ana e poshtme është

pak më e çelët me të njëjtin model, ndërsa flatrat e pasme të poshtme kanë një brez margjinal të zi me pika më të mëdha të bardha; femra është pak më e madhe dhe e ngjashme me mashkullin, por pa shenjën seksuale në flatrat e pasme. Ky lloj nuk ka specie të ngjashme. Kjo specie është kryesisht migratore dhe mund të ketë, varësisht nga kushtet klimatike dhe migracion nga jugu, gjenerata të vazhdueshme nga prilli deri në fund të nëntorit, ndërsa vezët, larvat dhe pupat kanë zakonisht stade të shkurtër. Në kushte të buta të rriturit mund të jenë edhe stad dimërues, megjithëse kjo është e pasigurt për Shqipërinë. Lloji jeton në terrene të hapura dhe të thata nga zonat e ulëta deri në 1000 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore të moderuara, popullata që mund të jetë e dendur. Në fazën larvare ushqehen me *Araujia sericifera, Cynanchum acutum* dhe *Gomphocarpus fruticosus*, ndërsa të rriturit ushqehen mbi lule të larta dhe *Rubus* spp.; në Shqipëri, lloji është lokal, i pranishëm në Ballkan dhe Evropë si dhe në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt dhe më tej në lindje. Sipas Listës së Kuqe të Shqipërisë ka statusin LC, ndërsa në Listën e Kuqe Evropiane është NA.

***Argynnis pandora*/Cardinal**
Pandora
Nymphalidae – Heliconiinae





***Argynnis pandora*, dhe harta e shpërhapjes**

Argynnis pandora është një flutur e madhe me gjatësi të flatrave të përparme 32–40 mm, me sfond kafe të artë dhe nuanca të ndryshueshme gjelbër-gri, më të theksuara në flatrat e pasme; flatrat e përparme kanë dy luspa androkoniale (androconial scales / sex-brand), ndërsa ana e poshtme e flatrave të përparme

ka zona bazale dhe diskale rozë, kurse flatrat e poshtme të pasme janë të gjelbra me shirita të ngushtë argjendi postdiskal dhe pika të vogla të bardha postdiskale; femra është pak më e madhe, me nuanca më të theksuara gjelbër-gri dhe me të njëjtin model në anën e poshtme. Specia e ngjashme me këtë lloj është *Argynnis paphia*. Kjo specie ka një deri në dy brezni në vit nga maji deri në shtator, vezët kalojnë dimrin në diapauzë, larvat zhvillohen në pranverë dhe pupëzimi është i shkurtër; jeton në livadhe të thata dhe të ndriçuara me shkurre dhe bimësi të pasur me lule, nga zona e ulët deri në 1800 m mbi nivelin e detit. Lloji ka kërkesa hapësinore të larta dhe popullata mund të jetë e dendur. Larvat ushqehen me *Viola alba, V. arvensis, V. kitaibeliana* dhe *V. tricolor*, ndërsa të rriturit ushqehen kryesisht mbi *Carduus* dhe *Centaurea*. Në Shqipëri ka përhapje lokale, është i pranishëm në Ballkan dhe Evropë si dhe në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz dhe Kaukaz. Sipas Listës së Kuqe të Shqipërisë ka statusin VU, ndërsa në Listën e Kuqe Evropiane është LC.

***Argynnis paphia*/Silver-washed Fritillary**
Pafia
Nymphalidae – Heliconiinae





***Argynnis paphia*, dhe harta e shpërhapjes**

Argynnis paphia është një flutur e madhe me gjatësi të flatrave të përparme 27–35 mm, me sfond të ndritshëm ngjyrë kafe të artë; flatrat e përparme kanë katër shenja seksuale (te mashkulli), ndërsa ana e poshtme e flatrave të përparme është ngjyrë kafe e artë e zbehtë pa zona bazale ose diskale rozë, kurse flatrat e pasme të poshtme janë me ngjyrim të gjelbër-gri me shirita argjendi diskalë dhe postdiskalë transversalë; femra është pak më e madhe dhe më e zbehtë ngjyrë kafe e artë, ose në formën e rrallë valesina shfaqet gri me nuanca të gjelbërta,

ndërsa ana e poshtme ka shirita argjendi transversalë diskalë dhe postdiskalë më të theksuar.Specia e ngjashme me të është lloji *Argynnis pandora*. *Argynnis paphia* ka një brezni të gjatë nga maji deri në shtator, vezët çelin pas 14–19 ditësh, larvat kalojnë dimrin si larva të reja të fshehura në gropat e trungjeve dhe pupëzimi zgjat 14–25 ditë; jeton në livadhe të pasura me shkurre dhe hapësira të ndriçuara në pyje gjetherënëse nga zona e ulët deri në 1700 m mbi nivelin e detit. Lloji ka kërkesa hapësinore të konsiderueshme dhe popullata mund të jetë e dendur dhe ndonjëherë nomadike. Larvat ushqehen me *Viola alba, V. arvensis, V. canina, V. hirta, V. odorata, V. reichenbachiana, V. riviniana, V. tricolor* dhe *Filipendula ulmaria*, ndërsa të rriturit ushqehen me lule të ndryshme, shpesh *Rubus* spp. dhe *Sambucus ebulus*. Ky lloj në Shqipëri është i përhapur gjithandej, ai gjendet gjithashtu në Ballkan dhe Evropë si dhe në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz dhe Kaukaz. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Boloria dia*/Weaver's Fritillary**
Flatravjolca e vogël
Nymphalidae – Heliconiinae





***Boloria dia*, dhe harta e shpërhapjes**

Boloria dia është një flutur e vogël me gjatësi të flatrave të përparme 16–17 mm, me flatrat e pasme që kanë skaj të jashtëm të mprehtë në v8; ana e sipërme është portokalli me shenja të mëdha të zeza, vena të zeza dhe një seri njollash ovale postdiskale, ndërsa ana e poshtme e flatrave të pasme është ngjyrë violet-kuqe e errët me shenja të çelura dhe një seri ocelesh postdiskale të rrethuara me unazë kafe të kuqërremtë të errët; femra është pak më e madhe dhe ngjyrë portokalli më e zbehtë, por e ngjashme me mashkullin. Lloje të ngjashme: *Boloria*

euphrosyne, Boloria pales, Boloria titania. Kjo specie shfaqet me dy deri në tre brezni në vit, varësisht nga lartësia, adultët fluturojnë nga prilli deri në shtator, vezët çelin pas 5–8 ditësh, larvat kalojnë dimrin si L3 në shtresën e mbeturinave të bimëve dhe pupëzimi zgjat 10–16 ditë. *Boloria dia* jeton në livadhe me shkurre të shpërndara ose pyje të rralla, nga 600 deri në 1600 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore modeste, popullata që mund të jenë edhe të dendura, ndonjëherë nomadike. Në fazën larvare ushqehen me *Viola arvensis, V. canina, V. hirta, V. odorata, V. reichenbachiana, V. riviniana, V. tricolor*, si dhe *Prunella vulgaris, Potentilla reptans* dhe *Rubus idaeus*, ndërsa të rriturit ushqehen me një gamë të gjerë lulesh në livadhe; në Shqipëri është lokale në zona malore. *Boloria dia* gjendet në Ballkan dhe Evropë si dhe në Azinë e Vogël, Transkaukaz, Kaukaz dhe më tej lindje. Specia ka statusin VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe Evropiane.

***Boloria euphrosyne*/Pearl-bordered Fritillary**
Flutura bordurargjendë
Nymphalidae – Heliconiinae





***Boloria euphrosyne*, dhe harta e shpërhapjes**

Boloria euphrosyne flutur mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 19–23 mm. Ana e sipërme është portokalli-kafe e çelët me vena dhe njolla të zeza dhe me një seri njollash postdiskale relativisht të vogla, ovale. Flatrat e pasme në anën e sipërme kanë një njollë qelizore të rrumbullakët të zezë, si dhe vena dhe njolla të zeza. Ana e poshtme e flatrave të përparme është më e zbehtë, portokalli-kafe e çelët, ndërsa ana e poshtme e flatrave të pasme është portokalli-kuqe, duke përfshirë zonën bazale të qelizës; brezi diskal është i verdhë, përveç s4 që është me ngjyrë të shndritshme argjendi; njollat bazale në s1c dhe njollat margjinale janë gjithashtu argjendi të shndritshme; në qelizë gjendet një pikë e

vogël e zezë e rrethuar me të verdhë; si dhe një seri e vogël njollash sy postdiskale të errëta. Femra pak më e madhe, me anën e sipërme pak më të errët dhe me shenja submarginale më të çelura, ndërsa ana e poshtme e flatrave të pasme është e ngjashme me atë të mashkullit. Speciet e ngjashme: *B. dia, B. graeca, B. pales, B. titania, B. selene, B. eunomia*. Të rriturit shfaqen në një ose dy breza në vit, në varësi të lartësisë nga niveli i detit në periudhën nga prilli deri në gusht. Vezët çelin pas 11–15 ditësh. Larvat kalojnë dimrin në stadin L4 në shtresën e mbeturinave bimore. Pupacioni zgjat 9–21 ditë. Specia jeton në livadhe të pasura me lule në pyje të hapura, në skajet e pyjeve dhe në zona me shkurre dhe pemë të shpërndara, nga 500 deri në 1900 m mbi nivelin e detit. Kërkesa hapësinore modeste, mund të arrijë dendësi të lartë popullate. Larvat ushqehen me *Viola arvensis, V. canina, V. cenisia, V. eximia, V. hirta, V. lutea, V. odorata, V. reichenbachiana, V. riviniana* dhe *V. tricolor*, si dhe herë pas here me *Vaccinium uliginosum* dhe *Primula vulgaris*. Të rriturit ushqehen me lule të ndryshme, preferon kompozitat e verdha. Në Shqipëri e përhapur në Alpet e Veriut dhe lokale në male të tjera. Lloji gjendet në Ballkan në Evropë në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz, Kaukaz dhe më tej në lindje. LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, dhe në atë Evropiane.

***Boloria graeca*/Balkan Fritillary**

Fritilari ballkanik

Nymphalidae – Heliconiinae





***Boloria graeca*, dhe harta e shpërhapjes**

Boloria graeca është flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme 16–18 mm. Margjina e flatrave të pasme është me kënd të theksuar në v8. Ana e sipërme është portokalli-kafe e çelët (portokalli-kanelle) me shenja të vogla dhe të ndryshueshme. Flatrat e pasme në anën e sipërme kanë vena të zeza, njolla dhe një seri njollash postdiskale. ana e poshtme e flatrave të përparme është portokalli-fulvous më e zbehtë, pa zona bazale dhe diskale rozë, ndërsa ana e poshtme e flatrave të pasme është më e zbehtë dhe me të paktën tre njolla sy postdiskale të dukshme me qendra të shndritshme. Femra është pak më e madhe, me anën e sipërme më të zbehtë, ndërsa ana e poshtme e flatrave të

pasme është me model të përzier njollash. Speciet e ngjashme: *Boloria pales, Boloria dia, Boloria euphrosyne, Boloria titania*. Të rriturit kanë një brezni të vetme nga mesi i qershorit deri në fund të gushtit, ndonjëherë edhe në fillim të shtatorit. Vezët kanë një stad të shkurtër zhvillimi. Larvat kalojnë dimrin në gjendje gjysmë të rritur. Pupacioni ka gjasë të jetë i shkurtër. Specia jeton në livadhe subalpine të lagështa dhe në terrene shkëmbore, kryesisht nga 1400 deri në 2200 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa hapësinore modeste dhe mund të arrijë dendësi të lartë popullate. Larvat ushqehen me *Viola calcarata, V. eximia, V. perinensis* dhe *V. tricolor*. Të rriturit ushqehen me një gamë të gjerë lulesh, shpesh me *Scabiosa* spp. Në Shqipëri është e përhapur në Alpet e Veriut dhe lokale në zona të tjera malore. Është e pranishme në Ballkan, në Evropë dhe gjithashtu në Turqinë lindore. Kjo specie në Listën e Kuqe të Shqipërisë ka statusin NE, edhe në nivelin Evropian sipas IUCN-së është klasifikuar si LC.

***Boloria pales*/Shepherd's Fritillary**
Flutura e bariut
Nymphalidae – Heliconiinae





***Boloria pales*, dhe harta e shpërhapjes**

Boloria pales është flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme 16–18 mm. Margjina e flatrave të pasme ka një kënd të lehtë në v8. Ana e sipërme është ngjyrë e zbehtë violet-kafe me shenja të vogla dhe të ndryshueshme. Ana e poshtme e flatrave të pasme është më e errët, portokalli-kafe, me ngjyrë pothuajse të njëtrajtshme. Femra është pak më e madhe, ndërsa ana e sipërme është më e zbehtë; ana e poshtme e flatrave të përparme ka njolla të zeza të dobëta, të vogla ose që mungojnë. Ana e poshtme e flatrave të pasme ka

zakonisht vetëm një njollë sy postdiskal të dukshëm (të tjerët, nëse ekzistojnë, janë të zbehtë ose "të verbër"). Speciet e ngjashme: *Boloria graeca, Boloria dia, Boloria euphrosyne, Boloria titania*. Të rriturit kanë një brezni të vetme nga korriku deri në gusht. Vezët kanë një cikël të shkurtër zhvillimi. Larvat kalojnë dimrin si larva të reja. Pupacioni është i shkurtër. Specia jeton në livadhe alpine të lagështa dhe të pasura me lule, nga 2100 deri në 2600 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa hapësinore modeste dhe mund të arrijë dendësi të lartë popullate. Larvat ushqehen me *Viola calcarata* dhe *V. cenisia*, si dhe me *Bistorta vivipara, Plantago alpina, Valeriana* spp. dhe *Dryas* spp. Të rriturit ushqehen me një gamë të gjerë lulesh. Në Shqipëri është shumë lokale, në kufirin jugor të shpërndarjes së saj në Evropë. Mungon në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukaz dhe Kaukaz. Specia ka statusin VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe Evropiane, sipas IUCN-së.

***Boloria titania*/Titania's Fritillary**
Titania
Nymphalidae – Heliconiinae





***Boloria titania*, dhe harta e shpërhapjes**

Boloria titania është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 21–24 mm. Ana e sipërme paraqitet me ngjyrë portokalli të ndezur, të mbuluar me shenja të forta të zeza, ndërsa ana e poshtme e flatrave të pasme ka një ngjyrim purpur-kafe me vizatim të çrregullt si mermer. Femra është zakonisht më e madhe se mashkulli, me ngjyrim më të zbehtë në anën e sipërme, ndërsa ana e poshtme paraqitet më e errët purpur-kafe dhe me shenja më të theksuara. Mund të ngatërrohet me specie të afërta si *Boloria dia, Boloria euphrosyne, Boloria graeca* dhe *Boloria pales*. Specia zhvillon një brezni të vetme në vit, me të rriturit që shfaqen nga qershori deri në fillim të gushtit. Faza e vezës

është ndoshta e shkurtër, ndërsa larvat dimërojnë në stadin e parë (L1). Pupacioni zhvillohet në një periudhë relativisht të shkurtër. *Boloria titania* banon në livadhe të lagështa, në pyje të hapura, zakonisht në lartësi nga 1200 deri në 1700 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa të konsiderueshme hapësinore, por në kushte të përshtatshme mund të arrijë dendësi të lartë popullate. Larvat ushqehen kryesisht me specie të gjinisë *Viola*, si *Viola canina*, *Viola reichenbachiana* dhe *Viola riviniana*, por referohet se është gjetur edhe në bimët e *Polygonum bistorta*. Të rriturit ushqehen me një shumëllojshmëri lulesh. Në Shqipëri ka përhapje të lokalizuar, e njohur kryesisht në Alpet e Veriut; Shqipëria përfaqëson kufirin më jugor të shpërndarjes së saj në Ballkan. Në rang më të gjerë kjo flutur gjendet në pjesën më të madhe të Evropës, ndërsa mungon në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazinë dhe Kaukazin, si dhe më tej drejt lindjes. Specia ka statusin VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe Evropiane, sipas IUCN-së.

***Brenthis daphne*/Marbled Fritillary**
Dafnja
Nymphalidae – Heliconiinae





***Brenthis daphne*, dhe harta e shpërhapjes**

Brenthis daphne është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 21–26 mm. Ana e sipërme paraqitet me ngjyrë të verdhë në nuancë gëlqerore, me rreshta të rregullt shenjash postdiskale dhe nënmarginale; shenjat postdiskale në flatrat e përparme janë të pabarabarta, më të vogla në hapësirat s1 dhe s4 dhe më të mëdha në s2 dhe s3. Flatrat e pasme kanë pika të zeza të dukshme në zonën margjinale. Ana e poshtme është gjithashtu në ngjyrë të verdhë-gëlqerore, ndërsa baza e flatrave të pasme në hapësirën s4 është kryesisht kafe. Femra është zakonisht pak më e madhe dhe me ngjyrim më të

zbehtë në anën e sipërme. Mund të ngatërrohet me specie të afërta si *Brenthis hecate* dhe *Brenthis ino*. Specia zhvillon një brezni të vetme në vit; të rriturit shfaqen nga gjysma e dytë e majit deri në mes të gushtit. Vezët dimërojnë për një periudhë të gjatë, rreth 37–40 javë. Zhvillimi larvor zgjat rreth 8 javë, ndërsa pupacioni 18–26 ditë. *Brenthis daphne* banon në livadhe dhe zona të hapura pyjore me bimësi të pasur me lule, si dhe në habitate me *Rubus* dhe shkurre të ndryshme, nga ultësirat deri në rreth 1800 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa hapësinore modeste dhe në kushte të favorshme mund të arrijë dendësi të lartë popullate; është një specie me sjellje nomade dhe në disa rajone evropiane paraqet zgjerim të arealit drejt perëndimit dhe veriut. Larvat ushqehen kryesisht me specie të gjinisë *Rubus*, si *Rubus caesius, R. canescens, R. fruticosus, R. idaeus* dhe *R. ulmifolius*; përmendet gjithashtu edhe *Filipendula ulmaria*. Të rriturit ushqehen me nektarin e luleve, shpesh edhe të *Rubus* spp. Në Shqipëri është e përhapur kryesisht në zonat malore. Në Ballkan gjendet gjerësisht, ndërsa në shkallë më të gjerë është e shpërndarë në pjesën më të madhe të Evropës, me tendencë zgjerimi në veriperëndim, si dhe në Azi të Vogël, Transkaukazi, Kaukaz dhe më tej drejt lindjes. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Brenthis hecate*/Twin-spot Fritillary**
Hekatja
Nymphalidae - Heliconiinae





***Brenthis hecate*, dhe harta e shpërhapjes**

Brenthis hecate është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 18–22 mm. Ana e sipërme paraqitet me ngjyrë portokalli, me shenja postdiskale dhe nënmarginale të rregullta dhe të plota. Ana e poshtme e flatrave karakterizohet nga vena të errëta të theksuara, dy rreshta shenjash të vogla të errëta postdiskale dhe nënmarginale, si dhe dy linja margjinale të dukshme. Femra është zakonisht pak më e madhe dhe ana e sipërme shpesh

paraqet 142ocale më të errëta kafe. Mund të ngatërrohet me specie të afërta si *Brenthis daphne* dhe *Brenthis ino.*
Specia zhvillon një brezni të vetme në vit; të rriturit shfaqen nga gjysma e dytë e majit deri në fund të korrikut. Vezët kanë një stad të zgjatur zhvillimi; larva dimëron 142ocale korionit dhe zhvillohet në pranverë, ndërsa faza e pupës është relativisht e shkurtër. *Brenthis 142ocale* banon në livadhe të hapura me lule dhe në habitate me shkurre të shpërndara në pyje të rralla, zakonisht në lartësi nga 500 deri në 1300 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa hapësinore modeste dhe mund të arrijë dendësi të lartë 142ocale142e në kushte të favorshme. Larvat ushqehen kryesisht me *Filipendula ulmaria*, ndërsa raportohen gjithashtu *Filipendula vulgaris* dhe specie të gjinisë *Spiraea* (kjo e fundit nuk gjendet natyrshëm në Shqipëri, por përmenden disa kultivarë si *Spiraea alba, S. japonica* dhe *S. salicifolia*). Të rriturit ushqehen me një 142oca të gjerë lulesh.
Në Shqipëri është specie 142ocale dhe kërkon vëmendje në studime të mëtejshme. Në Ballkan është e përhapur gjerësisht, ndërsa në shkallë më të gjerë gjendet në pjesën më të madhe të Evropës, si dhe në Azi të Vogël, Transkaukazi, Kaukaz dhe më tej drejt lindjes. Specia ka statusin VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe Evropiane, sipas IUCN-së.

***Brenthis ino*/Lesser Marbled Fritillary**
Flatramermerta e vogël
Nymphalidae – Heliconiinae





***Brenthis ino*, dhe harta e shpërhapjes**

Brenthis ino është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 17–20 mm. Ana e sipërme paraqitet me ngjyrë bazë të verdhë-kafe të çelët, me një brez të zi të vazhdueshëm përgjatë skajeve të flatrave të përparme dhe të pasme. Ana e poshtme e flatrave të pasme ka një bazë të verdhë-kafe në hapësirën s4, me njolla postdiskale të parregullta dhe njolla sy të dallueshme. Femra është zakonisht pak më e madhe, me anën e sipërme shpesh më të errët

në nuanca kafe-gri dhe me një shkëlqim të lehtë vjollcë te individët e freskët. Mund të ngatërrohet me specie të afërta si *Brenthis daphne* dhe *Brenthis hecate.* Specia zhvillon një brezni të vetme në vit; të rriturit shfaqen nga gjysma e dytë e qershorit deri në korrik. Vezët dimërojnë me larvën e re brenda korionit; zhvillimi larvor zgjat rreth 8 javë, ndërsa faza e pupës 10–18 ditë. *Brenthis ino* banon në livadhe të lagështa me lule dhe në zona me shkurre të shpërndara, shpesh pranë ujërave rrjedhëse ose liqeneve, zakonisht në lartësi nga 1200 deri në 1600 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa hapësinore modeste dhe në kushte të favorshme mund të arrijë dendësi të lartë popullate. Larvat ushqehen kryesisht me *Filipendula ulmaria* dhe *Filipendula vulgaris*; janë raportuar gjithashtu *Aruncus dioicus*, specie të gjinisë *Rubus* dhe *Sanguisorba*. Të rriturit ushqehen me një shumëllojshmëri lulesh.
Në Shqipëri është shumë e lokalizuar dhe kërkon studime të mëtejshme, duke u gjendur në kufirin jugor të shtrirjes së saj në Ballkan. Në rajon është e përhapur në disa vende të Evropës Juglindore, ndërsa në shkallë më të gjerë shtrihet në pjesë të mëdha të Evropës, si dhe në Azinë e Vogël, Transkaukazi, Kaukaz dhe më tej drejt lindjes. Specia ka statusin VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe Evropiane, sipas IUCN-së.

***Fabriciana adippe*/High Brown Fritillary**
Adipja
Nymphalidae – Heliconiinae





***Fabriciana adippe*, dhe harta e shpërhapjes**

Fabriciana adippe është një flutur e madhe, me gjatësi të flatrave të përparme prej 25–31 mm. Ana e sipërme paraqitet me ngjyrë të ndritshme portokalli-kafe, ndërsa flatrat e përparme te mashkulli kanë shenja seksuale të dukshme dhe të gjera përgjatë venave v2–3. Ana e poshtme është më e zbehtë; flatrat e pasme kanë ngjyrë kafe të çelët, shpesh me një nuancë të lehtë jeshile ulliri, me njolla

argjendi të ndryshueshme dhe një rresht postdiskal me njolla sy të rrethuara me kafe dhe me qendër argjendi. Në hapësirën s4 zakonisht ndodhet ose mungon një njollë e vogël, pa pikë të zezë. Femra ka madhësi të ngjashme me mashkullin dhe anë të sipërme të ngjashme, por pa shenjat seksuale; ana e poshtme është gjithashtu e ngjashme. Mund të ngatërrohet me specie të afërta si *Fabriciana niobe* dhe *Speyeria aglaja*.

Specia zhvillon një brezni të vetme në vit; të rriturit shfaqen nga mesi i qershorit deri në gusht. Vezët dimërojnë me larvën e re brenda korionit; zhvillimi larvor zgjat rreth 8–10 javë, ndërsa faza e pupës 14–28 ditë. *Fabriciana adippe* banon në kullota të thata gëlqerore me shkurre të shpërndara dhe në hapësira të hapura me diell në pyje të rralla, zakonisht në lartësi nga 500 deri në 1800 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa të konsiderueshme hapësinore dhe në kushte të favorshme mund të arrijë dendësi të lartë popullate. Larvat ushqehen me specie të gjinisë *Viola*, si *Viola canina, Viola hirta, Viola odorata, Viola reichenbachiana, Viola riviniana* dhe *Viola tricolor.* Të rriturit ushqehen me një shumëllojshmëri të madhe lulesh.

Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht, veçanërisht në zonat malore. Në Ballkan është gjerësisht e përhapur, ndërsa në shkallë më të gjerë është e shpërndarë në pjesën më të madhe të Evropës, si dhe në Azinë e Vogël, Transkaukazi, Kaukaz dhe më tej drejt lindjes. Kjo specie në Listën e Kuqe të Shqipërisë ka statusin NE, edhe në nivelin Evropian sipas IUCN-së është klasifikuar si LC.

***Fabriciana niobe*/Niobe Fritillary**

Niobja

Nymphalidae – Heliconiinae





***Fabriciana niobe*, dhe harta e shpërhapjes**

Fabriciana niobe është një flutur e madhe, me gjatësi të flatrave të përparme prej 23–30 mm. Ana e sipërme paraqitet me ngjyrë të ndritshme portokalli-kafe, ndërsa flatrat e përparme te mashkulli kanë shenja seksuale të ngushta përgjatë venave v2 dhe v3. Ana e poshtme është portokalli-kafe me njolla argjendi, të cilat te forma eris paraqiten në ngjyrë kafe të çelët. Flatrat e pasme karakterizohen

nga një njollë e verdhë (ose kafe e çelët) në bazën e qelizës, shpesh me një pikë të vogël të zezë në qendër. Femra ka madhësi të ngjashme me mashkullin dhe anë të sipërme të ngjashme, por pa shenjat seksuale; ana e poshtme është gjithashtu e ngjashme. Mund të ngatërrohet me specie të afërta si *Fabriciana adippe* dhe *Speyeria aglaja*. Specia zhvillon një brezni të vetme në vit; të rriturit shfaqen nga fundi i majit deri në gusht. Vezët dimërojnë, ndërsa zhvillimi larvor zgjat rreth 8 javë dhe faza e pupës rreth 2 javë. *Fabriciana niobe* banon në livadhe me lule me shkurre të shpërndara, në hapësira të hapura pyjore dhe në kullota (sub)alpine, zakonisht në lartësi nga 500 deri në 1900 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa të konsiderueshme hapësinore dhe në kushte të favorshme mund të arrijë dendësi të lartë popullate. Larvat ushqehen me një gamë të gjerë speciesh të gjinisë *Viola,* si *Viola alba, Viola arvensis, Viola canina, Viola eximia, Viola hirta, Viola odorata, Viola reichenbachiana, Viola riviniana, Viola rupestris* dhe *Viola tricolor*. Të rriturit ushqehen me lule të ulëta, gjembaçe dhe edhe me pemë në lulëzim.
Në Shqipëri është specie lokale, kryesisht në zonat malore. Në Ballkan është e përhapur në disa vende të rajonit, ndërsa në shkallë më të gjerë shtrihet në pjesë të mëdha të Evropës, si dhe në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi, Kaukaz dhe më tej drejt lindjes. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

Issoria lathonia/Queen of Spain Fritillary
Flatrargjenda e vogël
Nymphalidae – Heliconiinae






***Issoria lathonia*, dhe harta e shpërhapjes**

Issoria lathonia është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 19–23 mm. Ana e sipërme paraqitet me ngjyrë të ndritshme portokalli-kafe (fulvous), ndërsa flatrat e përparme nuk kanë shenja seksuale dhe kanë skajin e jashtëm të harkuar (konkav) poshtë venës v5. Ana e poshtme

e flatrave të pasme karakterizohet nga njolla shumë të mëdha argjendi, të dallueshme dhe të shpërndara. Femra është zakonisht pak më e madhe, me karakteristika të ngjashme me mashkullin. Mund të ngatërrohet me individë të ngjashëm brenda kompleksit të fluturave argjendore.
Specia zhvillon të paktën tre breza të vazhdueshëm në vit, nga gjysma e dytë e marsit deri në nëntor. Faza e vezës zgjat 4–9 ditë; larva dimëron në stadin L3 ose L4 (rrallë L5), ndërsa pupacioni zgjat 8–15 ditë. *Issoria lathonia* banon në zona të hapura dhe livadhe të ashpra në ultësira, por mund të ngjitet edhe në lartësi kodrinore deri në rreth 2600 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa hapësinore të konsiderueshme, me dendësi popullate mesatare dhe sjellje nomade, duke u shpërndarë gjerësisht në habitatet e përshtatshme. Larvat ushqehen me një gamë të gjerë speciesh të gjinisë *Viola,* si *Viola aetolica, V. arvensis, V. canina, V. dacica, V. eximia, V. hirta, V. kitaibeliana, V. lutea, V. odorata, V. reichenbachiana, V. riviniana, V. rupestris* dhe *V. tricolor.* Të rriturit ushqehen me një shumëllojshmëri të gjerë lulesh.
Në Shqipëri është e përhapur kryesisht në zonat malore. Në Ballkan gjendet gjerësisht në shumicën e vendeve të rajonit, ndërsa në Evropë është e shpërndarë në një pjesë të madhe të kontinentit, si dhe në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi, Kaukaz dhe më tej drejt lindjes. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Speyeria aglaja*/Dark Green Fritillary**
Njollaperla
Nymphalidae – Heliconiinae





***Speyeria aglaja*, dhe harta e shpërhapjes**

Speyeria aglaja është flutur e madhe, me gjatësi të flatrave të përparme prej 24–29 mm. Ana e sipërme paraqitet me ngjyrë të ndritshme portokalli-kafe (fulvous), ndërsa flatrat e përparme te mashkulli kanë shenja seksuale lineare mbi venat. Ana e poshtme e flatrave të pasme është kafe e çelët-verdhë me një nuancë të dukshme jeshile në bazë, pa ocela postdiskale dhe me njolla submargjinale të

bardha-argjendi. Femra është zakonisht pak më e madhe, me anë të sipërme më të zbehtë, por përndryshe e ngjashme me mashkullin. Mund të ngatërrohet me specie të afërta si *Fabriciana adippe* dhe *Fabriciana niobe*.
Specia zhvillon një brezni të vetme në vit; të rriturit shfaqen nga qershori deri në gusht. Faza e vezës zgjat 14–25 ditë; larva dimëron si larvë e re për 41–47 javë, ndërsa pupacioni zgjat 14–25 ditë. *Speyeria aglaja* banon në livadhe të hapura me lule dhe në pyje të hapura, zakonisht në lartësi nga 500 deri në 2000 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa hapësinore modeste dhe në kushte të favorshme mund të arrijë dendësi të lartë popullate. Larvat ushqehen me një gamë të gjerë speciesh të gjinisë *Viola,* si *Viola aetolica, V. calcarata, V. canina, V. elatior, V. hirta, V. lutea, V. odorata, V. reichenbachiana, V. riviniana, V. rupestris, V. tricolor,* si dhe *Polygonum bistorta*. Të rriturit ushqehen me një shumëllojshmëri të gjerë lulesh.
Në Shqipëri është e përhapur në zonat malore. Në Ballkan gjendet gjerësisht në shumicën e vendeve të rajonit, ndërsa në shkallë më të gjerë është e shpërndarë në pjesën më të madhe të Evropës, si dhe në Azinë e Vogël, Transkaukazi, Kaukaz dhe më tej drejt lindjes. Kjo specie në Listën e Kuqe të Shqipërisë ka statusin NE, edhe në nivelin Evropian sipas IUCN-së është klasifikuar si LC.

***Libythea celtis*/Nettle-tree Butterfly**
Caracja
Nymphalidae – Libytheinae





***Libythea celtis*, dhe harta e shpërhapjes**

Libythea celtis është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme prej 17–22 mm. Palpet e gojës janë të zgjatura, rreth 3–4 herë më të gjata se koka, tipar shumë karakteristik i kësaj specieje. Ana e sipërme paraqitet me ngjyrë të errët kafe, me shenja portokalli; flatrat e përparme kanë një "dhëmb" të dallueshëm në majë dhe një njollë të vogël të bardhë pranë kostës.

Ana e poshtme është pak më e zbehtë, me shenja të ngjashme, ndërsa flatrat e pasme janë kafe-gri me një vijë më të errët mbi venën mesatare dhe shpesh me një shenjë të bardhë në bazën e venës v4. Femra dhe mashkulli janë të ngjashëm në madhësi dhe model, me ndryshime të lehta në tonalitet. Mund të ngatërrohet me individë të ngjashëm në ngjyrë dhe formë të flatrave të pasme. Specia zhvillon zakonisht një brez të vetëm në vit, ndonjëherë edhe një brez të pjesshëm të dytë në varësi të lartësisë, me fluturim nga maji deri në gusht; pas dimërimit, të rriturit shfaqen sërish nga fillimi i pranverës deri në prill. Fazat e vezës, larvës dhe pupës janë relativisht të shkurtra. *Libythea celtis* banon në zona të ngrohta ku gjendet *Celtis australis*, si pranë vendbanimeve ashtu edhe në shpate shkëmbore me shkurre të shpërndara, nga ultësirat deri në rreth 1500 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa hapësinore modeste, por mund të formojë dendësi të lartë popullate dhe konsiderohet specie nomade. Larvat ushqehen kryesisht me *Celtis australis*, por janë raportuar gjithashtu mbi *Celtis tournefortii*, *Arbutus unedo, Morus alba* dhe *Prunus avium*. Të rriturit ushqehen me një gamë të gjerë lulesh, përfshirë edhe lulet e pemëve, dhe shpesh marrin pjesë në sjelljen e "mud-puddling". Në Shqipëri është e përhapur. Në Ballkan gjendet në shumicën e vendeve të rajonit, ndërsa në Evropë është e shpërndarë gjerësisht, si dhe në Azinë e Vogël, Transkaukazi, Kaukaz dhe më tej drejt lindjes. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Limenitis camilla*/White Admiral**

Admirali i bardhë

Nymphalidae – Limenitidinae





***Limenitis camilla*, dhe harta e shpërhapjes**

Limenitis camilla është një flutur e madhe, me gjatësi të flatrave të përparme prej 26–30 mm. Ana e sipërme ka ngjyrë bazë të zezë me shenja të bardha postdiskale. Flatrat e përparme kanë një njollë qelizore të dobët ose të munguar, njolla të vogla të bardha në majë, një brez postdiskal të bardhë të parregullt dhe njolla submarginale të errëta. Flatrat e pasme paraqesin një brez postdiskal të

bardhë të rregullt dhe njolla submarginale të errëta, ndonjëherë me shenja të kuqe në zonën submarginale të këndit anal. Ana e poshtme është portokalli-kafe me nuancë gri-blu në bazë, duke ruajtur të njëjtin model shenjash, por më të theksuar; flatrat e pasme kanë dy rreshta njollash të vogla të zeza postdiskale. Femra dhe mashkulli janë të ngjashëm, me femrën shpesh me shenja pak më të mëdha. Mund të ngatërrohet me specie të afërta si *Limenitis reducta, Neptis rivularis* dhe *Neptis sappho*. Specia zhvillon një brezni të vetme në vit, nga qershori deri në fillim të gushtit, me një brez të pjesshëm të dytë të mundshëm në shtator. Fazat e vezës dhe pupës janë të shkurtra, ndërsa larva dimëron në stadin L3. *Limenitis camilla* banon në pyje të hapura dhe të lagështa, zakonisht nga 200 deri në 1500 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa hapësinore modeste, por në kushte të favorshme mund të arrijë dendësi të lartë popullate; është specie nomade pas shpërthimeve të numrit të individëve. Larvat ushqehen kryesisht me *Lonicera periclymenum*, por edhe me *L. caprifolium, L. nigra, L. xylosteum* dhe *Symphoricarpos albus*. Të rriturit ushqehen me nektar lulesh, shpesh edhe me *Rubus* spp. Në Shqipëri është shumë lokale, kryesisht në Alpet e Veriut dhe në kufirin jugor të shtrirjes së saj në Ballkan, duke kërkuar studime të mëtejshme. Në Ballkan dhe Evropë është e përhapur në shumë vende, si dhe në Azinë e Vogël, Transkaukazi, Kaukaz dhe më tej drejt lindjes. Specia ka statusin VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe Evropiane, sipas IUCN-së.

***Limenitis populi* / Poplar Admiral**
Admirali i plepit
Nymphalidae – Limenitidinae





***Limenitis populi*, dhe harta e shpërhapjes**

Limenitis populi është një flutur me madhësi të madhe, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 35–40 mm. Ana e sipërme është gri-kafe e errët me njolla të bardha në zonat postdiskale dhe në qelizë, të cilat shpesh janë të reduktuara ose ndonjëherë mungojnë plotësisht (forma tremulae Esper, 1800). Ana e sipërme e krahëve të përparmë ka njolla të zbehta portokalli-kuqe dhe të zeza submargjinale, ndërsa në krahët e pasmë këto shenja janë më të dukshme. Ana e poshtme është portokalli, me shenja të bardha dhe gri-blu më të përcaktuara, ndërsa në krahët e pasmë paraqitet një seri e vetme pikash të vogla të zeza

postdiskale. Femrat janë më të mëdha dhe kanë njolla të bardha dukshëm më të zhvilluara, si dhe një brez të bardhë më të theksuar në krahët e pasmë. Specia ka një periudhë fluturimi të shkurtër me një brez në vit, nga qershori në lartësi më të ulëta deri në korrik në lartësi më të mëdha. Vezët kanë një stad të shkurtër, ndërsa larvat dimërojnë në stad L3 brenda një hibernakulumi. Pupacioni është i shkurtër. *Limenitis populi* banon në pyje gjetherënëse të mëdha dhe të ndriçuara, ku ka prani të konsiderueshme të *Populus tremula* në lartësi më të ulëta, ndërsa në lartësi më të mëdha gjendet edhe në pyje të përziera të hapura deri në 1500 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë të mëdha dhe dendësia e popullatës duket shpesh e ulët, por mund të jetë e nënvlerësuar për shkak të mënyrës së fshehtë të jetesës në majat e pemëve. Larvat ushqehen kryesisht me *Populus tremula*, ndërsa përmenden gjithashtu *Populus alba* dhe *Populus nigra*. Të rriturit ushqehen me lëngje nga materiale të kalbura dhe jashtëqitje. Në Shqipëri, specia është e regjistruar së fundmi. Në Ballkan ka shpërndarje të gjerë në vende të ndryshme, ndërsa në Evropë është e pranishme në zona të përshtatshme. Nuk gjendet në Azi të Vogël dhe prania në Transkaukazi dhe Kaukaz është e pasigurt, më në lindje është e pranishme. Nuk konsiderohet e rrezikuar dhe klasifikohet në kategorinë LC (shqetësim i ulët) në nivel mesdhetar sipas IUCN, ndërsa në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet NA.

***Limenitis reducta*/ Southern White Admiral**
Admiralja e bardhë e jugut
Nymphalidae – Limenitidinae





***Limenitis reducta*, dhe harta e shpërhapjes**

Limenitis reducta është një flutur me madhësi të madhe, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 23–27 mm. Ana e sipërme është blu-e zezë me shenja të bardha postdiskale dhe njolla të vogla submargjinale të errëta me bordurë blu. Ana e sipërme e krahëve të përparmë ka një njollë të dukshme të bardhë në qelizë, njolla të bardha në pjesën apikale dhe njolla të bardha postdiskale të parregullta. Në krahët e pasmë paraqitet një brez i rregullt i bardhë postdiskal. Ana e

poshtme e krahëve të përparmë është kafe e kuqërremtë, ndërsa krahët e pasmë kanë një brez bazal gri të zbehtë, një brez qendror të bardhë të gjerë dhe një seri të vetme pikash të vogla të zeza postdiskale. Specia zakonisht ka dy brezni në vit, me ndonjëherë edhe një brez të tretë të pjesshëm, me të rritur që shfaqen nga prilli deri në tetor. Vezët kanë një stad të shkurtër zhvillimi, ndërsa larvat dimërojnë në stad L3. Pupacioni është i shkurtër. *Limenitis reducta* banon në zona të thata dhe të ngrohta shkëmbore me shkurre të shpërndara dhe skaje pyjesh, shpesh pranë luginave lumore dhe zonave përreth tyre, nga niveli i ulët deri në 1600 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë modeste dhe dendësia e popullatës mund të jetë e lartë; specia ka sjellje nomade. Larvat ushqehen kryesisht me Lonicera xylosteum, ndërsa përmenden gjithashtu *Lonicera alpigena, L. caprifolium, L. etrusca, L. implexa, L. japonica, L. periclymenum* dhe *Symphoricarpos albus*. Të rriturit ushqehen me nektar nga lule të ndryshme, shpesh edhe *Rubus*. Në Shqipëri, specia është e përhapur. Në Ballkan ka shpërndarje të gjerë, ndërsa në Evropë dhe më tej gjendet në zona të përshtatshme. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Neptis rivularis*/ Hungarian Glider**
Avioni i hungarez
Nymphalidae – Limenitidinae





***Neptis rivularis*, dhe harta e shpërhapjes**

Neptis rivularis është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 25–27 mm. Ana e sipërme është e zezë, ndërsa ana e sipërme e krahëve të përparmë paraqet një vijë të bardhë të reduktuar në qelizë. Ana e

sipërme e krahëve të pasmë ka një brez të vetëm të bardhë, të pjerrët, të ndërprerë nga vena të zeza të theksuara. Ana e poshtme është ngjyrë kafe-kanelle.
Specia zakonisht ka një brez të vetëm në vit, me të rritur që shfaqen nga qershori deri në gusht. Vezët kanë një stad të shkurtër, ndërsa larvat dimërojnë në stad L3. Pupacioni është i shkurtër. *Neptis rivularis* banon në pyje gjetherënëse të hapura, të ngrohta dhe të lagështa, shpesh pranë ujërave rrjedhëse, në lartësi nga 500 deri në 1500 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë të konsiderueshme dhe dendësia e popullatës mund të jetë e lartë. Larvat ushqehen me *Aruncus dioicus*, *Filipendula ulmaria* dhe *Spiraea* sp., ndërsa në natyrë Spiraea nuk gjendet në Shqipëri (por kultivohet disa specie si *Spiraea alba*, *S. japonica* dhe *S. salicifolia*). Të rriturit ushqehen me nektar nga lule përgjatë ujërave rrjedhëse dhe kryejnë edhe mud-puddling.
Në Shqipëri nuk ka të dhëna të konfirmuara dhe specia ndodhet në kufirin jugor të shpërndarjes së saj në Ballkan. Në Ballkan ka shpërndarje të gjerë, ndërsa në Evropë dhe më tej gjendet në zona të përshtatshme. Specia klasifikohet në kategorinë NA në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe NA në nivel mesdhetar sipas IUCN.

***Neptis sappho* / Common Glider**
Avioni i zakonshëm
Nymphalidae – Limenitidinae





***Neptis sappho*, dhe harta e shpërhapjes**

Neptis sappho është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 22–24 mm. Ana e sipërme është e zezë. Ana e sipërme e krahëve të përparmë paraqet një vijë të bardhë të qartë dhe të ngushtë në qelizë dhe një shenjë trekëndore të dukshme përtej saj. Në krahët e pasmë ka breza të bardhë

diskal dhe postdiskal. Ana e poshtme ka ngjyrë kafe-kanelle të kuqe me të njëjtin model shenjash. Femrat janë pak më të mëdha, me shenja të ngjashme.
Specia zakonisht ka dy ose më shumë brezni në vit, në varësi të lartësisë, me të rritur që shfaqen nga prilli deri në shtator. Vezët kanë një stad të shkurtër, ndërsa larvat dimërojnë në stad të maturuar. Pupacioni është i shkurtër. *Neptis sappho* banon në pyje gjetherënëse të lagështa me zona të hapura me diell ose skaje pyjesh, ndonjëherë pranë ujërave rrjedhëse. Është specie e zonave të ulëta, por mund të gjendet deri në 1000 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë modeste dhe dendësia e popullatës mund të jetë e lartë. Larvat ushqehen me *Lathyrus niger, Lathyrus vernus* dhe shpesh edhe me *Robinia pseudoacacia* të introduktuar. Të rriturit rrallë ushqehen me lule të ulëta dhe kryejnë edhe mud-puddling.
Në Shqipëri ekziston një regjistrim i pakonfirmuar nga Alpet Shqiptare Veriore dhe specia ndodhet në kufirin jugor të shpërndarjes së saj në Ballkan. Në Ballkan ka shpërndarje të gjerë, ndërsa në Evropë dhe më tej gjendet në zona të përshtatshme. Klasifikohet në kategorinë NA në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe NA në nivel mesdhetar sipas IUCN.

***Aglais io* / Peacock Butterfly**
Flutura sypallua e ditës
Nymphalidae – Nymphalinae





***Aglais io*, dhe harta e shpërhapjes**

Aglais io është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 27–29 mm. Ana e sipërme është ngjyrë e kuqe rubin me shenja të mëdha ocelare në krahët e përparmë dhe në krahët e pasmë. Ana e poshtme është ngjyrë kafe-e zezë. Femrat janë pak më të mëdha, me shenja të ngjashme me ato të meshkujve.

Specia dimëron në stadin e rritur dhe është në fluturim nga fillimi i pranverës deri në maj, ndërsa një brez i dytë i pjesshëm mund të shfaqet në kushte të nxehta nga qershori deri në shtator. Vezët zhvillohen për 5–14 ditë. Larvat zhvillohen për 15–30 ditë; në stadet e hershme jetojnë në grup brenda një rrjete mëndafshi, ndërsa në stadet e mëvonshme jetojnë individualisht. Pupacioni zgjat 10–16 ditë. Aglais io banon në zona të hapura me livadhe me lule dhe prani të hithrave, nga niveli i ulët deri në 2500 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë të konsiderueshme, dendësia e popullatës shpesh e lartë dhe sjellja nomade. Larvat ushqehen kryesisht me *Urtica dioica*, ndërsa përmenden gjithashtu *Urtica pilulifera, U. urens, Humulus lupulus* dhe *Parietaria judaica.* Të rriturit ushqehen me lule të ndryshme.
Në Shqipëri, specia është e përhapur në zonat malore. Në Ballkan ka shpërndarje të gjerë, ndërsa në Evropë dhe më tej gjendet në zona të përshtatshme. Specia klasifikohet në kategorinë LC (shqetësim i ulët) në nivel mesdhetar sipas IUCN dhe në kategorinë NE në Listën e Kuqe të Shqipërisë.

***Aglais urticae* / Small Tortoiseshell**
Flutura e hithrave
Nymphalidae – Nymphalinae





***Aglais urticae*, dhe harta e shpërhapjes**

Aglais urticae është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 22–25 mm. Ana e sipërme është portokalli e kuqe me shenja të zeza dhe të verdha, si dhe shenja blu submargjinale në krahët e përparmë dhe të pasmë. Ana e sipërme e krahëve të përparmë ka dy njolla të vogla të zeza

postdiskale në s2 dhe s3 dhe një njollë të bardhë apikale. Ana e sipërme e krahëve të pasmë ka një zonë të madhe bazale të zezë. Ana e poshtme ka shenja submargjinale blu me shkëlqim në krahët e përparmë dhe të pasmë, ndërsa ngjyra bazë është kafe-okër me bazë më të errët dhe majë më të errët. Ana e poshtme e krahëve të pasmë është kafe-e zezë me zonë postdiskale më të çelur. Femrat janë të ngjashme.
Specia dimëron në stadin e rritur dhe është në fluturim nga fillimi i pranverës deri në maj; mund të ketë nga një deri në tre brezni në vit në varësi të lartësisë, me aktivitet nga qershori deri në tetor. Vezët zhvillohen për 6–13 ditë. Larvat zhvillohen për 13–29 ditë dhe në stadet e hershme jetojnë në rrjetë mëndafshi, ndërsa pupacioni zgjat 8–18 ditë. Aglais urticae banon në të gjitha llojet e hapësirave të hapura me lule dhe prani të hithrave, nga niveli i ulët deri në 2600 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë të mëdha, dendësia e popullatës mund të jetë e lartë dhe specia ka sjellje migratore. Larvat ushqehen kryesisht me Urtica dioica, ndërsa përmenden gjithashtu Urtica urens dhe Humulus lupulus. Të rriturit ushqehen me lule të ndryshme.
Në Shqipëri, specia është e përhapur në zonat malore. Në Ballkan ka shpërndarje të gjerë, ndërsa në Evropë dhe më tej gjendet në zona të përshtatshme. Nuk konsiderohet e rrezikuar dhe klasifikohet në kategorinë LC (shqetësim i ulët) në nivel mesdhetar sipas IUCN dhe në kategorinë NE në Listën e Kuqe të Shqipërisë.

***Araschnia levana* / Map Butterfly**
Portokalli e ndezur me njolla të zeza
Nymphalidae – Nymphalinae





***Araschnia levana*, dhe harta e shpërhapjes**

Araschnia levana është një flutur me madhësi të vogël, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 16–19 mm në gjeneratën pranverore dhe 17–21 mm në gjeneratën verore. Paraqet dimorfizëm sezonal të theksuar. Ana e sipërme e gjeneratës pranverore (forma levana) është portokalli me shenja të zeza, ndërsa gjenerata verore (forma prorsa) është e zezë me breza diskalë ngjyrë kremi të

çelur. Ana e poshtme ka shenja të ngjashme "hartë" dhe vena të bardha; te forma levana është kafe-e kuqërremtë, ndërsa te forma prorsa më e errët kafe-e kuqërremtë. Femrat janë pak më të mëdha dhe maja e krahëve të përparmë është pak më e rrumbullakët se te meshkujt.
Specia ka dy brezni në vit, nga prilli deri në maj dhe nga fundi i qershorit deri në gusht. Vezët vendosen në formë të vetme "kulle" dhe zhvillohen për 4–7 ditë. Larvat zhvillohen për 17–29 ditë. Pupacioni dimëron, ndërsa para verës zgjat 9–15 ditë. *Araschnia levana* banon në pyje, skaje pyjesh dhe livadhe të lagështa të papërpunuara me shkurre të shpërndara dhe *Rubus*, nga niveli i ulët deri në 1500 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë modeste, dendësia e popullatës mesatare, sjellje nomade dhe është në zgjerim të arealit në Ballkan; është regjistruar së fundmi në Shqipëri.
Larvat ushqehen kryesisht me *Urtica dioica*, ndërsa përmenden gjithashtu *Urtica urens* dhe *Humulus lupulus*. Të rriturit ushqehen me lule të ndryshme, me preferencë për lulëzime në formë ombrelash.
Në Shqipëri ka të dhëna të fundit dhe ndodhet në kufirin jugor të shpërndarjes së saj në Ballkan. Në Ballkan ka shpërndarje të gjerë, ndërsa në Evropë dhe më tej gjendet në zona të përshtatshme. Klasifikohet në kategorinë NE në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe NA në nivel mesdhetar sipas IUCN.

***Euphydryas aurinia*/Marsh Fritillary**
E hershmja
Nymphalidae – Nymphalinae





***Euphydryas aurinia*, dhe harta e shpërhapjes**

Euphydryas aurinia është një flutur me madhësi të vogël deri mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme zakonisht rreth 17–19 mm. Ana e sipërme paraqitet me ngjyrë bazë e verdhë e çelët, e ndërthurur me një rrjetëzim të theksuar shenjash të zeza që formojnë një model karakteristik në formë katrorësh. Ana e poshtme e flatrave të pasme ka ngjyrë yellow-buff me nuancë

të lehtë jeshile ulliri, me njolla argjendi të ndryshueshme dhe një rresht postdiskal me njolla të rrethuara me kafe dhe qendër argjendi; në disa individë këto janë të reduktuara ose të paqarta. Të dy gjinitë janë të ngjashme në pamje, por femra mund të jetë pak më e madhe dhe me ngjyra disi më të zbehta.
Specia zhvillon zakonisht një brezni në vit, me të rriturit që shfaqen nga maji deri në korrik, në varësi të kushteve klimatike dhe lartësisë. Vezët vendosen në grupe në pjesën e poshtme të gjetheve të bimëve me të cilat insekti ushqehet. Larvat jetojnë në koloni dhe ndërtojnë një fole mëndafshi (silky nest), ku dimërojnë në stadet e hershme larvore. Zhvillimi vazhdon në pranverë, ndërsa pupacioni ndodh në tokë ose në bimësi të ulët. Banon në livadhe të lagështa, kullota, moçale dhe zona me bimësi të ulët, në toka të pasura me lagështi. Mund të gjendet nga ultësirat deri në zona kodrinore dhe malore, zakonisht deri në rreth 1500 m mbi nivelin e detit. Larvat ushqehen me bimë si *Succisa pratensis*, *Scabiosa* dhe *Knautia*, ndërsa të rriturit ushqehen me nektarin e një game të gjerë lulesh.
Në Shqipëri ka një përhapje të fragmentuar dhe është e lidhur ngushtë me habitatet e saj specifike. Kjo specie gjendet në pjesë të mëdha të Evropës dhe në disa rajone të Azisë Perëndimore. Sipas kritereve të IUCN, në shumë vende evropiane konsiderohet specie me shqetësim për shkak të humbjes së habitatit. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

Euphydryas maturna/Scarce Fritillary
Maturna
Nymphalidae – Nymphalinae





***Euphydryas maturna*, dhe harta e shpërhapjes**

Euphydryas maturna është një flutur me madhësi të vogël deri mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 18–23 mm. Ana e sipërme paraqitet me ngjyrë portokalli-kafe me rrjetëzim të theksuar shenjash të zeza, ndërsa ana e poshtme është më e çelët, me nuanca krem dhe portokalli në model mozaik. Të

dy gjinitë janë të ngjashme, por femra zakonisht është pak më e madhe dhe më e zbehtë.
Specia zhvillon një brezni në vit, me të rriturit që shfaqen nga maji deri në korrik. Vezët vendosen në grupe mbi bimët ushqyese. Larvat jetojnë në koloni dhe zhvillohen fillimisht së bashku, duke dimëruar në stadet e hershme larvore. Euphydryas maturna banon në pyje të hapura ose shkurre me shtresë të pasur bimësh barishtore, nga ultësira deri mbi 1000 m mbi nivelin e detit, në lokalitete në kufirin jugor të shpërndarjes së saj. Larvat ushqehen kryesisht me *Fraxinus excelsior*, por edhe me *Ligustrum* dhe *Viburnum*, ndërsa të rriturit ushqehen me nektarin e luleve.
Në Shqipëri kjo flutur e ditës ka përhapje të kufizuar dhe të fragmentuar, e lidhur kryesisht me habitate të përshtatshme si pyjet e hapura dhe zonat me bimësi të pasur ushqimore për larvat, duke e bërë specie relativisht të rrallë. Në një shtrirje më të gjerë, në Evropë gjendet në zona të shpërndara, kryesisht në pjesën qendrore dhe lindore, me popullata të izoluara dhe shpesh në rënie. Rënia lidhet kryesisht me humbjen dhe fragmentimin e habitateve, ndryshimet në përdorimin e tokës dhe faktorë të tjerë mjedisorë. Në Shqipëri kjo specie klasifikohet si VU, ndërsa në nivel Evropian sipas IUCN-së renditet në kategorinë VU A2c

***Melitaea athalia*/Heath Fritillary**
Athalia
Nymphalidae – Nymphalinae





***Melitaea athalia*, dhe harta e shpërhapjes**

Melitaea athalia është një flutur me madhësi të vogël deri mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 18–22 mm. Ana e sipërme paraqitet me ngjyrë portokalli të ndezur me një rrjetëzim të dendur shenjash të zeza që formojnë një model karakteristik, ndërsa ana e poshtme e flatrave të pasme është më e çelët,

me nuanca krem, portokalli dhe të verdha në formë mozaiku. Të dy gjinitë janë të ngjashme, por femra zakonisht është pak më e madhe dhe me ngjyra disi më të zbehta. Mund të ngatërrohet me specie të afërta të gjinisë *Melitaea*, por modeli i saj mbetet relativisht i dallueshëm.
Specia zhvillon zakonisht një brezni në vit, me të rriturit që shfaqen nga maji deri në gusht, në varësi të kushteve klimatike dhe lartësisë. Vezët vendosen në grupe mbi bimët me të cilat insekti ushqehet, ndërsa larvat jetojnë në koloni në fazat e hershme dhe dimërojnë në këtë stad. Zhvillimi vazhdon në pranverë dhe pupacioni ndodh në bimësi të ulët. Lloji banon në livadhe, kullota, skaje pyjesh dhe zona me bimësi të ulët, nga ultësirat deri në zonat malore. Ka përshtatshmëri të mirë ekologjike dhe mund të gjendet në një gamë të gjerë habitatësh të hapur. Larvat ushqehen kryesisht me specie të gjinisë *Plantago* dhe *Veronica*, ndërsa të rriturit ushqehen me nektarin e luleve të ndryshme.
Në Shqipëri është relativisht e përhapur në habitate të përshtatshme, veçanërisht në zona kodrinore dhe malore. Në një shtrirje më të gjerë gjendet në pjesën më të madhe të Evropës dhe në disa rajone të Azisë, me popullata përgjithësisht të qëndrueshme. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Melitaea cinxia*/Glanville Fritillary**
Cinksia
Nymphalidae – Nymphalinae





***Melitaea cinxia*, dhe harta e shpërhapjes**

Melitaea cinxia është një flutur me madhësi të vogël deri mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 16–20 mm. Ana e sipërme paraqitet me ngjyrë portokalli të ndezur me një rrjetëzim të rregullt shenjash të zeza, që formojnë një model të qartë me katrorë, ndërsa ana e poshtme e flatrave të pasme është më e

zbehtë, me nuanca krem, portokalli dhe të verdha në formë mozaiku. Të dy gjinitë janë të ngjashme, por femra zakonisht është pak më e madhe dhe me ngjyra disi më të zbehta. Mund të ngatërrohet me specie të afërta të gjinisë *Melitaea*, por modeli i saj është relativisht i dallueshëm.
Specia zhvillon një brezni në vit, me të rriturit që shfaqen nga prilli deri në qershor. Vezët vendosen në grupe mbi bimët ushqimore, ndërsa larvat jetojnë në koloni dhe ndërtojnë fole mëndafshi, ku edhe dimërojnë në stadet e hershme. Zhvillimi vazhdon në pranverë dhe pupacioni ndodh në bimësi të ulët. Lloji banon në livadhe të thata, kullota dhe zona të hapura me bimësi të ulët, shpesh në toka me diell dhe të varfra në lëndë ushqyese, nga ultësirat deri në zonat kodrinore. Larvat ushqehen kryesisht me specie të gjinisë *Plantago* dhe *Veronica*, ndërsa të rriturit ushqehen me nektarin e luleve të ndryshme.
Në Shqipëri është e përhapur në zona të përshtatshme, kryesisht në habitate të hapura. Në një shtrirje më të gjerë gjendet në pjesën më të madhe të Evropës dhe në disa rajone të Azisë. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Melitaea diamina*/False Heath Fritillary**
Krahporotkallikafta me kuti të zeza
Nymphalidae – Nymphalinae





***Melitaea diamina*, dhe harta e shpërhapjes**

Melitaea diamina është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 18–24 mm. Ana e sipërme karakterizohet nga një ngjyrim portokalli në kafe të ngrohtë, i shoqëruar me një rrjet të dendur vijash dhe njollash të zeza që formojnë një model të theksuar “mozaik”. Ana e poshtme e flatrave të pasme është më e zbehtë, me nuanca kremi deri në kafe të hapur, e

zbukuruar me shirita dhe njolla të errëta të rregulluara në formë brezash. Femrat janë zakonisht pak më të mëdha dhe me ngjyra më të buta krahasuar me meshkujt, ndërsa modeli i njollëzimit mbetet i ngjashëm në të dy gjinitë. Mund të ngatërrohet me specie të tjera të gjinisë *Melitaea* si *M. athalia, M. aurelia* dhe *M. phoebe*, të cilat ndajnë ngjashmëri në vizatimin nga ana kurrizore e flatrave. Specia zakonisht zhvillon një brez në vit, me të rriturit që shfaqen nga fundi i pranverës deri në mesin e verës, kryesisht gjatë muajve qershor–korrik. Vezët vendosen mbi bimët me të cilat lloji ushqehet dhe larvat zhvillohen në mënyrë të sinkronizuar me periudhën e vegjetacionit, shpesh duke kaluar dimërimin në stad larval të vonshëm. Pupacioni ndodh në pranverën pasardhëse dhe zgjat relativisht pak. *Melitaea diamina* banon kryesisht në livadhe të lagështa, zona moçalore alpine dhe subalpine, si dhe në skajet e pyjeve të hapura, zakonisht në lartësi mesatare deri të larta malore. Larvat ushqehen kryesisht me bimë të gjinisë *Valeriana*, si *Valeriana officinalis*, por mund të përdorin edhe disa *Asteraceae* dhe *Caprifoliaceae* në zona të ndryshme të shpërndarjes. Të rriturit ushqehen me nektar nga një gamë e gjerë lulesh livadhore. Në Shqipëri, prania e saj është e kufizuar dhe e lokalizuar, kryesisht në habitate të përshtatshme malore, ndërsa në Ballkan shfaqet në mënyrë të shpërndarë në zona me klimë të freskët dhe të lagësht. Specia ka statusin VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe Evropiane, sipas IUCN-së.

***Melitaea didyma*/Spotted Fritillary**

Kuqaloshja

Nymphalidae – Nymphalinae





***Melitaea didyma*, dhe harta e shpërhapjes**

Melitaea didyma është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 20–26 mm. Ana e sipërme karakterizohet nga ngjyrë portokalli e ndezur në të kuqe të ngrohtë, e shoqëruar me një rrjet të theksuar vijash dhe njollash të zeza që krijojnë një model të rregullt tipik për gjininë. Femrat shfaqin shpesh një variacion më të madh në ngjyrim, duke qenë më të errëta ose më të

zbehta në varësi të formave lokale, ndërsa meshkujt zakonisht kanë ngjyrë më të fortë portokalli dhe kontrast më të theksuar. Ana e poshtme e flatrave të pasme është e verdhë në okër të çelur, me shirita dhe pika të rregullta të bardha dhe të zeza, të cilat formojnë një model karakteristik të dallueshëm nga speciet e afërta si *Melitaea parthenoides* dhe *Melitaea cinxia*. Specia zakonisht ka dy brezni në vit në pjesën më të madhe të arealit të saj, me të rriturit që shfaqen nga prilli deri në tetor, me kulme kryesore në fund të pranverës dhe në verë. Vezët vendosen në grupe mbi bimët ushqyese dhe larvat zhvillohen në mënyrë gregare në stadet e hershme, duke kaluar dimërin zakonisht në stad larval të vonshëm ose në diapauzë të pjesshme, në varësi të kushteve klimatike të zonës. *Melitaea didyma* banon në livadhe të thata dhe gjysmë të thata, shkurre të hapura, kullota malore dhe zona me vegjetacion të ulët, nga niveli i detit deri në lartësi mesatare malore. Larvat ushqehen kryesisht me bimë të familjes Plantaginaceae dhe Asteraceae, si *Plantago lanceolata*, *Centaurea* spp. dhe *Veronica* spp., ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga një shumëllojshmëri lulesh livadhore.
Në Shqipëri është e përhapur kryesisht në zona kodrinore dhe malore me klimë Evropiane. Ka shpërndarje të gjerë në Evropë, Afrikën e Veriut dhe pjesë të Azisë së butë, duke qenë një nga speciet më të adaptueshme të gjinisë së saj. Specia ka statusin VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe Evropiane, sipas IUCN-së.

***Melitaea ornata*/Eastern Knapweed Fritillary**
Lindorja
Nymphalidae – Nymphalinae





***Melitaea ornata*, dhe harta e shpërhapjes**

Melitaea ornata është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 20–25 mm. Ana e sipërme paraqet një ngjyrim portokalli në të kuqe të ngrohtë, i mbuluar me një rrjet të dendur vijash dhe njollash të zeza që formojnë një model karakteristik tipik të gjinisë. Ana e poshtme e flatrave të pasme është e verdhë në okër të çelur, me rreshta pikash dhe brezash të bardhë

dhe të zinj që krijojnë një kontrast të qartë dhe ndihmojnë në dallimin nga speciet e afërta si *Melitaea didyma* dhe *Melitaea phoebe*. Femrat janë shpesh pak më të mëdha dhe me ngjyrosje më të zbehtë ose më të errët në varësi të popullatës, ndërsa meshkujt kanë ngjyrë më të fortë dhe më uniforme. Specia zakonisht ka një deri në dy brezni në vit, në varësi të kushteve klimatike, me të rriturit që shfaqen nga pranvera e vonë deri në verë. Vezët vendosen në grupe mbi bimët ushqyese dhe larvat zhvillohen fillimisht në mënyrë gregare, duke kaluar dimërimin zakonisht në stad larval të vonshëm. Pupacioni ndodh në pranverë dhe zgjat një periudhë të shkurtër para shfaqjes së të rriturve. *Melitaea ornata* banon në livadhe të thata dhe gjysmë të thata, zona shkurrore të hapura dhe kullota me vegjetacion të ulët, zakonisht në zona kodrinore dhe malore. Larvat ushqehen kryesisht me bimë të familjes Plantaginaceae dhe Scrophulariaceae, si *Plantago* spp. dhe *Veronica* spp., ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga një shumëllojshmëri lulesh livadhore. Në Shqipëri, specia është e pranishme në mënyrë të lokalizuar në habitate të përshtatshme të thata dhe gjysmë të thata, ndërsa në Ballkan dhe më gjerë në Evropën juglindore ka shpërndarje të fragmentuar, por të qëndrueshme. Në Shqipëri kjo specie klasifikohet si DD, ndërsa në nivel Evropian sipas IUCN-së renditet në kategorinë LC.

***Melitaea phoebe*/Knapweed Fritillary**
Flutura e livadheve
Nymphalidae – Nymphalinae





***Melitaea phoebe*, dhe harta e shpërhapjes**

Melitaea phoebe është një flutur me madhësi mesatare deri të madhe, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 22–28 mm. Ana e sipërme ka ngjyrim portokalli të ndezur me nuanca në të kuqe të ngrohtë, e mbuluar me një rrjet të dendur vijash dhe njollash të zeza që krijojnë një model të rregullt dhe karakteristik për gjininë. Ana e poshtme e flatrave të pasme është e verdhë në okër të çelur, me shirita

dhe pika të bardha të rrethuara nga konture të errëta, të cilat e bëjnë relativisht të dallueshme nga speciet e afërta si *Melitaea didyma* dhe *Melitaea ornata*. Femrat janë zakonisht më të mëdha dhe me ngjyrim më të errët ose më të zbehtë në varësi të popullatës, ndërsa meshkujt kanë ngjyra më intensive dhe kontrast më të fortë. Zakonisht lloji ka 1–2 brezni në vit, me të rritur që shfaqen nga pranvera e vonë deri në fund të verës. Vezët vendosen në grupe mbi bimët ushqyese, duke dimëruar në stad larval të vonshëm; pupacioni ndodh në pranverë dhe është i shkurtër. Lloji banon në livadhe të thata dhe gjysmë të thata, kullota malore, zona shkëmbore dhe skaje shkurresh, nga niveli i detit deri në lartësi mesatare malore. Larvat ushqehen kryesisht me Asteraceae (sidomos *Centaurea, Carduus* dhe *Cirsium*), ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga lule të ndryshme livadhore.
Në Shqipëri, specia është e përhapur në mënyrë të lokalizuar por relativisht të shpeshtë në zona të hapura kodrinore dhe malore. Në rang më të gjerë ka shpërndarje të madhe në Evropë dhe në pjesë të Azisë perëndimore, duke qenë një nga përfaqësueset tipike të habitateve të thata dhe gjysmë të thata. Nuk konsiderohet globalisht e rrezikuar dhe zakonisht klasifikohet si LC (shqetësim i ulët), megjithatë popullatat lokale mund të ndikohen nga degradimi i livadheve dhe ndryshimet në përdorimin e tokës. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

Melitaea trivia/Lesser Spotted Fritillary
Trivia
Nymphalidae – Nymphalinae





***Melitaea trivia*, dhe harta e shpërhapjes**

Melitaea trivia është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 17–19 mm. Ana e sipërme ka ngjyrë portokalli, me model karakteristik shenjash të zeza. Ana e poshtme e flatrave të pasme është e verdhë në okër të çelur, me shirita dhe pika të bardha të rregullta të kufizuara nga vija të errëta, që e bëjnë të dallueshme nga speciet e afërta si *Melitaea didyma* dhe

Melitaea phoebe. Femrat janë zakonisht pak më të mëdha dhe me ngjyrosje më të zbehtë, ndërsa meshkujt kanë kontrast më të fortë dhe ngjyrim më të ndezur. Specia zhvillon dy deri në tre brezni në vit, në varësi të lartësisë, me të rriturit që shfaqen nga pranvera e vonë deri në verë. Vezët vendosen në grupe mbi bimët ushqyese dhe larvat zhvillohen fillimisht në mënyrë gregare, larvat me shumë gjasë dimërojnë si larva të vogla. Pupacioni ndodh në pranverë dhe zgjat një periudhë relativisht të shkurtër para shfaqjes së brezit të ri të të rriturve. *Melitaea trivia* banon në brigje të ashpra dhe shpate të pasura me lule, nga ultësirat deri në rreth 1800 m mbi nivelin e detit. Larvat ushqehen kryesisht me specie të gjinisë Verbascum, ndërsa më rrallë janë raportuar edhe specie të gjinisë Veronica; ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga një shumëllojshmëri lulesh livadhore.
Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht në zonat malore, ndërsa në Evropë ka një shpërndarje mjaft të gjerë, sidomos në rajonet jugore dhe qendrore. Nuk konsiderohet globalisht e rrezikuar dhe zakonisht klasifikohet si LC (shqetësim i ulët), megjithatë popullatat lokale mund të ndikohen nga degradimi i habitateve dhe ndryshimet në përdorimin e tokës. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Nymphalis antiopa*/Camberwell Beauty**
Zimbajtësja
Nymphalidae – Nymphalinae





***Nymphalis antiopa*, dhe harta e shpërhapjes**

Nymphalis antiopa është një flutur me përmasa të mëdha, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 30–34 mm, duke u renditur ndër speciet më të dallueshme të familjes Nymphalidae. Ana e sipërme e flatrave ka ngjyrë kafe-vjollcë shumë të errët, me një brez marginal krem-verdhë dhe njolla blu submarginale; te

individët që kanë dimëruar, brezi marginal bëhet i bardhë. Ky kombinim ngjyrash i jep një pamje shumë karakteristike dhe e bën lehtësisht të identifikueshme në natyrë. Ana e poshtme është shumë e errët, me brez marginal krem-verdhë (ose të bardhë pas dimërimit) dhe njolla blu submarginale pak të dukshme.

Specia zakonisht ka një brez në vit në shumicën e zonave të Evropës, me të rriturit që shfaqen shumë herët në pranverë, shpesh nga marsi, pasi dimërojnë si imago (flutur e rritur), një veçori e rrallë për fluturat e rajonit. Vezët vendosen në grupe mbi degëzat e bimëve ushqyese dhe larvat zhvillohen në koloni, duke kaluar disa stade deri në pupacion gjatë verës. *Nymphalis antiopa* banon në zona të hapura brenda pyjeve, pranë grykave shkëmbore dhe pyjeve lumore me prani të specieve të gjinisë *Salix* dhe *Populus*, nga ultësirat deri në lartësi të mëdha gjatë migrimit. Larvat ushqehen kryesisht me specie të gjinisë *Salix, Populus* dhe Betula, por janë raportuar edhe mbi *Alnus* dhe *Ulmus*. Të rriturit ushqehen me lëngje frutash të pjekura, rrjedhje pemësh dhe ndonjëherë nektar lulesh.

Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht, e lidhur kryesisht me zonat pyjore dhe luginat me bimësi të dendur. Në rang më të gjerë është e përhapur në Evropë dhe Azinë e Vogël, si dhe në Transkaukazi, Kaukaz dhe më tej drejt lindjes. Nuk konsiderohet e rrezikuar globalisht dhe klasifikohet si LC (shqetësim i ulët), megjithëse popullatat lokale mund të ndikohen nga humbja dhe degradimi i habitateve pyjore. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Nymphalis polychloros*/Large Tortoiseshell**

Shumëngjyrëshja

Nymphalidae – Nymphalinae





***Nymphalis polychloros*, dhe harta e shpërhapjes**

Nymphalis polychloros është një flutur me përmasa të mëdha, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 30–34 mm. Nymphalis polychloros është një flutur me përmasa të mëdha, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 30–34 mm. Ana e

sipërme ka ngjyrë bazë kafe të errët në vjollcë, me kufij margjinalë krem të verdhë (që pas dimërimit bëhen të bardhë) dhe njolla blu submarginale. Ana e poshtme është shumë e errët, me zona margjinale krem të verdhë (pas dimërimit të bardha) dhe njolla blu submarginale të zbehta. Femrat janë pak më të mëdha, me shenja të ngjashme. Femrat dhe meshkujt janë të ngjashëm, por femrat shpesh janë pak më të mëdha dhe me ngjyrim më të zbehtë.
Specia zakonisht ka një brez në vit, me të rriturit që shfaqen herët në pranverë pas dimërimit si imago. Pas çiftëzimit, vezët vendosen në grupe mbi degët e bimëve ushqyese dhe larvat zhvillohen në koloni, duke kaluar disa stade gjatë pranverës dhe verës përpara pupacionit. *Nymphalis polychloros* banon në pyje gjetherënëse, skaje pyjesh, zona lumore dhe parqe me prani të drurëve si shelgu (*Salix* spp.), elm (*Ulmus* spp.), plepi (*Populus* spp.) dhe pemë frutore. Të rriturit ushqehen me lëngje frutash të pjekura, rrjedhje pemësh dhe ndonjëherë nektar lulesh.
Në Shqipëri specia është e pranishme. Në Evropë ka shpërndarje të gjerë, por popullatat shpesh janë të fragmentuara dhe me dendësi të ndryshueshme. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Nymphalis xanthomelas*/Yellow-legged Tortoiseshell**
Këmbëverdha
Nymphalidae – Nymphalinae





***Nymphalis xanthomelas*, dhe harta e shpërhapjes**

Nymphalis xanthomelas është një flutur e madhe, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 30–32 mm. Ana e sipërme ka ngjyrim portokalli të ndezur në të kuqe, e ndërthurur me njolla dhe shirita të zinj të theksuar që formojnë një model të fortë kontrasti. Skajet e krahëve janë të errëta dhe të kufizuara me një

brez të hollë të zbehtë, duke i dhënë një pamje karakteristike dhe të dallueshme nga speciet e tjera të gjinisë. Ana e poshtme është kafe deri në blu-të zezë në bazë, me zonë postdiskale më të çelët, me model të çrregullt që imiton lëvoren e pemëve dhe shërben si kamuflim kur flutura pushon me krahë të mbyllur. Femrat dhe meshkujt janë të ngjashëm, me ndryshime të lehta në madhësi dhe intensitet ngjyrash.
Specia zakonisht ka një brez në vit, me të rriturit që shfaqen herët në pranverë pas dimërimit si imago. Pas çiftëzimit, vezët vendosen në grupe mbi degët e bimëve ushqyese dhe larvat zhvillohen në mënyrë gregare gjatë stadieve të hershme, duke kaluar më pas në zhvillim të vetmuar deri në pupacion në verë. *Nymphalis xanthomelas* banon në pyje gjetherënëse, zona lumore, skaje pyjesh dhe habitate me lagështi, duke preferuar prani të drurëve si shelgu (*Salix* spp.), plepi (*Populus* spp.) dhe thana (*Prunus padus*), të cilat shërbejnë si bimë ushqyese për larvat. Të rriturit ushqehen me lëngje frutash të pjekura, rrjedhje pemësh dhe ndonjëherë nektar lulesh.
Në Shqipëri, specia është shumë e lokalizuar dhe pa rregjistrime së fundmi, e lidhur kryesisht me habitate të lagështa dhe zona me bimësi të zhvilluar pranë ujërave. Në rang më të gjerë ka shpërndarje në Evropën lindore dhe Azi, por popullatat mund të jenë të fragmentuara. Specia ka statusin VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe Evropiane, sipas IUCN-së.

Polygonia c-album/Comma Butterfly
C-bardha
Nymphalidae – Nymphalinae





***Polygonia c-album*, dhe harta e shpërhapjes**

Polygonia c-album është një flutur mesatare me gjatësi të flatrave të përparme 22–24 mm. Faqja e sipërme e flatrave ka ngjyrë portokalli në kafe të ngrohtë me njolla dhe shirita të zinj të shpërndarë në mënyrë të çrregullt. Ana e poshtme: kafe e errët me model të ngjashëm me lëvoren e pemëve të thara; karakteristikë dalluese është shenja e bardhë në formë “C” në pjesën qendrore të krahut të

pasmë. Dimorfizëm sezonal i theksuar, format pranverore janë me ngjyrim më të çelët dhe më të kontrastuar, ndërsa forma verore më e errët dhe më e zbehtë. Femrat janë pak më të madha se meshkujt, me ngjyrim dhe model të ngjashëm, shpesh pak më të zbehtë.
Specie të ngjashme *Polygonia egea*. Ky lloj ka dy brezni në vit në shumicën e arealit. Individët e brezit të fundit dimërojnë si imago dhe shfaqen sërish në pranverë. Vezët zhvillohen 4–7 ditë; larvat 15–27 ditë; pupacioni zgjat rreth 9–17. *Polygonia c-album* banon në pyje gjetherënëse, skaje pyjesh, shkurre, parqe dhe kopshte. Gjendet nga zonat e ulëta deri në rreth 2000 m mbi nivelin e detit. Lloji ka përshtatshmëri të lartë ekologjike. Larvat ushqehen kryesisht me *Urtica dioica*, *Humulus lupulus*, *Ulmus* spp., *Salix* spp., *Ribes* spp., si dhe *Corylus avellana, Prunus spinosa* dhe *Rubus idaeus*. Të rriturit ushqehen me nektar lulesh, fruta të pjekura dhe lëngje nga pemë të dëmtuara.
Lloji është i përhapur në Shqipëri në zona pyjore dhe gjysmëpyjore. Në Evropë lloji është shumë i përhapur dhe me shpërndarje të gjerë. Gjendet gjithashtu në Azi të Vogël, Lindjen e Afërt dhe Kaukaz. Nuk konsiderohet globalisht i rrezikuar dhe klasifikohet si LC (shqetësim i ulët). Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Polygonia egea*/Southern Comma**
Egea
Nymphalidae – Nymphalinae





***Polygonia egea*, dhe harta e shpërhapjes**

Polygonia egea është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 22–23 mm. Ana e sipërme e flatrave ka ngjyrim portokalli në kafe të ngrohtë, me njolla dhe shirita të zinj të theksuar por më të rregullt krahasuar me *Polygonia c-album*. Ana e poshtme është kafe e errët me model kamuflues që imiton lëvoren e pemëve dhe gjethet e thata; shenja e bardhë në formë “C” është më e vogël dhe më pak e theksuar se te *P. c-album*, duke qenë tipar dallues i

rëndësishëm. Femrat janë zakonisht pak më të mëdha dhe me ngjyrë më të zbehtë se meshkujt. Të rriturit shfaqen nga fillimi i pranverës deri në mars pas dimërimit. Ka dy brezni nga maji deri në tetor. Individët e brezit të fundit dimërojnë si imago dhe rishfaqen në pranverë. Vezët vendosen veç e veç mbi bimët ushqyese dhe larvat zhvillohen në mënyrë të vetmuar, duke kaluar disa stade deri në pupacion. *Polygonia egea* banon në zona të ngrohta dhe të thata, të shkurretës Evropiane, skaje pyjesh, kodrina të thata dhe hapësira me vegjetacion të ulët. Larvat ushqehen kryesisht me *Urtica dioica*, *Parietaria* spp., dhe bimë të tjera barishtore, ndërsa të rriturit ushqehen me nektar lulesh, fruta të pjekura dhe lëngje nga pemë të dëmtuara.
Në Shqipëri, specia është e përhapur në mënyrë të lokalizuar kryesisht në zona të ngrohta kodrinore. Në Evropë ka shpërndarje më të kufizuar në krahasim me *P. c-album*, duke u përqendruar kryesisht në rajonet jugore dhe juglindore. Nuk konsiderohet globalisht e rrezikuar dhe klasifikohet si LC (shqetësim i ulët), megjithatë është e ndjeshme ndaj ndryshimeve në habitatet natyrore dhe degradimit të shkurretës Evropiane. Kjo specie në Listën e Kuqe të Shqipërisë ka statusin NE, edhe në nivelin Evropian sipas IUCN-së është klasifikuar si LC.

Vanessa atalanta/Red Admiral
Admiralja
Nymphalidae – Nymphalinae





***Vanessa atalanta*, dhe harta e shpërhapjes**

Vanessa atalanta është një flutur me madhësi mesatare deri të madhe, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 28–31 mm. Ana e sipërme ka ngjyrim të zi kadifeje, i ndërprerë nga një brez i gjerë i kuq i ndezur që kalon diagonalisht nëpër krahët e përparëm dhe nga njolla të bardha të theksuara në pjesën e

sipërme të krahut të përparmë. Ky kombinim e bën një nga fluturat më të dallueshme në natyrë. Ana e poshtme e krahëve është më e zbehtë, me nuanca kafe dhe gri, e përshtatur për kamuflim kur flutura pushon me krahë të mbyllur. Specia zakonisht ka një deri në dy brezni nga qershori deri në nëntor. Në zonat më të ftohta, individët e fundit mund të migrojnë dhe të dimërojnë në rajone më të ngrohta, duke u rikthyer në pranverë. Vezët vendosen veç e veç mbi bimët me të cilat lloji ushqehet dhe larvat zhvillohen në mënyrë të vetmuar, duke kaluar disa stade deri në pupacion. *Vanessa atalanta* banon në një gamë shumë të gjerë habitatesh, duke përfshirë pyje, livadhe, zona urbane, kopshte dhe skaje shkurresh, nga niveli i detit deri në zona malore. Larvat ushqehen kryesisht me *Urtica dioica* (hithra), ndërsa të rriturit ushqehen me nektar lulesh, fruta të pjekura dhe lëngje pemësh.
Në Shqipëri, specia është e përhapur dhe relativisht e shpeshtë në të gjithë territorin, me prani si në zona urbane ashtu edhe natyrore. Në rang më të gjerë lloji ka shpërndarje shumë të gjerë në Evropë dhe Azi (duke përfshirë Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazinë dhe Kaukazin), duke qenë gjithashtu një specie migratore e njohur. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Vanessa cardui*/Painted Lady**
Shtegëtarja
Nymphalidae – Nymphalinae





***Vanessa cardui*, dhe harta e shpërhapjes**

Vanessa cardui është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 27–30 mm. Ana e sipërme ka ngjyrim portokalli në rozë të ndezur, e ndërprerë nga njolla dhe shirita të zinj të theksuar, si dhe njolla të bardha në pjesën e sipërme të krahut të përparmë. Ky model i jep një pamje

shumë karakteristike dhe të dallueshme nga fluturat e ngjashme. Ana e poshtme e flatrave është më e zbehtë, në nuanca kafe dhe gri me model kompleks, i përshtatur për kamuflim kur pushon.
Specia zakonisht ka dy deri në tre brezni të vazhdueshme në vit, me të rritur që shfaqen nga marsi deri në fillim të dhjetorit. Specia është migratore. Në rajonet mesdhetare, larvat dimërojnë si vemje. Të rriturit mund të shfaqen nga pranvera e hershme deri në vjeshtë, në varësi të kushteve klimatike dhe flukseve migratore. Vezët vendosen veç e veç mbi bimët ushqyese dhe larvat zhvillohen në mënyrë të vetmuar, duke kaluar disa stade deri në pupacion relativisht të shpejtë. *Vanessa cardui* banon në një gamë shumë të gjerë habitatesh, përfshirë livadhe, zona të hapura, shkurre, toka bujqësore dhe hapësira urbane. Larvat ushqehen kryesisht me bimë të familjes Asteraceae, si *Cirsium* spp., *Carduus* spp., dhe *Malva* spp., ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga një shumëllojshmëri e gjerë lulesh.
Në Shqipëri, specia është e përhapur gjerësisht në të gjithë territorin. Në rang më të gjerë ka shpërndarje në Evropë dhe Azi, duke përfshirë Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazinë dhe Kaukazin, si dhe më tej në lindje. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Aphantopus hyperantus*/Ringlet**
Hiperantia
Nymphalidae – Satyrinae





***Aphantopus hyperantus*, dhe harta e shpërhapjes**

Aphantopus hyperantus është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 20–24 mm. Ana e sipërme është ngjyrë kafe e errët uniforme, shpesh me njolla të vogla okër ose portokalli dhe disa “sy” (oceli) të errët në krahët e pasmë, të cilët shërbejnë si mekanizëm mbrojtës ndaj grabitqarëve. Femrat janë zakonisht pak më të mëdha dhe me njolla më të

theksuara, ndërsa meshkujt kanë ngjyrë më të errët dhe më uniforme. Ana e poshtme e krahëve është kafe në gri, me një pamje më të zbehtë dhe me ocelë të vegjël të errët në krahët e pasmë, të cilët ndihmojnë në kamuflim kur flutura pushon në bimësi të dendur.
Specia ka një brez në vit, me të rritur që shfaqen nga fundi i qershorit deri në fillim të gushtit. Vezët vendosen veç e veç mbi barishtet ushqyese dhe larvat dimërojnë në stadin L3. *Aphantopus hyperantus* banon në livadhe të lagështa dhe gjysmë të lagështa, skaje pyjesh, shkurre dhe zona me bar të dendur, zakonisht në zona të freskëta dhe me lagështi mesatare. Larvat ushqehen kryesisht me barishte të familjes Poaceae, ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga lule të ndryshme livadhore.
Në Shqipëri, specia është e përhapur në mënyrë të lokalizuar, kryesisht në zona veriore dhe malore me livadhe të lagështa. Në Evropë ka shpërndarje të gjerë, sidomos në rajonet qendrore dhe veriore. Specia ka statusin VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe Evropiane, sipas IUCN-së.

***Arethusana arethusa*/False Grayling**
Aretusa
Nymphalidae – Satyrinae





***Arethusana arethusa*, dhe harta e shpërhapjes**

Arethusana arethusa është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 22–24 mm. Ana e sipërme është ngjyrë kafe e hapur në gri-kafe, me nuanca të buta dhe shpesh me një brez të errët postdiskal dhe disa ocelë (sy) të vegjël në krahët e pasmë. Pamja e përgjithshme është më e zbehtë

dhe më e "thatë" krahasuar me shumë *Satyrinae* të tjera, gjë që e ndihmon në kamuflim në habitatet e thata. Femrat janë zakonisht pak më të mëdha dhe me ngjyrë më të errët, ndërsa meshkujt kanë ton më uniform. Ana e poshtme e krahëve është ngjyrë kafe e çelur deri në gri, me vija të holla dhe ocelë të vegjël të errët, të cilët ndihmojnë në prishjen e siluetës kur flutura pushon mbi barishte të thata.
Specia ka një brez në vit, me të rritur që shfaqen nga korriku deri në shtator. Vezët vendosen veç e veç mbi barishtet ushqyese dhe larvat dimërojnë si larva shumë të vogla në tufëza bari të shkurtër. *Arethusana arethusa* banon në livadhe të thata, kullota stepike, kodrina të thata dhe zona me vegjetacion të ulët, shpesh në terrene me diell dhe tokë të varfër. Larvat ushqehen kryesisht me barishte të familjes Poaceae, ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga lule të ndryshme livadhore.
Në Shqipëri specia është lokale, nuk është regjistruar në Alpet e Veriut të Shqipërisë, por ndoshta është më e përhapur në zonat malore (kërkohen studime të mëtejshme). Në Evropë ka shpërndarje të gjerë, por të fragmentuar, sidomos në rajonet jugore dhe lindore. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Brintesia circe*/Great Banded Grayling**
Brintesia
Nymphalidae – Satyrinae





***Brintesia circe*, dhe harta e shpërhapjes**

Brintesia circe është një flutur e madhe, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 33–36 mm. Ana e sipërme e krahëve ka ngjyrë bazë të zezë, e karakterizuar nga një brez i gjerë i bardhë postdiskal. Në krahët e përparmë gjendet një ocel i zi apikal, ndërsa ana e poshtme paraqet ngjyrim gri në të zi me brez të gjerë të

bardhë postdiskal, më pak të rregullt në krahët e pasmë. Femrat janë më të mëdha se meshkujt, por në pjesën tjetër paraqesin tipare të ngjashme.
Specia ka një brezni të vetme në vit, me të rritur që shfaqen nga qershori deri në fillim të shtatorit. Vezët kanë një stad të shkurtër zhvillimi, ndërsa larvat dimërojnë në stad të hershëm. *Brintesia circe* banon në një gamë të gjerë livadhesh të thata me terren guror dhe me shkurre ose pemë të shpërndara, si edhe në pyje të rralla dhe skaje pyjesh, nga ultësirat deri në 1600 m lartësi mbidetare. Larvat ushqehen kryesisht me barishte të familjes Poaceae, ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga lule të ndryshme livadhore.
Në Shqipëri specia është e përhapur gjerësisht. Në Evropë ka shpërndarje të gjerë. Gjendet gjithashtu në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi, Kaukaz dhe më tej në lindje. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Chazara briseis*/Hermit**
Briseida
Nymphalidae – Satyrinae





***Chazara briseis*, dhe harta e shpërhapjes**

Chazara briseis është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 21–30 mm (♂♂) dhe 28–34 mm (♀♀). Ana e sipërme ka ngjyrë bazë të zezë, me një brez të gjerë të bardhë postdiskal. Ana e poshtme e krahut të përparmë paraqet një ocel të zi apikal. Ana e poshtme ka ngjyrë bazë gri në të

zezë, me një brez të gjerë të bardhë postdiskal, më pak të rregullt në krahët e pasmë.
Specia ka një brez në vit, me të rritur që shfaqen nga mesi i qershorit deri në shtator. Vezët kanë një stad të shkurtër zhvillimi, ndërsa larvat dimërojnë si larva të vogla. Pupacioni është i shkurtër. *Chazara briseis* banon në livadhe të thata, kullota stepike, zona shkëmbore dhe kodrina me vegjetacion të ulët, zakonisht në terrene të ekspozuara ndaj diellit dhe me tokë të varfër. Larvat ushqehen kryesisht me barishte të familjes Poaceae, ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga lule të ndryshme të zonave të thata.
Në Shqipëri specia është e lokalizuar dhe nuk është regjistruar në Alpet e Veriut të Shqipërisë, por ndoshta është më e përhapur në zonat malore (kërkohen studime të mëtejshme). Në Evropë ka shpërndarje të gjerë, por të fragmentuar, veçanërisht në rajonet jugore dhe lindore. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

Coenonympha arcani/Pearly Heath
Arkania
Nymphalidae – Satyrinae





***Coenonympha arcania*, dhe harta e shpërhapjes**

Coenonympha arcani është një flutur me madhësi të vogël deri mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 17–20 mm. Ana e sipërme është me ngjyrë bazë të verdhë-portokalli, me një brez të gjerë të errët marginal. Femrat janë zakonisht pak më të mëdha dhe me ngjyrë më të zbehtë, ndërsa meshkujt kanë

tonalitet të ngjyrimit më të ngrohtë dhe më uniform. Ana e poshtme e krahëve ka ocelë me unaza të jashtme të verdha-portokalli dhe të zeza, një brez të bardhë të dhëmbëzuar dhe një vijë metalike submargjinale.
Specia ka një brez në vit, me të rritur që shfaqen nga qershori deri në gusht. Vezët kanë një stad të shkurtër zhvillimi, ndërsa larvat dimërojnë si larva L4, të fshehura në tufat e barit ushqyes. Pupacioni zgjat 10–19 ditë. *Coenonympha arcania* banon në livadhe me lule me shkurre ose pemë të shpërndara, nga 300 deri në 1700 m lartësi mbidetare. Larvat ushqehen kryesisht me barishte të familjes Poaceae, ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga lule të ndryshme livadhore.
Në Shqipëri specia është e përhapur në zonat malore. Në Evropë ka shpërndarje të gjerë, sidomos në rajonet qendrore dhe jugore. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

Coenonympha leander/Russian Heath
Leandra
Nymphalidae – Satyrinae






***Coenonympha leander*, dhe harta e shpërhapjes**

Coenonympha leander është një flutur e vogël deri mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 18–20 mm. Ana e sipërme është kafe në gri-kafe, shpesh uniforme, me ocelë shumë të vegjël ose të reduktuar në krahët e pasmë. Femrat janë zakonisht pak më të mëdha dhe me ngjyrë më të zbehtë, ndërsa meshkujt

kanë ton më të errët dhe më uniform. Ana e poshtme është karakteristike: krahët e përparmë janë portokalli në kafe me një ocel të dukshëm, ndërsa krahët e pasmë janë gri në të bardhë me një brez submarginal të errët dhe ocelë të vegjël të rrethuar me të bardhë.
Specia ka një brez në vit, me të rritur që shfaqen nga fundi i majit deri në korrik, në varësi të lartësisë. Vezët kanë një stad të shkurtër zhvillimi, ndërsa larvat dimërojnë në stad gjysmë të rritur. Pupacioni është i shkurtër. *Coenonympha leander* banon në shpatet me bar të ngrohta me lule, me shkurre të shpërndara dhe në skajet e pyjeve, nga 500 deri në 1700 m lartësi mbidetare. Larvat ushqehen kryesisht me barishte të familjes Poaceae, ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga lule të ndryshme livadhore.
Në Shqipëri është shumë lokale. Në Evropë ka shpërndarje të gjerë por të fragmentuar, sidomos në rajonet jugore dhe lindore të kontinentit. Specia ka statusin VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe Evropiane, sipas IUCN-së.

***Coenonympha orientalis*/Oriental Heath**
Orjentalja
Nymphalidae – Satyrinae





***Coenonympha orientalis*, dhe harta e shpërhapjes**

Coenonympha orientalis është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 15–16 mm. Ana e sipërme e flatrave është kafe në gri-kafe, zakonisht uniforme dhe me pak kontrast, me ocelë të vegjël ose të reduktuar në krahët e pasmë. Femrat janë zakonisht pak më të mëdha dhe me ngjyrë më të

zbehtë, ndërsa meshkujt kanë ton më të errët dhe më uniform. Ana e poshtme është karakteristike: krahët e përparmë kanë nuanca portokalli në kafe me një ocel të vogël, ndërsa krahët e pasmë janë gri në të bardhë me një brez të bardhë të rregullt dhe ocelë pa unaza të jashtme verdhë-portokalli dhe të zeza.
Specia zakonisht ka një brez në vit, me të rritur që shfaqen nga maji deri në korrik, në varësi të lartësisë. Vezët vendosen veç e veç mbi barishtet ushqyese dhe larvat dimërojnë si gjysmë të rritura (hibernating larva). Pupacioni është i shkurtër. *Coenonympha orientalis* banon në livadhe gëlqerore me Juniperus të shpërndarë, nga 1000 deri në 2000 m lartësi mbidetare. Larvat ushqehen kryesisht me Brachypodium sylvaticum dhe Festuca ovina, ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga lule të ndryshme të ulëta.
Në Shqipëri është lokale (kërkohen studime të mëtejshme). Në Ballkan ka shpërndarje të kufizuar dhe të fragmentuar. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet në kategorinë VU, ndërsa në Listën e Kuqe të IUCN-së në nivel Evropian renditet në kategorinë NT B2b (iii,v).

***Coenonympha pamphilus*/Small Heath**
Pamfilia
Nymphalidae – Satyrinae





***Coenonympha pamphilus*, dhe harta e shpërhapjes**

Coenonympha pamphilus është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 14–16 mm. Ana e sipërme është bright yellow-orange, me një brez të vogël marginal dhe një ocel të vogël apikal gri në krahët e përparmë. Femrat janë zakonisht pak më të mëdha. Ana e poshtme është gri-kafe uniforme,

me një brez submarginal pak më të zbehtë dhe me një vijë metalike antemargjinale.
Specia ka deri në tre brezni në vit (në varësi të lartësisë), nga prilli deri në tetor. Vezët kanë një stad të shkurtër zhvillimi dhe larvat dimërojnë në stade të ndryshme. *Coenonympha pamphilus* banon në një gamë shumë të gjerë livadhesh me lule nga niveli i detit deri në 2000 m lartësi mbidetare, rrallë më lart. Larvat ushqehen kryesisht me barishte të familjes Poaceae, ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga një shumëllojshmëri lulesh në vegjetacionin barishtor. Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht.
Në Evropë ka shpërndarje shumë të gjerë dhe është një nga speciet më të zakonshme. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Coenonympha rhodopensis*/Eastern Large Heath**
Rodopensis
Nymphalidae – Satyrinae





***Coenonympha rhodopensis*, dhe harta e shpërhapjes**

Coenonympha rhodopensis shtë një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 16–19 mm. Ana e sipërme është portokalli në okër me brez margjinal gri më të gjerë dhe shpesh me njollë të vogël bazale të errët. Oceli apikal mungon ose është i paqartë. Femrat janë zakonisht pak më të mëdha dhe me ngjyrë më të zbehtë, ndërsa meshkujt kanë tonalitet më të errët dhe më

uniform. Ana e poshtme e krahëve është portokalli në të verdhë, me një ocel apikal të zi me pupil të bardhë dhe unazë të verdhë. Krahët e pasmë janë gri-kafe me një pikë të bardhë diskoidale të larguar nga kosta në s4–s5 dhe me ocelë submarginalë shpesh të zhvilluar mirë.
Specia zakonisht ka një brez në vit, me të rritur që shfaqen nga qershori deri në korrik. Vezët vendosen veç e veç mbi barishtet ushqyese dhe larvat dimërojnë në stad larval. Pupacioni është i shkurtër. *Coenonympha rhodopensis* banon në livadhe malore me lule nga 900 deri në 2500 m lartësi mbidetare. Larvat ushqehen kryesisht me Festuca sp. dhe Sesleria sp., ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga lule të ndryshme të vegjetacionit barishtor.
Në Shqipëri është e përhapur në mënyrë të lokalizuar në zonat malore. Në Ballkan ka shpërndarje të kufizuar dhe të fragmentuar. Kjo specie në Listën e Kuqe të Shqipërisë ka statusin NE, edhe në nivelin Evropian sipas IUCN-së është klasifikuar si LC.

***Erebia aethiops*/Scotch Argus**
Zijoshja aethiops
Nymphalidae – Satyrinae





***Erebia aethiops*, dhe harta e shpërhapjes**

Erebia aethiops është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 22–26 mm. Ana e sipërme është kafe e errët deri në të zezë, me ocelë të vegjël portokalli të rrethuar me të zezë në krahët e përparmë dhe ndonjëherë edhe në krahët e pasmë. Femrat janë zakonisht pak më të mëdha

dhe mund të kenë ocelë më të theksuar, ndërsa meshkujt janë më uniformë dhe më të errët. Ana e poshtme e flatrave është gri-kafe më e çelët, me ocelë të vegjël të errët dhe një brez të zbehtë postdiskal. Kontrasti i ulët e bën të vështirë dallimin kur pushon në vegjetacion.
Specia zakonisht ka një brez në vit, me të rritur që shfaqen nga korriku deri në shtator. Vezët vendosen veç e veç mbi barishtet ushqyese dhe larvat dimërojnë në stad larval. Pupacioni ndodh i fshehur në vegjetacion të ulët dhe zgjat pak. *Erebia aethiops* banon në livadhe të lagështa dhe gjysmë të lagështa, skaje pyjesh dhe zona me bar të dendur, shpesh në terrene kodrinore dhe malore me klimë të freskët.
Larvat ushqehen kryesisht me barishte të familjes Poaceae, ndërsa të rriturit ushqehen me nektar nga lule të ndryshme livadhore.
Në Shqipëri, specia është e pranishme në mënyrë të lokalizuar, kryesisht në zona veriore dhe malore me livadhe të freskëta dhe të lagështa. Në Evropë ka shpërndarje të gjerë, sidomos në rajonet qendrore, veriore dhe alpine. Popullatat lokale mund të ndikohen nga ndryshimet klimatike dhe degradimi i livadheve natyrore. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Erebia alberganus*/Almond-eyed Ringlet**
Unazka e bajames
Nymphalidae–Satyrinae





***Erebia alberganus*, dhe harta e shpërhapjes**

Erebia alberganus është flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 20–22 mm. Ana e sipërme është kafe e errët, me njolla heshtake të zgjatura portokalli-të kuqe që përfshijnë ocelë me pupilë të bardhë në s2, s4 dhe s5 (ndonjëherë edhe të tjera) në upf dhe s1 deri s5 në uph. Femrat janë zakonisht pak më të mëdha dhe mund të kenë ocelë më të theksuar, meshkujt janë më të errët dhe më uniformë. Ana e poshtme është me ngjyrim gri-kafe në kafe të çelur, me

ocelë të vegjël dhe një brez të zbehtë që ndihmon në kamuflim në mjedise me barishte të dendura dhe hije. Ky model i flatrave nga ana e poshtme e tyre është i rëndësishëm për fshehjen e fluturës në habitatet alpine dhe subalpine. Specia zakonisht ka një brez në vit, me të rritur që shfaqen nga qershori deri në korrik. Vezët vendosen veç e veç mbi barishtet ushqyese dhe larvat zhvillohen ngadalë, duke kaluar dimërimin në stad larval dhe duke përfunduar zhvillimin në pranverën e vitit pasardhës. Pupa qëndron fshehur në vegjetacion të ulët dhe zgjat pak ditë. *Erebia alberganus* banon në livadhe alpine të lagështa me lule të shumta nga 1000 deri në 2000 m mbi nivelin e detit. Larvat ushqehen me *Festuca ovina*, *Anthoxanthum odoratum* dhe *Poa annua*. Fluturat ushqehen me një shumëllojshmëri lulesh. Në Shqipëri e njohur nga një regjistrim në Alpet, të cilat janë në kufirin juglindor të zonës së saj të përndarjes në Gadishullin Ballkanik. Në Ballkan e përhapur në shumicën e vendeve të rajonit, përfshirë zonat perëndimore, qendrore dhe juglindore të tij. Në Evropë shpërndarje të gjerë në rajonet perëndimore, alpinë, veriore, veriperëndimore dhe lindore të kontinentit. Nuk është e pranishme në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi, Kaukaz dhe zonat më lindore. Nuk konsiderohet globalisht e rrezikuar, por është e ndjeshme ndaj ndryshimeve klimatike dhe humbjes së habitateve alpine. Specia renditet në Listën e Kuqe të Shqipërisë me statusin NE, edhe në nivelin Evropian sipas IUCN-së është klasifikuar si LC.

***Erebia cassioides*/Common Brassy Ringlet**

Zioshja kasiodes

Nymphalidae – Satyrinae





***Erebia cassioides*, dhe harta e shpërhapjes**

Erebia cassioides është flutur me madhësi të vogël, me gjatësi të flatrave të përparme 16–19 mm. Ana e sipërme kafe e errët në të zezë, me reflektime metalike të gjelbërta. Krahu i përparmë ka majë të theksuar, me një brez të shkurtër ngjyrë kafe të çelur që nuk hyn në qelizë dhe përfshin dy ocelë subapikalë me pupilë të bardhë. Krahu i pasmë në anën e sipërme ka tre ocelë të zhvilluar mirë me pupilë të bardhë, të rrethuar nga

njolla kafe të çelura. Ana e poshtme e krahëve është gri, me një brez diskal më të errët të përcaktuar qartë nga vija tërthore kafe të errët. Femrat janë me madhësi të ngjashme, me ngjyrim më të çelur dhe shenja më të zbehta. Ana e poshtme është gri deri në gri të verdhë, e spërkatur me luspa më të errëta, ndonjëherë me një brez diskal më të errët kontrastues. Specia është e vështirë për t'u identifikuar, në raste dyshimi, rekomandohet përdorimi i genitalieve të meshkujve. Të rriturit shfaqen në një brez të vetëm nga korriku deri në fillim të shtatorit. Veza ka stad të shkurtër. Larva dimëron si larvë e re. Pupa ka stad të shkurtër. *Erebia cassioides* banon në kullota alpine nga 1800 deri në 2500 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore shumë të vogla dhe mundësi për dendësi të lartë popullatash. Larvat ushqehen kryesisht me *Festuca ovina*, *F. rubra* dhe *F. violacea*, si dhe me *Nardus* dhe *Sesleria*. Fluturat ushqehen me një shumëllojshmëri lulesh të ulëta alpine. Në Shqipëri shumë lokale në veri të vendit. Në Ballkan është e pranishme në Shqipëri, Bullgari, Bosnjë dhe Hercegovinë, Greqi, Kroaci, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Kosovë, Rumani, Slloveni dhe Serbi. Në Evropë gjendet në Gadishullin Iberik, Itali, Alpe, rajonin balltik, Evropën Veriperëndimore, Mbretërinë e Bashkuar, Skandinavi dhe Evropën Lindore. Nuk është e pranishme në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi, Kaukaz dhe më në lindje. Specia renditet bazuar në kriteret e IUCN–së, në listen e Kuqe Evropiane, në kategorinë LC, ndërkohë që Listën e Kuqe të Shqipërisë lloji klasifikohet në kategorinë DD.

***Erebia epiphron*/Mountain Ringlet**
Zijoshja epifron
Nymphalidae – Satyrinae





***Erebia epiphron*, dhe harta e shpërhapjes**

Erebia epiphron është një flutur me madhësi të vogël, me gjatësi të flatrave të përparme 17–18 mm. Ana e sipërme është kafe e errët. Krahu i përparmë ka majë të theksuar, me një brez postdiscal të kuq që përfshin ocelë të verbër, i ndryshueshëm nga s2 deri në s5. Krahu i pasmë ka një brez postdiscal të reduktuar që përfshin pika të vogla të zeza. Ana e poshtme është kafe, pothuajse pa shenja, rrallë me pika të vogla të errëta. Femrat janë pak më të mëdha dhe pak më të shënuara në anën e sipërme, ndërsa ana e poshtme është kafe më e çelur. Speciet e ngjashme përfshijnë Erebia të tjera, të cilat janë të gjitha më të

mëdha dhe nuk kanë modelin karakteristik me ocelë të verbër në brez portokalli postdiscal. As në krahët e përparmë, as në të pasëm, dhe as në anën e poshtme nuk shfaqet ky model. Të rriturit shfaqen në një brez të vetëm nga fundi i qershorit deri në gusht. Veza ka stad të shkurtër. Larva dimëron dhe shpesh kërkon dy vite për zhvillim. Pupa ka stad të shkurtër. Erebia epiphron banon në një shumëllojshmëri të gjerë habitatesh subalpine dhe alpine, si në zona të thata ashtu edhe në zona më të lagështa shkëmbore, nga 1500 deri në 2300 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore modeste dhe dendësi shpesh të lartë popullatash. Larvat ushqehen kryesisht me Nardus stricta, Festuca airoides, Festuca ovina, Festuca rubra, Festuca valesiaca dhe Festuca violacea, si dhe me Carex praecox, Danthonia decumbens, Deschampsia cespitosa dhe Poa annua. Fluturat ushqehen me lule alpine, shpesh Arnica. Në Shqipëri është regjistruar vetëm në veri të vendit. Në Ballkan është e pranishme në Shqipëri, Bullgari, Bosnjë dhe Hercegovinë, Greqi, Kroaci, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Kosovë, Rumani, Slloveni dhe Serbi. Në Evropë gjendet në Gadishullin Iberik, Itali, Alpe, rajonin balltik, Evropën Veriperëndimore, Mbretërinë e Bashkuar, Skandinavi dhe Evropën Lindore. Nuk është e pranishme në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi, Kaukaz dhe më në lindje. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet në kategorinë VU, ndërsa në Listën e Kuqe të IUCN-së në nivel Evropian renditet në kategorinë LC.

***Erebia euryale*/Large Ringlet**
Zijoshja eurialë
Nymphalidae – Satyrinae





***Erebia euryale*, dhe harta e shpërhapjes**

Erebia euryale është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 21–23 mm. Ana e sipërme është kafe e errët në të zezë, me breza postdiscalë të kuq që përfshijnë ocelë të vegjël, zakonisht pa pupilë të bardhë; krahu i përparmë nuk ka seks-brend. Ana e poshtme është kafe e kuqërremtë, me brez submargjinal të zbehtë, të bardhë në të verdhë, dhe pak ocelë të vegjël, shpesh të verbër. Femrat janë kafe më të errëta, me breza postdiscalë të verdhë në të kuq dhe numër të ndryshueshëm ocelësh. Speciet më të ngjashme janë

Erebia aethiops, *E. ligea* dhe *E. pronoe*, të cilat dallohen kryesisht nga prania e seks-brendit, modeli i brezave postdiscalë, ocelët dhe skajet e krahëve. Identifikimi mbështetet në kombinimin e disa karaktereve dhe, në raste të dyshimta, në genitaliet e meshkujve. Të rriturit shfaqen në një brez të vetëm nga korriku deri në gusht. Veza dhe pupa kanë stade të shkurtra, ndërsa larva dimëron dhe shpesh kërkon dy vite për zhvillim.
Erebia euryale banon në habitate të hapura dhe të lagështa, livadhe, skaje pyjesh dhe shpate me pemë të shpërndara, shpesh halorë, me kërkesa hapësinore modeste dhe dendësi të lartë popullatash. Larvat ushqehen kryesisht me *Carex flacca, C. ferruginea, C. sempervirens, Calamagrostis varia, Festuca airoides, F. ovina, F. rubra, Poa nemoralis, Sesleria caerulea* dhe *Milium effusum*, si dhe me barishte të tjera, ndërsa të rriturit ushqehen me lule të ndryshme, shpesh *Arnica*.
Në Shqipëri është regjistruar vetëm në veri të vendit, ndërsa në Ballkan është e përhapur në pjesën më të madhe të rajonit. Në Evropë ka shpërndarje të gjerë në zonat perëndimore, qendrore, veriore dhe lindore, përfshirë rajonet alpine dhe subalpine, por mungon në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi, Kaukaz dhe më në lindje. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet në kategorinë **NE**, ndërsa në nivel Evropian sipas IUCN-së renditet në kategorinë **LC**.

***Erebia gorge*/Silky Ringlet**
Zijosha gorge
Nymphalidae – Satyrinae





***Erebia gorge*, dhe harta e shpërhapjes**

Erebia gorge është një flutur me madhësi të vogël, me gjatësi të flatrave të përparme 17–20 mm. Ana e sipërme është kafe e errët në të zezë. Krahu i përparmë ka brez postdiscal portokalli-të kuq me ocelë shumë të vegjël, ndonjëherë të munguar, me unazë të bardhë dhe pupilë të zezë (deri në dy), ndërsa krahu i pasmë është pothuajse i pashënuar. Ana e poshtme e krahut të përparmë ka një zonë të madhe bazale portokalli-të kuqe që shtrihet deri në zonën submargjinale, ndërsa krahu i pasmë ka model pak të dukshëm. Femrat

janë pak më të mëdha dhe më të çelura, me brez postdiscal portokalli-të kuq më të zbehtë dhe dy ocelë të mëdhenj të zinj me pupilë të bardhë, ndonjëherë edhe një të tretë më të vogël; ana e poshtme e krahut të pasmë është më e çelur, me brez postdiscal më të zbehtë. Specia e ngjashme është *Erebia rhodopensis*, e cila është pak më e madhe, banon në livadhe alpine dhe dallohet nga seks-brendi në krahun e përparmë, ocelët apikalë të bardhë të lidhur me ocelët përgjatë skajit të jashtëm, brezi diskal i errët në anën e poshtme dhe brezi i errët submargjinal. Të rriturit shfaqen në një brez të vetëm nga korriku deri në gusht. Veza dhe pupa kanë stade të shkurtra, ndërsa larva zhvillohet për dy vite, duke dimëruar vitin e parë si larvë e vogël dhe të dytin si larvë pothuajse e rritur. *Erebia gorge* banon në morena dhe shpate shkëmbore në lartësi 1700–2600 m, me kërkesa hapësinore modeste dhe dendësi të ulët popullatash. Larvat ushqehen me *Poa alpina, P. annua, P. minor, Festuca airoides, F. halleri, F. violacea* dhe *Sesleria caerulea*, ndërsa të rriturit me lule alpine pranë morenave dhe shpateve shkëmbore, shpesh *Arnica*. Në Shqipëri është shumë lokale në veri, me një popullatë të izoluar në Malin e Tomorrit, ndërsa në Ballkan është e përhapur në pjesën më të madhe të rajonit. Në Evropë ka shpërndarje të gjerë në zonat perëndimore, qendrore, veriore dhe lindore, përfshirë rajonet alpine dhe zonat kodrinore e malore, por mungon në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi, Kaukaz dhe më në lindje. Në Listën e Kuqe Evropiane sipas IUCN-së klasifikohet në kategorinë **LC**, ndërsa në Listën e Kuqe të Shqipërisë në kategorinë **NT**.

***Erebia ligea*/Arran Brown**
Zijoshja kafe
Nymphalidae – Satyrinae





***Erebia ligea*, dhe harta e shpërhapjes**

Erebia ligea është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 24–27 mm. Ana e sipërme është kafe e errët në të zezë, me skaje të alternuara bardh e zi dhe brez postdiscal portokalli-të kuq me 3–4 ocelë të qartë me pupilë të bardhë. Krahu i përparmë ka seks-brend, ndërsa i pasmi ka tre

ocelë të qartë. Ana e poshtme e krahut të pasmë karakterizohet nga një vijë e bardhë e dukshme nga kosta deri në s5, që mund të shoqërohet me shenja të bardha submargjinale dhe ocelë postmarginalë të zhvilluar mirë. Femrat janë pak më të mëdha dhe më të errëta, me breza postdiscalë më të çelur dhe vijë të bardhë më të gjatë e më të gjerë në anën e poshtme. Speciet e ngjashme janë *Erebia aethiops, E. euryale* dhe *E. pronoe*, të cilat dallohen kryesisht nga seks-brendi, skajet e krahëve, brezi postdiscal dhe numri e zhvillimi i ocelëve. Identifikimi bëhet më mirë duke kombinuar disa karaktere dhe, në raste të dyshimta, rekomandohet përdorimi i genitalieve të meshkujve. Të rriturit shfaqen në një brez të vetëm nga fundi i qershorit deri në mes të gushtit. Veza dimëron në vitin e parë, larva në vitin e dytë në stadin L3, ndërsa pupa zgjat 13–20 ditë. *Erebia ligea* banon në pyje të lehta me bredh, në zona kodrinore në lartësi 800–2000 m, me kërkesa hapësinore modeste dhe dendësi të lartë popullatash. Larvat ushqehen me *Deschampsia cespitosa, Festuca rubra, Molinia caerulea* dhe *Sieglingia decumbens*, si dhe me barishte të tjera, ndërsa të rriturit ushqehen me lule të ndryshme, shpesh *Arnica*. Në Shqipëri është lokale dhe kërkon kërkime të mëtejshme, ndërsa në Ballkan është e përhapur në pjesën më të madhe të vendeve të rajonit. Në Evropë ka shpërndarje të gjerë në zonat perëndimore, qendrore, veriore dhe lindore, përfshirë rajonet alpine dhe pyjet e freskëta, por mungon në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi, Kaukaz dhe më në lindje. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet në kategorinë **NE**, ndërsa në nivel Evropian sipas IUCN-së në kategorinë **LC**.

***Erebia medusa*/Woodland Ringlet**
Zijoshja e pyllit
Nymphalidae – Satyrinae





***Erebia medusa*, dhe harta e shpërhapjes**

Erebia medusa është flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 23–25 mm. Ana e sipërme është kafe e errët në të zezë, me ocelë me pupilë të bardhë në një brez pothuajse të bashkuar. Krahu i përparmë ka brez të ndërprerë në v3, me ocelë më të mëdhenj në s4–s5 dhe më të vegjël në s2, rrallë edhe në s1b dhe s6, ndërsa krahu i pasmë ka 3–4 ocelë pak më të vegjël. Ana e poshtme është kafe më e çelur, me shenja të ngjashme dhe ocelë më të

vegjël në krahun e pasmë. Femrat janë pak më të mëdha dhe kanë ocelë më të mëdhenj në anën e poshtme, me pupilë më pak të ndritshëm. Specia e ngjashme është *Erebia oeme*, e cila është pak më e vogël dhe dallohet nga brezi i rregullt submargjinal në krahun e përparmë dhe ocelët më të mëdhenj me pupilë të bardhë të ndritshëm në krahun e pasmë; megjithatë, dallimi nga format e vogla të *E. medusa* në lartësi të mëdha mund të jetë i vështirë. Në raste dyshimi rekomandohet përdorimi i genitalieve të meshkujve. Të rriturit shfaqen në një brez të vetëm nga fundi i majit deri në fillim të gushtit, në varësi të lartësisë. Veza zgjat 10–16 ditë, larva dimëron si larvë gjysmë e rritur dhe pupa zgjat 17–23 ditë. *Erebia medusa* banon në livadhe të lagështa, kullota të hapura me bar dhe pyje të lehta, në lartësi 500–2500 m, me kërkesa hapësinore modeste dhe dendësi të lartë popullatash. Larvat ushqehen kryesisht me *Carex nigra, C. praecox, Brachypodium pinnatum, Festuca ovina, F. rubra, Phleum pratense* dhe *Molinia caerulea*, si dhe me barishte të tjera, ndërsa të rriturit ushqehen me lloje të ndryshme lulesh. Në Shqipëri është e përhapur në Alpet dhe lokale në zona të tjera malore, në Ballkan e pranishme në pjesën më të madhe të rajonit. Në Evropë ka shpërndarje të gjerë në zonat perëndimore, qendrore dhe lindore, përfshirë rajonet alpine dhe zonat e hapura me bar; në Skandinavi zëvendësohet nga *Erebia polaris*. Gjendet gjithashtu në Azinë e Vogël, Transkaukazi, Kaukaz dhe më në lindje. Specia klasifikohet në kategorinë **LC** si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në Listën e Kuqe të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Erebia melas*/Black Ringlet**

Zijoshja melas

Nymphalidae – Satyrinae





***Erebia melas*, dhe harta e shpërhapjes**

Erebia melas është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 21–24 mm. Ana e sipërme është ngjyrë e zezë me reflektime metalike dhe shpesh ka dy ocelë apikalë me pupilë të bardhë, të cilët janë të ndryshueshëm. Krahu i pasmë në anën e sipërme ka ocelë më pak të shënuar

ose të munguar. Ana e poshtme është e ngjashme me anën e sipërme. Femrat kanë ngjyrim më të çelur dhe janë më të shënuara me ocelë. Krahu i përparmë rrallë mund të ketë një brez të zbehtë të kuqërremtë. Ana e poshtme është kafe me nuanca më të çelura dhe e mermerizuar, ndonjëherë me një brez postdiscal më të qartë. Specie të ngjashme janë Erebia të tjera, por në asnjë prej tyre nuk ka ngjyrim bazë të zi. Të rriturit shfaqen në një brez të vetëm nga korriku deri në shtator. Veza ka stad të shkurtër. Larva dimëron si larvë e vogël. Pupa ka stad të shkurtër. *Erebia melas* banon në shpate shkëmbore dhe terrene të thepisura nga 1200 deri në 2100 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore modeste dhe dendësi popullatash mesatare. Larvat ushqehen me Festuca ovina. Fluturat ushqehen me lule të disponueshme, shpesh Arnica. Në Shqipëri është lokale në zonat malore. Në Ballkan është e përhapur në pjesën më të madhe të rajonit. Në Evropë ka shpërndarje të gjerë në zonat perëndimore, qendrore, veriore dhe lindore, përfshirë rajonet alpine dhe zonat shkëmbore malore. Nuk është e pranishme në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi, Kaukaz dhe më në lindje. Specia renditet bazuar në kriteret e IUCN–së, në listen e Kuqe Evropiane, në kategorinë NT B2b (iii,iv), ndërkohë që në Listën e Kuqe të Shqipërisë lloji klasifikohet në kategorinë LC.

***Erebia oeme*/Bright-eyed Ringlet**
Zijoshja njollaçift
Nymphalidae – Satyrinae





***Erebia oeme*, dhe harta e shpërhapjes**

Erebia oeme është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 21–24 mm. Ana e sipërme është ngjyrë e zezë me reflektime metalike dhe shpesh ka dy ocelë apikalë me pupilë të bardhë, të cilët janë të ndryshueshëm. Krahu i pasmë në anën e sipërme ka ocelë më pak të shënuar ose të munguar. Ana e poshtme është e ngjashme me anën e sipërme. Femrat kanë ngjyrim më të çelur dhe janë më të shënuara me ocelë. Krahu i përparmë rrallë mund të ketë një brez të zbehtë të kuqërremtë. Ana e poshtme është kafe

me nuanca më të çelura dhe e mermerizuar, ndonjëherë me një brez postdiscal më të qartë. Specie të ngjashme janë Erebia të tjera, por në asnjë prej tyre nuk ka ngjyrim bazë të zi. Të rriturit shfaqen në një brez të vetëm nga korriku deri në shtator. Veza ka stad të shkurtër. Larva dimëron si larvë e vogël. Pupa ka stad të shkurtër. Erebia melas banon në shpate shkëmbore dhe terrene të thepisura nga 1200 deri në 2100 m mbi nivelin e detit, me kërkesa hapësinore modeste dhe dendësi popullatash mesatare. Larvat ushqehen me Festuca ovina. Fluturat ushqehen me lule të disponueshme, shpesh Arnica. Në Shqipëri është lokale në zonat malore. Në Ballkan është e përhapur në pjesën më të madhe të rajonit. Në Evropë ka shpërndarje të gjerë në zonat perëndimore, qendrore, veriore dhe lindore, përfshirë rajonet alpine dhe zonat shkëmbore malore. Nuk është e pranishme në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi, Kaukaz dhe më në lindje. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Erebia ottomana*/Ottoman Brassy Ringlet**
Otomanja
Nymphalidae – Satyrinae





***Erebia ottomana*, dhe harta e shpërhapjes**

Erebia ottomana është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 19–21 mm. Ana e sipërme është kafe e errët në të zezë, me reflektime metalike jeshile. Krahu i përparmë ka tre ose më shumë ocelë submargjinalë përgjatë skajit të jashtëm dhe një brez të shkurtër kafe të çelur që hyn pjesërisht në qelizë. Ana e poshtme është gri më e çelur dhe me kontrast të ulët; krahu i

përparmë ka brez të gjerë margjinal, ndërsa i pasmi një brez diskal të dobët. Femrat janë pak më të mëdha dhe më të çelura, me më shumë ocelë, breza postdiscalë më të mëdhenj dhe anë të poshtme në të verdhë të çelur. Specia e ngjashme është *Erebia cassioides*, e cila është pak më e vogël, jeton zakonisht mbi 2000 m dhe ka periudhë fluturimi më të vonshme, por me mbivendosje me *E. ottomana*. Ajo dallohet nga dy ocelët apikalë me pupilë të bardhë, brezi submargjinal portokalli-të kuq, shpesh i shkurtër dhe i ndërprerë, si dhe brezi diskal gri i kaltër ose gri në anën e poshtme të krahut të pasmë. Identifikimi mund të jetë i vështirë dhe, në raste dyshimi, rekomandohet përdorimi i genitalieve. Të rriturit shfaqen në një brez të vetëm nga qershori deri në gusht. Veza dhe pupa kanë stade të shkurtra, ndërsa larva dimëron. *Erebia ottomana* banon në livadhe subalpine dhe alpine në lartësi 1200–2500 m, me kërkesa hapësinore modeste dhe dendësi popullatash shpesh të larta. Larvat ushqehen me *Festuca nigrescens, F. ovina, F. paniculata, F. rubra* dhe *Nardus stricta*, ndërsa të rriturit me lule të ndryshme. Në Shqipëri është lokale në zonat malore dhe kërkon kërkime të mëtejshme, ndërsa në Ballkan është e përhapur në pjesën më të madhe të rajonit. Në Evropë gjendet në rajonet malore dhe alpine të jugut, qendrës dhe lindjes, si dhe në disa zona të fragmentuara; gjendet gjithashtu në Azinë e Vogël. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet në kategorinë **NE**, ndërsa në nivel Evropian sipas IUCN-së në kategorinë **LC**.

***Erebia pandrose*/Dewy Ringlet**
Zijoshja pandrosë
Nymphalidae – Satyrinae





***Erebia pandrose*, dhe harta e shpërhapjes**

Erebia pandrose është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 20–25 mm. Ana e sipërme është ngjyrë kafe e errët në të zezë. Krahu i përparmë ka vija të errëta në qelizë, një vijë postdiscal të errët dhe një zonë të gjerë postdiscale ngjyrë kafe të çelur që përfshin ocelë të zinj të verbër nga s2 deri në s5. Krahu i pasmë në anën e sipërme ka ocelë të vegjël të verbër me një

unazë të zbehtë portokalli ose të munguar. Ana e poshtme e krahut të përparmë është kafe e kuqërremtë, me kosta gri dhe ocelë të verbër. Ana e poshtme e krahut të pasmë është gri në të argjendtë, me një brez diskal të theksuar. Femrat janë pak më të mëdha. Kanë ngjyrim më të çelur kafe dhe të njëjtin model si meshkujt, ndërsa ana e poshtme është gri-verdhë me brez diskal më të errët. Speciet e ngjashme janë Erebia të tjera, por asnjë nuk ka modelin karakteristik të ocelëve të verbër në brezin portokalli postdiscal. Të rriturit shfaqen në një brez të vetëm nga qershori deri në mes të korrikut. Veza ka stad të shkurtër. Larva zhvillohet për dy vite, duke dimëruar në vitin e parë si larvë e vogël dhe në vitin e dytë si larvë pothuaj e rritur. Pupa ka stad të shkurtër. *Erebia pandrose* banon në livadhe alpine dhe shpate shkëmbore mbi vijën e pyjeve nga 1900 deri në 2500 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa hapësinore modeste dhe dendësi popullatash që mund të jenë të larta. Larvat ushqehen kryesisht me Festuca ovina, Festuca violacea, Nardus stricta, Poa dhe Sesleria caerulea. Fluturat ushqehen me lule të disponueshme, shpesh Arnica. Në Shqipëri është shumë lokale dhe në kufirin jugor të shpërndarjes në Gadishullin Ballkanik. Në Ballkan është e përhapur në pjesën më të madhe të rajonit. Në Evropë ka shpërndarje në zonat alpine dhe subalpine të jugut, qendrës dhe veriut të kontinentit. Nuk është e pranishme në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi, Kaukaz dhe më në lindje. Specia renditet bazuar në kriteret e IUCN–së, në listen e Kuqe Evropiane, në kategorinë LC, ndërkohë që Listën e Kuqe të Shqipërisë lloji klasifikohet në kategorinë NT.

***Erebia pronoe*/Water Ringlet**
Zijoshja pronoje
Nymphalidae – Satyrinae





***Erebia pronoe*, dhe harta e shpërhapjes**

Erebia pronoe është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 21–25 mm. Ana e sipërme është ngjyrë kafe e errët në të zezë, me një shenjë seksuale të padukshme dhe një brez postdiscal të kuq mirë të përcaktuar, që përfshin dy njolla subapikale dhe një ocel të vogël në s2. Krahu i pasmë në anën e sipërme ka dy ose tre ocelë të vegjël submarginalë me unazë të kuqe.

Ana e poshtme e krahut të përparmë është gri-vjollcë, me një shpërndarje të imët të irrorimit gri-argjendtë dhe një brez diskal ngjyrë kafe të errët. Ana e poshtme e krahut të pasmë është gri-vjollcë, me brez diskal dhe marginal më të errët. Femrat janë pak më të mëdha, me ngjyrim më të çelur kafe dhe të njëjtat shenja. Ana e poshtme e femrave është gri-kafe e çelur, me brez diskal dhe marginal më të errët. Speciet e ngjashme përfshijnë Erebia aethiops, Erebia ligea dhe Erebia euryale, të cilat dallohen nga kombinime të ndryshme të ocelëve, brezit postdiscal dhe modelit të krahëve. Në raste të dyshimta, rekomandohet përdorimi i karaktereve të genitalieve të meshkujve për identifikim. Të rriturit shfaqen në një brez të vetëm nga fundi i korrikut deri në shtator. Veza ka stad të shkurtër. Larva dimëron si larvë e vogël. Pupa ka stad të shkurtër.
Erebia pronoe banon në livadhe të lagështa në zonat subalpine dhe alpine, shpesh në lugina të vogla dhe pranë përrenjve malorë. Ka kërkesa hapësinore mesatare dhe dendësi popullatash që mund të jenë të larta. Larvat ushqehen me Anthoxanthum odoratum, Festuca ovina, Festuca rubra dhe Poa. Të rriturit ushqehen me lule të ndryshme. Në Shqipëri janë vetëm të dhëna të vjetra dhe nevojiten kërkime të mëtejshme. Në Ballkan është e përhapur në shumicën e rajonit malor. Në Evropë gjendet në zonat alpine dhe subalpine të jugut, qendrës dhe veriut. Nuk është e pranishme në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi, Kaukaz dhe më në lindje. Specia renditet bazuar në kriteret e IUCN–së, në listen e Kuqe Evropiane në kategorinë LC, ndërkohë që në Listën e Kuqe të Shqipërisë lloji klasifikohet në kategorinë DD.

***Erebia rhodopensis*/Nicholl's Ringlet**
Zijoshja rodopensis
Nymphalidae – Satyrinae





***Erebia rhodopensis*, dhe harta e shpërhapjes**

Erebia rhodopensis është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 19–20 mm. Ana e sipërme është ngjyrë kafe e errët në të zezë, me një shenjë seksuale të pranishme, dhe me breza postdiscalë portokalli të kuq që përfshijnë dy ocelë apikalë me pupilë të bardhë dhe, rrallë, një ocel të tretë rudimentar në s2. Krahu i pasmë në anën e sipërme ka tre ocelë submarginalë

me pupilë të bardhë në një brez postdiscal të ndërprerë ngjyrë portokalli të kuqe. Ana e poshtme e krahut të përparmë është portokalli në të kuqërremtë, me kosta dhe skajin e jashtëm kafe dhe me dy ocelë apikalë. Ana e poshtme e krahut të pasmë është kafe, me zonë bazale dhe postdiscale më të çelur, brez diskal dhe marginal të errët dhe rrallë ocelë rudimentarë. Femrat janë pak më të mëdha, me breza postdiscalë më të çelur portokalli dhe ocelë submarginalë më të mëdhenj në anën e poshtme, me kontrast më të theksuar në shenja.Specia e ngjashme është Erebia gorge, e cila dallon nga madhësia më e vogël ose më e madhe, mungesa e shenjës seksuale të theksuar dhe prania e dy ocelëve apikalë të shkëputur, si dhe mungesa e modelit karakteristik të këtij lloji në brezin postdiscal. Të rriturit shfaqen në një brez të vetëm nga mesi i korrikut deri në fund të gushtit. Veza ka stad të shkurtër. Larva zhvillohet për dy vite, duke dimëruar në vitin e parë si larvë e vogël dhe në vitin e dytë si larvë pothuaj e rritur. Pupa ka stad të shkurtër. Erebia rhodopensis banon në livadhe alpine mbi vijën e pyjeve nga 2100 deri në 2500 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa hapësinore modeste dhe mund të formojë popullata me dendësi të lartë. Larvat ushqehen me Poa. Të rriturit ushqehen me lule të disponueshme, shpesh Arnica dhe Dianthus. Në Shqipëri regjistruar vetëm nga Mali i Gramozit. Në Ballkan është e përhapur në zonat malore të rajonit. Në Evropë gjendet në zonat alpine dhe subalpine të jugut, qendrës dhe veriut. Nuk është e pranishme në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi, Kaukaz dhe më në lindje. Specia renditet bazuar në kriteret e IUCN–së, në listen e Kuqe Evropiane, në kategorinë NT B2a, ndërkohë që në Listën e Kuqe të Shqipërisë lloji klasifikohet në kategorinë DD.

***Erebia triarius*/de Prunner's Ringlet**
Zijoshja triare
Nymphalidae – Satyrinae





***Erebia triarius*, dhe harta e shpërhapjes**

Erebia triarius është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 19–20 mm. Ana e sipërme është ngjyrë kafe e errët në të zezë, me një shenjë seksuale të pranishme, dhe me breza postdiscalë portokalli të kuq që përfshijnë dy ocelë apikalë me pupilë të bardhë dhe, rrallë, një ocel të tretë rudimentar në s2. Krahu i pasmë në anën e sipërme ka tre ocelë submarginalë me pupilë të bardhë në një brez postdiscal të ndërprerë ngjyrë portokalli të kuqe.

Ana e poshtme e krahut të përparmë është portokalli në të kuqërremtë, me kosta dhe skajin e jashtëm kafe dhe me dy ocelë apikalë. Ana e poshtme e krahut të pasmë është kafe, me zonë bazale dhe postdiscale më të çelur, brez diskal dhe marginal të errët dhe rrallë ocelë rudimentarë. Femrat janë pak më të mëdha, me breza postdiscalë më të çelur portokalli dhe ocelë submarginalë më të mëdhenj në anën e poshtme, me kontrast më të theksuar në shenja. Specia e ngjashme është *Erebia gorge*, e cila dallon nga madhësia më e vogël ose më e madhe, mungesa e shenjës seksuale të theksuar dhe prania e dy ocelëve apikalë të shkëputur, si dhe mungesa e modelit karakteristik të këtij lloji në brezin postdiscal. Të rriturit shfaqen në një brez të vetëm nga mesi i korrikut deri në fund të gushtit. Veza ka stad të shkurtër. Larva zhvillohet për dy vite, duke dimëruar në vitin e parë si larvë e vogël dhe në vitin e dytë si larvë pothuaj e rritur. Pupa ka stad të shkurtër. *Erebia rhodopensis* banon në livadhe alpine mbi vijën e pyjeve nga 2100 deri në 2500 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa hapësinore modeste dhe mund të formojë popullata me dendësi të lartë. Larvat ushqehen me *Poa*. Të rriturit ushqehen me lule të disponueshme, shpesh *Arnica* dhe *Dianthus*. Në Shqipëri është regjistruar vetëm nga Mali i Gramozit dhe kërkon kërkime të mëtejshme. Në Ballkan është e përhapur në zonat malore të rajonit. Në Evropë gjendet në zonat alpine dhe subalpine të jugut, qendrës dhe veriut. Nuk është e pranishme në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi, Kaukaz dhe më në lindje. Specia renditet bazuar në kriteret e IUCN–së, në listen e Kuqe Evropiane, në kategorinë NT A2c, ndërkohë që në Listën e Kuqe të Shqipërisë lloji klasifikohet në kategorinë DD.

***Hipparchia fagi*/Woodland Grayling**
Pylltarja
Nymphalidae–Satyrinae





***Hipparchia fagi*, dhe harta e shpërhapjes**

Hipparchia fagi flutur me madhësi mesatare deri të madhe, me gjatësi të flatrave të përparme 33–38 mm. Ana e sipërme është ngjyrë gri-kafe e errët, me një shenjë seksuale te meshkujt dhe një brez postdiscal ngjyrë kremi të çelur, shpesh me një njollë të zbehtë fuscous që përfshin ocelë të ndryshueshëm në s5 dhe s2, të cilët mund të mungojnë. Krahu i pasmë në anën e sipërme ka një brez të madh postdiscal të bardhë, shpesh me një ocel të vogël në s2 dhe me kufirin e jashtëm të zonës bazale pothuaj të drejtë ose lehtësisht të harkuar. Ana e poshtme e krahut të përparmë ka një zonë të verdhë ose të bardhë në pjesën apikale të

brezit postdiscal. Ana e poshtme e krahut të pasmë është gri-kafe me nuanca, me vijëzime të errëta, vija të zeza diskale dhe submarginale dhe një brez të gjerë postdiscal të bardhë shumë të theksuar, shpesh me një ocel të vogël. Femrat janë më të mëdha, me breza postdiscalë më të çelur dhe shpesh me nuanca të verdha në zonën apikale. Specia ngjan me *Brintesia circe* dallohet nga prania e një brezi postdiscal plotësisht të bardhë, me skaj të jashtëm të dhëmbëzuar dhe pa ndërprerje. *H. syriaca* është shumë e ngjashme, duke kërkuar shpesh analizë të genitalieve për identifikim. Të rriturit shfaqen në një brez të vetëm nga qershori deri në gusht, me një periudhë aestivimi. Veza ka stad të shkurtër. Larva dimëron. Pupa ka stad të shkurtër. *H. fagi* banon në zona me bar në shkurre të hapura, pyje dhe skaje pyjore, shpesh duke pushuar mbi trungje pemësh, nga 400 deri në 1500 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa hapësinore mesatare dhe ndonjëherë formon popullata me dendësi të lartë. Larvat ushqehen me *Brachypodium phoenicoides*, *B. pinnatum, B. retusum, Bromus erectus, Dactylis glomerata, Festuca ovina, F. rubra, Holcus lanatus, H. mollis* dhe *Poa pratensis*. Të rriturit ushqehen me lule, praktikojnë edhe thithjen e mineraleve në tokë të lagësht. Në Shqipëri e përhapur në shumë zona, shpesh ngatërrohet me *H. syriaca*. Në Ballkan e pranishme në shumicën e vendeve. Në Evropë ka shpërndarje të gjerë në jug, qendër dhe pjesërisht veri. Gjendet gjithashtu në Kaukazin perëndimor. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Hipparchia fatua*/Freyer's Grayling**
Fatua
Nymphalidae – Satyrinae





***Hipparchia fatua*, dhe harta e shpërhapjes**

Hipparchia fatua është një flutur me madhësi mesatare deri të madhe, me gjatësi të flatrave të përparme 30–34 mm. Ana e sipërme është ngjyrë gri-kafe e errët, me shenjë seksuale te meshkujt dhe me ocelë të verbër në s2 dhe s5, shpesh me njolla të vogla të bardha në s3 dhe s4. Krahu i pasmë në anën e sipërme ka një

vijë submarginale të errët, të mirëpërcaktuar, me lunula me skaj të jashtëm konkav. Ana e poshtme e krahut të përparmë është e zezë, me ocelë me pupilë të bardhë në s2 dhe s5 dhe me njolla më të mëdha të bardha në s3 dhe s4. Ana e poshtme e krahut të pasmë ka vija diskale dhe submarginale të zeza, të mprehta, me vijë submarginale të theksuar dhe të valëzuar. Femrat janë më të mëdha, me shenja postdiscale të verdha dhe me ocelë të rrethuar me të verdhë dhe pupilë të bardhë në s2 dhe s5, si dhe njolla të bardha të theksuara në s3 deri në s4. Krahu i pasmë në femra ka shpesh ocel të vogël në s2 dhe njolla të bardha në s3 deri në s6. Specia e ngjashme *H. statilinus* është më e vogël dhe dallohet nga vija submarginale më pak e theksuar dhe më e paqartë në anën e poshtme, si dhe nga mungesa ose dobësia e vijës diskale. Të rriturit shfaqen në një brez të vetëm nga qershori deri në shtator, me periudhë aestivimi. Veza ka stad të shkurtër. Larva dimëron. Pupa stad të shkurtër. *H. fatua* banon në zona të nxehta dhe të thata me gurë, me shkurre të shpërndara ose pemë të vogla, nga ultësira deri në 1000 m mbi nivelin e detit. Ka kërkesa hapësinore mesatare dhe mund të formojë popullata me dendësi mesatare. Larvat ushqehen me *Festuca* dhe *Poa annua*. Të rriturit rrallë ushqehen me lule, dhe shpesh vërehen duke pushuar mbi gurë ose trungje pemësh. Në Shqipëri e njohur vetëm nga një regjistrim i vjetër. Në Ballkan është e përhapur në shumicën e rajonit. Në Evropë gjendet në zonat jugore, qendrore dhe pjesërisht veriore, si dhe në Azinë e Vogël dhe rajonet përreth. Kjo specie në Listën e Kuqe të Shqipërisë ka statusin NE, edhe në nivelin Evropian sipas IUCN-së është klasifikuar si LC.

***Hipparchia semele*/Grayling**
Semelja
Nymphalidae – Satyrinae





***Hipparchia semele*, dhe harta e shpërhapjes**

Hipparchia volgensis është një flutur me madhësi mesatare (Fw: 21–25 mm). Meshkujt kanë anën e sipërme kafe, me breza postdiscalë të verdhë-portokalli, sex-brand dhe ocelë në flatrët e përparme, ndërsa femrat janë më të mëdha dhe

kanë breza postdiscalë më të gjerë e më të zbehtë. Ana e poshtme e flatrëve paraqet ngjyrosje portokalli dhe gri-kafe të larmishme, me ocelë dhe brez postdiscal të zbehtë. Për shkak të ngjashmërisë dhe ndryshueshmërisë së llojeve të afërta, përfshirë *H. senthes* dhe *H. volgensis*, identifikimi vetëm nga morfologjia e jashtme është i pasigurt dhe rekomandohet verifikimi përmes genitaleve. Të rriturit kanë një brez të vetëm nga qershori deri në gusht; veza zhvillohet për 15–23 ditë, vemja dimëron në stadin L2 ose L3 dhe pupa zhvillohet për 30–36 ditë. Specia banon në kullota të hapura, me diell, ranore dhe shkëmbore, me tokë të zhveshur dhe shkurre të shpërndara, nga ultësirat deri në 1300 m. Vemjet ushqehen kryesisht me *Agrostis capillaris, A. vinealis, Brachypodium phoenicoides, B. pinnatum, B. retusum, Corynephorus canescens, Festuca ovina* dhe *F. rubra*, ndërsa të rriturit ushqehen me lule të ndryshme, kryejnë mud-puddling dhe pushojnë mbi gurë e trungje. Në Shqipëri njihet vetëm nga Alpet e Shqipërisë së Veriut, me të dhëna të konfirmuara përmes genitaleve, por kërkohet verifikim i mëtejshëm për shkak të mundësisë së ngatërrimit me llojet e afërta. Në Evropë ka shpërndarje të gjerë, përfshirë pjesën më të madhe të Ballkanit. Ka status DD në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe të IUCN në nivel Evropian.

***Hipparchia senthes*/Balkan Grayling**
Senthesi
Nymphalidae – Satyrinae





***Hipparchia senthes*, dhe harta e shpërhapjes**

Hipparchia senthes është një flutur me madhësi mesatare. Gjatësia e krahut të përparmë është 26–27 mm. Ana e sipërme është me ngjyrë bazë kafe, me breza postdiskalë të verdhë-portokalli të ndërprerë dhe ndonjëherë të përcaktuar dobët, me përhapje të ngjyrës përgjatë venave. Në krahun e përparmë të anës së

sipërme meshkujt kanë njollë androkoniale dhe ocelë në hapësirat s2 dhe s5, ndërsa në krahun e pasmë të anës së sipërme kanë një ocel të vogël në s2. Ana e poshtme e krahut të përparmë është portokalli, me skajin dhe pjesën e përparme gri-kafe të larmishme, si dhe dy ocelë në skajin e jashtëm. Ana e poshtme e krahut të pasmë është e mermeruar me gri të çelur dhe të errët, me zonën bazale të ndjekur nga një brez postdiskal të bardhë ose të zbehtë. Femrat janë më të mëdha, me breza postdiskalë të verdhë-portokalli më të zhvilluar në anën e sipërme. Ana e poshtme e krahut të pasmë paraqet një model më të njëtrajtshëm të larmishëm dhe brezi postdiskal i zbehtë është i dobët ose mungon. Specia paraqet një brezni në vit dhe të rriturit fluturojnë nga mesi i majit deri në shtator. Stadi i vezës është i shkurtër. Larva dimëron, ndërsa stadi i pupës është i shkurtër. *Hipparchia senthes* banon në vende të nxehta dhe të thata shkëmbore, me tokë të hapur dhe shkurre të shpërndara, nga ultësira deri në 1200 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë modeste dhe dendësia e popullatës mund të jetë e lartë. Fluturat e rritura ushqehen me një larmi të madhe lulesh, thithin lëndë minerale nga toka e lagësht (mud-puddling) dhe shpesh pushojnë mbi gurë ose trungje pemësh. Në Shqipëri është një specie shumë lokale bazuar në të dhënat e konfirmuara nga gjenitaliet. Ekziston mundësia e ngatërrimit me Hipparchia semele dhe Hipparchia volgensis, ndaj nevojiten më shumë të dhëna të konfirmuara nga gjenitaliet. Shpërndahet në Ballkan, në pjesë të mëdha të Evropës, si dhe në Azinë e Vogël dhe Lindjen e Afërt. Specia ka status DD në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe të IUCN në nivel Evropian.

Hipparchia statilinus/Tree Grayling
Statilinja
Nymphalidae – Satyrinae





***Hipparchia statilinus*, dhe harta e shpërhapjes**

Hipparchia statilinus është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të krahut të përparmë 23–26 mm. Meshkujt kanë anën e sipërme gri-kafe të errët, me shenja relativisht pak të dukshme, njollë androkoniale dhe ocelë në hapësirat s2

dhe s5, shpesh të shoqëruar me njolla të vogla të bardha në s3 dhe s4. Ana e poshtme e krahut të përparmë është më e errët, me ocelë me bebëz të bardhë, ndërsa krahu i pasmë është gri-kafe, me vija të valëzuara dhe kontrast të dobët. Femrat janë pak më të mëdha dhe dallohen nga shenjat postdiskale të verdha të zbehta, ocelët me unazë të verdhë e bebëz të bardhë dhe njollat e bardha më të dallueshme. Specia ka një brezni në vit dhe të rriturit fluturojnë nga korriku deri në shtator, ndërsa në lartësi të ulëta mund të shfaqen më herët. Stadi i vezës zgjat rreth 19 ditë, larva dimëron në stad të hershëm dhe stadi pupor zgjat 21–46 ditë. *H. statilinus* banon në kullota shkëmbore ose stepore me tokë të hapur, nga ultësirat deri në 1500 m mbi nivelin e detit; ka kërkesa hapësinore modeste dhe mund të arrijë dendësi të lartë popullate. Larvat ushqehen me një gamë të gjerë barishtesh, kryesisht *Bromus erectus, B. secalinus, B. sterilis, Dactylis glomerata, Deschampsia caespitosa, Festuca ovina, F. rubra, Ochlopoa annua* dhe *Stipa pennata*, si dhe me lloje të tjera barishtore, ndërsa të rriturit ushqehen me një larmi lulesh. Në Shqipëri specia është e përhapur gjerësisht. Shpërndarja e saj përfshin Ballkanin, pjesë të mëdha të Evropës, Azinë e Vogël, Transkaukazin, Kaukazin dhe shtrihet më tej drejt lindjes. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet VU, ndërsa në Listën e Kuqe të IUCN-së në nivel Evropian renditet LC.

***Hipparchia syriaca*/Eastern Rock Grayling**
E mermerta siriane
Nymphalidae – Satyrinae





***Hipparchia syriaca*, dhe harta e shpërhapjes**

Hipparchia statilinus është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të krahut të përparmë 23–26 mm. Meshkujt kanë anën e sipërme gri-kafe të errët, me shenja relativisht pak të dukshme, njollë androkoniale dhe ocelë në hapësirat s2 dhe s5, shpesh të shoqëruar me njolla të vogla të bardha në s3 dhe s4. Ana e

poshtme e krahut të përparmë është më e errët, me ocelë me bebëz të bardhë, ndërsa krahu i pasmë është gri-kafe, me vija të valëzuara dhe kontrast të dobët. Femrat janë pak më të mëdha dhe dallohen nga shenjat postdiskale të verdha të zbehta, ocelët me unazë të verdhë e bebëz të bardhë dhe njollat e bardha më të dallueshme. Specia ka një brezni në vit dhe të rriturit fluturojnë nga korriku deri në shtator, ndërsa në lartësi të ulëta mund të shfaqen më herët. Stadi i vezës zgjat rreth 19 ditë, larva dimëron në stad të hershëm dhe stadi pupor zgjat 21–46 ditë. *H. statilinus* banon në kullota shkëmbore ose stepore me tokë të hapur, nga ultësirat deri në 1500 m mbi nivelin e detit; ka kërkesa hapësinore modeste dhe mund të arrijë dendësi të lartë popullate. Larvat ushqehen me një gamë të gjerë barishtesh, kryesisht *Bromus erectus, B. secalinus, B. sterilis, Dactylis glomerata, Deschampsia caespitosa, Festuca ovina, F. rubra, Ochlopoa annua* dhe *Stipa pennata*, si dhe me lloje të tjera barishtore, ndërsa të rriturit ushqehen me një larmi lulesh. Në Shqipëri specia është e përhapur gjerësisht. Shpërndarja e saj përfshin Ballkanin, pjesë të mëdha të Evropës, Azinë e Vogël, Transkaukazin, Kaukazin dhe shtrihet më tej drejt lindjes. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet VU, ndërsa në Listën e Kuqe të IUCN-së në nivel Evropian renditet LC.

***Hipparchia volgensis*/Delattin's Grayling**
Volgensis
Nymphalidae – Satyrinae





***Hipparchia volgensis*, dhe harta e shpërhapjes**

Hipparchia volgens është një flutur me madhësi mesatare. Gjatësia e krahut të përparmë është 21–25 mm. Ana e sipërme është me ngjyrë bazë kafe, me breza postdiskalë të verdhë-portokalli të ndërprerë dhe ndonjëherë të përcaktuar dobët, me përhapje të ngjyrës përgjatë venave. Në krahun e përparmë të anës së sipërme gjendet njolla androkoniale, si dhe ocelë në s2 dhe s5. Në krahun e

pasmë të anës së sipërme gjendet një ocel i vogël në s2. Ana e poshtme e krahut të përparmë është portokalli, me skaj dhe costë gri-kafe të larmishme, si dhe dy ocelë në skajin e jashtëm. Ana e poshtme e krahut të pasmë është e mermeruar me gri të çelur dhe të errët, me zonë bazale të ndjekur nga një brez postdiskal të bardhë ose të zbehtë. Femrat janë më të mëdha dhe kanë breza postdiskalë më të mëdhenj dhe më të zbehtë në anën e sipërme. Speciet e ngjashme janë *Hipparchia semele* dhe *Hipparchia senthes*, ndërsa identifikimi në bazë të morfologjisë së jashtme nuk është i mundur dhe rekomandohet fort identifikimi në bazë të gjenitalieve të meshkujve dhe femrave. Identifikimi në bazë të morfologjisë së jashtme nuk është i mundur. Identifikimi në bazë të gjenitalieve të meshkujve dhe femrave rekomandohet fort. Specia ka një brezni në vit nga qershori deri në shtator. Stadi i vezës është i shkurtër, larva dimëron, ndërsa pupacioni është i shkurtër. *Hipparchia volgensis* banon në vende të nxehta dhe të thata shkëmbore me shkurre të shpërndara, nga ultësira deri në 1200 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë modeste dhe dendësia e popullatës mund të jetë e lartë. Larvat ushqehen me *Elymus repens* dhe ndoshta me barëra të tjera. Fluturat e rritura ushqehen me një larmi të madhe lulesh dhe kryejnë grumbullim mineralesh nga toka e lagësht (mud-puddling), shpesh duke pushuar mbi gurë ose trungje pemësh. Në Shqipëri është lokale. Mund të ngatërrohet me *Hipparchia semele* dhe *Hipparchia senthes*. Shpërndahet në Ballkan dhe në pjesë të Evropës, si dhe është e pranishme në Ukrainën juglindore. Nuk është e pranishme në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi dhe Kaukaz. Specia ka status DD në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe të IUCN në nivel Evropian.

***Hyponephele lupinu*/Oriental Meadow Brown**

Ulkonjëza e livdadheve (Ulpina)

Nymphalidae – Satyrinae






***Hyponephele lupinus*, dhe harta e shpërhapjes**

Hyponephele lupinu është një flutur me madhësi mesatare. Gjatësia e krahut të përparmë është 26–28 mm. Krahët e pasmë kanë skaj të jashtëm të dhëmbëzuar. Ana e sipërme e meshkujve është me ngjyrë bazë të verdhë-kafe me reflektim bronzi në bazë. Në krahun e përparmë të anës së sipërme meshkujt kanë një njollë seksuale të madhe dhe të errët, të dukshme, të pandërprerë nga venat, dy ocelë të verbër në zonën nënapikale, zona portokalli-verdhë e kufizuar rreth ocelëve dhe një ocel të vogël apikal të verbër. Ana e sipërme e krahut të pasmë është e pa shënuar. Ana e poshtme e krahut të përparmë është portokalli-kafe e çelur, me kufi gri dhe një ocel apikal të dukshëm me bebëz të bardhë, ndonjëherë

edhe me ocel të verbër në s2. Ana e poshtme e krahut të pasmë është gri-kafe e çelur, me imtësi të errëta dhe një brez diskal të zbehtë. Femrat janë pak më të mëdha dhe kanë krahët e pasmë me skaj më të theksuar të dhëmbëzuar se meshkujt. Ana e sipërme e tyre është me ngjyrë bazë kafe, me dy ocelë të verbër në s2 dhe s5, të rrethuar me unazë portokalli të zbehtë dhe të ndarë nga ngjyra bazë në v4. Ana e poshtme e femrave ka një zonë bazale më të errët, të ndjekur nga një brez më të çelur dhe më të zbehtë. Speciet e ngjashme janë *Hyponephele lycaon* dhe *Maniola jurtina*. *Hiponephele lycaon* është më e vogël dhe ka një njollë seksuale më të ngushtë te meshkujt, shpesh të ndërprerë nga venat, ndërsa femrat kanë zona portokalli postdiskale me ocelë dhe zakonisht dy ocelë apikalë të verbër. *Maniola jurtina* ka madhësi të ngjashme, zakonisht me një ocel të vetëm me bebëz të bardhë dhe një zonë portokalli më të zhvilluar te femrat, si dhe një brez diskal më të theksuar në anën e poshtme. Specia ka një brezni në vit nga qershori deri në fillim të shtatorit, me femrat që kalojnë periudhë aestivimi në zona të thata. Vezët kanë stad të shkurtër, larvat dimërojnë dhe pupacioni është i shkurtër. *Hyponephele lupinus* banon në vende të nxehta shkëmbore me shkurre të shpërndara, nga ultësira deri në 1250 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore modeste dhe dendësia e popullatës mund të jetë mesatare. Larvat ushqehen kryesisht me *Bromus erectus, Festuca ovina, Festuca rubra, Poa annua* dhe *Stipa pennata*, dhe me *Aegilops geniculata*. Fluturat e rritura ushqehen me një larmi lulesh. Në Shqipëri është lokale. Gjendet në Ballkan, Evropë, Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi dhe më tej drejt lindjes. Listën e Kuqe të Shqipërisë ka statusin NE, në nivelin Evropian sipas IUCN-së është klasifikuar si LC.

***Hyponephele lycaon*/Dusky Meadow Brown**
Ulkonjëza e mbrëmjes e livadheve (Likaonja)
Nymphalidae – Satyrinae





***Hyponephele lycaon*, dhe harta e shpërhapjes**

Hyponephele lycaon është një flutur me madhësi mesatare. Gjatësia e krahut të përparmë është 20–24 mm. Ana e sipërme është me ngjyrë bazë gri-kafe. Në krahun e përparmë të anës së sipërme meshkujt kanë një njollë seksuale të ngushtë, të ndërprerë nga ngjyra më e çelur në v2 dhe v3, si dhe një nuancë pak

fulvoze në zonën postdiskale. Ana e sipërme e krahut të pasmë është e pa shënuar. Ana e poshtme e krahut të përparmë është portokalli-kafe e çelur, me kufi marginal gri dhe një ocel apikal të dukshëm me bebëz të bardhë. Ana e poshtme e krahut të pasmë është gri-kafe, me imtësi të errëta deri në gri të çelur dhe një brez diskal të errët, pak të dallueshëm. Femrat janë pak më të mëdha dhe kanë krahët e pasmë pak të dhëmbëzuar. Në krahun e përparmë të anës së sipërme kanë një zonë diskale të verdhë-portokalli dhe një zonë bazale të errët të ndryshueshme. Ana e sipërme e krahut të pasmë është gri-kafe, me një brez diskal të zbehtë të kufizuar nga një vijë më e errët drejt zonës bazale. Speciet e ngjashme janë Hyponephele lupinus dhe *Maniola jurtina. Hyponephele lupinus* është më e madhe dhe ka një njollë seksuale më të madhe te meshkujt, ndërsa femrat kanë dy ocelë nënapikalë të verbër dhe zona portokalli të kufizuara rreth ocelëve. *Maniola jurtina* ka madhësi të ngjashme, zakonisht me një ocel të vetëm me bebëz të bardhë dhe një brez diskal të mirëpërcaktuar në anën e poshtme. Specia ka një brezni në vit nga qershori deri në shtator. Stadi i vezës është i shkurtër, larva dimëron si larvë e re dhe pupacioni është i shkurtër. Hyponephele lycaon banon në vende të nxehta shkëmbore me shkurre të shpërndara, nga 200 deri në 1800 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë modeste dhe dendësia e popullatës mund të jetë e lartë. Larvat ushqehen me *Brachypodium pinnatum, Bromopsis erectus, Festuca ovina, F. rubra, Poa* dhe *Stipa pennata*. Fluturat e rritura ushqehen me larmi lulesh. Në Shqipëri e përhapur gjerë në zonat malore. Gjendet në Ballkan, pjesë të Evropës, Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi dhe më tej drejt lindjes Në Listën e Kuqe të Shqipërisë ka statusin NE, në nivelin Evropian klasifikuar si LC.

***Kirinia climene*/Lesser Latice Brown**

Klimenja

Nymphalidae – Satyrinae





***Kirinia climene* dhe harta e shpërhapjes**

Kirinia climene një flutur me madhësi mesatare. Gjatësia e krahut të përparmë është 23–28 mm. Ana e sipërme është me ngjyrë bazë kafe të errët. Në krahun e përparmë të meshkujve gjendet një zonë e madhe diskale e fulvoze, një njollë androkoniale e dobët përgjatë v1 dhe një ocel i vogël apikal i verbër, ndonjëherë që mungon. Në krahun e pasmë të anës së sipërme meshkujt kanë një brez

postdiskal fulvoz që përfshin ocelë të errët të verbër. Ana e poshtme e krahut të përparmë është me ngjyrë bazë më të çelur, me apiks dhe skaj të jashtëm gri dhe një ocel apikal të vogël me bebëz të bardhë. Ana e poshtme e krahut të pasmë është gri-kafe e çelur, me ocelë të dukshëm, disa me bebëz të bardhë. Femrat janë më të mëdha. Në krahun e përparmë kanë zonë diskale më të çelur, njolla kostale dhe apikale të verdhë dhe një ocel të vogël apikal të verbër. Në krahun e pasmë brezi postdiskal fulvoz është rrallë i reduktuar dhe ocelët, nëse janë të pranishëm, janë pak të dukshëm. Ana e poshtme është më e çelur, me zona diskale më të hapura dhe njolla kostale dhe apikale të verdha të zbehta. Speciet e ngjashme janë *K. roxelana*, e cila është më e madhe dhe ka njollë seksuale të dukshme te meshkujt, venë të harkuar dhe ocelë të dobët në anën e sipërme të krahut të pasmë, pa brez portokalli rreth ocelëve dhe me ocelë të dukshëm me bebëz të bardhë dhe të dyfishtë në anën e poshtme. Specia ka një brezni në vit nga qershori deri në korrik. Stadi i vezës i shkurtër, larva dimëron si larvë e vogël dhe pupacioni i shkurtër. *K. climene* banon në livadhe të thata dhe të ngrohta me barishte të larta, në pyje gjetherënëse dhe zona me shkurre, nga 700 deri në 1700 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore modeste, dendësia e popullatës mund të jetë e lartë. Larvat ushqehen me *Poa annua* dhe *P. nemoralis*. Fluturat e rritura rrallë ushqehen me lule dhe me lëngje nga plagët e pemëve, shpesh qëndrojnë në shkurre të ulëta dhe të hijëzuara, duke fluturuar rrallë. Në Shqipëri konfirmuar së fundmi nga Mali i Thatë, të dhënat historike Krumë kërkojnë verifikim. Gjendet në Ballkan, pjesë të Evropës, Azinë e Vogël, Transkaukazi dhe më tej drejt lindjes. Listën e Kuqe të Shqipërisë VU, në Listën e Kuqe Evropiane LC.

***Kirinia roxelana*/Lattice Brown**
Rokselanja
Nymphalidae – Satyrinae





***Kirinia roxelana*, dhe harta e shpërhapjes**

Kirinia roxelana është një flutur me madhësi mesatare. Gjatësia e krahut të përparmë është 29–31 mm. Krahët e përparmë janë të ngushtë. Ana e sipërme është me ngjyrë bazë kafe. Në krahun e përparmë të meshkujve gjenden njolla

seksuale të deformuara në zonën bazale dhe diskale, një zonë e madhe fulvoze dhe një ocel apikal në s5. Në krahun e pasmë të anës së sipërme ocelët janë të zbehtë dhe duken lehtë përmes. Ana e poshtme e krahut të përparmë është e ngjashme me anën e sipërme. Ana e poshtme e krahut të pasmë ka një seri ocelësh me bebëz të bardhë dhe unazë të verdhë, të vegjël në s4 dhe s5. Femrat janë më të mëdha. Në krahun e përparmë kanë njolla kostale dhe apikale më të çelura. Në krahun e pasmë ocelët duken lehtë përmes. Ana e poshtme ka një zonë të madhe portokalli postdiskale dhe shenja më të theksuara. Speciet e ngjashme janë *Kirinia climene*, e cila është më e vogël dhe ka njollë seksuale lineare te meshkujt, venë të drejtë, ocelë më të dukshëm në krahun e pasmë të anës së sipërme, brez portokalli që përfshin ocelët dhe zona diskale më pak të shënuar në anën e poshtme. Specia ka një brezni në vit nga mesi i majit deri në gjysmën e parë të gushtit. Stadi i vezës është i shkurtër, larva dimëron dhe pupacioni është i shkurtër. *Kirinia roxelana* banon në terrene të ashpra me barishte të rralla në shkurre të dendura dhe pyje të ngrohta, nga ultësira deri në 1400 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë të vogla dhe dendësia e popullatës mund të jetë e lartë. Larvat ushqehen me *Anthoxanthum odoratum*, *Lolium perenne, Milium effusum, Poa annua*, *Poa pratensis* dhe *Poa trivialis*. Fluturat pothuajse nuk ushqehen me lule, por vërehen në fruta të kalbura dhe shpesh qëndrojnë në shkurre të ulëta dhe të hijëzuara, duke fluturuar rrallë nëse nuk shqetësohen. Në Shqipëri specia është lokale. Shpërndahet në Ballkan, Evropë, Azinë e Vogël dhe më tej drejt lindjes. Nuk konsiderohet e rrezikuar. Kjo specie në Listën e Kuqe të Shqipërisë ka statusin NE, edhe në nivelin Evropian sipas IUCN-së është klasifikuar si LC.

Lasiommata maera/Large Wall Brown
Njollasykafejta
Nymphalidae – Satyrinae





***Lasiommata maera*, dhe harta e shpërhapjes**

Lasiommata maera është një flutur me madhësi mesatare. Gjatësia e krahut të përparmë është 25–28 mm në gjeneratën e parë dhe 22–23 mm në gjeneratën

verore. Ana e sipërme është me ngjyrë bazë kafe. Në krahun e përparmë meshkujt kanë një njollë seksuale të gjerë, një zonë postdiskale fulvoze dhe një ocel apikal të madh me bebëz të bardhë, ndonjëherë me dy bebëza, si dhe ndonjëherë një ocel të vogël në s6. Ana e sipërme e krahut të pasmë ka zonë diskale të pashënuar dhe ocelë me unazë fulvoze dhe bebëz të bardhë në s2, s3 dhe s4. Ana e poshtme është gri e çelur me nuanca pak të larmishme dhe ocelë postdiskalë të rrethuar me unazë të verdhë-kafe në s2 deri në s6. Femrat janë pak më të mëdha dhe kanë zonë fulvoze më të gjerë dhe më të ndritshme, me ocelë apikalë të ngjashëm me meshkujt. Ana e poshtme është e ngjashme me atë të meshkujve. Speciet e ngjashme janë *Lasiommata petropolitana* dhe *Lasiommata megera. Lasiommata petropolitana* është pak më e vogël dhe më pak e ndryshueshme, me zonë bazale të krahut të përparmë kafe të errët, dy shirita të errët në qelizë dhe vijë të valëzuar diskale të errët. Lasiommata megera është më e vogël, me zonë bazale portokalli dhe brez të ngushtë portokalli postdiskal në krahun e përparmë. Specia ka një deri në dy brezni në vit nga mesi i prillit deri në shtator. Stadi i vezës zgjat 5–12 ditë, larva dimëron si larvë L3 dhe pupacioni zgjat 10–24 ditë. Lasiommata maera banon në livadhe të thata dhe shkëmbore nga ultësira deri në 2000 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë të konsiderueshme dhe dendësia e popullatës është mesatare. Larvat ushqehen kryesisht me *Bromus erectus, Festuca ovina, Festuca rubra, Phleum pratense, Poa annua, Poa bulbosa* dhe *Poa pratensis*. Fluturat e rritura ushqehen me një larmi të madhe lulesh në vegjetacionin barishtor. Në Shqipëri specia është e përhapur në mënyrë të gjerë në zonat malore. Shpërndahet në Ballkan, Evropë, Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt dhe më tej drejt lindjes. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Lasiommata megera*/Wall Brown**
Megera
Nymphalidae – Satyrinae





***Lasiommata megera*, dhe harta e shpërhapjes**

Lasiommata megera është një flutur me madhësi mesatare. Gjatësia e krahut të përparmë është 19–25 mm. Ana e sipërme është me ngjyrë bazë portokalli-verdhë me model të errët kafe. Në krahun e përparmë meshkujt kanë një njollë seksuale të dukshme, një ocel apikal me bebëz të bardhë dhe shpesh edhe një ocel shtesë të vogël. Në krahun e pasmë të anës së sipërme gjenden ocelë me bebëz të bardhë nga s1c deri në s4. Ana e poshtme është gri dhe pak e larmishme, me ocelë të rrethuar me unazë kafe të çelur në brezin postdiskal nga s1c deri në s6. Femrat janë pak më të mëdha dhe kanë ngjyrë bazë pak më të çelur. Speciet e ngjashme janë *Lasiommata maera* dhe *Lasiommata petropolitana*. *Lasiommata maera* është më e madhe dhe shumë e ndryshueshme në të dy gjinitë, me zonë bazale kafe në krahun e përparmë dhe pa vijë të errët tërthore diskale. *Lasiommata petropolitana* është pak më e madhe, me zonë bazale kafe të errët, dy shirita të errët në qelizë dhe vijë diskale të valëzuar dhe të errët. Specia ka brezni të vazhdueshme nga marsi deri në tetor. Stadi i vezës zgjat 5–11 ditë, larva dimëron si larvë L3 dhe pupacioni zgjat 12–22 ditë. Lasiommata megera banon në një gamë të gjerë terrenesh të ashpra dhe shkëmbore, nga ultësira deri në 1800 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë të konsiderueshme dhe dendësia e popullatës është mesatare. Larvat ushqehen kryesisht me *Bromus erectus, Bromus hordeaceus, Bromus sterilis, Cynosurus cristatus, Dactylis glomerata, Danthonia decumbens, Festuca ovina, Festuca rubra, Poa annua, Poa bulbosa* dhe *Poa pratensis*. Fluturat e rritura ushqehen me një larmi lulesh në vegjetacionin barishtor. Në Shqipëri specia është e përhapur gjerësisht. Shpërndahet në Ballkan, Evropë, Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt dhe më tej drejt lindjes. Nuk konsiderohet e rrezikuar, por në disa rajone ka rënie. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Lasiommata petropolitana*/Northern Wall Brown**
Petropolitanja
Nymphalidae – Satyrinae





***Lasiommata petropollitana*, dhe harta e shpërhapjes**

Lasiommata petropolitana flutur me madhësi mesatare. Gjatësia e krahut të përparmë është 19–21 mm. Ana e sipërme është ngjyrë kafe e errët. Në krahun e përparmë meshkujt kanë një njollë seksuale të gjerë, shirita të errët të padukshëm në qelizë, një zonë postdiskale fulvoze të ndërprerë dhe një ocel apikal të madh me bebëz të bardhë, ndonjëherë edhe një ocel të vogël në s6. Në krahun e pasmë të anës së sipërme ka vijë diskale të errët, të valëzuar dhe të harkuar, me ocelë të rrethuar me unazë fulvoze dhe bebëz të bardhë në s2, s3 dhe s4. Ana e poshtme është gri-kafe më e errët dhe pak e larmishme, me ocelë postdiskalë të rrethuar me unazë verdhë-portokalli nga s2 deri në s6. Femrat kanë madhësi të ngjashme dhe një zonë fulvoze më të gjerë dhe më të vazhdueshme në krahun e përparmë, me ocelë apikalë të ngjashëm me meshkujt. Ana e poshtme është e ngjashme me atë të meshkujve. Speciet e ngjashme janë *L. maera* dhe *L. megera. L. maera* është më e madhe dhe shumë e ndryshueshme në të dy gjinitë, me zonë bazale kafe në krahun e përparmë dhe pa vijë të errët tërthore diskale. *L. megera* është më e vogël, me zonë bazale portokalli dhe brez të ngushtë portokalli postdiskal në krahun e përparmë. Specia ka një brez në vit, me të rritur që shfaqen nga mesi i majit deri në gusht, në varësi të lartësisë. Stadi i vezës është i shkurtër, larva është e gjatë dhe pupacioni kalon dimrin. *L. petropolitana* banon në vende të hapura shkëmbore në pyje me pisha ose bredh, nga 700 deri në 2000 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë të moderuara dhe dendësia e popullatës është mesatare. Larvat ushqehen kryesisht me *Calamagrostis epigejos, Dactylis glomerata, Festuca ovina, F. rubra* dhe *Melica nutans*. Fluturat e rritura ushqehen me një larmi të madhe lulesh. Në Shqipëri e lokalizuar në zonat malore. Shpërndahet në Ballkan dhe Evropë, si dhe në Azinë e Vogël dhe rajone të tjera lindore. Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet në kategorinë VU, në Listën e Kuqe Evropiane LC.

***Maniola jurtina*/Meadow Brown**
E kafejta e livadheve (Jurtina)
Nymphalidae – Satyrinae





***Maniola jurtina*, dhe harta e shpërhapjes**

Maniola jurtina është një flutur me madhësi mesatare. Gjatësia e krahut të përparmë është 22–25 mm. Ana e sipërme është ngjyrë kafe e errët. Meshkujt kanë një njollë të madhe seksuale të errët në krahët e përparmë dhe rrallë shenja të vogla portokalli të zbehta, si dhe një ocel apikal pothuajse ose plotësisht të verbër. Ana e sipërme e femrave është pak më e çelur, me zonë diske dhe postdiskale portokalli të ndryshueshme dhe një ocel apikal. Ana e poshtme është ngjyrë fulvoze e madhe, me skaje kafe të çelur në kostë dhe buzë të jashtme, si dhe një ocel të madh me bebëz të bardhë në krahun e përparmë. Krahët e pasmë kanë ngjyrë gri-kafe të çelur, me bazë pak më të errët dhe pika të vogla të ndryshueshme në brezin postdiskal, ndonjëherë të mungueshme. Femrat janë pak më të mëdha. Ana e sipërme e tyre ka zonë diske dhe postdiskale portokalli të çelur të ndryshueshme dhe një ocel apikal. Ana e poshtme është e ngjashme me atë të meshkujve, me brez postdiskal të dallueshëm verdhë-kafe pa ocelë. Speciet e ngjashme janë *H. lupinus* dhe *H. lycaon*. *H. lupinus* ka madhësi të ngjashme, me njollë seksuale të madhe te meshkujt dhe ocel apikal të verbër, ndërsa femrat kanë dy ocelë subapikalë të verbër dhe zona portokalli-verdhë të kufizuara rreth tyre. *Hyponephele lycaon* është më e vogël, me njollë seksuale më të ngushtë te meshkujt dhe ocel apikal të verbër, ndërsa femrat kanë brez portokalli që përfshin ocelët dhe dy ocelë apikalë të verbër. Specia ka një brez në vit, me femra që kalojnë periudhë aestivimi, nga maji deri në shtator. Stadi i vezës zgjat 14–30 ditë, larvat dimërojnë në stade të ndryshme dhe pupacioni zgjat 14–30 ditë. *Maniola jurtina* banon në livadhe dhe kullota nga ultësira deri në 1800 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë të moderuara dhe *dendësia e popullatës shpesh është e lartë. Larvat ushqehen kryesisht me Agrostis capillaris, Alopecurus pratensis, Brachypodium pinnatum, Bromus erectus, Cynosurus cristatus, Dactylis glomerata, Festuca ovina, Festuca rubra, Holcus lanatus dhe Lolium perenne*. Fluturat e rritura ushqehen me një larmi lulesh. Në Shqipëri shumë e përhapur. Gjendet në Ballkan, Evropë, Azinë e Vogël dhe më tej drejt lindjes. LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, dhe në atë Evropiane.

***Melanargia galathea*/Marbled White**
Galatea
Nymphalidae – Satyrinae





***Melanargia galathea*, dhe harta e shpërhapjes**

Melanargia galathea është një flutur me madhësi mesatare. Gjatësia e krahut të përparmë është 23–26 mm. Ana e sipërme paraqet model karakteristik bardh e zi, me njolla dhe njësime të alternuara, pa zona bazale të errëta të shkrira. Në krahun e përparmë mungon shiriti i vetëm tërthor në qelizë dhe zona e bardhë e qelizës shtrihet vetëm në dy të tretat drejt bazës. Ana e poshtme ka ngjyrë gri-zezë me shenja të errëta, me ocelë në një brez submargjinal të ndërprerë dhe me brez diskal që zgjerohet drejt kostës. Femrat janë më të mëdha dhe kanë shenja të ngjashme me meshkujt. Ana e poshtme e femrave është e verdhë e çelur me ngjyrë bazë të verdhë-gri dhe shenja të verdha-gri; forma pa shenja, leucomelas, nuk është e rrallë. Speciet e ngjashme janë *Melanargia larissa* dhe *Melanargia russiae. Melanargia larissa* është pak më e madhe dhe ka zona bazale të errëta të shkrira, një vijë të hollë të zezë që kalon nëpër qelizë dhe brez qendror të pandërprerë në anën e poshtme. *Melanargia russiae* ka madhësi të ngjashme, pa zona bazale të errëta të shkrira, me një shirit zig-zag në qelizë dhe brez qendror të pandërprerë me vena të shënuara me të zezë. Specia ka një brez në vit, me të rritur që shfaqen nga qershori deri në gusht. Stadi i vezës zgjat 18–22 ditë, larva dimëron si larvë e vogël dhe pupacioni zgjat 16–29 ditë. *Melanargia galathea* banon në livadhe nga ultësira deri në 2000 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë të moderuara dhe dendësia e popullatës shpesh është e lartë. Larvat ushqehen kryesisht me *Brachypodium pinnatum, Brachypodium sylvaticum, Bromus erectus, Cynosurus cristatus, Festuca ovina, Festuca rubra* dhe *Phleum pratense*. Fluturat e rritura ushqehen me një larmi të madhe lulesh. Në Shqipëri specia është e përhapur në zonat malore. Shpërndahet në Ballkan dhe në pjesën më të madhe të Evropës, si dhe në Azinë e Vogël dhe rajonet lindore. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Melanargia larissa*/Balkan Marbled White**
Laramanja Larisë
Nymphalidae – Satyrinae





***Melanargia larissa*, dhe harta e shpërhapjes**

Melanargia larissa është një flutur me madhësi mesatare. Gjatësia e krahut të përparmë është 25–30 mm. Ana e sipërme ka model bardh e zi të tipit "mosaik", me njolla të zeza shpesh më të dendura dhe zona bazale të errëta të përhapura që mbulojnë qelizën. Në krahun e përparmë kalon një vijë e hollë nëpër qelizë dhe zona e errët e përhapur shpesh e fsheh ocelin paraapikal. Ana e poshtme ka ngjyrë gri deri gri-kafe, me zona bazale të errëta dhe ocelë të dukshëm në krahët e pasmë, të cilët nuk janë të futur në hapësira të errëta përreth. Femrat janë më të mëdha dhe kanë zona të verdha të çelura në pjesën apikale dhe në krahun e pasmë, ndërsa meshkujt janë më të vegjël dhe me kontrast më të fortë. Speciet e ngjashme janë *Melanargia galathea* dhe *Melanargia russiae*. Specia ka një brez në vit, me të rritur që shfaqen nga maji deri në mes të gushtit. Stadi i vezës është i shkurtër, larva kalon aestivim si e re dhe dimëron si larvë e vogël, ndërsa pupacioni është i shkurtër. *Melanargia larissa* banon në livadhe të thata dhe shkëmbore me shkurre të shpërndara nga 200 deri në 1500 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë të moderuara dhe dendësia e popullatës shpesh është e lartë. Larvat ushqehen kryesisht me *Poa annua* dhe *Poa pratensis*. Fluturat e rritura ushqehen me një larmi lulesh livadhore. Në Shqipëri specia është e përhapur në jug dhe më e lokalizuar në veri. Shpërndahet në Ballkan, Evropë dhe më tej drejt lindjes Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Melanargia russiae*/Esper's Marbled White**
Laramanja e lartësive
Nymphalidae – Satyrinae





***Melanargia russiae*, dhe harta e shpërhapjes**

Melanargia russiae është një flutur me madhësi mesatare. Gjatësia e krahut të përparmë është 25–27 mm. Ana e sipërme ka model bardh e zi me njolla të zeza të forta dhe të ndryshueshme, me një shirit zig-zag të zi që kalon nëpër qelizë dhe një njollë të çelur në fundin e qelizës. Ana e poshtme ka shenja gri të rrethuara fort me vija të zeza dhe ocelë të dukshëm që nuk janë të vendosur në hapësira të errëta përreth. Femrat janë më të mëdha dhe kanë shenja më të zgjeruara dhe më të hirtë, ndërsa meshkujt janë më të vegjël dhe me kontrast më të fortë. Speciet e ngjashme janë *Melanargia galathea* dhe *Melanargia larissa*. *Melanargia galathea* nuk ka zona bazale të errëta të përhapura dhe nuk ka vijë që kalon nëpër qelizë. Specia ka një brez në vit, me të rritur që shfaqen nga mesi i qershorit deri në mes të gushtit. Stadi i vezës është i shkurtër, larva dimëron si larvë L2 dhe pupacioni është i shkurtër. *Melanargia russiae* banon në livadhe të ngrohta malore me shkurre të shpërndara, nga 1000 deri në 1900 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë të moderuara dhe dendësia e popullatës mund të jetë e lartë. Larvat ushqehen kryesisht me *Agrostis capillaris, Briza media, Bromus erectus, Festuca ovina, Lamarckia aurea* dhe *Poa annua*. Fluturat e rritura ushqehen me një larmi lulesh të mëdha livadhore. Në Shqipëri specia është shumë e lokalizuar dhe në kufi të zonës së saj të shpërndarjes në Ballkan. Shpërndahet në Ballkan dhe më gjerë në Evropë dhe lindje. Kjo specie në Listën e Kuqe të Shqipërisë ka statusin NT, edhe në nivelin Evropian sipas IUCN-së është klasifikuar si LC.

***Minois dryas*/Dryad**
Driada
Nymphalidae – Satyrinae





***Minois dryas*, dhe harta e shpërhapjes**

Minois dryas është një flutur e madhe, me gjatësi të flatrave të përparme 27–30 mm. Meshkujt dhe femrat kanë ngjyrim bazë të errët kafe në të zezë në anën e sipërme të krahëve. Ana e sipërme e krahëve të përparmë paraqet ocelë me qendër blu në s2 dhe s5, ndërsa në krahët e pasmë ato janë rrallë të pranishme ose të reduktuara. Femrat janë më të mëdha dhe paraqesin ocelë më të theksuar me qendër blu. Ana e poshtme është kryesisht kafe e errët, me pak shenja ose pothuajse e pa shënuar, ndërsa ndonjëherë mund të shfaqet një ocel rudimentar në s2 në krahët e pasmë. Specie e ngjashme është *Satyrus ferula*, me madhësi të ngjashme, por që ndryshon nga prania e dy ocelëve me qendër të bardhë në s2 dhe s5; tek meshkujt shpesh shfaqen pika të bardha shtesë, ndërsa femrat kanë pika shtesë në brezin portokalli. Ana e poshtme e kësaj specie paraqet gjithashtu dy ocelë me qendër të bardhë dhe në disa raste një brez postdiscal të zbehtë te meshkujt. Cikli jetësor përfshin një brez të vetëm në vit, me të rritur që shfaqen nga qershori deri në gusht. Veza ka një stad të shkurtër, ndërsa larva dimëron në stad të vogël dhe pupacioni i shkurtër. Kjo specie banon në kullota me bar të lartë në zona të ngrohta me shkurre dhe pemë të shpërndara, shpesh pranë liqeneve natyrore dhe ujërave me rrjedhje të ngadaltë, në lartësi nga 200 deri në 1500 m mbi nivelin e detit. Kërkon hapësira të konsiderueshme dhe popullatat mund të jenë me densitet mesatar. Vemjet ushqehen kryesisht me barishte të familjes Poaceae, veçanërisht *Molinia caerulea* dhe *Bromus erectus*, si dhe me një numër të madh speciesh të tjera barishtore. Fluturat e rritura ushqehen me nektar nga lule të ndryshme. Në Shqipëri është e njohur vetëm nga të dhëna historike. Në Ballkan ka shpërndarje të gjerë, të fragmentuar, në Evropë dhe më gjerë shfaqet me zona. E ndjeshme ndaj ndryshimeve të habitatit. Ka status DD në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe LC në Listën e Kuqe Evropiane.

***Pararge aegeria*/Speckled Wood**
Egeria
Nymphalidae – Satyrinae





***Pararge aegeria*, dhe harta e shpërhapjes**

Pararge aegeria është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 19–22 mm. Ana e sipërme e krahëve paraqet ngjyrë të ndryshueshme nga e verdhë e zbehtë deri në fulvoze (kafe e artë), me shenja të errëta kafe. Në krahët e përparmë ka një sex-brand të gjerë dhe një ocel apikal me qendër të bardhë. Në krahët e pasmë, ana e sipërme paraqet një seri ocelësh postdiscalë të vendosur në njolla të zbehta të verdha deri në fulvoze në s2, s3, s4 dhe ndonjëherë s5. Ana e poshtme është e ngjashme me atë të sipërmen. Ana e poshtme e krahëve të pasmë ka ngjyrë të ndryshueshme të verdhë-kafe, me zonë më të errët margjinale që përfshin njolla të vogla të bardha. Femrat janë të ngjashme me meshkujt. Nuk ka specie të ngjashme. Cikli jetësor përfshin brezni të vazhdueshme nga prilli deri në nëntor. Veza zhvillohet për 5–12 ditë. Larva dimëron pjesërisht si larvë gjysmë e rritur, përndryshe ka një stad të shkurtër 17–30 ditë. Pupa gjithashtu mund të dimërojë pjesërisht për 26–31 javë, ose në kushte të tjera ka një stad të shkurtër 10–28 ditë. *Pararge aegeria* banon në vende me hije në kopshte, parqe dhe të gjitha llojet e pyjeve, nga zonat e ulëta deri në vijën e drurëve, rrallë mbi 1600 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë të vogla, ndërsa dendësia e popullatës mund të jetë e lartë. Vemjet ushqehen kryesisht me *Dactylis glomerata*, *Deschampsia cespitosa*, *Festuca gigantea*, *Melica nutans*, *Melica uniflora*, *Poa annua*, *Poa bulbosa*, *Poa nemoralis*, *Poa pratensis* dhe *Poa trivialis*, si dhe me shumë specie të tjera barishtore. Fluturat ushqehen me një shumëllojshmëri lulesh, fruta të pjekura dhe shpesh me *Rubus*. Në Shqipëri është e përhapur gjerësisht. Në Ballkan dhe Evropë ka shpërndarje të gjerë dhe në zona të përshtatshme habitatesh. Në Azi të Vogël, Lindjen e Afërt, Transkaukazi dhe më tej në lindje gjithashtu është e pranishme. Specia është vlerësuar LC si në Listën e Kuqe të Shqipërisë, ashtu edhe në atë të IUCN-së për rajonin Evropian.

***Proterebia phegea*/Dalmatian Ringlet**
Unazka dalmatiane
Nymphalidae – Satyrinae





***Proterebia phegea*, dhe harta e shpërhapjes**

Proterebia phegea është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 22–24 mm. Ana e sipërme është ngjyrë kafe. Në krahët e përparmë paraqet një apex dhe buzë të jashtme të lara në gri, me ocelë të dyfishtë të bashkuar me qendër të bardhë në s4 dhe s5, si dhe ocelë shtesë të vendosur më distalisht në s1b (ndonjëherë të dyfishtë), s2, s3 dhe s6. Në krahët e pasmë, ana e sipërme ka një seri të rregullt ocelësh me qendër të bardhë nga s1b deri në s6. Ana e poshtme e krahëve të përparmë ka një zonë diskoidale të kuqe të errët, me apex pak të hirtë, ndërsa ana e poshtme e krahëve të pasmë është ngjyrë kafe me vena më të çelura pak të dukshme. Femrat janë pak më të mëdha, me ngjyrë bazë më të çelur dhe ocelë më të theksuar, ndërsa meshkujt më të errët dhe më uniformë. Nuk ka specie të ngjashme; të gjitha i përkasin gjinisë *Erebia*, me një rresht të rregullt ocelësh të zinj me qendër të bardhë në krahët e përparmë. Cikli jetësor përfshin një brez të vetëm nga fundi i marsit deri në maj, në varësi të lartësisë. Veza ka një stad të shkurtër. Larva kalon periudhë aestivimi, rritet në vjeshtë dhe dimëron si larvë e rritur. Pupa ka një stad të shkurtër. *Proterebia phegea* banon në shpate me barishte të thata dhe shkëmbore, mbi substrat gëlqeror dhe ofiolitik, nga 250 deri në 1300 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë të vogla, ndërsa dendësia e popullatës mund të jetë mesatare. Vemjet ushqehen me *Festuca ovina*. Fluturat e rritura ushqehen me lule të disponueshme në pranverën e hershme. Në Shqipëri është regjistruar së fundmi nga Bulqiza dhe nga au-Dejës, me nevojë për kërkime të mëtejshme. Në Ballkan dhe Evropë ka shpërndarje të gjerë, por në disa zona të fragmentuar. Në Azi të Vogël, Gadishullin e Krimesë, Transkaukazi, Kaukaz dhe më tej në lindje gjithashtu është e pranishme. Kjo specie në Listën e Kuqe të Shqipërisë ka statusin NE, edhe në nivelin Evropian është klasifikuar si LC.

***Pseudochazara amalthea*/White-banded Grayling**
Antela
Nymphalidae – Satyrinae





***Pseudochazara amalthea*, dhe harta e shpërhapjes**

Pseudochazara amalthea është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 23–25 mm. Ana e sipërme është ngjyrë kafe. Paraqet një brez postdiscal të bardhë të parregullt. Në krahët e përparmë ka një sex-brand të dukshëm dhe ocelë "të verbër" në s2 dhe s5 (shpesh të verbër). Ana e sipërme e krahëve të pasmë ka një sufuzion fulvoz në pjesën distale të brezit të bardhë postdiscal dhe një ocel të vogël me qendër të bardhë në këndin anal. Ana e poshtme e krahëve të përparmë është gri-kafe e zbehtë me model mermeror. Ana e poshtme e krahëve të përparmë ka ocelë më të mëdhenj dhe shpesh me qendër të bardhë. Ana e poshtme e krahëve të pasmë ka brez të bardhë postdiscal dhe një ocel të vogël me qendër të bardhë në këndin anal. Femrat janë më të mëdha dhe ana e poshtme ka ngjyrë më të zbehtë, me brez postdiscal të bardhë të reduktuar. Nuk ka specie të ngjashme (për krahasim të shpejtë, figurat e *P. amymone* bazohen në ekzemplarë të vjetër). Cikli jetësor përfshin një brez të vetëm nga qershori deri në shtator; femrat kalojnë aestivim. Veza ka një stad të shkurtër. Larva dimëron. Pupa ka një stad të shkurtër. *Pseudochazara amalthea* banon në shpate të thata dhe të nxehta shkëmbore me barishte të rralla (gëlqeror dhe ofiolitik), nga 400 deri në 1800 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë mesatare, ndërsa dendësia e popullatës mund të jetë mesatare. Vemjet ushqehen me *Festuca* sp. Fluturat ushqehen me lule të disponueshme. Në Shqipëri është lokale në jug të vendit, me nevojë për kërkime të mëtejshme. Në Ballkan dhe Evropë ka shpërndarje të gjerë. Në ishujt grekë pranë Turqisë dhe në Azi të Vogël gjendet një specie motër, *Pseudochazara anthelea*. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet si VU, ndërsa në Listën e Kuqe të IUCN-së në nivel Mesdhetar, klasifikohet si NT B2c(iv).

***Pseudochazara amymone*/Brown's Grayling**
Aminonia
Nymphalidae – Satyrinae





***Pseudochazara amymone*, dhe harta e shpërhapjes**

Pseudochazara amymone flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 22–25 mm te meshkujt dhe 24–27 mm te femrat. Ana e sipërme është kafe e errët. Te meshkujt, krahët e përparmë kanë një brez të gjerë postdiscal gri-kafe, që çelet gjatë periudhës së fluturimit, me dy ocelë të zinj në S2 dhe S5 dhe, ndonjëherë, dy ocelë shumë të vegjël ose pika të bardha në S3 dhe S4. Në qelizë ndodhet një sex-brand i theksuar. Krahu i pasmë ka një ocel në S2, të vendosur në një brez të gjerë portokalli, ndërsa ana e poshtme ndryshon nga gri e bardhë në kafe-portokalli. Femrat kanë brez postdiscal zakonisht portokalli, me dy ocelë të zinj me pupilë të bardhë dhe shpesh dy ocelë të vegjël në S3 dhe S4. Specia e ngjashme *P. tisiphone* dallohet nga vija submarginale difuze në anën e poshtme të krahëve, mungesa e shenjave lineare të zeza në zonën bazale, pozicioni i ndryshëm i sex-brand-it dhe prania e dy ocelëve në brezin submarginal te meshkujt. Specia ka një brez të vetëm. Veza vendoset pak pas çiftëzimit, larva dimëron në stadin L1 dhe pupa zgjat mbi 30 ditë në kushte mbarështimi. *P. amymone* banon në shpate shumë të pjerrëta shkëmbore, me zhavorr të lirshëm dhe substrat ofiolitik të kuq-gri, me barishte dhe shkurre të shpërndara dhe zona pothuajse pa vegjetacion. Meshkujt shpesh fluturojnë në shpate të pjerrëta veriore dhe luftojnë në majat e kodrave gjatë ditëve shumë të nxehta. Specia ka kërkesa të ulëta hapësinore dhe është shumë lokale, megjithëse dendësia e popullatës mund të jetë e lartë. Popullatat mund të gjenden brenda popullatave më të gjera të *P. tisiphone*, ndërsa disa individë shpërndahen në fund të periudhës së fluturimit. Vemjet ushqehen në natyrë me Poaceae, ndërsa në kushte mbarështimi me *Festuca ovina* dhe *Dactylis glomerata*. Të rriturit ushqehen rrallë me lule, por janë vërejtur në *Acontholimon, Scabiosa* dhe *Centaurea* sp.; mudpuddling është raportuar te të dyja gjinitë.Në Shqipëri, shumë lokale, në Ballkan ka shpërndarje më të gjerë. Në Azinë e Vogël, Lindjen e Afërt, Kaukaz dhe më tej në lindje gjendet specia motër *P. mamurra*. Specia klasifikohet VU në Listën e Kuqe të Shqipërisë dhe EN B1ab(ii,iii,iv,v)+B2ab(ii,iii,iv,v) në Listën e Kuqe të IUCN-së.

***Pseudochazara geyeri*/Grey Asian Grayling**
Flutura e Geyerit
Nymphalidae – Satyrinae





***Pseudochazara geyeri*, dhe harta e shpërhapjes**

Pseudochazara geyeri është një flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme rreth 24 mm. Ana e sipërme është ngjyrë gri e verdhë, me shenja pak më të errëta në bazë dhe në zonën submargjinale. Në krahët e përparmë paraqiten dy ocelë me qendër të bardhë në s2 dhe s5. Ana e poshtme e krahëve të përparmë është e verdhë, me shenja të theksuara të zeza dhe ocelë më të mëdhenj me qendër të bardhë. Ana e poshtme e krahëve të pasmë është gri e verdhë më e çelur, me brez postdiscal të bardhë dhe chevron-e kafe në formë sagittate në zonën submargjinale. Femrat janë pak më të mëdha, me ngjyrë më të çelur dhe shenja e ocelë më të dukshëm (ndonjëherë të verbër). Ana e poshtme e femrave është krem e zbehtë me shenja të forta dhe dy ocelë të mirëpërcaktuar (rrallë të verbër). Nuk jepen specie të ngjashme për krahasim të shpejtë. Cikli jetësor përfshin një brez të vetëm nga fundi i korrikut deri në fund të gushtit. Veza ka ndoshta një stad të shkurtër. Larva ndoshta dimëron si larvë e vogël. Pupa ndoshta ka një stad të shkurtër. *Pseudochazara geyeri* banon në shpate të thata dhe të nxehta shkëmbore me barishte të rralla, nga 1300 deri në 1900 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë mesatare, ndërsa dendësia e popullatës mund të jetë mesatare. Vemjet ushqehen me *Festuca ovina*. Fluturat ushqehen me lule të disponueshme. Në Shqipëri është e njohur vetëm nga të dhëna të vjetra, shumë lokale në juglindje, me nevojë për kërkime të mëtejshme. Në Ballkan dhe Evropë ka shpërndarje të gjerë. Në Azi të Vogël, Transkaukazi dhe më tej në lindje gjithashtu është e pranishme. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet si NT dhe në Listën e Kuqe të IUCN-së në nivel Evropian si EN B1a(iii,v)+ B2ab(iii,v).

***Pseudochazara tisiphone*/Dark Grayling**
Tisifonia
Nymphalidae – Satyrinae





***Pseudochazara tisiphone*, dhe harta e shpërhapjes**

Pseudochazara tisiphone flutur me madhësi mesatare, me gjatësi të flatrave të përparme 25–28 mm. Ana e sipërme është ngjyrë kafe. Në krahët e përparmë ndodhet sex-brand jashtë qelizës, me dy ocelë me qendër të bardhë në s2 dhe s5, si dhe pika të bardha në s3 dhe s4. Në krahët e pasmë ka dy ocelë të vegjël, të rrethuar në mënyrë të paqartë me të zezë, të vendosur në një brez submargjinal portokalli. Ana e poshtme e krahëve të përparmë paraqet një vijë submargjinale të difuzuar, pa shenja lineare të zeza në zonën bazale, me një zonë të madhe portokalli të zbehtë, me ocelë pak më të mëdhenj me qendër të bardhë në s2 dhe s5 dhe pika më të mëdha të bardha në s3 dhe s4. Ana e poshtme e krahëve të pasmë është kafe e zbehtë e lara, me shenja rrallë vestigiale. Femrat janë më të mëdha, me ngjyrë bazë pak më të çelur dhe me ocelë pak më të fortë; brezi portokalli postdiscal është pak më i madh, përndryshe i ngjashëm me meshkujt. Specie e ngjashme është *Pseudochazara amymone*, Cikli jetësor përfshin një brez të vetëm nga fundi i qershorit deri në gusht. Veza ka ndoshta një stad të shkurtër. Larva dimëron. Pupa ka ndoshta një stad të shkurtër. *Pseudochazara tisiphone* banon në pllaja shkëmbore dhe shpate shkëmbore në substrat ofiolitik, me zhavorr të lirshëm dhe barishte të shpërndara, nga 1000 deri në 1700 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë mesatare, ndërsa dendësia e popullatës mund të jetë e lartë. Vemjet ushqehen me *Festuca ovina*. Fluturat ushqehen me lule të disponueshme. Në Shqipëri është lokale në juglindje dhe ka një popullatë të izoluar pranë Bulqizës, me nevojë për kërkime të mëtejshme. Në Ballkan dhe Evropë ka shpërndarje të gjerë. Në Azi të Vogël (e pa verifikuar) dhe më tej në lindje gjendet një specie motër, *Pseudochazara mniszechii*. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë klasifikohet në kategorinë VU, ndërsa në Listën e Kuqe të IUCN-së në nivel Evropian renditet në kategorinë NT B2a.

***Pyronia cecilia*/Southern Gatekeeper**
Çeçilja
Nymphalidae – Satyrinae





***Pyronia cecilia*, dhe harta e shpërhapjes**

Pyronia cecilia është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme 15–16 mm. Ana e sipërme është ngjyrë fulvoze (kafe-portokalli), me kosto më të errët kafe dhe një brez marginal të gjerë kafe të errët. Në krahët e përparmë paraqitet një sex-brand katërkëndor i ndërprerë nga venat portokalli dhe një ocel apikal i dyfishtë me qendër të bardhë. Ana e poshtme e krahëve të përparmë është portokalli me ocel apikal të dyfishtë me qendër të bardhë. Ana e poshtme e krahëve të pasmë është gri e lehtë e lara, pa pika të bardha. Femrat janë pak më të mëdha. Specie e ngjashme është *Pyronia tithonus*, e cila është pak më e madhe ose e ngjashme në madhësi; meshkujt kanë sex-brand më pak të ndërprerë nga venat portokalli dhe më pak të zhvilluar, pa sex-brand në qelizë; krahët e përparmë mund të kenë ocel në brezin portokalli (jo gjithmonë) dhe zonë bazale më të errët; ana e poshtme është kafe me pika të vogla të bardha. Cikli jetësor përfshin një brez të vetëm nga fundi i qershorit deri në gusht. Veza ka një stad të shkurtër. Larva dimëron si larvë e vogël. Pupa ka një stad të shkurtër. *Pyronia cecilia* banon në livadhe të thata me barishte të rralla dhe shkurre të shpërndara në zona të ngrohta, nga ultësira deri në 700 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë të vogla, ndërsa dendësia e popullatës mund të jetë e lartë. Vemjet ushqehen kryesisht me *Deschampsia caespitosa*, *Poa annua* dhe *Poa nemoralis*, si dhe me specie të tjera barishtore. Fluturat ushqehen me një shumëllojshmëri të madhe lulesh. Në Shqipëri është lokale dhe kërkon studime të mëtejshme. Në Ballkan dhe Evropë ka shpërndarje të gjerë. Në Azi të Vogël gjithashtu është e pranishme. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë: NE. Në Listën e Kuqe të IUCN-së në nivel Mesdhetar: LC.

***Pyronia tithonus*/Gatekeeper**
Titonja
Nymphalidae – Satyrinae





***Pyronia tithonus*, dhe harta e shpërhapjes**

Pyronia tithonus është një flutur e vogël, me gjatësi të flatrave të përparme 17–19 mm. Ana e sipërme është ngjyrë fulvoze (kafe-portokalli), me kosto më të errët kafe dhe një brez marginal të gjerë kafe të errët. Në krahët e përparmë paraqitet një sex-brand i dukshëm, pak i ndërprerë nga venat portokalli, dhe një ocel apikal i dyfishtë shpesh me qendër të bardhë. Ana e poshtme e krahëve të përparmë është portokalli me ocel apikal të dyfishtë me qendër të bardhë. Ana e poshtme e krahëve të pasmë është kafe, me njolla të vogla të bardha të vendosura brenda nuancave verdhë-kafe. Femrat janë pak më të mëdha dhe pak më të zbehta. Specie e ngjashme është *Pyronia cecilia*, e cila është pak më e vogël ose e ngjashme në madhësi; meshkujt kanë sex-brand drejtkëndor, më të ndërprerë nga venat portokalli dhe të vendosur në qelizë; krahët e përparmë zakonisht pa ocel në brezin portokalli dhe me zonë bazale portokalli; ana e poshtme është gri e lehtë e lara dhe pa pika të bardha. Cikli jetësor përfshin një brez të vetëm nga fillimi i korrikut deri në fund të gushtit. Veza zhvillohet për 14–22 ditë. Larva dimëron si larvë L2 ose L3. Pupa zgjat 16–21 ditë. *Pyronia tithonus* banon në livadhe të ngrohta të mbingarkuara me bar, me shkurre të shpërndara dhe *Rubus*, nga ultësira deri në 1300 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë të vogla, ndërsa dendësia e popullatës mund të jetë e lartë. Vemjet ushqehen kryesisht me shumë specie të Poaceae, përfshirë *Agrostis*, *Alopecurus*, *Brachypodium*, *Cynosurus*, *Dactylis*, *Deschampsia*, *Festuca*, *Phleum*, *Poa* dhe të tjera. Fluturat ushqehen me një shumëllojshmëri lulesh dhe shpesh grumbullohen mbi *Rubus*. Në Shqipëri është lokale. Në Ballkan dhe Evropë ka shpërndarje të gjerë, ndërsa në Azi të Vogël gjithashtu është e pranishme. Në Listën e Kuqe të Shqipërisë: NE. Në Listën e Kuqe të IUCN-së në nivel Mesdhetar: LC.

***Satyrus ferula*/Great Sooty Satyr**
Ferulja
Nymphalidae – Satyrinae





***Satyrus ferula*, dhe harta e shpërhapjes**

Satyrus ferula është një flutur me madhësi mesatare deri të madhe, me gjatësi të flatrave të përparme 25–30 mm. Ana e sipërme është ngjyrë kafe e errët deri në të zezë. Në krahët e përparmë ka ocelë me qendër të bardhë në s2 dhe s5, si dhe shpesh pika të vogla të bardha në s3 dhe s4. Femrat janë më të mëdha dhe me ngjyrë më të çelur, ndërsa meshkujt më të errët. Ana e poshtme është më e çelur, me brez postdiscal më të zbehtë. Specie e ngjashme është *Minois dryas*, e cila dallohet nga prania e ocelëve me qendër blu në s2 dhe s5; mungesa ose prania e dobët e ocelëve në s3 dhe s4 te meshkujt; mungesa e brezit portokalli te femrat; margjina më e valëzuar; dhe model më uniform në anën e poshtme. Cikli jetësor përfshin një brez të vetëm nga mesi i qershorit deri në fund të gushtit. Veza ka një stad të shkurtër. Larva dimëron si larvë e vogël. Pupa ka një stad të shkurtër. *Satyrus ferula* banon në livadhe të hapura dhe të thata shkëmbore nga 400 deri në 1800 m mbi nivelin e detit. Kërkesat hapësinore janë mesatare, ndërsa dendësia e popullatës shpesh është e lartë. Vemjet ushqehen kryesisht me *Festuca ovina* dhe *Bromus erectus*, si dhe me disa specie të tjera barishtore. Fluturat ushqehen me një shumëllojshmëri lulesh. Në Shqipëri është e përhapur në zonat malore. Në Ballkan dhe Evropë ka shpërndarje të gjerë, ndërsa në Azi të Vogël dhe Kaukaz gjithashtu është e pranishme. Kjo specie në Listën e Kuqe të Shqipërisë ka statusin NE, edhe në nivelin Evropian sipas IUCN-së është klasifikuar si LC.

Në vend të pasthënies

Ky libër solli ndër faqet e tij kontributin e shumë njerëzve të apasionuar, të cilët u janë përkushtuar këtyre insekteve magjike, jo vetëm për t'i njohur, por edhe për t'i mbrojtur e ruajtur, që e nesërmja t'i gjejë ende pjesë të natyrës dhe të pasurisë së saj.

Ai u bazua në informacionin e mbledhur me kujdes dhe të prezantuar në faqen web të Universitetit të Tiranës **"Fluturat e Shqipërisë"**, nën kujdesin e autorëve **Sylvain Cuvelier dhe Anila Paparisto**.

Përmbajtja e tij u përpunua dhe u përgatit me përkushtim, nën kujdesin e **Prof. Dr. Anila Paparisto**, me kontributin e **Dr. Xhuliana Qirinxhi, Prof. Asoc. Dr. Eltjon Halimi**, dhe anëtareve të projektit, në kuadrin e Projekteve PKKZH 2024 të Agjensisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

Grafika e këtij libri është përgatitur nga **Dea Ektori**, ndërsa hartat janë përgatitur nga **Sylvain Cuvelier**.

Urojmë që udhëtimi juaj mes faqeve të këtij libri të ketë qenë i ndjerë dhe t'ju ketë sjellë sadopak nga ai pasion dhe ajo dashuri për fluturat që autorët e këtij libri kanë për to.



"Fluturat e Shqipërisë" *është më shumë se një monografi shkencore: është një vepër ku dija, pasioni dhe dashuria për natyrën takohen për të ruajtur kujtesën e biodiversitetit shqiptar. Për Departamentin e Biologjisë të Universitetit të Tiranës, ajo është një hallkë e çmuar në traditën e gjatë të studimit të natyrës dhe një* ***in memoriam*** *i denjë për* ***Prof. Dr. Kastriot Misjen****, i cili ia kushtoi një jetë studimit të fluturave dhe la pas jo vetëm dije, por edhe një gjurmë të pashlyeshme në shkencën shqiptare.* ***Shkenca nuk fillon nga e para me çdo brez; ajo kujton, trashëgon, ndërton dhe fluturon më tej.*** *Mirënjohje autorëve dhe, në mënyrë të veçantë,* ***Dr. Sylvain Cuvelier****, për përkushtimin dhe kontributin e tij të jashtëzakonshëm në njohjen, dokumentimin dhe ruajtjen e kësaj pasurie të natyrës shqiptare.* ***Një vepër që i jep kujtesë shkencore bukurisë së natyrës dhe i jep asaj një të ardhme.***

Prof. Dr. Valbona Aliko; *Përgjegjëse e Departamentit të Biologjisë Fakulteti i Shkencave të Natyrës – Universiteti i Tiranës*

"Fluturat e Shqipërisë" *përbën një kontribut të rëndësishëm shkencor dhe dokumentues për njohjen e biodiversitetit të vendit. Botimi ndërthur në mënyrë të qartë informacionin taksonomik dhe ekologjik me të dhëna mbi shpërndarjen gjeografike dhe statusin e ruajtjes së specieve, të mbështetura edhe nga një paraqitje e pasur vizuale dhe harta të shpërndarjes. Veçanërisht me vlerë është përmbledhja dhe përditësimi i njohurive për 209 llojet e fluturave të ditës të regjistruara në Shqipëri, si dhe evidentimi i nevojës për monitorim të vazhdueshëm të biodiversitetit.*
Monografia ka gjithashtu vlerë praktike, pasi informacioni mbi habitatet, kërkesat ekologjike dhe statusin e ruajtjes mund të shërbejë si bazë për studime të mëtejshme dhe për hartimin e masave të mbrojtjes dhe konservimit. Integrimi i të dhënave historike, monitorimeve në terren dhe teknologjive dixhitale e bën botimin një material të dobishëm si për komunitetin shkencor, ashtu edhe për studentët, specialistët e mjedisit dhe publikun e interesuar për natyrën shqiptare.

Prof. Dr. Julian Shehu; *Përgjegjës i Departamentit QKFF; Fakulteti i Shkencave të Natyrës – Universiteti i Tiranës*